




**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE
DHE BALLKANIKE**

**KATEGORIZIMI GJUHËSOR I IDESË SË KOHËS
NË SISTEMIN FOLJOR TË GJUHËS SHQIPE,
KRAHASUAR ME GJUHËN RUSE**

**PUNIM PËR GRADËN SHKENCORE “DOKTOR”
NË GJUHËSI**



**DOKTORANTE
ALMA PINARI (KALLARI)**

**UDHËHEQËS SHKENCOR
PROF.DR. AVNI XHELILI**

Tiranë, 2014

PUNIM

i përgatitur nga

Alma Pinari (Kallari)

**PËR GRADËN SHKENCORE “DOKTOR”
NË GJUHËSI**

**KATEGORIZIMI GJUHËSOR I IDESË SË KOHËS
NË SISTEMIN FOLJOR TË GJUHËS SHQIPE,
KRAHASUAR ME GJUHËN RUSE**

Udhëheqës shkencor
Prof. dr. Avni Xhelili

Mbrohet më, __. __. 2014 para jurisë:

Prof. Dr. Klodeta Dibra Kryetar

Prof. Dr. Ethem Lika Anëtar (Oponent)

Prof. As. Dr. Xhemile Zykaj..... Anëtar (Oponent)

Prof. Dr. Ilo Stefanllari Anëtar

Prof. As. Dr. Elida Tabaku Anëtar

“...Mírënjohja dhe falënderimi do ta udhëheqin mendjen tënde kah rrugët nëpër të cilat vijnë gjërat; do të të mbajnë ty në harmoni të afërt me mendimin krijues dhe do të të parandalojnë të mos biesh në mendimin garues...”.

Në përfundim të këtij punimi , shpreh mírënjohjen dhe falënderimin tím për të gjithë ata profesorë që më kanë ndihmuar me idetë dhe përvojën e tyre akademike, veçanërisht për udhëheqësin shkencor të këtij punimi Prof.dr. Avni Xhelilin.

Falënderoj të gjithë kolegët e departamentit për ndihmën, sugjerimet dhe mbështetjen e tyre.

Nuk harroj për asnjë moment rolin e familjes sime në çdo iniciativë time.

Motivimit tím të përhershëm ...Amanta ...!

PASQYRA E LËNDËS

HYRJE.....i

KREU I

QASJA SEMANTIKE FUNKSIONALE NË STUDIMIN E KATEGORIVE GJUHËSORE

1.1. Përshkrimi strukturor formal dhe funksional i gjuhës.....	1
1.2. Kategoritë semantike funksionale.....	4
1.3. Fusha semantike funksionale.....	9
1.4. Fusha semantike funksionale dhe kategoria gramatikore.....	13
Përfundime për kreun I.....	13

KREU II

SEMANTIKA E ASPEKTIT DHE ASPEKTUALITETI

2.1. Disa fjalë rreth studimeve aspektologjike.....	15
2.2. Aspektualiteti si koncept dhe kategori semantike funksionale.....	17
2.3. Fusha semantike funksionale e aspektualitetit dhe komponentët e saj përbërës.....	20
2.3.1. Kategoria gramatikore e aspektit foljor në gjuhën ruse.....	24
2.3.1.1. Rreth semantikës gramatikore të kundërvënies <i>aspekt i kryer/aspekt i pakryer</i>	27
2.3.1.2. Mekanizmi i formimit të aspekteve dhe çiftet aspektore.....	34
2.3.2. Rreth studimit të dukurive aspektuale në gjuhën shqipe.....	37
2.4. Tipologjia e situatave të përdorimit të aspekteve dhe disa veçori të përkthimit të tyre në gjuhën shqipe.....	42
2.4.1. Tipat e situatave aspektuale.....	44
2.4.1.1. Tipat e përdorimit të aspektit të pakryer.....	44
2.4.1.2. Tipat e përdorimit të aspektit të kryer.....	49
2.5. Realizimet semantike të aoristit, perfektit dhe imperfektit në gjuhën ruse	51

2.5.1. E shkuara e aspektit të kryer në kuptimin e aoristit.....	52
2.5.2. E shkuara e aspektit të kryer në kuptimin e perfektit.....	54
2.5.3. E shkuara e aspektit të kryer në kuptimin e pluskuamperfektit	57
2.6. Veçori të përkthimit të foljeve të aspektit të kryer në përdorimin <i>perfektor dhe aoristik të tyre (Analizë statistikore)</i>	58
2.6.1. E shkuara e aspekti të kryer në kuptimin e perfektit.....	59
2.6.2. Përdorimi i formave të aspektit të kryer në kuptimin e pluskuamperfektit	61
2.6.3. Përdorimi i formave të aspektit të kryer në kuptimin e aoristit.....	64
2.7. Limitativiteti si komponent semantik aspektual.....	67
2.8. Mënyrat e veprimit si komponent aspektual.....	71
2.8.1. Semantika e mënyrave të veprimit në gjuhën ruse dhe veçoritë e funksionimit të tyre në përkthimet shqip.....	81
1. Mënyra e fillimit të veprimit.....	82
2. Mënyra delimitative e veprimit.....	86
3. Mënyra perdurative e veprimit.....	87
4. Mënyra çastore e veprimit.....	89
5. Mënyra e përsëritjes së e veprimit (mënyra iterative).....	90
6. Mënyra e përshkallëzimit sasior dhe e uljes së intensitetit të një veprimi	91
Përfundime për kreun II.....	93

KREU III

SEMANTIKA E KOHËS DHE TEMPORALITETI

3.1. Kategoria e kohës: aspekti filozofik.....	94
3.2. Kategoria e kohës: aspekti lingvistik.....	97

3.3. Temporaliteti si kategori semantike funksionale.....	99
3.3.1. Temporaliteti jofoljor.....	101
3.3.2. Temporaliteti foljor: kategoria gramatikore e kohës.....	103
3.3.2.1. Deiksisi kohor.....	104
3.3.2.2. Çasti i ligjërit si pikë e orientimit temporal.....	106
3.4. Interpretimi i potencialit semantik të formave kohore të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe.....	111
3.4.1. Koha e tashme.....	111
3.4.1.1. E tashmja sintetike.....	114
3.4.1.2. E tashmja analitike.....	118
3.4.1.3. Interpretimi i idesë së kohës të format e së tashmes.....	121
3.4.2. Koha e shkuar.....	123
3.4.2.1. E pakryera.....	124
3.4.2.2. E kryera e thjeshtë.....	129
3.4.2.3. E kryera.....	136
3.4.3. Koha e ardhme.....	146
3.4.3.1. E ardhmja.....	147
3.4.3.2. E ardhmja e përparme.....	150
Përfundime për kreun III.....	152
KREU IV	
KATEGORIA E TAKSISËS	
4.1. Statusi konceptual dhe kategorial i taksisë.....	154
4.2. Shprehja e semantikës taksisë në gjuhën shqipe.....	157
4.2.1 Marrëdhëniet taksisë të parakohësisë.....	159

4.2.1.1. E ardhmja e përparme të së shkuarës.....	162
4.2.2. Marrëdhëniet taksisore të paskohësisë.....	162
Përfundime për kreun IV.....	164
PËRFUNDIME TË PËRGJITHSHME.....	165
BIBLIOGRAFIA.....	172

HYRJE

Nëpërmjet gjuhës në vetëdijën e bartësve të saj pasqyrohen dukuri a procese të botës materiale, të cilat s'mund të perceptohen ndryshe, veçse në unitet me kategoritë e kohës dhe hapësirës. Këto dy koncepte universale të lidhura midis tyre formojnë një "rrjet koordinatash", përmes të cilit individët e cilësdo kulturë pasqyrojnë realitetin që i rrethon dhe krijojnë një lloj modeli të tyre të botës. Njerëzit nuk lindin me ndjenjën e kohës a të hapësirës, ato fitohen dhe mbajnë vulën e kulturës, së cilës ata i përkasin.

Në një gjuhë mund të gjejmë disa modele kohore që kushtëzohen jo vetëm nga përvoja kulturore njohëse e bartësve të saj, por edhe nga karakteristikat e vetë gjuhës, e cila funksionon në ligjërim. I përcjellë me anë të gjuhës, ligjërimi, ashtu si edhe realiteti jashtëgjuhësor, ekziston në kohë. Pikërisht për të shprehur aspektin temporal të këtij realiteti gjuha zotëron një repertor të pasur mjetesh të brendshme, të cilat variojnë nga njëra gjuhë në tjetrën.

Problematika e modeleve gjuhësore të nominimeve kohore ka tërhequr vëmendjen e studiuesve, numri i të cilëve ka ardhur duke u rritur dhjetëvjeçarët e fundit. Në gjuhësinë bashkëkohore kategorizimi dhe interpretimi gjuhësor i idesë së kohës vazhdon të mbetet drejtim me interes shkencor. Ideja e kohës vështrohet në gjuhësi si një makrosistem i gjerë që përmbledh sisteme të veçanta, të cilat pasqyrojnë anë të ndryshme të nocionit KOHË, në kuptimin më të gjerë të kësaj fjale.

Në shkencën gjuhësore studimi i problemit të kohës ka filluar me përshkrimin e sistemit të formave kohore, të cilat luajnë një rol të veçantë në interpretimin gjuhësor të idesë së kohës, për faktin se shprehin veprime (ngjarje) që zhvillohen në kohë.

Marrëdhëniet kohore gjejnë pasqyrim në semantikën e njësisve gjuhësore në rrafshin leksikor dhe gramatikor. Ndryshe nga mjetet leksikore, format gramatikore nuk emërtojnë këtë apo atë segment konkret kohe, por shprehin marrëdhënie kohore më të përgjithshme, abstrakte.

Rreth kuptimit dhe interpretimit të kategorisë së kohës gjuhëtarët kanë pikëpamje të ndryshme, megjithatë këndvështrimet e tyre konvergojnë në një pikë. Çdo gjuhë, në një mënyrë a një tjetër, është e pajisur me mjete që shprehin:

- a) marrëdhëniet e veprimit foljor me çastin e ligjërimin;
- b) marrëdhëniet midis vetë veprimeve;

c) mënyrën e paraqitjes së zhvillimit të veprimit në kohë;

Të trija semantikët e përmendura kanë në themel të tyre idenë e kohës, por secila prej tyre qëndron në rrafsh të ndryshme gjuhësore. Marrëdhëniet e veprimit foljor me çastin e ligjërimin gjejnë pasqyrim në kategorinë semantike të temporalitetit, marrëdhëniet kohore midis veprimeve përbëjnë kategorinë semantike të taksisë, ndërsa mënyrat e paraqitjes së zhvillimit të veprimeve në kohë i përkasin kategorisë semantike të aspektualitetit¹.

Mendohet se shprehja e marrëdhënieve temporale, aspektuale dhe ato të taksisë² është karakteristike për të gjitha gjuhët, por mjetet e tyre janë idioetnike. Universaliteti i këtyre marrëdhënieve shërben si bazë për të ndërmarrë studime në rrafshin kontrastiv.

Kategoritë semantike të temporalitetit, aspektualitetit dhe taksisë të gjuhës shqipe janë ballafaquar me kategoritë përkatëse në gjuhën ruse. Është e kuptueshme që shqipja dhe rusishtja, si dy gjuhë tipologjiksht të largëta, të kenë veçoritë e tyre në përthyerjen e idesë së kohës. Të dyja ato karakterizohen nga kategoria gramatikore e kohës që përbën komponentin më të abstraktuar të semantikës temporale, por nëse sistemi kohor i rusishtes gjatë zhvillimit historik të kësaj gjuhe është thjeshtëzuar në pesë forma (tri për aspektin e pakryer dhe dy për aspektin e kryer), koha e foljes në gjuhën shqipe paraqitet me një numër shumë më të madh formash. Ndryshe nga rusishtja, shqipja është gjuhë me disa forma perfekte. Disa prej trajtave perfekte (kohët relative) shërbejnë si mjet formal për shprehjen e semantikës së taksisë. Ndërkohë, rusishtja ka shumë të zhvilluar kategorinë gramatikore të aspektit foljor, e cila përbën komponentin më të rëndësishëm të semantikës aspektuale në të. Këto dallime flasin për rrugët e ndryshme që kanë ndjekur këto dy gjuhë a kultura në përthyerjen gjuhësore të idesë së kohës dhe krijimin e modelit kohor të tyre.

Analiza dhe përshkrimi i kategorive semantike të temporalitetit, taksisë dhe aspektualitetit, që pasqyrojnë anë të ndryshme të idesë së kohës, janë mbështetur kryesisht në parimet e gramatikës funksionale. Gramatika funksionale, ndryshe nga gramatika tradicionale, bën objekt studimi jo vetëm mjetet gramatikore të shprehjes së kategorive semantike të mësipërme, por edhe bashkëveprimin e tyre me mjetet leksikore dhe kontekstuale.

Kategoritë semantike funksionale përfaqësojnë fusha (zona) të tëra semantike. Ato ngërthejnë kuptime leksikore, gramatikore, fjalëformuese a kombinime të tyre, të cilat kanë korrelacion të përbashkët nocionor. E thënë ndryshe, fushat integrojnë mjete të ndryshme gjuhësore (morfologjike, sintaksore, leksikore, leksiko-gramatikore), të cilat ndërveprojnë mbi bazën e të njëjtit funksion semantik.

¹ Termit temporal/temporalitet, aspektual/aspektualitet janë krijuar sipas modelit të përhapur në gjuhësi modal/modalitet.

² Termit taksisë, është huazuar nga greqishtja (taxis – rend, vendosje, pozicion) është futur vonë në gjuhësi nga R. Jakobsoni.

Parimi semantik i përshkrimit të njëjive gjuhësore ndryshon nga përshkrimi tradicional, i cili nisët nga forma gramatikore për të arritur të kuptimet e saj. Kur lexon, p.sh., kuptimet e kohës së shkuar në gramatikat teorike të shqipes, krijohet përshtypja sikur kemi të bëjmë me kohë të pakryer, me kohë të kryer, me kohë më se të kryer etj. Në të vërtetë veprimi mund të jetë i kryer (i përfunduar) ose i pakryer (i papërfunduar), por jo koha. Kjo e fundit (koha gramatikore) është ose kohë e tashme, ose kohë e shkuar, ose kohë e ardhme.

Format kohore (e tashmja, e shkuara, e ardhmja) mund të interpretohen si të tilla vetëm në lidhje me pyetjen **kur?** (kthehej kur? – çdo mbrëmje; u kthye kur? – në mbrëmje; është kthyer kur? – sot). Në këto raste mund të pohohet se format e mësipërme i përkasin kohës së shkuar, e cila është semantike e mirëfilltë temporale.

Por nëse folësit ose shkruarit nuk do t'i interesonte vetëm koha e kryerjes së veprimit, por edhe mënyra si është zhvilluar procesi (veprimi), atëherë kuptimet e tjera që i mbivendosen formës kohore në një kontekst a situatë të caktuar ligjërimore nuk mund të vështrohen si kuptime të dyta apo përdorime stilistike të njëjës apo tjetrës formë, sikurse interpretohen në mjaft raste nëpër gramatikat normative. Karakteristikat e ndryshme të veprimit foljor që nuk i referohen çastit të ligjërimin s'mund të kategorizohen si semantike temporale. Mënyra e paraqitjes së zhvillimit (rrjedhës) së veprimit apo e shpërndarjes së tij në kohë është semantike aspektuale, e cila qëndron në një rrafsh tjetër gjuhësor nga semantika temporale.

Nga ana tjetër, duhet bërë dallimi midis kuptimit kohor që ka si qëndër deiktike çastin e ligjërimin dhe kohës së veprimit që kryhet **para** ose **pas** një veprimi tjetër. Çështja shtrihet kështu: a përbën të njëjtën kategori morfologjike (të kohës) rasti, kur koha e veprimit përcaktohet në lidhje me çastin e ligjërimin (kohët absolute) dhe rasti, kur përcaktimi i kohës së veprimit kushtëzohet nga koha e një veprimi tjetër (kohët relative). Në punim bëhen përpjekje për të provuar se format e kohëve relative dhe disa forma të së ardhmes në gjuhën shqipe përbëjnë një kategori tjetër, e cila në gjuhësi njihet si kategoria e taksisës (greqisht: taxis – vendosje, renditje).

Statusi gjuhësor i disa formave foljore në gjuhën shqipe vazhdon të mbetet një çështje e hapur, e diskutueshme. Ndër to mund të përmendim interpretimin jobindës të kundërvënive “e kryer e thjeshtë/e pakryer”, “kohë relative/kohë absolute” etj..

Përmes këndvështrimit semantik funksional është synuar të analizohet organizimi i semantikës morfologjike dhe sintagmatike të trajtave foljore të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe, aspekte të veçanta të të cilit, sipas nesh, nuk kanë gjetur zgjidhje të kënaqshme.

Një studim i tillë në rrafshin semantik funksional ndërmerret për herë të parë në gjuhën shqipe. Dukuritë gjuhësore të temporalitetit, aktualitetit dhe taksisës në gjuhën shqipe janë krahasuar me rusishten. Mbi bazën e fakteve gjuhësore janë bërë përpjekje për të nxjerrë në pah përkimet dhe dallimet në planin e përmbajtjes dhe shprehjes së kategorive semantike të temporalitetit, taksisës dhe aktualitetit në të dyja gjuhët, veçoritë që kanë

ato si në organizimin dhe strukturimin e fushave semantike përkatëse, ashtu edhe në paradigmen e mjeteve shprehëse të semantikave të marra në shqyrtim.

Qëmtimi dhe interpretimi i kuptimeve të ndryshme aspektuale a temporale të shqipes, madje edhe atëherë kur ato i ballafaqon me një gjuhë tjetër (në këtë rast me rusishten) paraqiten si një proces aspak i lehtë, ndonjëherë edhe i pamundur. Këtu kemi parasysh veçanërisht rastet, kur analiza kufizohet brenda kategorisë morfologjike. Mungesa e mjeteve të specializuara për shprehjen e aspektit foljor në gjuhën shqipe detyrimisht e zhvendos hulumtimin nga rrafshi morfologjik, në rrafshin semantik funksional. Mungesa e aspektit në statusin e një kategorie morfologjike nuk do të thotë që shqipes (apo gjuhëve të tjera joaspektore) i mungojnë mjetet e shprehjes së kuptimeve aspektuale. Interpretimi dhe diferencimi i këtyre mjeteve është i mundur, nëse dukurisë së marrë në shqyrtim do t'i qaseshim jo vetëm nga ana formale, por edhe përmbajtësore e funksionale.

Objektin e këtij studimi e përbëjnë kategoritë semantike funksionale të temporalitetit, aspektualitetit dhe taksisë së foljes në gjuhën shqipe (të krahasura me rusishten), të cilat karakterizojnë statusin dhe funksionimin e formave kohore të dëftores.

Studimi ka si qëllim të qëmtojë organizimin semantik funksional të kategorive semantike të aspektualitetit, temporalitetit dhe taksisë si dhe mjetet gjuhësore të shprehjes së tyre.

Arritja e objektivave parasheh trajtimin e çështjeve të mëposhtme:

1. analizën e veçorive të temporalitetit, aspektualitetit dhe taksisë si kategori semantike funksionale, si dhe konkretizimin a saktësimin e kuptimeve gramatikore që lidhen me realizimin e tyre;
2. përcaktimin dhe diferencimin e kuptimeve temporale, aspektuale dhe të taksisë tek format foljore të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe;
3. organizimin e fushave semantike të temporalitetit, aspektualitetit dhe taksisë dhe shpërndarjen e komponentëve strukturues brenda tyre;
4. analizën përqasëse të mjeteve gramatikore, leksikore e kontekstore të shprehjes së temporalitetit, aspektualitetit dhe taksisë në gjuhën shqipe e ruse;
5. përgjithësimin e mënyrave të përkthimit dhe transmetimit të kuptimeve aspektoro-kohore nga rusishtja në shqip.

Në **planin metodologjik**, punimi bazohet në karakterin sistemor dhe hierarkik të gjuhës, në varësinë e ndërsjellë të dukurive gjuhësore, në bashkëveprimin integruar të leksikut

dhe gramatikës, i cili gjen pasqyrim në situata a kontekste të ndryshme temporale, taksisore e aspektuale.

Në **planin teorik**, studimi mbështetet në idetë e gjuhësisë funksionale, të cilat mundësojnë përshkrimin e kategorive morfologjike në aspektin dinamik, duke u nisur nga funksioni tek forma. Nuk janë lënë mënjanë edhe të dhënat e strukturës formale të dukurive të marra në shqyrtim. Madje njohja paraprake e tyre është kusht për ndërtimin e modeleve funksionale.

Për realizimin e këtij punimi janë pasur parasysh studimet e K. Cipos, Sh. Demirajt, Ali Dhrimos, F. Agalliut, S. Rizës dhe të gjuhëtarëve të tjerë. Për gjuhën ruse janë shfrytëzuar punimet e Ju.S.Masllovit, A.V. Bondarkos, V.A. Plungianit etj.

Si **material gjuhësor** për këtë studim kanë shërbyer shembujt e nxjerrë nga vepra të letërsisë shqipe (Migjeni, D.Agolli, I. Kadare, S. Drini, M. Kuteli, F. Gjata, Gj. Fishta, N. Tozaj, J. Bllaci, Sh. Musaraj, Dh. Xhuvani, K. Blushi etj.). Nga letërsia ruse janë shfrytëzuar vepra të autorëve të shek. XIX e XX (L. Tolstoi, M. Gorki, F. Dostojevski, A. Çehov, I. Turgenjev, L. Ulickaja etj.). Për analizën e kategorive semantike të marra në shqyrtim janë nxjerrë mbi 3500 shembuj. Në raste të rralla janë shfrytëzuar materiale gjuhësore nga autorë punimesh të ndryshme rreth kategorive të temporalitetit, aspektualitetit dhe taksisës.

Teza të shtruara për mbrojtje

1. Temporaliteti është koha absolute, që tregon pozicionin e veprimit foljor në boshtin kohor në raport me çastin e ligjërimin.
2. Kuptimet kohore që nuk kanë si pikë referimi çastin e ligjërimin përbëjnë kategorinë semantike të taksisës. Taksisa është koha relative, e cila pasqyron marrëdhëniet kohore midis veprimeve, pavarësisht nga çasti i ligjërimin.
3. Realizimi i kuptimeve të taksisës në sistemin foljor të shqipes dëshmohet si kategori gramatikore që realizohet nga format e kohës relative dhe disa forma të së ardhmes.
4. Aspektualiteti ka të bëjë me zhvillimin a shpërndarjen kohore të veprimit foljor. Nëse temporaliteti është koha e jashtme e një veprimi, aspektualiteti është koha e brendshme e tij.
5. Realizimi i kuptimeve aspektuale në gjuhën shqipe nuk bazohet në ndonjë kundërvënie formash foljore. Shprehja e kuptimeve aspektuale realizohet në nivelin semantik funksional dhe varet nga bashkëveprimi i paradigmave kohore me kontekstin aspektual.

Për arritjen e objektivave të mësipërme në punim do të trajtohen çështjet e mëposhtme:

- 1. analiza e veçorive të temporalitetit, aspektualitetit dhe taksisë si kategori semantike funksionale, si dhe konkretizimi e saktësimi i kuptimeve gramatikore që lidhen me realizimin e tyre;*
- 2. përcaktimi dhe diferencimi i kuptimeve temporale, aspektuale dhe taksisore të format foljore të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe;*
- 3. organizimi i fushave semantike të temporalitetit, aspektualitetit dhe taksisë dhe shpërndarja e komponentëve strukturues brenda tyre;*
- 4. analiza përfaqëse e mjeteve gramatikore, leksikore e konteksture të shprehjes së temporalitetit, aspektualitetit dhe taksisë në gjuhën shqipe e ruse;*
- 5. përgjithësimi i mënyrave të përkthimit dhe transmetimit të kuptimeve aspektoro-kohore nga rusishtja në shqipe;*

Metodat e përdorura

Për trajtimin e temës janë ndjekur procedura gramatikore formale e strukturore. Midis metodave semantike vlen të përmendet interpretimi semantik funksional i dukurive gjuhësore të marra në shqyrtim. Në analizën e dukurive gjuhësore nuk mungojnë edhe metodat e përshkrimit e krahasimit si dhe analiza kontekstuale e faktorëve që kushtëzojnë funksionimin e mjeteve shprehëse të semantikës temporale, aspektuale dhe të taksisë.

Vlerat teorike

Në planin teorik studimi mbart vlera dhe ndihmesa të caktuara sa i përket përthyerjes gjuhësore të idesë së kohës. Ndër më kryesoret mund të veçonim:

- ⇒ për herë të parë është veçuar dhe përcaktuar statusi i kategorisë semantike funksionale të taksisë në gjuhën shqipe;*
- ⇒ janë qëmtuar, përshkruar e interpretuar komponentët përbërës dhe mjetet gjuhësore të shprehjes së kategorive semantike funksionale të temporalitetit dhe aspektualitetit dhe taksisë në sistemin dhe strukturën e shqipes;*
- ⇒ qasja semantike funksionale në analizën e fakteve gjuhësore në aspektin e funksionimit të tyre përbën risi metodologjike të studimit;*

Vlerat praktike

Rezultatet e studimit mund të përdoren në kurset e gramatikës teorike, gjuhësisë së përgjithshme dhe teorisë e praktikës së përkthimit.

Organizimi i materialit gjuhësor që nisët nga kuptimi të mjetet e shprehjes së tij është më produktiv edhe për praktikën e mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhëve të huaja. Parimi i analizës nga kuptimi tek mjetet modelon veprimtarinë mendore e ligjërimore të folësit. Për atë që mëson një gjuhë të huaj e rëndësishme është të dijë, se me ç' mënyra e mjete (gramatikore, leksikore, leksiko-gramatikore, kontekstuale) shprehet një semantikë e caktuar. Kjo mënyrë konceptimi ndryshon nga të mësuarit e gjuhës së huaj duke u mbështetur kryesisht në gramatikat tradicionale përshkruese.

Struktura dhe përmbajtja e punimit

Studimi përbëhet nga hyrja, katër kapituj, përfundime të pjesshme, përfundime të përgjithshme, bibliografia dhe letërsia e vjelë.

Në hyrje janë formuluar objekti, qëllimi, motivimi i temës dhe risitë që sjell ky studim. Hyrja përmban gjithashtu metodat e përdorura për shtjellimin e materialit, bazën teorike të tij si dhe vlerat teorike dhe praktike të punimit. Punimi mbyllet me bibliografinë e literaturës së shfrytëzuar.

Në kreun e parë "Qasja semantike funksionale në studimin e kategorive gjuhësore " zënë vend pikëpamjet rreth qasjeve formale dhe funksionale në studimin e dukurive gjuhësore, të cilat dallohen për nga kahu i analizës së faktit gjuhësor. Në rastin e parë (qasja formale) analiza fillon nga mjetet gjuhësore për të arritur te kuptimet; në rastin e dytë (qasja funksionale) hulumtimi zhvillohet në kah të kundërt: nga kuptimi për te mjetet të cilatdo rrafsh gjuhësor (morfologjik, sintaksor, leksikor, fjalëformues).

Vëmendje e posaçme në këtë kapitull u kushtohet kategorive semantike funksionale dhe fushave semantike funksionale si dy nocione themelore të gramatikës funksionale. Kategoritë e temporalitetit, aspektualitetit dhe taksisë, megjithëse kanë një shkallë të lartë mëvetësimi e përgjithësimi, përbëjnë një kompleks semantik më të gjerë, një grupim kategorish semantike, në themel të të cilave qëndron nocioni KOHË.

Kreu i dytë "Semantika e aspektit dhe aspektualiteti" i kushtohet analizës së semantikës aspektuale, e cila, në kuptimin strikt, përmbledh të gjitha karakteristikat e veprimit foljor nga këndvështrimi i pranisë ose mungesës së perspektivës kohore në to. Në një kuptim më të gjerë fusha semantike e aspektualitetit përfshin të gjithë tipat e zhvillimit a shpërndarjes së veprimit në kohë si: fazat e veprimit, shkallën e intensitetit, segmentimin e brendshëm të tij etj. Ideja e kohës në kuptimet aspektuale shfaqet si veti inherente e vetë veprimit foljor, si "kohë e brendshme" e tij.

Janë analizuar komponentët aspektualë përbërës të fushës semantike të aspektualitetit si dhe mjetet gjuhësore të shprehjes së tyre në gjuhën shqipe e ruse. Janë trajtuar me hollësi kategoria e aspektit si elementi më i qendërzuar i fushës semantike funksionale të

aspektualitetit dhe mënyrat e veprimit foljor si elementi periferik i saj në të dyja gjuhët. Aspekti foljor i gjuhëve sllave është vështruar si kategori e formave foljore, të cilat në rrafshin paradigmatic paraqiten si kundërvënie dygjymtyrëshe: aspekt i kryer (perfektiv)/aspekt i pakryer (imperfektiv). Në themel të kundërvënies aspekt i kryer/aspekt i pakryer qëndron tipari i veprimit tërësor. Format aspektore nuk i referohen qendrës deiktike (çastit të ligjërimit). Kuptimin e aspektit në këto gjuhë e kanë edhe ato forma foljore, të cilat nuk e kanë kategorinë e kohës (format e pashtjelluara). Më afër me format kohore të shqipes janë kuptimet e veçanta të përdorimit të formave aspektore (përdorimi i tyre në kupimin e imperfektit, perfektit, aoristit, pluskuamperfektit).

Komponent shumë i rëndësishëm i semantikës aspektuale janë edhe mënyrat e veprimit foljor, të cilat nuk formojnë kundërvënie paradigmatiche dhe as mbështeten në ndonjë sistem formash. Ato janë modifikime semantike (me mjete formale) dhe përfshijnë grupe të caktuara foljesh. Në mënyrë të veçantë jemi ndalur në veçimin dhe interpretimin e mënyrave të veprimit në gjuhën shqipe.

Mbi bazën e përkthimeve nga rusishtja në këtë kapitull janë bërë edhe disa përgjithësime rreth vështirësive dhe veçorive të transmetimit të semantikës aspektuale në gjuhën shqipe.

Objekt shqyrtimi i **kreut të tretë** “Semantika e kohës dhe temporaliteti” është bërë kompleksi i semantikës temporale. Nëse aspektualiteti shpreh “kohën e brendshme” të rrjedhës a të veprimit foljor, temporaliteti pasqyron “kohën e jashtme” me karakteristike të qartë deiktike. Kjo do të thotë që kuptimet temporale realizojnë idenë e kohës si orientim i veprimit ndaj çastit të ligjërimit. Tipari deiktik shërben për të bërë diferencimin e kuptimeve kohore të mirëfillta nga kuptimet e tjera që s’kanë lidhje me çastin e ligjërimit (kohën e jashtme, absolute).

Ndryshe nga trajtesat e derisotme, vëllimi i semantikës temporale për gjuhën shqipe në këtë punim është rrudhur. Prej saj janë shkëputur ato marrëdhënie kohore që kanë si orientues jo çastin e ligjërimit si kohë fizike, por kohën e kryerjes së një veprimi tjetër (kategoria e taksisës).

Në këtë kapitull është bërë përshkrimi i semantikës dhe funksionimit të mjeteve gramatikore dhe leksiko-gramatikore të shprehjes së marrëdhënieve kohore, organizimi i semantikës morfologjike dhe sintagmatike të formave kohore të dëftores në gjuhën shqipe.

Në **kreun e katërt** “Taksisa dhe mjetet gjuhësore të shprehjes së saj në gjuhën shqipe” trajtohen marrëdhëniet kohore ndërmjet veprimeve që i përkasin të njëjtit rrafsh kohor në struktura tërësore shumëkallëzuesore. Këto lloje marrëdhëniesh përbëjnë kategorinë e taksisës, e cila shpreh parakohësi, njëkohësi, ose paskohësi të ngjarjes në lidhje me kohën e një ngjarje tjetër. Fushën semantike të kësaj kategorie në gjuhën shqipe e përbëjnë format pluskuamperfektore dhe format e së ardhmes së përparme dhe së ardhmes së të shkuarës, por edhe mjetet leksikore e ndërtimet sintaksore.

Kreu I

QASJA SEMANTIKE FUNKSIONALE NË STUDIMIN E KATEGORIVE GJUHËSORE

1.1. Përshkrimi strukturor formal dhe funksional i gjuhës

Struktura e gjuhës (aspekti strukturor) dhe funksionimi i saj (aspekti funksional) janë dy aspekte themelore të gjuhësisë të lidhura ngushtë midis tyre, por për qëllime studimore del në pah herë njëri e herë tjetri komponent.

Përshkrimi formal mbështetet në procedura analitike që synojnë të nxjerrin në pah sa më shumë njësi gjuhësore dhe të përcaktojnë lidhjet sistimore midis tyre. Në studimet e këtij lloji ndeshemi kryesisht me grupe të ndryshme të njësive gjuhësore, me tipa sintagmash e skema fjalish. Analiza gjuhësore orientohet në përshkrimin e strukturave të njësive të veçanta, duke filluar me mjetet gjuhësore për të mbërritur te kuptimet e tyre. Jashtë vëmendjes së studiuesit mbeten prodhimi i tekstit, gjenerimi i ligjërimit, pra, sistemi i gjuhës mbetet i shkëputur nga ligjërimi.

Përshkrimi tradicional i klasave, kategorive apo njësive të tjera gjuhësore në rrafshin morfologjik, sintaksor dhe fjalëformues të jep mundësi të dallosh veçoritë e formave gramatikore dhe kuptimet e tyre, por, duke qenë se studimi mbetet brenda caqeve të njërit apo tjetrit nënsistem, një analizë e tillë jo rrallë mbetet e fragmentuar, e cunguar. Kjo ndodh ngaqë tipare të ndryshme të kuptimeve që ngërthen e njëjta kategori gjenden të shpërndara në pjesë të ndryshme të gramatikës: morfologji, sintaksë a fjalëformim. Fjala vjen, kuptimet e shquarsisë/pashquarsisë i gjen të analizuar në morfologji tek klasa e emrave, por studimi i tyre nuk mund të konsiderohet i plotë, nëse në të nuk përfshihet funksioni sintaksor i rendit të fjalëve për të dalluar temën nga rema, sidomos për gjuhët pa nyjë. “Faktet e gramatikës, sipas O. Jespersenit, janë po ato për të dyja pjesët e gramatikës, por qasja ndaj tyre është e ndryshme: të dyja pjesët e gramatikës me trajtimin e ndryshëm të tyre plotësojnë njëra-tjetrën dhe, të marra së bashku, ato japin një pasqyrë të qartë dhe komplekse të fakteve të përbashkëta të njëres ose tjetres gjuhë”¹.

Ndërtimi sistemor i gramatikave, i mbështetur në traditën latine, në një farë shkalle pengon a kufizon vështrimin kompleks të kuptimeve të ngjashme të shprehura me mjete të rrafsheve të ndryshme gjuhësore. Analiza komplekse nënkupton para së gjithash të gjitha

¹ Есперсен О., *Философия грамматики*, përkthim nga anglishtja, М. 2002

mjetet e mundshme gjuhësore: morfologjike, sintaksore, fjalëformuese, leksikore si edhe kombinimet e tyre me elemente të kontekstit, të cilat në bashkëveprim me njëra-tjetrën krijojnë së toku një tërësi funksionesh. Pavarësisht shpërndarjes së tyre (në morfologji, sintaksë, leksik etj.), mjetet e mësipërme konvergojnë mbi bazën e funksioneve të përbashkëta semantike.

Ndryshe nga gramatika tradicionale, ku shqyrtimi i faktit gjuhësor niset nga forma (mjeti), qasja funksionale niset nga funksionet për te mjetet gjuhësore. Zbatimi i parimit “nga funksionet te mjetet” nuk është i ri në gjuhësi. Ai ka shërbyer për përpilimin e gramatikave funksionale, të cilat nëpërmjet mënyrës së veçantë të analizës funksionale, duke lidhur sistemin e gjuhës me sistemin e ligjërit, plotësojnë gramatikën tradicionale. Janë të shumtë autorët që gramatikën funksionale e shohin si pjesë të modelit funksional të gjuhës².

Gramatika funksionale operon kryesisht me dy nocione themelore: “fushë semantike” dhe “kategori semantike”. Në themel të saj qëndron parimi integruar i analizës së dukurive gjuhësore, ku vëmendja kryesore e studiuesit përqendrohet në funksionin semantik të njësisë gjuhësore dhe ligjësitë e përdorimit të tyre. Modeli i gramatikës funksionale merret me përshkrimin e strukturës së fushave semantike si tërësi mjetesh të niveleve të ndryshme gjuhësore. Si të tilla mund të përmendnim fushat semantike funksionale të komparativitetit, posesivitetit, modalitetit, aspektualitetit, temporalitetit, diatezorësisë, taksisë, vetorësisë etj. Organizimi i këtyre fushave bazohet në parimin semantik strukturor dhe funksional, të cilët ndërveprojnë ngushtë midis tyre.

Në studimet gjuhësore të dhjetëvjeçarëve të fundit vihet re prirja e gjuhëtarëve për t’u përqendruar në modelin funksional të përshkrimit të gjuhës. Sipas këtij modeli theksi i analizës gjuhësore zhvendoset në aspektin funksional të dukurive gjuhësore. Në një qasje të tillë objekt studimi nuk janë thjesht dhe vetëm kategoritë morfologjike, si p.sh., tek folja kategoritë e vetës, kohës, aspektit, mënyrës a diatezës, por kategori semantike më të gjera (vetorësia, temporaliteti, aspektualiteti, modaliteti, diatezorësia, taksisa etj.)

Qasja funksionale orientohet para së gjithash në përmbajtjen dhe analizën e funksioneve të cilitdo mjet gjuhësor që merr pjesë në një akt ligjërimor. Në thelb një prirje e tillë në studimet gjuhësore synon të nxjerrë në pah kategori të tilla, të cilat mund të përfshijnë disa

² Mathesius V. *Obsahový rozbor současné angličtiny na základě obecně lingvistickém*. Nakladatelství, ČSAV. Praha 1961.

Якобсон Р. *Значение лингвистических универсалий для языкознания // История языкознания XIX и XX веков в очерках и извлечениях*. М., 1965, ч. II. Фр. Данеш,

И. Вахек. “*Пражские исследования в области структурной грамматики на современном этапе*”, Сборник статей, (Москва, 1967),

Звягинцев, В. *Структурно-семантические и прагматические характеристики восклицательных предложений в английской диалогической речи*, 1977,

А.В. Бондарко, *Теория функциональной грамматики*, 1987.

kategori ose të bashkojnë kategorinë gramatikore dhe dukuri të tjera që e shoqërojnë atë nga pikëpamja leksikore e semantike, fjala vjen, rasat dhe parafjalët, aspektin dhe mënyrat e veprimit foljor, mënyrat e veprimit dhe ndajfoljet etj. Prirje të tilla çojnë në lindjen e teorive të reja, në themel të të cilave qëndron parimi semantik i përshkrimit. Detyrë e studiuesit është jo përcaktimi i kuptimit kryesor (invariant) të formës, por potenciali semantik i arsenalit të mundshëm të kuptimeve, të cilat janë në përdorim të folësit sa herë që ai vihet përpara zgjedhjes së njëres ose tjetrës formë³.

Një drejtim i tillë në gjuhësi është edhe teoria e fushave semantike funksionale e zhvilluar nga A.V. Bondarko⁴, e cila në thelb mbështetet në teorinë e kategorive nocionore të O. Jespersenit, B. Uorfit e I.I. Meshçaninovit. Në themel të tyre qëndrojnë kategori që rrokin zona të tëra semantike dhe që ngërthejnë kuptime të ndryshme gramatikore, leksikore, fjalëformuese, por që kanë të përbashkët të njëjtën referencë nocionore. Këto kategori Bondarko i ka emërtuar si “semantike funksionale”, term të cilit i jemi përmbajtur edhe ne në këtë studim. Nëpërmjet zgjerimit të togfjalëshit “kategori semantike” në “kategori semantike funksionale” Bondarko bën dallimin midis aspektit semantik të studimit të gjuhës mbi baza funksionale dhe aspektit morfologjik. Mjetet e shprehjes së kategorive semantike funksionale, edhe pse u përkasin rrafshëve të ndryshme gjuhësore, ndërveprojnë mbi bazën e funksioneve semantike të përbashkëta, përkatësisht përmes “fushave semantike funksionale”⁵.

Aspekti semantik funksional dhe ai strukturor formal nuk duhen konceptuar si zëvendësim paradigmatsh, sikur njëra qasje është vjetëruar dhe vendin e saj e zë qasja tjetër. Gjuha funksionon si një e tërë dhe e pandarë. Qasjet e ndryshme për studimin e dukurive gjuhësore janë vetëm procedime që ndjekin gjuhëtarët për të ndriçuar anë të ndryshme të së njëjtës dukuri, madje zotërimi i strukturës formale të gjuhës është kusht për ndërtimin e një modeli funksional. Anët formale dhe funksionale të gjuhës janë të lidhura pazgjidhshmërisht, por në përshkrimin gjuhësor jo rrallë theksi vihet herë në njëren e herë në tjetrën anë⁶.

Studimet semantike funksionale kanë gjetur përhapje të gjerë në gjuhësinë bashkëkohore. Metodatat e analizës semantike funksionale të dukurive gjuhësore mundësojnë përshkrimin e faktit gjuhësor si nga pikëpamja përmbajtësore e formale, ashtu edhe nga pikëpamja e funksionimit të tij në procesin e veprimtarisë ligjërimore. Studimet e dukurive gramatikore realizohen në rrafshin morfologjik, por jo vetëm. Ato shtrihen edhe në analizën e mjeteve të rrafshëve të tjera gjuhësore, duke çelur rrugën e përshkrimit të kategorive semantike të një rendi më të lartë, të cilat u mbivendosen kategorive morfologjike. I tillë është rasti i

³ Степанов Ю.С., *Основы общего языкознания*, М. 2001

⁴ Бондарко А.В., *Вид и время русского глагола*, М. 1971

⁵ shih Bondarko A.V., 1971; 1984; 1987; 1992, etj.

⁶ Сузов И.П., *Введение в теоретическое языкознание*, Электронный учебник в формате Doc. Тверской государственный университет, 2000.

kategorisë morfologjike të kohës dhe kategorisë semantike të temporalitetit, i kategorisë gramatikore të aspektit dhe kategorisë së aspektualitetit, i kategorisë së mënyrës dhe asaj të modalitetit etj.

Natyrisht, studimi i kategorive semantike funksionale presupozon analizën e atyre mjeteve të rrafshëve të ndryshme gjuhësore, që kanë funksion semantik të përbashkët. P.sh., mjetet e ndryshme gramatikore, leksikore, kontekstuale të shprehjes së semantikës temporale, aspektuale dhe të taksisë i lidh ideja e kohës. Kështu, format kohore (absolute), format kohore (relative), format aspekte përbëjnë bërthamën e kategorive semantike apo bazën formale të mjeteve për shprehjen e kategorive semantike, përkatësisht të temporalitetit, taksisë dhe aspektualitetit. I gjithë ky kompleks kategorish semantike pasqyron anë të ndryshme të nocionit gjuhësor të kohës.

1.2. Kategoritë semantike funksionale

Në gjuhësi njihen disa drejtime për shqyrtimin e dukurive gjuhësore. Ndër to mund të përmendim drejtimin gramatikor tradicional, drejtimin semantiko-sintaksor, drejtimin konjitiv, drejtimin komunikativ, drejtimin semantiko-funksional (gramatika funksionale). Në këtë punim shqyrtimi i kompleksit semantik *aspektualitet-temporalitet-taksisë* është bërë kryesisht nga kënvështrimi semantiko-funksional.

Në studimet e atyre gjuhëtarëve që analizën e dukurive gjuhësore e kanë mbështetur në parimin e gramatikës funksionale “nga semantika te forma” bëhen më të dallueshme problemet e ndërveprimit kompleks midis kuptimit dhe funksionit, planit të përmbajtjes dhe planit të shprehjes. Sistemi gjuhësor karakterizohet nga potenciale semantike të njëjve gjuhësore që krijohen nga ndërveprimi i këtyre njëjve me elemente të gjithfarëllojshme të mjedisit përreth: kategorive të tjera, treguesve leksikorë, situatës ligjërimore etj. Kështu, p.sh., funksioni i formave kohore të foljes zotëron një shkallë të tillë të përgjithësimit (abstraktimit) të përmbajtjes, çka bën të mundur konkretizimin dhe modifikimin e saj nga bashkëveprimi me elementet temporale të situatës a kontekstit. Forma kohore përbën bazën deiktike të funksionit temporal, ndërsa gjithë potenciali tjetër semantik përcaktohet nga funksionimi (ndërveprimi) i saj me kategori të tjera (në këtë rast me aspektualitetin, taksisë, modalitetin), me tregues leksikorë të tipit *tani, dje, sot* etj., ose me situatën ligjërimore.

Duke funksionuar së bashku me elementet e tjerë dhe duke shprehur njërin apo tjetrin kuptim, të modifikuar a plotësuar nga konteksti a situata ligjërimore, forma gramatikore kryen një funksion të caktuar. Sipas Bondarkos “nocioni i funksionit (semantik) mbështetet

në nocionin e kuptimit, duke e lidhur atë me qëllimin, me funksionimin fillestar të formës, me kushtet dhe rezultatet e ligjërimit⁷.

Si kuptimet, ashtu edhe funksionet semantike të njësive gjuhësore ngërthejnë në vetvete përmbajtjen semantike gjuhësore (semantikën gjuhësore) dhe krijojnë raporte sistemore, të cilat në literaturën gjuhësore njihen si kategori semantike. Planin e përmbajtjes së këtyre kategorive e përbëjnë nocionet analoge me nocionet e shprehura nga kategoria gramatikore, ndërsa planin e shprehjes e përbëjnë mjetet e niveleve të ndryshme gjuhësore.

Kështu, me kategori semantike kuptohen ato kategori komplekse, që ngërthejnë një tërësi kuptimesh përmbajtësore, të shprehura me elemente të ndryshme gjuhësore. Ato janë shenja abstrakte të gjuhës, të cilat përshkojnë dhe organizojnë të gjithë strukturën e saj: kuptimet leksikore, gramatikore e fjalëformuese, klasat semantike të njësive gjuhësore si dhe fushat semantike⁸.

Në literaturën gjuhësore jo rrallë kategoritë semantike njëjtësohen me kategoritë nocionore⁹. Shumë studiues vënë shenjën e barazimit midis tyre. Për ta, nëse ka kuptim kundërvënia e kategorive semantike dhe kategorive nocionore në rrafshin e emërimit të aspekteve të ndryshme të një dukurie, atëherë kemi të bëjmë me kundërvënie të kategorive gjuhësore (që lidhen me njësitë gjuhësore) dhe kategorive logjike, të cilat nuk u referohen njësive gjuhësore (përmbajtjes së njësive gjuhësore ose mënyrës së kategorizimit të realitetit me mjete gjuhësore), por pasqyrojnë ligjësitë e njohjes së botës, pavarësisht nga mundësitë e shprehjes së tyre¹⁰.

A.V. Bondarko nuk i kundërvë njëra me tjetrën kategoritë nocionore dhe kategoritë semantike, por ai është i mendimit se ato janë anë të ndryshme të së njëjtës dukuri të marrë në shqyrtim. Bondarko dallon dy nivele të kategorive nocionore dhe sistemeve të tyre: nivelin e kategorive nocionore universale fundamentale dhe nivelin e kategorive nocionore që realizohen në funksionet semantike të një gjuhe të caktuar. Sipas tij me termin “kategori nocionore” kihen parasysh konceptet logjike, por jo kategoritë gjuhësore¹¹.

⁷ Бондарко А.В. *Теория функциональной грамматики*, 1987.

⁸ Васильев Л.М., *Семантические, грамматические и когнитивные категории языка*, Международная научная конференция Казанского государственного университета 7 - 10 тетор 1997.

⁹ Termi “kategori nocionore” është futur në gjuhësi nga O. Jesperseni, por në literaturën gjuhësore qarkullojnë edhe emërtime të tjera, si kategori filozofike, logjike, psikologjike, ontologjike, jashtëgjuhësore, konjitive, konceptuale, semantike etj.

¹⁰ Për më shumë shih: М.М. Гухман, *Понятийные категории, языковые универсалии и типология*, Вопросы языкознания, 1985, №3., И.И. Мещанинов, *Понятийные категории в языке*, Труды Военного института иностранных языков, 1945 №1.

¹¹ Бондарко А.В., *Понятийные категории и языковые семантические функции в грамматике*, Универсалии и типологические исследования, М., 1974.

Autorë të tjerë pohojnë se kur flitet për kategori semantike, zakonisht të bien ndër mend pohimet e Jespersenit a Meshçaninovit, të cilët përdorin termat “kategori nocionore” ose “kategori logjike”. M.V. Vsevolodova mendon se termat “kategori logjike” dhe “kategori nocionore” u duhen atashuar kategorive të gjuhës, ndërsa realizimi i tyre në cilëndo gjuhë duhet emërtuar si kategori semantike¹².

Ka edhe ndonjë qëndrim më të prerë: kategoritë semantike vështrohen si të shkëputura nga kategoritë nocionore. Për L.I.M.Vasiljevin dallimet kanë të bëjnë me faktin se kategoritë semantike, ndryshe nga ato nocionore, shprehen gjuhësisht me mjete leksikore, gramatikore a mjete të tjera, që janë të veçanta për secilën gjuhë, por edhe për faktin se për to nuk janë të huaj konotacioni dhe figuracioni. Këto janë dallime të qenësishme dhe plotësisht të mjaftueshme për të pranuar vijën e ndarjes midis kategorive semantike dhe kategorive nocionore. Sipas këtij studiuesi kategoritë semantike janë kategori përmbajtësore abstrakte të gjuhës (në zanafillë të tyre – nocionore), të cilat shprehen me mjete të gramatikës eksplicite dhe implicite¹³.

Kategoritë nocionore përbëjnë komponentë kuptimorë më të përgjithësuar, të cilët janë karakteristikë jo për fjalë të veçanta a sisteme formash të tyre, por për klasa më të gjera. Ndryshe nga kategoritë gramatikore e semantike, kategoritë nocionore kundrohen pavarësisht nga mënyrat konkrete të shprehjes së tyre.

Në literaturën gjuhësore kategoritë semantike trajtohen si elemente të gramatikës implicite. Idenë e gramatikës implicite në gjuhësi e gjejmë fillimisht në punimet e Humboldt, por konture më të qarta ajo mori në punimin e B.L. Uorfit “*A Linguistic Consideration of Thinking in Primitive Communities*” të vitit 1936. Për këtë nocion ai përdori termin “kriptotip”. Kriptotipi, sipas Uorfit, ishte një kuptim i thellë, i hollë, i pakapshëm, i cili nuk gjen shprehje në fjalët e përdorura realisht. Të tilla kategori më shumë sesa kuptohen, rroken me intuitë a si ndjesi. Ndërkaq ato mund të jenë më racionale, sesa klasifikimet e shprehura në mënyrë eksplicite¹⁴. Dy vjet më vonë ai i emërtoi këto kategori si implicite. Më pas teoria e kategorive implicite u zhvillua edhe nga gjuhëtarë të tjerë. Në gjuhësinë ruse ajo u lëvrua nga S.D. Kacnelson, A.V.Bondarko etj.¹⁵

Për Kacnelsonin “gramatika implicite s’është aspak paliativ, të cilit gjuhët i drejtohen kur nuk zotërojnë format përkatëse. Faktet gjithnjë e më shumë po provojnë se gramatika e

¹² Всеволодова М.В., Поля, категории и концепты в грамматической системе языка, Вопросы языкознания, 2009, № 3.

¹³ Васильев Л.М., Современная лингвистическая семантика, Изд. 2-е, М., 2009.

¹⁴ Whorf B. L., *Language, thought and reality* / Selected writings of Benjamin Lee Whorf / ed. by J. B. Carrol. Cambridge, MA, 1956.).

¹⁵ Кацнельсон С. Д., Типология языков и речевое мышление. Л., 1972, А. В. Бондарко, Грамматическое значение и смысл. Л., 1978.

këtij lloji është në natyrën e secilës gjuhë dhe është pikërisht ajo që shërben si bazë për çdo rend gramatikor¹⁶.

Sipas këndvështrimeve të mësipërme, për kategori implicite bëhet fjalë në ato raste kur tipare semantike dhe sintaktike të fjalëve a togfjalëshave nuk kanë gjetur shprehje morfologjike eksplicite, por janë të qenësishme për ndërtimin dhe kuptimin e thënies. Një semantikë e tillë bëhet e dallueshme nga konteksti a situata ligjërimore. Për ilustrim po sjellim ndonjë shembull.

Në gjuhën shqipe taksisa (siç do të argumentohet në kreun IV të këtij punimi) është kategori semantike eksplicite, sepse format kohore relative shërbejnë si mjet formal për shprehjen e saj. Në gjuhën ruse, përkundrazi, taksisa është kategori implicite dhe bëhet e dallueshme vetëm nga konteksti. P.sh.: *Собираясь в путь вспомнил, что совсем недавно купил новую книгу.* Përkthimi në shqip i kësaj fraze do të ishte: *Kur po bëhesha gati për udhë, u kujtova se pak ditë më parë kisha blerë një libër të ri.* Siç shihet nga ky shembull, kuptimi i taksisë i shprehur në gjuhën shqipe me formën e më se të kryerës **kisha blerë** (veprimi i saj i paraprin veprimeve të predikatëve të tjerë) është dhënë në rusisht me anë të formës së aspektit të kryer në kohën e shkuar **купил**. Në kontekste të tjera po kjo formë (**купил**) mund të përdoret në kuptimet e aoristit ose perfektit të shqipes, të cilat rusishtes gjithashtu i mungojnë. P.sh.: *Купил книгу и вышел из магазина (Bleva librin dhe dola nga libraria); Ты купил сегодня молока? (Ti ke blerë qumësht sot?)*

Shembujt e mësipërm na bindin se jashtë kontekstit (situatës ligjërimore) forma e foljes **купил** nuk mund të kishte asnjërin nga kuptimet e mësipërme, përveç kuptimin kohor të së shkuarës dhe kuptimin të aspektit të kryer. Duke u vendosur në situata të tjera kategoriale (taksisore ose temporale) forma **купил** zgjeron potencialin e saj semantik me kuptimet implicite të pluskuamperfektit, perfektit ose aoristit.

Në rastet kur një kuptim është implicit në njërën gjuhë dhe eksplicit në gjuhën tjetër (i shprehur me mjete formale), përshkrimi ndërgjuhësor i semantikave të tilla paraqet vështirësi. I tillë është rasti, p.sh., i pranisë së kategorisë morfologjike të aspektit në gjuhën ruse dhe i mungesës së saj në shqipe. Është e vështirë, në mos e pamundur, të gjesh barasvlerësin në shqipe të një veprimi foljor të shprehur me anë të formës së aspektit perfektiv me parashtesën *за-* (*заговорил, закричал etj.*) që shënon fazën e fillimit të veprimit, por të vështruar si një fazë tërësore, të mbyllur, që ndryshon nga ndërtimet analitike me kuptimin e fillimit të veprimit të tipit *начал говорить, начал писать*. P.sh.:

Завтра, наверное, расскажут, что произошло – заговорил он.

¹⁶ Кацнельсон С. Д., *верб и синтаксис*.

Në pamundësi për të ruajtur kuptimin aspektual të fillimit të veprimit, përkthyesit nga rusishtja e paraqitin veprimin e foljes *заговорил* si të përfunduar duke përdorur formën e së kryerës së thjeshtë. Ja përkthimi i tekstit të mësipërm:

- *Me siguri, nesër do të na tregojnë se ç'ka ndodhur- tha ai.* (Përdorimi i ndërtimit *zuri/nisi të thoshte ai* në kontekstin e mësipërm do të ishte i papërshtatshëm)

Në procesin e veprimtarisë ligjërimore kategoritë semantike bashkëveprojnë me njëra-tjetrën. Sipas gjuhëtarëve, problematika e ndërveprimit të kategorive semantike zë një vend të rëndësishëm në studimet e gjuhësisë bashkëkohore. Prej tyre varet zgjidhja e shumë problemeve, si problemi i përmbajtjes dhe formës, i karakterit sistemor dhe shenjor të gjuhës etj.¹⁷. Një ndërveprim të tillë e gjejmë, p.sh., te kategoritë semantike të temporalitetit dhe aspektualitetit. Në themel të tyre qëndron nocioni “kohë”, por ky nocion përthyeret në mënyra të ndryshme në secilën prej tyre. Temporaliteti pasqyron kohën e jashtme të veprimit (marrëdhëniet e veprimit foljor me çastin e ligjërimin, si orientues i jashtëm). Ideja e kohës tek aspektualiteti shfaqet si veti e brendshme e veprimit që nuk i referohet qendrës deiktike (çastit të ligjërimin). Sipas gjuhëtarit francez Gustav Gijom, aspektualiteti shpreh kohën e brendshme të veprimit.

Kategoritë semantike dallojnë njëra nga tjetra për nga vëllimi i përmbajtjes dhe gjymtyrëzimi i brendshëm i tyre, nga shkalla e mëvetësisë dhe abstraktimit, nga lidhjet dhe ndërveprimi me kategoritë e tjera semantike. Ndër to bëjnë pjesë kategoritë e veprimit, gjendjes, sasisë, cilësisë, hapësirës etj., të cilat korrelojnë me nocione nga më të përgjithshmet.

Si mjete të shprehjes së kategorive semantike shërbejnë gramemat e kategorive gramatikore, nënklasat leksikore e fjalëformuese të fjalëve emërtuese, fjalët shërbyese, ndërtimet sintaksore etj.

Kategoritë semantike mund të studiohen duke u bazuar në materialin e një gjuhë të vetme, por edhe në rrafshin kontrastiv me gjuhë të tjera. Duke qenë se shumica e kategorive semantike janë universale, ato shërbejnë si bazë për ballafaqimin e gjuhëve. Studime të tilla japin të dhëna interesante për gjuhët tipologjiksht dhe gjenetiksht të ndryshme. Nga ana tjetër, të dhënat e këtyre studimeve janë mjaft të dobishme për praktikën e përvetësimit aktiv të gjuhës së huaj. Për të realizuar një komunikim konkret në përdorim mund të përfshihen njësi të rrafshëve të ndryshme gjuhësore me funksione të njëjta ose të përafërta.

¹⁷ Васильев Л.М., *vepër e cituar*)

1.3. Fusha semantike funksionale

Nocioni i fushës mendohet të jetë huazuar në gjuhësi nga shkencë të tjera. Për herë të parë teoria e fushës lindi në gjuhësinë gjermane nën ndikimin e nocioneve përkatëse të fizikës dhe shkencave të tjera të ciklit natyror (fushë elektromagnetike, fushë e gravitetit etj.). Përfaqësuesit e saj janë K. Hejze dhe I. Trir¹⁸.

E përbashkëta në përdorimin e këtij termi lidhet me idenë e një hapësire të caktuar dhe idenë e bashkëveprimit të elementeve strukturues të saj që kanë funksion të përbashkët. Si në çdo sistem, semantikisht fusha karakterizohet nga tërësia e hapësirës. Nga pikëpamja strukturore fusha përbëhet prej mjeteve heterogjene. Teoria e fushës në gjuhësi është e rëndësishme sidomos për gramatikën funksionale, për analizat kontrastive, por edhe për teorinë e përkthimit. Por ç'kuptohet në gjuhësi me fushë semantike funksionale?

Si fusha semantike funksionale konsiderohen ato grupime njësisht gramatikore e leksikore si dhe kombinimet e mundshme të mjeteve të ndryshme të një gjuhe, të cilat ndërveprojnë mbi bazën e funksioneve semantike të përbashkëta.

Në themel të çdo fushe semantike funksionale qëndrojnë kategori semantike të caktuara, si dhe tërësia e mjeteve për shprehjen e tyre. Ato kanë si planin e përmbajtjes, ashtu edhe atë të shprehjes dhe shërbejnë si bazë për analizën e funksioneve të njësisve gjuhësore të niveleve të ndryshme.

Si rregull, fushat semantike funksionale përfshijnë të gjitha kategoritë semantike themelore që bëhen objekt shqyrtimi në gramatikë. (Studiuesit mendojnë se numri i përgjithshëm i kategorive semantike gjuhësore mund të jetë nga 33 deri në 39, varësisht nga kriteret e përdorura për veçimin e tyre). Mbi këtë bazë, ato formojnë disa grupime. Grupimet përmbledhin fusha, bërthamat (qendrat) e të cilave përbëhen nga marrëdhëniet predikat-subjekt/predikat-objekt; marrëdhëniet atributive, posesive, sasiore, cilësore; marrëdhëniet rrethore etj. P.sh., fushat e aspektualitetit, temporalitetit, modalitetit, vetorisë, diatezorisë përbëjnë grupimin e fushës semantike funksionale me bërthamë predikative.

Secili grupim përbëhet nga komponentët përkatës. Grupime të tilla të fushës semantike funksionale së bashku me komponentët përkatës janë të pranishme në çdo gjuhë,

¹⁸ Heyse K., *System der Sprach Wissenschaft*. – Berlin, 1856.

I. Trier, *Sprachliche Felder-Zeitschrift für deutsche Bildung*. Vol. 1. – Heidelberg, 1932. (Cituar sipas С.И. Дружинина, *Функционально-семантическое поле как новый метод целостного грамматического описания языковых явлений*, Филологические науки, 2007, Vol. 12).

ndërkohë që këto të fundit dallohen njëra nga tjetra për nga mënyra e strukturimit të fushave, konfiguracioni, lidhjet apo bashkëveprimi i tyre.

Në gjuhën shqipe ekzistojnë të gjitha grupimet e fushës semantike funksionale të përmendura më sipër, por ndryshe nga ruseshtja, p.sh., fushës semantike funksionale të aspektualitetit, që bën pjesë në grupimin me bërthamë predikative, i mungon komponenti i kategorisë gramatikore të aspektit foljor. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për praninë e kategorisë gramatikore të shquarsisë dhe pashquarsisë, e cila përbën bërthamën e fushës semantike funksionale përkatëse në gjuhën shqipe, por që i mungon grupimit predikat-subjekt/predikat-objekt të gjuhës ruse.

Parimi semantik strukturor dhe parimi funksional shërbejnë si bazë për organizimin e fushave semantike funksionale. Struktura e fushave përbëhet nga bërthama (qendra) dhe periferia. P.sh., bërthamën e fushës së semantike të temporalitetit në gjuhën shqipe e ruse e përbën kategoria gramatikore e kohës si njësia gjuhësore më e specializuar për shprehjen e semantikës kohore, ndërsa periferinë e përbëjnë leksiku kohor, ndajfoljet temporale, ndërtimet sintaksore që shprehin marrëdhënie kohore etj. Mjetet që përbëjnë qendrën a periferinë duhet domosdoshmërisht të karakterizohen nga përbashkësia semantike dhe funksionale.

Nga pikëpamja strukturore midis fushave semantike funksionale gjuhëtarët dallojnë:

- a) fusha monocentrike;
- b) fusha policentrike.

Tipi strukturor monocentrik përfshin kryesisht fushat që kanë bërthamë gramatikore, d.m.th., që mbështeten në një kategori gramatikore të pastër. Të tipit monocentrik në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhën ruse janë fushat e temporalitetit, modalitetit, diatezorësisë, vetorësisë etj., bërthamën apo qendrën e të cilave e përbëjnë kategoritë gramatikore, përkatësisht të kohës, mënyrës, diatezës, vetës.

Ndodh që qendra e fushës semantike funksionale të tipit monocentrik të mos jetë gjithnjë e pastër, unike, por komplekse, hetereogjene. Në këtë rast kemi të bëjmë me mungesën e një sistemi të vetëm formash gramatikore dhe me praninë e një numri mjetesh gjuhësore heterogjene, të cilët formojnë qendrën e fushës. Kjo nëndarje afron me tipin policentrik të fushës semantike funksionale, por nuk është e njëjta gjë me të. Tipari dallues midis tyre qëndron në faktin, se mjetet gjuhësore që grupohen në përbërje të bërthamës heterogjene nuk përfaqësojnë secili fushë të veçantë, por elemente të së njëjtës qendër që bashkëveprojnë midis tyre. Në këtë rast, siç do të shihet më poshtë, mungon gjymtyrimi i fushës semantike funksionale në zona apo sfera funksionale të ndryshme, ku diferencimi i brendshëm “qendër – periferi”, është i dukshëm. Diferencime të tilla janë karakteristike për fushat semantike funksionale me strukturë bicentrike a policentrike.

Fushat policentrike karakterizohen nga copëzimi në dy a më shumë zona, ku secila prej tyre ka qendrën dhe komponentët periferikë. Kësaj ndarje i përkasin shumica e fushave semantike funksionale në gjuhën shqipe dhe ruse.

Po marrim si shembull fushën e posesivitetit. Në gjuhën shqipe kjo fushë ka qendrën atributive, që është kryesorja, dhe qendrën predikative, e cila mund të konsiderohet si dytësore. Qendra atributive përbëhet nga ndërtimet me përemrat pronorë *libri im* dhe nga format rasore të emrave *libri i vëllait*, ndërsa qendrën predikative e përbëjnë predikatët posesivë të tipit *unë kam...*

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për fushën semantike funksionale të posesivitetit në gjuhën ruse. Në të janë të pranishme të dyja këto qendra. Krahaso: *моя книга, книга брата* dhe *у меня есть..., я имею...*

Në rastin e sipërpërmendur, si posesiviteti atributiv, ashtu edhe ai predikativ nuk janë gjë tjetër, veçse tipa të ndryshëm të funksioneve posesive, të cilat kushtëzojnë edhe tipat e ndryshëm të mjeteve gjuhësore. Prej këtej rrjedh edhe struktura policentrike e një fushe të caktuar (në shembullin e sjellë më sipër - bicentrike).

Në një rast tjetër, edhe pse fushat bazohen mbi të njëjtën kategori semantike, ato mund të kenë dallime thelbësore për nga struktura e tyre. Kështu, p.sh., fusha e shquarësisë/pashquarësisë në gjuhën shqipe, që është e pajisur me një, për rrjedhojë edhe me kategorinë gramatikore përkatëse, dallon nga rusishtja, e cila bën pjesë në të ashtuquajturat “gjuhë pa një”, por që për shprehjen e kuptimeve të mësipërme përdor mjete të tjera gjuhësore të niveleve të ndryshme: disa lloje përemrash, rendin e fjalëve, disa tipa fjalish të nënrenditura e ndonjë mjet tjetër. Në shumë raste në rusishte, por përgjithësisht në gjuhët pa një, është konteksti ai që mundëson dallimin e një emri të shquar nga një emër i pashquar. Për rrjedhojë edhe strukturimi i fushës semantike funksionale të shquarësisë/pashquarësisë në këto gjuhë është i ndryshëm.

Nëse do të përmblihdhim çka u parashtrua më sipër, për fushat semantike do të rendisim disa tipare kryesore:

- Fusha përfshin inventarin e elementeve, të lidhura midis tyre nga pikëpamja strukturore;
- Elementet që formojnë fushën kanë të njëjtën semantikë dhe funksione të përbashkët;
- Elementet gjuhësore që përbëjnë bërthamën janë më të specializuara për kryerjen e funksioneve, përdoren sistematikisht dhe kanë denduri më të madhe krahasuar me elementet e tjera.


Analiza e një fushe semantike funksionale mund të konsiderohet si modelim i strukturës së fushës ose strukturim i saj. Analiza nënkupton disa etapa:

- ⇒ përcaktimin e komponentëve përbërës të fushës semantike funksionale mbi bazën e tiparit semantik të përbashkët për të gjithë komponentët;
- ⇒ përcaktimin e lidhjeve midis komponentëve;
- ⇒ përcaktimin e tipit të fushës, për të cilat u fol më sipër;
- ⇒ përcaktimin e ndërveprimit të fushës në shqyrtim me fusha të tjera semantike.

Ndërveprimi i fushave semantike funksionale përbën një veçori të qenësishme që duhet të mbahet parasysh gjatë përshkrimit të tyre. Ato nuk funksionojnë të izoluar, por janë në kontakt me fusha të tjera, kryqëzohen, madje depërtojnë në zonat e njëra-tjetres dhe formojnë segmente difuze të tipit temporal-modal, temporal-aspektual, aspektual-temporal-taksisor etj.


Strukturimin dhe ndërveprimin e fushave semantike funksionale të aspektualitetit, temporalitetit dhe taksisë në përthyerjen e idesë së kohës po e paraqitim me anë të skicave të mëposhtme:

FUSHAT SEMANTIKE FUNKSIONALE TË ASPEKTUALITETIT, TEMPORALITETIT DHE TAKSISËS NË
GJUHËN RUSE



- ▶ **Fusha e aspektualitetit** në gjuhën ruse është monocentrike, bërtamën e së cilës e përbën kategoria morfologjike e aspektit foljor. Periferia përbëhet nga mënyrat e veprimit dhe mjete të ndryshme leksikore.
- ▶ **Fusha e temporalitetit** është gjithashtu monocentrike. Qendërën e saj e përbën kategoria morfologjike e kohës (kohët absolute). Periferia përbëhet nga mjete të tjera leksikore (treguesit temporalë) dhe mjete sintaksore.
- ▶ **Fusha e taksisë** është policentrike. Gjuhës ruse i mungon kategoria grammatikore e taksisë, e shprehur me mjete formale. Semantika taksisore shprehur me ndërtime sintaksore polipredikative. Komponent tjetër i fushës semantike të taksisë në gjuhën ruse janë format pohore dhe mohore me përcjellore.

FUSHAT SEMANTIKE FUNKSIONALE TË ASPEKTUALITETIT, TEMPORALITETIT DHE TAKSISËS NË
GJUHËN SHQIPE



- ▶ **Fusha e aspektualitetit** në gjuhën shqipe është policentrike. Shqipësi i mungon kategoria morfologjike e aspektit foljor. Komponent kryesor i shprehjes së kuptimeve aspektuale janë mënyrat e veprimit foljor, si dhe format kohore të shoqëruara me elemente leksikore, kontekstuale.
- ▶ **Fusha e temporalitetit** është monocentrike. Qendërën e saj e përbën kategoria morfologjike e kohës (kohët absolute). Periferia përbëhet nga mjete të tjera leksikore (treguesit temporalë) dhe sintaksore.
- ▶ **Fusha e taksisë** është monocentrike. Qendërën e saj e përbëjnë kuptimet e kategoria grammatikore e taksisë, e shprehur me mjete formale (kohët relative të së shkuarës dhe të së ardhmes). Periferinë e përbëjnë disa ndërtime sintaksore polipredikative.

1.4. Fusha semantike funksionale dhe kategoria gramatikore

Kur flitet për fushë është me rëndësi të bëhet dallimi midis saj dhe kategorisë gramatikore. Siç u tha më sipër, fusha semantike funksionale përfshin të gjithë sferën e funksioneve, që bazohen mbi një kategori semantike të caktuar. Kështu, fusha e temporalitetit në gjuhën shqipe përmbledh të gjithë sferën e marrëdhënieve temporale, përfshirë edhe ato kuptime që qëndrojnë (pjesërisht ose tërësisht) jashtë formave gramatikore të kohës, p.sh., raportin e shkuar e afërt/e shkuar e largët me determinantët e tipit *sapo, posa – shumë kohë përpara, që prej shumë kohësh* etj. Nga ky këndvështrim fusha semantike funksionale mund të karakterizohet funksionalisht e plotë.

Kategoria gramatikore ngërthen vetëm ato kuptime, të cilët janë relevante për një sistem të dhënë formash. Pra, ndryshe nga fusha semantike funksionale, kategoria gramatikore shfaqet e paplotë, e pjesshme.

Tiparet dalluese midis fushës semantike funksionale dhe kategorisë gramatikore qëndrojnë jo vetëm në planin e përmbajtjes, por edhe në planin e shprehjes formale. Nëse për kategorinë gramatikore mjetet e shprehjes nuk mund të jenë të gjithfarëlojshme, përkundrazi, për fushën semantike funksionale ato mund të jenë edhe morfologjike, edhe sintaksore, edhe fjalëformuese, edhe leksikore, edhe çdo kombinim i tyre. Për fushën semantike funksionale ato mund të jenë diskrete, dhe jo diskrete, eksplicite dhe implicite, të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta, mjete gjuhësore të mirëfillta dhe kombinime të tyre me elemente të situatës ligjërimore.

Si përfundim, mund të themi se fushat semantike funksionale, si nga pikëpamja funksionale, ashtu edhe formale, janë të plota. Plotësia funksionale dhe formale e fushës semantike funksionale gjen shprehjen e vet në faktin se ato përfshijnë jo vetëm njësitë, klasat dhe kategoritë gramatikore, por edhe elemente të tjera që i përkasin një kategorie semantike të caktuar.

Përfundime për kreun I

⇒ Për studimin e një dukurie gjuhësore mund të nisemi nga forma te semantika (nga mjetet te funksioni – qasja formale) dhe nga semantika te forma (nga funksioni te mjetet – qasja funksionale). Qasja formale mbështetet në mjetet që zotëron gjuha për të realizuar funksionet e tyre përkatëse. Qasja funksionale shkon edhe më tej. Krahas mjeteve të tipit ndajshesor (gramatikat normative), ajo bën objekt shqyrtimi mjete më komplekse, të cilat karakterizohen nga ndërveprimi i elementeve të niveleve të ndryshme gjuhësore (fjalëformuese, morfologjike, sintaksore, leksikore, kontekstuale) brenda së njëjtës fushë semantike. Përshkrimi funksional (gramatika funksionale),

ndryshe nga përshkrimi formal (gramatika formale), merr parasysh sjelljen gjuhësore të folësit, i cili e paraqit gjuhën në përdorim. Qasja formale dhe qasja funksionale nuk përjashtojnë e para të dytën ose anasjelltas. Ato, duke plotësuar njëra-tjetrën, japin një përshkrim më të plotë të dukurive gjuhësore të marra në shqyrtim.

- ⇒ Gramatika funksionale merret me përshkrimin e strukturës së fushave semantike, mbi të cilat ngrihen kategoritë semantike. Kategoritë semantike funksionale dhe fushat përkatëse janë dy nocionet themelore të kësaj gramatike. Kategoritë semantike formojnë anën përmbajtësore të fushave. Analiza e kategorive (përmbajtja) është e lidhur me mjetet konkrete të gjuhës, me forma të caktuara të shprehjes gjuhësore. Vështrimi i kategorive semantike së bashku me kompleksin e mjeteve të shprehjes, të cilat u përkasin rrafshëve të ndryshme gjuhësore, nuk është gjë tjetër, veçse fusha semantike funksionale e analizuar në gramatikën funksionale.
- ⇒ Në nivelin nocionor (konceptual) gjuhët mund të mos kenë dallime sa i takon kategorive dhe tipareve semantike, ndërkohë që shprehja gjuhësore e tyre në formën e funksioneve semantike (në strukturën e fushës) shpërfaq dallime të shumta. Kjo ndodh ngaqë gjuhë të ndryshme pasqyrojnë të njëjtin realitet a segment të tij ose realitete të ngjashme jashtëgjuhësore në mënyra të ndryshme. Ndryshimet që ka gjuha shqipe dhe gjuha ruse në strukturimin e fushave të aspektualitetit, temporalitetit dhe taksisë pasqyrojnë dallimet në mjetet gjuhësore, veçoritë kulturore, mendësinë e bartësve të tyre etj.
- ⇒ Aspektualiteti, temporaliteti dhe taksisa formojnë së bashku atë kompleks kategorish semantike, të cilat përfaqësojnë aspekte të ndryshme të ndryshme të nocionit të përgjithshëm *kohë*. Si shumica e kategorive semantike, ato janë universale. Universaliteti i tyre buron nga ligjësitë e përgjithshme të pasqyrimin të realitetit në vetëdijën e njerëzve gjatë veprimtarisë së tyre.
- ⇒ Kategoritë semantike funksionale ashtu si edhe kategoritë morfologjike, kanë planin e përmbajtjes dhe planin e shprehjes. Për nga përmbajtja kategoritë semantike funksionale janë analoge me kategoritë morfologjike. Kështu, kategoria gramatikore e mënyrës dhe kategoria semantike funksionale e modalitetit i përkasin së njëjtës zonë semantike. E njëjta gjë mund të thuhet për kategorinë semantike funksionale të temporalitetit dhe kategorisë gramatikore të kohës, por edhe për kategori të tjera.
- ⇒ Në rrafshin e shprehjes kategoritë semantike funksionale dallojnë prej kategorive morfologjike. Kategoritë semantike funksionale shprehen me mjete gjuhësore të cilat i përkasin rrafshëve dhe aspekteve të ndryshme gjuhësore: morfologjike, sintaksore, leksikore, leksiko-gramatikore, fjalëformuese etj. Ato ndërveprojnë brenda një kategorie semantike të caktuar dhe kanë funksione të përbashkëta. Sistemi i larmishëm i mjeteve përbën fushën semantike funksionale.

Kreu II

SEMANTIKA E ASPEKTIT DHE ASPEKTUALITETI

2.1. Disa fjalë rreth studimeve aspektologjike

Përpjekjet e para për t'i ndarë foljet në klasa aspektuale i gjejmë që në lashtësi. Ndarja e parë i përket Aristotelit, i cili i gruponte foljet në dy klasa: folje cakësore dhe folje jocakësore (limitative/jolimitative). Po ky autor bënte edhe disa dallime të tjera aspektuale midis vetë formave foljore. Megjithatë në gramatikat e mëvonshme dallimet aspektuale te format foljore filluan të vështroheshin si nëndarje të veçanta të kategorisë së kohës, pikëpamje të cilat për një kohë të gjatë patën ndikim në studimet për foljen në gjuhësinë përendimore, madje edhe në gjuhësinë sllave. Mjafton të përmendim këtu gramatikën ruse të M.V. Lomonosovit, i cili te folja e rusishtes dallonte 10 kohë foljore.

Tek autorët e hershëm grekë (Dionis Trakasi) ndeshim edhe termini “*eídos*” (lat.aspekt = pamje, paraqitje). Por D. Trakasi e përdorte këtë term për të treguar dallimet ndërmjet fjalëve “primitive” dhe të prejardhura, si dhe dallimet te disa grupe semantike emrash dhe foljesh, të cilat nga këndvështrimi i aspektologjisë bashkëkohore vetëm pjesërisht përkojnë sot me mënyrat e veprimit foljor.

Termi “aspekt” është përdorur edhe në gramatikën latine të E. Donatit, po ashtu edhe nga ndonjë autor rus i Mesjetës (Meteli Smotricki në gramatikën e tij të vitit 1648). Kundërvënja *aspekt i kryer/aspekt i pakryer* te foljet e gjuhëve sllave u vu në dukje nga gramatikanët çekë të shekullit XVII (veçanërisht nga V. Rosa). Këta autorë u morën për herë të parë me përshkrimin e mekanizmit morfologjik të aspektit në gjuhët sllave. Në fillim të shekullit XIX gjuhëtari slloven dhe një nga themeluesit e sllavistikës, Jernej Bartol Kopitar, e vështron aspektin e kryer dhe aspektin e pakryer si veçori gramatikore kryesore të gjuhëve sllave, ndërkohë hedh dritë edhe mbi përkimet kuptimore të aspekteve në gjuhët sllave, në greqishten e vjetër e gjuhët romane. Në këtë periudhë nis edhe zhvillimi i teorisë për aspektin në gjuhën ruse nga I. Fater, A. Bolldirev e më pas nga N.Greç, K. Aksakov, N. Nekrasov.

Indoeuropianisti gjerman G. Kurcius, duke u marrë me studimin e aspektit në gjuhën e vjetër greke, parimisht ndau kategorinë e kohës nga kategoria e aspektit. Gjuhëtarë të tjerë si F. Miklloshiç, A.A. Potebnja, G.K. Uljanov, dhe F.F. Fortunatov S.H. Shafranov, Ll.P. Razmusen, hodhën themelet e aspektologjisë krahasuese dhe historike sllave. Ndërsa ndarja e foljeve cakësore dhe jocakësore në gjuhët romane i përket gramatikës franceze të L. Mejgre (1550).

Në gjysmën e parë të shek. XX një ndihmesë të rëndësishme në studimin e aspektit të foljes ruse dhanë A. Mazon, C.O. Karcevski, A.A. Shahmatov, A.M. Peshkovski, V.V. Vinogradov. Në këtë kohë shfaqen edhe studimet e para të mirëfillta për gjuhët e tjera sllave. Një etapë e rëndësishme në zhvillimin e aspektologjisë si shkencë lidhet me veçimin e aspektit nga mënyrat e veprimit foljor, të trajtuar nga S. Agreli (1908)¹⁹ me material nga gjuha polake dhe që u pasua më tej nga A.A. Potebnja. Kjo bëri që të dallohej më qartë aspekti si kategori gramatikore, ç'ka shërbeu si bazë për punimet e mëvonshme në fushën e aspektologjisë së përgjithshme.

Nga fundi i viteve '40 të shek. XX dhe në vazhdim filloi të bëhej ndarja e klasave dhe nënklasave aspektuale të njëjësive foljore. Konkretisht, filluan të studioheshin kushtet kontekstuale dhe situative ku realizohen kuptime të veçanta aspektore, u hodh dritë mbi konceptin e fushës semantiko-funksionale të aspektualitetit, një hap ky shumë i rëndësishëm për aspektologjinë. Studime janë bërë mbi material nga rusishtja (N.S. Avillova, A.V. Bondarko, M.J. Glllovinskaja, M.A. Sheljakin, etj.), polonishtja (A. Vezhbickaja), bullgarishtja (J.S. Masllov, V. Stankov) dhe të gjuhëve të tjera sllave.

Në mënyrë të vazhdueshme janë bërë studime aspektologjike për gjuhën angleze (I.P. Ivanova, R. Mak-Koard, A. Shopf etj.), për gjuhët gjermane (B.M. Balin, etj.), për gjuhët romane (E. Benvenist, V. Pollak, K. Heger etj.). Nuk kanë mbetur jashtë vëmendjes edhe gjuha latine, gjuha e vjetër dhe e re greke, gjuhët balltike, indiane dhe gjuhë të tjera të familjes së madhe indoevropiane. Në rrethin e gjerë të studimeve aspektologjike janë përfshirë edhe gjuhë joindoevropiane si gjuhët ugrofine, turke, mongole, koreane, kineze dhe gjuhë të tjera.

Aspektologjia konsiderohet tashmë si një degë e gramatikës, e cila studion aspektin foljor dhe gjithë sferën e aspektualitetit, prkt., të kuptimeve aspektuale dhe kuptimeve të tjera të ndërthurura me to, të cilat në gjuhë të ndryshme fitojnë një shprehje dhe status të caktuar. Krahas kategorive gramatikore aspektore dhe aspektoro-kohore, aspektologjia studion klasat e foljeve që shprehin veprime dinamike, statike, veprime me cak/pa cak (prkt., folje cakësore/jocakësore), nënklasat, prkt., mënyrat e veprimit, komponentët e ndryshëm aspektualë, që nuk i përkasin leksikut foljor, si edhe mjete të ndryshme sintaksore. Gjuhëtarët sot bëjnë fjalë për aspektologji historike, për aspektologji të përgjithshme ose të veçantë, aspektologji krahasuese ose përqasëse.

Formimi i aspektologjisë ruse si shkencë lidhet me emrat e studiuesve të tillë si S. Agrel, E. Koshmider, N. Avillova, V. Vinogradov, A. Bondarko, M. Gollovinska, A. Isaçenko, I. Melçuk, L. Razmusen, S. Karcevski, M. Sheljakin, E. Petruhina, A. Tihonov etj.

¹⁹ Агрелль С. О способах действия польского глагола, *Вопросы глагольного вида*. М., 1962.

Në aspektologjinë bashkëkohore debatet prekin para së gjithash problemet e bazës logjike të opozicioneve aspektuale, tipologjinë semantike të foljeve²⁰, çështjen e bashkëveprimit të aspektit me kategori të tjera gramatikore dhe me fushat semantike funksionale përkatëse.

Aspektologët janë të mendimit se çdo gjuhë ka aftësinë për të shprehur semantika të tillë universale si aspektualiteti, temporaliteti e kategori të tjera semantike, karakteri universal i të cilave mundëson krahasimin e gjuhëve tipologjikisht të ndryshme. Krahasimin e tyre e mundëson prania e *tertium comparationis*²¹ (bazës për krahasim), pavarësisht nga dallimet që kanë gjuhët në strukturë dhe forma gjuhësore.

V. Broj konstaton se “kohët e fundit është bërë e mundur të dëshmoen prani të sistemeve aspektore edhe në gjuhë të tjera joslave, të cilat në parim funksionojnë si opozicioni i gjuhëve sllave *aspekt i kryer/aspekt i pakryer*, edhe pse në detaje janë të ndryshme”. Broj flet për një transformim pikëpamjesh që po ndodh kohët e fundit dhe që ai e vlerëson si “ironi të historisë së gjuhësisë”²².

Kjo ironi e historisë së gjuhësisë ka të bëjë me faktin, që koncepte të përshkruara dhe të diferencuara mjaft qartë në kuadër të aspektologjisë sllave në një mjedis jo sllav, ose nuk diferencohen fare, ose atyre iu vishet një përmbajtje e re, si rezultat i së cilës lind shumëkuptimësia e një termi. Në të vërtetë këtu bëhet fjalë jo thjesht për dukuri specifike të gjuhëve sllave, por për koncepte të aspektologjisë së përgjithshme.

Ndaj është me vend të qartësojmë se ç’kuptohet në aspektologji me termat dhe konceptet *aspekt* (vid) dhe *aspektualitet*, nga njëra anë, dhe *mënyrë veprimi* (aktionsart) dhe *aksionalitet*, nga ana tjetër. Por për të pasur një analizë të qartë të këtyre koncepteve dhe një vështrim sa më të plotë të semantikave të ngjashme, të shprehura me mjete që qëndrojnë në rrafsh të ndryshme gjuhësore, duhet mënjanuar kufizimi që të dikton ndërtimi sistemor i gramatikave. Kjo nënkupton analizën e të gjitha mjeteve të mundshme gjuhësore: morfologjike, sintaksore, fjalëformuese, leksikore si edhe kombinimet e mundshme të tyre, të cilat së toku krijojnë tërësi funksionesh.

2.2. Aspektualiteti si koncept dhe kategori semantike funksionale

Aspektualiteti përbën një koncept gramatikor kompleks, nëpërmjet të të cilit jepet ideja “e mënyrave të ndryshme të këndvështrimit mbi organizimin e brendshëm temporal të një

²⁰ Shih. Vendler Z. *Verbs and Times, Linguistics in Philosophy*. Ithaca; New York, 1967,

²¹ Вежбицка А. *Семантические универсалии и описание языков*. М., 1999., fq. 51

²² Брой В. *Семантика глагольного вида как отвлечение от предельных свойств лексем (иерархическая модель компонентов)*, *Семантика и структура славянского вида*. Kraków, 1997, fq. 49.

situatë”²³. Aspektualiteti gjen shprehjen e vet në disa kategori e forma gramatikore si dhe në disa struktura sintaksore. Pikërisht larmia e mjeteve shprehëse e bën aspektualitetin dukuri komplekse.

Koncepti i aspektualitetit lidhet me koncepte dhe kategori të tjera si temporaliteti, modaliteti, aksionaliteti etj. Më ngushtë aspektualiteti ndërvepron me temporalitetin, sepse në themel të të dy koncepteve qëndron përthyerja e idesë së kohës. Por ndryshe nga temporaliteti, i cili na paraqet një lokalizim të thjeshtë të situatës në boshtin kohor, aspektualiteti e karakterizon atë nga pikëpamja e rrjedhës së saj (zgjatjes, përsëritjes, përfundimit, intensivitetit etj.), duke bërë të mundur që njëjta situatë të paraqitet në mënyra dhe stade të ndryshme, sipas rëndësisë që ato kanë për folësin²⁴.

Karakterit aspektual i ngjarjes nuk na jepet si një vëzhgim i drejtpërdrejtë i saj, por si rezultat i perceptimit subjektiv të situatës nga folësi. Pra, kuptimi aspektual është gjithmonë subjektiv dhe na jep mundësinë e interpretimeve të ndryshme të dukurive të pasqyruara.

Koncepti “aspektualitet” bashkërendon me kategorinë semantike funksionale përkatëse, e cila pasqyron lidhjen ndërmjet vetë konceptit dhe mjeteve gjuhësore për shprehjen e tij në rrafsh semantik. Kategoria semantike funksionale e aspektualitetit, ashtu si edhe kategoria morfologjike e aspektit ka planin e përmbajtjes dhe planin e shprehjes. Për nga përmbajtja kategoria semantike funksionale është analoge me kategorinë morfologjike, sepse ato i bashkon e njëjta zonë semantike. Dallimi midis tyre qëndron në planin e shprehjes. Kategoria morfologjike shprehet vetëm me mjete morfologjike, ndërsa kategoria semantike përfshin edhe mjete të tjera si mjetet leksikore, sintaksore, kontekstuale etj. Zgjedhja e mjeteve gjuhësore për shprehjen e aspektualitetit varet nga shumë faktorë: nga specifika e situatës dhe perceptimi i saj, nga qëllimi i komunikimit dhe përvoja gjuhësore e folësit, nga tipi i diskursit.

Aspektualiteti është i lidhur më shumë me fushëveprimin e predikatit foljor përderisa komponenti foljor i thënies (leksema foljore – tema e saj), përveçse shënon një ngjarje, jep për të edhe informacion aspektual lidhur me parametrat e rrjedhës së veprimit në kohë. Shprehjen e këtij informacioni folësi i gjuhës ruse, ndryshe nga folësi i shqipes, e ka të detyrueshme. Ai gjithnjë vihet para zgjedhjes, nëse do të përdorë formën e aspektit të kryer ose formën e aspektit të pakryer.

²³ Comrie B., (vepër e cituar)

²⁴ Падучева Е.В., *Семантические исследования (Семантика времени и вида в русском языке; Семантика нарратива)*, М.: Языки русской культуры, 1996, 4

Duhet vënë në dukje edhe fakti se realizimi i funksioneve semantike funksionale të aspektualitetit kryhet gjatë procesit të funksionimit gjuhësor të strukturës në tërësi. Jo më pak rëndësi kanë edhe komponentët e tjerë të kompleksit predikativ: subjekti dhe objekti me karakteristikat e tyre gramatikore dhe semantike, përderisa vetë struktura kuptimore e leksemës foljore nënkupton një lidhje të caktuar midis veprimit dhe subjektit a objektit, si dhe mjete të ndryshme kontekstuale që shërbejnë si tregues aspektualë. Elementet e kontekstit e përqëndrojnë vëmendjen te rrjedha e veprimit, nëse ai zgjat, kryhet për një orë, kryhet përnjëherë, kryhet ngadalë etj. *Varka u fundos (ngadalë, për 10 minuta, sa hap e mbyll sytë)*. Këto karakteristika të veprimit janë të shpeshta, të mundshme, por jo gjithnjë të detyrueshme për folësin.

Kështu, aspektologët dallojnë:

- a) aspektualitetin foljor, që përfshin tiparin aspektual si një veti e brendshme e leksemës foljore dhe kategorinë gramatikore të aspektit;
- b) aspektualitetin jofoljor (leksikor dhe kontekstual-sintaksor) me pjesëmarrjen e mjeteve të tjera të shprehjes së funksioneve aspektuale.

Sikurse u vu në dukje, aspektualiteti lidhet me “kohën e brendshme” të veprimit. Termi “kohë e brendshme” i përket gjuhëtarit francez Gustav Gijom²⁵. Për realizimin e tij çdo veprim kërkon periudhën e vet kohore (sasinë e vet të kohës). Tiparet (karakteristikat) aspektuale të veprimit shënojnë mënyrën e shpërndarjes së veprimit brenda kohës inhereente, nëse ky veprim zgjat (me ose pa kufizim), është i shkurtër (çastor), kryhet disa herë ose vetëm një herë, zhvillohet si proces ose si një fakt tërësor, ka një cak të brendshëm gjatë rrjedhës së tij ose jo etj. Në një kuptim më të ngushtë sfera e aspektualitetit përfshin të gjitha karakteristikat e veprimit foljor nga pikëpamja e pranisë/mungesës së paraqitjes së perspektivës kohore. Në një kuptim më të gjerë aspektualiteti përmbledh të gjithë tipat e rrjedhës a shpërndarjes së veprimit në kohë (në ç’fazë të zhvillimit të tij është, sa dinamike, statike, intensive është rrjedha e tij).

Shpesh në qendër të vëmendjes së studimeve aspektologjike mbetet çështja e dominantit semantik funksional të kategorisë së aspektualitetit. Në këto studime gjuhëtarët janë përpjekur të qëmtojnë atë tipar, i cili mund të pranohej si bazë semantike universale e aspektualitetit. Për aspektologjinë sllave problemi konsiderohet i zgjidhur, sepse si bazë e tillë shërben kategoria e aspektit, e cila shënon dallimet në paraqitjen e veprimit si tërësor. Aspekti vështrohet si kategori morfologjike, e cila gjen shprehjen e vet në kundërvënien e formave të aspektit të kryer/aspektit të pakryer. Më i paqartë mbetet dominanti semantik i aspektualitetit për gjuhët joslave.

²⁵ Guillaume G. *Immanence et transcendance dans la categorie du verbe*, Guillaume G. Langage et science du langage. 3-e ed. P., 1973.

2.3. Fusha semantike funksionale e aspektualitetit dhe komponentët e saj përbërës

Bazuar në parimet e gramatikës funksionale, aspektologu A. Bondarko e vështron aspektualitetin jo vetëm si një kategori semantike, por edhe si një bashkim të dyanshëm të semantikës aspektuale me sistemin e mjeteve shprehëse gjuhësore të rrafshëve të ndryshme, të cilat formojnë fushën përkatëse semantike funksionale. Prania e fushës semantike funksionale të aspektualitetit, si një tërësi mjetesh për shprehjen e kuptimeve aspektuale shërben edhe si pikënisje për ndërmarrjen e këtij studimi në planin kontrastiv.

Brenda caqeve të kësaj fushe ndërthuren tipa të ndryshëm kuptimesh aspektuale, të cilët në një tërësi a tjetër mënyrë shprehin nuanca a karakteristika të veprimit foljor, përfshirë edhe ecurinë e këtij veprimi, por në çdo rast pa iu referuar çastit të ligjërimit si qendër deiktike e lokalizimit kohor. Në këtë fushë dallohen elementet formale të shprehjes: nga kundërvënia e pastër e formave gramatikore të foljes (për gjuhën ruse në statusin e kategorisë së aspektit) e deri tek dukuritë e “gramatikës latente”², ku përfshihen: opozicionet e klasave dhe nënklasave aspektuale të tilla, si foljet cakësore/jocakësore (limitative/jolimitative), tipare të ndryshme të veprimit dhe mënyrat e veprimit (aktionsarten).

Elementet formale (formantët e posaçëm morfologjikë), të cilët shprehin kuptimin themelor të kategorisë semantike përkatëse përbëjnë qendrën (bërthamën) e fushës semantike funksionale, ndërsa periferia përfaqësohet nga mikrofusha (mikrozona) të tjera, të strukturuar nga mjete leksiko-gramatikore ose leksikore.

Teorikisht fusha semantike funksionale e aspektualitetit mund të përbëhet nga komponentë të ndryshëm gjuhësorë, konkretisht nga:

a) një sistem, i cili bashkon një sërë formash gramatikore (morfologjike) me përmbajtje të njëjtë, d.m.th. nga ato forma që shprehin kategorinë gramatikore (morfologjike) të aspektit;

b) formime aspektuale dhe grupime të tyre, të cilat karakterizohen nga një gramatikalizim jo i plotë, d.m.th. nga mospërfshirja e plotë e gjithë leksikut foljor dhe formave gramatikore të foljes;

c) elemente aspektore të formave foljore me kuptim aspektoro-kohor (ose me kuptim kohor të ndërthurur me elemente aspektuale shtesë;

ç) togje të formuara me folje që tregojnë “fazën e veprimit” (fillimin, vazhdimin, dhe përfundimin e një veprimi) si dhe nga ndërtime të tjera analitike me semantikë aspektuale;

d) mjete sintaksore që kanë funksione aspektuale plotësuese, p.sh. ndërtimi i tipit *чем больше... - тем сильнее...* (sa më shumë... - aq më tepër...);

e) mënyrat e veprimit (aktionsarten);

ë) kundërvënia *folje cakësore/folje jockakësore* (folje terminative/jotermnative);

f) tregues leksikorë në cilësinë e rrethanorit, të tipit *долго, мгновенно, постепенно, медленно, часто, вдруг* etj. (*gjatë, në çast, gradualisht, ngadalë, shpesh, përnjëherësh*);


g) nga mjete të ndryshme të kombinuara në kontekst, të cilat përbëjnë të ashtuquajturën “gramatikë latente”.

Është e natyrshme që në gjuhë të ndryshme komponentët aspektualë të mësipërm të mos kenë të njëjtën shpërndarje, sepse, siç dihet, secila gjuhë e “gjymtyron” realitetin që na rrethon në mënyra të ndryshme. Për rrjedhojë edhe organizimi i fushës semantike funksionale të aspektualitetit është i ndryshëm.

Në gjuhën ruse, p.sh., fushën semantike funksionale të aspektualitetit e përbëjnë të gjithë komponentët aspektualë të sipërpërmendur. Ajo është fushë monocentrike, ku kategoria morfologjike e aspektit përbën komponentin më kryesor dhe më të abstraktuar të saj.

Në mënyrë grafike fushën semantike funksionale të aspektualitetit në të dyja gjuhët mund ta paraqesim të konfiguruar si më poshtë:


KONFIGURIMI GRAFIK I ASPEKTUALITETIT NË GJUHËN RUSE



Fushë monocentrike:

- a) kategoria gramatikore e aspektit;
- b) formime aspektore dhe grupimet të tyre, të cilat karakterizohen nga një gramatikalizim jo i plotë;
- c) elemente aspektore të formave me kuptim aspektoro-kohor;
- d) togje të formuara me foljet që tregojnë “fazë veprimi” dhe ndërtime të tjera analitike që shprehin aspektualitet;
- e) mjete sintaksore që kanë funksione plotësuese të aspektualitetit;
- f) mënyrat e veprimit (Aktionsarten);
- g) kundërvënia folje *cakësore/jocakësore* (folje terminative/aterminative);
- h) tregues leksikorë në cilësinë e rrethanorit të tipit *долго, мгновенно, постепенно* etj. (*gjatë, në çast, gradualisht* etj.);
- i) mjete të ndryshme në kontekst, “gramatika latente”

KONFIGURIMI GRAFIK I ASPEKTUALITETIT NË GJUHËN SHQIPE



Fushë policentrike:

- a) kundërvënie aspektuale, të cilat karakterizohen nga një gramatikalizim jo i plotë;
- b) elemente aspektuale të formave me kuptim aspektoro-kohor;
- c) togje të formuara me foljet që tregojnë "fazë veprimi" dhe ndërtime të tjera analitike që shprehin aspektualitet;
- d) mjete sintaksore që kanë funksione plotësuese të aspektualitetit;
- e) mënyrat e veprimit (Aktionsarten);
- f) tregues leksikorë, në cilësinë e rrethanorit, të tipit gjatë, në çast, gradualisht etj.;
- g) mjete të ndryshme në kontekst, "gramatika latente" ;

Në gjuhën shqipe kategoria e aspektit në statusin e kategorisë gramatikore nuk është zhvilluar, prandaj fusha semantike funksionale e aspektualitetit në këtë gjuhë është policentrike. Ndryshe nga rusishtja, fusha semantike funksionale e shqipes karakterizohet

nga kundërvënie me vlerë aspektuale, të cilat formojnë brenda saj mikrozona semantike të rrafshit leksiko-gramatikor ose leksikor (mënyrat e veprimit foljor).

Në shtjellimet e mëposhtme do të merren në shqyrtim komponentët aspektualë më kryesorë në gjuhën ruse e shqipe. Konkretisht:

1. Kategoria gramatikore e aspektit foljor, i cili mbështetet në kundërvënien dygjymtyrëshe *совершенный вид/несовершенный вид* (*aspekt i kryer/aspekt i pakryer*).
2. Komponentët aspektualë periferikë të fushës, ndër të cilët:
 - a) Mënyrat e veprimit, të cilat mbështeten në kuptimet leksikore të foljeve dhe shprehen me mjete morfologjike.
 - b) Kundërvënia *veprim cakësor/ veprim jocakësor*, në themel të së cilës qëndron *tipari i limitativitetit*.

2.3.1. Kategoria gramatikore e aspektit foljor në gjuhën ruse

Në gjuhë të ndryshme, qoftë edhe të afërta gjenetikisht, kategoritë gramatikore kanë ndjekur jo të njëjtën rrugë zhvillimi. Kështu, p.sh., sistemi i vjetër kohor i shqipes gjatë zhvillimit historik të saj është ruajtur dhe sot ai paraqitet mjaft i pasur në forma kohore. Përkundrazi, sistemi kohor i gjuhëve sllave ndoqi një rrugë tjetër. Në disa nga këto gjuhë ai pësoi shkurtime të ndjeshme dhe vendin e trajtave kohore të tilla si aoristit, imperfektit, pluskuamperfektit të sllavishtes së vjetër e zuri një sistem i ri, sistemi aspektor, i cili sot është karakteristik për të gjitha këto gjuhë.

Lindja dhe zhvillimi i aspektit foljor në gjuhët sllave u kushtëzua nga disa rrethana të caktuara. Mendimi më i përgjithshëm është se paragjuha indoevropiane fillimisht njëjthe vetëm aspektin foljor. Folësi i kësaj gjuhe mund të dallonte një veprim në vazhdim nga një veprim i përfunduar, ose mund të konstatonte një gjendje të caktuar. Mendohet që paraindoevropianishtja të ketë njohur tri aspekte: aspektin durativ (të vazhdimësisë), aspektin momental (të çastësisë), dhe aspektin rezultativ (që shprehte një gjendje të caktuar). Studiuesit mendojnë se kohët gramatikore, meqenëse përbënin logjikë më abstrakte, i takojnë fundit të paraindoevropianishtes ose indoevropianishtes së përbashkët. Mbi bazën e kuptimeve aspektore lindën kuptimet kohore të prezentit, aoristit dhe perfektit²⁶.

²⁶ Për më gjerë shih: Fortson B., *Indo-European language and culture. An Introduction* — Padstow: Blackwell Publishing, 2004.

Kuryłowicz J. *The inflectional categories of Indo-European*. — Heidelberg: Carl Winter, 1964.

Сафаревич Я., *Развитие формативов времени в индоевропейской глагольной системе*, Проблемы индоевропейского языкознания. — 1964.

Sistemi kohor i përfutur erdhi duke u zhvilluar edhe perfeksionuar në të gjitha gjuhët indoevropiane të mëpastajme, duke na dhënë kështu karakteristika më të plota të veprimit foljor.

Edhe grupi i gjuhëve sllave në këtë periudhë karakterizohet nga larmia e formave kohore. P.sh., kategoria e kohës, në gjuhën e vjetër ruse numëronte prezentin, imperfektin (që shprehte një veprim që zgjaste ose përsëritej në të shkuarën), aoristin (që shprehte një veprim të çastit në të shkuarën), perfektin (që shprehte rezultatin e veprimit), pluskuamperfektin, të ardhmen I, (e cila më përpara ishte një trajtë e thjeshtë), të ardhmen II (e cila shprehte një veprim që do të kryhej para një veprimi tjetër në të ardhmen).

Aty nga fundi i shekullit XVI, fillimi i shekullit XVII, në disa nga gjuhët sllave (rusishte, polonishte, çekishte etj.) filloi procesi i shuarjes së disa trajtave kohore. Në gjuhën ruse, psh., filluan të dalin nga përdorimi si të panevojshme trajtat kohore të imperfektit dhe aoristit.

Kjo dukuri mendohet të jetë kushtëzuar nga shtimi gradual i formimeve parashtesore prejfoljore. U ruajt në këtë gjuhë vetëm forma e perfektit. Me rënien e foljes ndihmëse, perfektin i vjetër mbeti përfaqësuesi i vetëm i trajtave kohore të së shkuarës. Kjo trajtë fitoi aftësinë të shprehë kuptimin e aspektit të kryer kur folja ishte formim parashtesor (*принёс увёл*), dhe atë të aspektit të pakryer, kur folja ishte pa parashtesë (*нёс, вёл*).

Nocioni “aspekt”, fillimisht mjaft i papërcaktuar, ka ardhur duke u qartësuar e kristalizuar. Prej tij janë shkëputur disa dukuri të afërta me të, të cilat u përkasin rrafshëve të tjera gjuhësore.

U deshën dhjetëvjeçarë të tërë rrahje mendimesh rreth çështjeve të përmbajtjes dhe përbërjes së aspektit foljor për të mbërritur te konceptimi i aspektit si kategori dygjymtyrëshe (binare), e cila përfshinte vetëm dy klasa foljesh, të aspektit të kryer dhe të aspektit të pakryer. Këtë ide për gjuhën ruse e gjejmë në punimet e gjuhëtarëve të tillë si F. Fortunatov, G. Uljanov, A. Shahmatov, S. Karcevski etj.

Në gjuhën e sotme ruse kategoria e aspektit përfaqësohet prej dy formave me të njëjtin kuptim leksikor - njëra e aspektit të kryer (perfektiv) *бросить-хедh*, tjetra e aspektit të

Перельмутер И. А., *К становлению категории времени в системе индоевропейского глагола*, Вопросы языкознания. — 1969. — № 5.

Савченко А. Н., *Сравнительная грамматика индоевропейских языков*. — М.: УРСС, 2003.

Тронский И. М., *Общеславянское языковое состояние*. — М.: УРСС, 2004.

Мейе А., *Введение в сравнительное изучение индоевропейских языков*. — М.: Издательство ЛКИ, 2007.

pakryer (imperfektiv) *бросать-hedh*, kurse kategoria e kohës numëron tri forma kohore për foljen e aspektit të pakryer *бросаю-hedh*, *бросал-hidhja*, *буду бросать-do të hedh*, dhe dy të tjera për foljet e aspektit të kryer *бросил-hodha*, *kam/kisha/pata hedhur*, *бросу-do të hedh*.

Pra, përse u përket kategorive foljore të aspektit dhe të kohës, gjuha ruse, sikurse edhe gjuhë të tjera sllave, ndryshuan tipologjinë e tyre. Përjashtim bëjnë disa gjuhë sllave të Ballkanit si bullgarishtja, maqedonishtja etj., të cilat, krahas aspektit, kanë ruajtur sistemin kohor të mëparshëm. Prania e aspektit foljor në statusin e kategorisë gramatikore përbën një specifikë të strukturës morfologjike të këtyre gjuhëve. Kjo do të thotë se folja në këtë gjuhë jo vetëm emërton një veprim ose gjendje, por ka aftësinë t'i karakterizojë ato gramatikisht edhe nga pikëpamja e kuptimeve aspektore.

Është me rëndësi të vëmë në dukje se aspekti foljor, ndryshe nga koha, nuk kufizohet dhe nuk i referohet aspak qendrës deiktike (çastit të ligjëritimit). Folja e gjuhës ruse mbetet e të njëjtit aspekt, pavarësisht nëse përdoret në të tashmen, të shkuarën dhe të ardhmen ose në format e paskajores a përcjellores. Kuptimin e aspektit (të kryer ose të pakryer) e ka çdo folje e gjuhës ruse në cilëndo trajtë të saj.

Me aspekt (*vid*) në gjuhën ruse, por edhe në gjuhë të tjera sllave, janë kuptuar karakteristika të tilla të veprimit foljor, si fillimi i veprimit, përfundimi i veprimit, shkalla e intensitetit, përsëritja apo kryerja e veprimit etj. Konceptime të tilla i takojnë një stadi disi më të hershëm në studimin e aspektit foljor.

Zhvillimi i aspektologjisë u shoqërua me një prirje tjetër në përpunimin e teorisë së aspektit foljor. Nga aspekti u veçua një dukuri tjetër e përafërt me të që njihet si “*mënyrat e veprimit foljor*” (rusisht *способы глагольного дjestija*, latinisht *action verbi*, gjermanisht – *aktionsarten*).

Aktualisht në gjuhën ruse flitet për kategori gramatikore të aspektit (*vid*), e cila mbështetet në kundërvënien formale të kuptimeve gramatikore *sovershennij/njesovershennij vid* (*aspekt i kryer/aspekt i pakryer ose aspekt perfektiv/aspekt imperfektiv*), dhe për *mënyra të veprimit foljor*, të cilat në dallim nga aspekti nuk formojnë kundërvënie paradigmatiske dhe as që mbështeten në ndonjë sistem formash.

Aspekti foljor është ndër dukuritë mjaft të rrahura në literaturën gjuhësore, megjithatë shumë çështje të kësaj dukurie ende kanë mbetur larg zgjidhjes së kënaqshme. Madje mendimet e studiuesve ndahen për probleme të tilla themelore, si: ç’përfaqëson në thelb aspekti, cila është semantika e tij, në ç’raport është aspekti me kategoritë e tjera të foljes, si koha, mënyra, diateza, cili mund të ishte kuptimi kategorial i formave aspektore etj.

Objekt i diskutimeve të shumta mbetet edhe çështja e pranisë ose mospranisë së aspektit foljor në gjuhët joslave. Në literaturën gjuhësore qarkullojnë teori të ndryshme, duke filluar me mohimin e plotë të aspektit gramatikor në gjuhët joslave e deri te pranimi i tij në të gjitha format foljore. Një numër studiuesish, edhe pse pranojnë kategorinë gramatikore të aspektit (p.sh., te folja e gjuhës frënge ose gjuhës angleze), gjithsesi ata nuk ndajnë të njëjtën pikëpamje për mjetet gramatikore të shprehjes së kësaj kategorie. Kjo problematikë mbetet edhe për gjuhën shqipe. Por le të ndalemi shkurt vetëm në disa nga pikëpamjet e shprehura rreth aspektit foljor të gjuhës ruse: ç'është kuptuar me aspekt në këtë gjuhë, cili është statusi strukturor i aspektit dhe në ç'rrafsh gjuhësor qëndron ai, cila është semantika e formave aspektore dhe si vepron mekanizmi i formimit të aspekteve në të.

2.3.1.1. Rreth semantikës gramatikore të kundërvënies

aspekt i kryer/aspekt i pakryer

Semantika gramatikore e kundërvënies *aspekt i kryer/aspekt i pakryer* vazhdimisht është bërë objekt studimi nga shumë gjuhëtarë të ndryshëm. Nuk gjen studim për aspektin foljor, ku të mos jetë rrahur çështja e semantikës së tij. Por edhe kësaj çështjeje, autorë të ndryshëm i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme dhe gjer më sot nuk gjejmë një përcaktim të aspektit të pranueshëm nga të gjithë. Problemi thelbësor në këto përcaktime ka qenë se njëri a tjetri kuptim që u është njohur formave aspektore, nuk përshkon mbarë klasën e foljeve, por mbetet brenda një diapazoni të kufizuar leksikor.

Më poshtë do të ndalemi shkurt vetëm në disa prej këtyre përcaktimeve, kryesisht në ato që më së shumti kanë zënë vend në literaturën gjuhësore.

Një numër jo i vogël studiuesish në përcaktimin e aspektit të gjuhëve sllave janë nisur nga kuptimi i foljeve të aspektit të pakryer.²⁷ Si tipar semantik të tyre këta autorë kanë pranuar zgjatjen e veprimit (*dlitjelnost' djejtviija*), por meqenëse foljet e aspektit të kryer formojnë kundërvënie me ato të aspektit të pakryer, atëherë tipari semantik i këtyre të fundit, nuk duhet të përmbahet tek të parat. Por a ndodh në të gjitha rastet kështu? Çdo veprim, sado i shkurtër të jetë, që të shtjellohet, kërkon një fragment kohor, qoftë edhe shumë të shkurtër. Kështu, foljet e aspektit të kryer, ashtu si edhe ato të aspektit të pakryer, mund të shprehin edhe veprime, shtjellimi i të cilave vazhdon për një periudhë kohore të gjatë. Psh. *Он проболел всю зиму (Ai ka qenë sëmurë gjithë dimrin); Его брат прожил всю жизнь в деревню (Vëllai i tij gjithë jetën e kaloi në fshat)*. Përderisa i njëjti tipar i zgjatjes së veprimit është i pranishëm te të dyja format, mbështetja në të bëhet e pavlevshme.

²⁷ Brugman A. und Delbrück K. *Grundriss der vergleichenden Grammatik der indogermanischen Sprachen*. Strassburg, 1913, Потебня А. *Из записок по русской грамматике*, М., Л., 1941, Пешковский А. М. *Русский синтаксис в научном освещении*, М. 1956

Të tjerë autorë në përcaktimin e aspektit janë nisur nga kuptimi i foljeve të aspektit të kryer. Si tipar semantik i aspektit të kryer është pranuar përfundimi i veprimit (*zakoncennost' djestvija*). Themelues i kësaj teorie mbahet F. Mikloshiçi, i cili pohonte se “Veprimi mund të paraqitet ose në vazhdim e sipër, ose si i përfunduar, i pari shprehet me anë të foljeve të aspektit të pakryer, i dyti mëpërmjet foljeve të aspektit të kryer”.²⁸ Një përkufizim të tillë, sipas të cilit foljet e aspektit të kryer tregojnë një veprim të përfunduar, ndërsa ato të aspektit të pakryer, veprim të papërfunduar e gjejmë në mjaft gramatika apo tekste të ndryshme të gjuhës ruse. S’ka dyshim, se ndërmjet foljeve të aspektit të kryer dhe atij të pakryer ka mjaft prej tyre, të cilat në kontekste të caktuara shprehin veprime të papërfunduara ose të përfunduara. Por do të ishte pa vend të pohonim se të gjitha foljet, pa përjashtim kanë kuptimet e mësipërme në cilindo kontekst të përdorimit të tyre.

Kuptimin e përfundimit të veprimit e kanë në radhë të parë foljet e aspektit të kryer, veprimi i të cilave përfshin gradualisht një objekt. Në këto raste, veprimi quhet i përfunduar kur është përfshirë tërësisht prej tij. Psh.: *сшить платье* (*qep fustanin*), *съесть яблоко* (*ha mollën*), *побелить стены* (*lyej muret*), *выпить чашку кофе* (*pi një filxhan kafe*).

Që veprimi i përfunduar lidhet me praninë e një objekti, këtë fakt në gjuhën ruse e dëshmon edhe përdorimi i gjinorese së pjesës (partitive) krahas përdorimit të kallëzores pa parafjalë pas foljeve të aspektit të kryer. Psh.: *выпить молоко* (*молока*) – pi qumështin (pi qumësht), *наколоть дрова* (*дров*) – çaj drutë (çaj dru), *съесть хлеб* (*хлеба*) – ha bukën (ha bukë).

Por do të ishte i gabuar përdorimi i gjinorese së pjesës pas foljeve të aspektit të pakryer (*пить молока, колоть дров, есть хлеба*). Kjo shpjegohet me faktin që gjinorja e pjesës nënkupton përfshirje të plotë të pjesës së veçuar, prandaj përdorimi i foljeve të aspektit të pakryer në këtë rast është i pavend, sepse veprimi i shënuar prej tyre nuk mund të shprehë përfshirjen e tërësishme të objektit.

Veprim të përfunduar në gjuhën ruse mund të tregojë edhe grupi i foljeve, që shpreh kalimin e sendit nga një gjendje në një tjetër: *высохнуть, умереть, постареть, одеревенеть* (*Отец постарел; Нога одеревенела*). Megjithatë, kuptimi i përfundimit të veprimit nuk mund të shtrihet në tërë klasën e foljeve. Në të mirë të këtij pohimi flasin fakte të tilla gjuhësore, si:

Ночью в лесу я увидел костёр и видел его до наступления утра.

Natën *pashë* në pyll zjarr dhe e *pashë* atë deri në agim.

С детства я *полюбил* море и *люблю* его до сих пор.

²⁸ Miklosich F. *Vergleichende Grammatik der slavischen Sprachen*, Wien, 1883.

Që fëmijë e *desha* detin dhe e *dua* atë edhe sot.

Nëse foljet e aspektit të kryer *увидел (pashë)*, *полюбил (desha)*, do të shprehnin veprim të përfunduar, ndërtimet e mësipërme do të ishin të pamundura, ashtu sikurse tingëllojnë absurde ndërtimet: *Я выпил своё молоко, и продолжаю его пить* (Unë e *piva* qumështin dhe *vazhdoj atë ta pi*); *Я съел свой хлеб и продолжаю его есть* (Unë e *hëngra* racionin tim të bukës dhe *vazhdoj atë ta ha*), ku foljet *выпил, съел* kanë kuptimin e përfundimit të veprimit.

Nga ana tjetër duhet vënë në dukje se kuptimi i përfundimit të veprimit mund të jetë i pranishëm edhe te disa folje të aspektit të pakryer në kohën e shkuar. Psh.: *По утрам я выпивал стакан молока (Mëngjeseve unë pija një gotë me qumësht)*. Folja *выпивал* tregon veprim që është përsëritur në të shkuarën, por secili akt veçmas ka përfunduar. Kryesisht veprim të përfunduar mund të shprehin edhe foljet e diatezës pësore në kohën e shkuar: *Дом строился рабочими*.

Pra, kuptimin e përfundimit të veprimit e kanë jo vetëm foljet e aspektit të kryer, por në disa raste edhe foljet e aspektit të pakryer. Po të pranohet përfundimin e veprimit si tiparin semantik të aspektit të kryer, do ta kërkonim atë edhe tek foljet e aspektit të kryer, të cilat tregojnë fillim veprimi (*заиницировать, заговорить* etj.). Përfundimi i veprimit, ashtu si edhe fillimi i veprimit janë faza të shtjellimit të tij. Si njëri, ashtu dhe tjetri, u takojnë mënyrave të veprimit foljor, por jo kuptimeve gramatikore të aspektit.

Për zbulimin e semantikës gramatikore të aspektit, disa gjuhëtarë në punimet e tyre kanë futur nocionin “*veprim pikë/veprim vijë*”. Këtë krahasim e kanë përdorur gjuhëtarë të tillë si Potebnja, Busllajevi, Peshkovski, F.de Sosyri etj. Edhe ndaj kësaj mënyre konceptimi janë shprehur rezerva. Në mjaft raste kjo paraqitje grafike përputhet me kuptimin e formave të aspektit të kryer ose të pakryer psh.: *Он рассказывает содержание прочитанной книги* (Ai po na tregon përmbajtjen e librit që ka lexuar), veprimi mund të paraqitet në formën e një vije (_____) dhe *Он рассказал содержание прочитанной книги* (Ai na tregoi përmbajtjen e librit që kishte lexuar), veprimi mund të paraqitet në formën e një pike (•). Po kjo paraqitje grafike do të ishte e papërshtatshme për të shprehur veprimin e foljeve të tilla si *пооткрывать, повытаскивать* etj. Veprimi i këtyre foljeve të aspektit të kryer nuk mund të paraqitet si një pikë e vetme, por si një seri pikash (.....).

Sot për sot në literaturën gjuhësore konkurojnë dy pikëpamje, të cilat dallimin semantik midis foljeve të aspektit të kryer dhe të pakryer e mbështesin në kuptimet *veprim cakësor/veprim jocabësor* dhe *veprim tërësor/veprim si proces*. Që të dyja këto teori kanë përkrahës të shumtë, por edhe kundërshtarë.

A) Sipas teorisë së parë, foljet e aspektit të kryer tregojnë veprime të cilat e arrijnë një cak (limit) të caktuar (në rusishte - *predjell*), ndërsa te foljet e aspektit të pakryer ideja e caktuar mungon.

Në përcaktimin e dallimeve ndërmjet aspektit të kryer dhe të pakryer, duke filluar nga vitet '50 të shekullit të kaluar, mbizotëruese u bë ideja e gjuhëtarit të njohur rus, V. Vinogradovit, sipas së cilit dallimi midis dy aspekteve qëndronte në praninë ose mungesën e caktuar të veprimit foljor.²⁹ Në fakt konceptimi i aspektit të kryer si paraqitje tërësore e veprimit, të kufizuar nga caku, nuk është tërësisht i ri në gramatikën ruse: së pari ai është formuluar nga Ll. Razmusen në fund të shek. XIX³⁰.

Pas Vinogradovit ideja e caktuar të veprimit u pasua dhe u zhvillua edhe nga gjuhëtarë të tjerë si (Ju. Maslov, N. Avilova, A. Bondarko, A. Llomov, M. Sheljakin, M. Gollovinskaja, E. Petruhina etj.) dhe është aktuale edhe në ditët e sotme. Por në punimet e studiuesve të mësipërm termi *cak i veprimit* saktësohet a ndërlikohet me nocionin *cak "i brendshëm" i veprimit*. P.sh., N. Avilova, autore e kapitullit "Kategoritë morfologjike të foljes" në Gramatikën ruse shkruan: "kufizim i veprimit nga caku do të thotë kufizim i veprimit nga caku i brendshëm abstrakt, i cili e paraqit veprimin si akt tërësor, të ndryshëm nga paraqitja e veprimit si proces që zgjat ose përsëritet"³¹.

Por ç'do të thotë *cak i veprimit* dhe *cak i brendshëm i veprimit*? Kur themi cak i një veprimi na vjen ndërmend kufiri, skaji, fillimi ose fundi i tij, ndërkohë që caku i brendshëm i veprimit s'mund të kuptohet ndryshe, veçse si skaj i veprimit brenda veprimit, si fillim a fund i veprimit në rrjedhën e tij.

Rreth pikëpamjes së parë është shfaqur mendimi se nocioni i caktuar të veprimit në thelb nuk është gjë tjetër vetëm se zëvendësimi terminologjik i nocionit të përfundimit. Veprimi arrin cakun, kur sendi, objekti që i nënshtrohet veprimit është përfshirë plotësisht prej tij (sendi mund të transformohet, rikrijohet, të ndryshojë vetitë e tij etj.). Psh.:

Вчера побелили стены. – Dje lyet muret.

Дрова сгорели. – Drutë u dogjën.

Siç del nga këta shembuj, është e vështirë, në mos e pamundur, të bësh dallimin midis veprimit që ka përfunduar, dhe veprimit që ka arritur cakun. Ideja e arritjes së caktuar nga veprimi, me fjalë të tjera, do të thotë se veprimi ka përfunduar.

²⁹ Vinogradov V.V., *Русский язык: грамматическое учение о слове*, М. 1972 (botimi i parë 1947).

³⁰ Размусен Л., *О глагольных временах и об отношении их к видам в русском, немецком и французском языках*. — Журнал министерства народного просвещения, 1891. № 6. <http://slovari.ru/default.aspx?s=0&p=5310&0a0=19>

³¹ "Грамматика русского языка" I, М. 1954.

Përkrahësit e kësaj teorie në ndonjë rast kanë operuar edhe me togfjalëshin trigjymtyrësh “cak i brendshëm cilësor”³² (*vnutrenij kacestvjenij predjell*), me sa duket për të mos e lidhur idenë e arritjes së caktut vetëm me foljet “objektore” (veprimi i të cilave përfshin një objekt).

Sipas mendimit tonë, edhe përdorimi i këtij termi nuk e përmirëson situatën për dy arsye:

Së pari, nuk mund të pranojmë që veprimi në vetvete ka një cak të brendshëm, aq më tepër cak të brendshëm cilësor të pavarur nga sendi.

Së dyti, nuk të bind fakti, që kuptimi i caktut të brendshëm cilësor është ai kuptim që përshkon tej e mbanë gjithë format e aspektit të kryer, me të cilin i përdor bartësi i gjuhës. Me fjalë të tjera, ky kuptim a është aq i kthjellët në vetëdijën e bartësit të gjuhës sa, fjala vjen, kuptimet e shkallëve të mbiemrave, kuptimi i numrit apo rasës tek emrat?

Në literaturën gjuhësore, sidomos në atë që i kushtohet problematikës së aspektit foljor të gjuhëve sllave, ndeshemi rëndom me pohime të tilla, si “*kategoria e aspektit është produkt i një pune abstraktuese mjaft të gjatë të mendimit njërëzor*”, “*kategoria e aspektit përbën një sistem mjaft të ndërlikuar kuptimesh*”, “*kategoria e aspektit është një nocion thellësisht abstrakt*” etj.³³.

Sikurse shihet edhe nga këto pak citime, karakteri abstrakt i kategorisë së aspektit gati-gati është fetishizuar. Vështirë është të besosh që mendimi njerëzor të ketë përpunuar një kategori të tillë aq abstrakte, saqë edhe vetë specialistët ta humbasin toruan, kur vjen puna për t’i dhënë formës gramatikore atë kuptim me të cilin ata vetë e përdorin korrekt në çdo hap. Më lehtë do të ishte t’ia besonin këtë gjë fantazisë abstrakte të specialistëve, sesa vetë dukurisë gjuhësore. Në përcaktimin e një forme gramatikore, në radhë të parë, duhet të mbështetemi në kuptimin në të cilin përdoret nga bartësi i gjuhës përkatëse. Në këtë kuptim, edhe aspekti, ashtu si kategoritë e tjera gramatikore, nuk mund të bëjë përjashtim.

B) Mbështetësit e pikëpamjes së dytë e shohin dallimin e semantikës *aspekt i kryer/aspekt i pakryer* në kuptimin *veprim tërësor/veprim si proces (cellostnoje djejestvije/djestvije kak proces)*. Kjo pikëpamje në zanafillë është më e hershme. Idenë e një veprimi tërësor e gjejmë në kursin e gjuhësisë së përgjithshme të F. de Sosyrit³⁴, por edhe tek disa autorë para tij. Kohët e fundit kjo pikëpamje ka zënë vend në mjaft studime, monografi e tekste të gjuhës ruse.

³² Bondarko A.V., *Vid i vremya russkogo gllagolla*. M., 1971.

³³ Koshevaja I.G., *Tipologicheskie strukturi jazika*, 1972, fq.41

³⁴ F.de Saussure, *Cours de linguistique g nerale*, 1967, fq.162

Në monografinë e A.V. Bondarkos “Vid i vremja russkogo gllagolla” gjejmë këtë përkufizim të aspektit të pakryer: “...*aspekti i kryer e shpreh veprimin në tërësinë e tij, por jo në zhvillim e sipër, ndërsa aspekti i pakryer, duke mos pasur tiparin e tërësisë së veprimit, mund të shprehë veprimin si proces*”³⁵.

Ky përcaktim është pranuar edhe nga autorët e tekstit të gramatikës së gjuhës ruse për studentët e degës së gjuhës ruse³⁶.

Kur bëhet fjalë për tërësi të veprimit, zakonisht mbahet parasysh perceptimi i veprimit si i pandashëm në faza të zhvillimit të tij (sipas Razmusenit “fillimi, mesi dhe fundi janë të përmbledhur në një”) ³⁷. Si argument i këtij këndvështrimi shërben edhe pamundësia e përdorimit të foljeve që tregojnë fazën e veprimit të tipit *начал, продолжал, кончил* (filloi, vazhdoi, mbaroi) me infinitivin e aspektit të kryer *написать* (shkruaj). Vetëm foljet e aspektit të pakryer mund të lidhen me foljet që tregojnë fazë veprimi *начал продолжал, кончил* (filloi, vazhdoi, mbaroi) me infinitivin e aspektit të pakryer të tipit *писать* (shkruaj). etj.)³⁸. Pra, edhe nga pikëpamja semantike aspekti në gjuhën ruse është një kategori e plotë. Kjo do të thotë që zgjedhja e njërit apo tjetrit aspekt mbart me vete një ngarkesë të caktuar semantike, e cila karakterizon shpalosjen e veprimit në kohë.

Megjithatë në gjuhën ruse ballafaqohemi edhe me disa raste, të cilat mbeten jashtë përkufizimit të mësipërm. Fjala është për përdorime të tilla të aspektit të pakryer që nuk kanë kuptimin e veprimit si proces (në zhvillim e sipër). P.sh.:

Каждый день он *прочитывал* несколько газет – Çdo ditë ai lexonte disa gazeta.

Каждое утро мама *приказывала* их убирать квартиру – Çdo mëngjes nëna i urdhëronte ata të pastronin shtëpinë.

Përdorimi i foljeve të aspektit të pakryer *прочитывал, приказывала* në fjalitë e mësipërme, më tepër ka të bëjë me konstatimin e veprimit, sesa me praqitjen e tij si proces. Arsyeja duhet kërkuar në semantikën e tyre leksikore dhe kontekstin ku ato përdoren. Ideja e procesit për këto folje përgjithësisht është e huaj. Këtë e dëshmon edhe fakti që ato nuk përdoren (ose përdoren në ndonjë rast të rrallë) në të tashmen. Në të shkuarën ato përdoren për të shprehur veprime të përfunduara, por që përsëriten. Ne i përmbahemi mendimit se

³⁵ Bondarko A.V. *Vid i vremya russkogo gllagolla*, M., 1971, fq.17

³⁶ Basha N., Xhelili A., *Sovremennij russkij jazik*, Morfollogia II, 1981

³⁷ Razmusen L., *vepër e cituar*

³⁸ *Ndërsa në gjuhën shqipe këto folje i gjejmë te trajtuara në mënyra të ndryshme. P.sh. në “Gramatika praktike e gjuhës shqipe” të M. Çelikut, M. Karapinjallit, R. Stringës ato trajtohen si folje me vlerë aspektore që tregojnë fillimin e veprimit. Po ashtu edhe tek “Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe” të A. Dhrimos, ato kundrohen gjerësisht, por autori në fjalë thekson se këto folje krahas kësaj vlere aspektore, kanë edhe vlera të tjera.*

kuptimi i procesit nuk është i pranishëm në të gjitha rastet e përdorimit të foljeve të aspektit të pakryer; ai lind në rrethana të caktuara kontekstuale.

Përfytyrimi i veprimit të aspektit të kryer si tërësor i kundërvihet një procesi eksplicit që mund të shprehet vetëm nga aspekti i pakryer: P.sh.: *Посмотри как ребенок спускается по лестнице* (*Shiko si fëmija po zbret shkallët*). Veprimi i shprehur nga folja *спускается* përbën fazën e mesme të zhvillimit të tij, është pikërisht kjo fazë që interpretohet si proces. Në raste të tilla kemi të bëjmë me shpalosjen e strukturës së brendshme kohore të rrjedhjës së veprimit: rrjedha e kohës sikur është e përfshirë në rrjedhën e shënuar nga veprimi. Vlen të theksojmë, se këtu bëhet fjalë pikërisht për një proces eksplicit.

Në vartësi nga konteksti format e aspektit të pakryer mund të shprehin jo vetëm veprime në rrjedhën e tyre, në proces, por edhe veprime të zakonshme, veprime që përsëriten, etj. Këto funksione të fundit nuk figurojnë në përkufizimin e A. V. Bondarkos, ndoshta sepse prania e tyre në të do të binte ndesh me idenë e invariantit gramatikor. Nuk mund të formojë kundërvëniet të pastër gramatikore veprimi tërësor me veprimin e zakonshëm, veprimin që përsëritet etj. Po për këtë arsye kuptimi i veprimit tërësor nuk mund të formojë kundërvëniet gramatikore me kuptimin e veprimit si proces.

Kuptimet e veprimit si proces, si i zakonshëm, si i përsëritur etj. nuk janë kuptime të kategorisë gramatikore të aspektit, por kuptime aspektuale të realizuara nga bashkëveprimi i formave aspektore me elemente të kontekstit ose me kuptime të kategorive të tjera, sidomos me kategorinë e kohës, por edhe me atë të diatezës dhe mënyrës, ashtu siç veprojnë ato edhe në vetë realitetin gjuhësor. Sa më shumë dritë të hidhet mbi proceset e këtij bashkëveprimi, aq më i kthjellët do të jetë edhe kuptimi i kategorisë së aspektit.

Sipas nesh, format aspektore janë të specializuara të shprehin gramatikiisht një nga karakteristikat e mundshme të veprimit foljor. Në gjuhën ruse, të pajisur me kategorinë morfologjike të aspektit, foljet e aspektit të kryer e paraqitin veprimin të tërësishëm, jo në rrjedhën e tij, tipar ky që u mungon foljeve të aspektit të pakryer. Tipari veprimit si *tërësor* që qëndron në themel të kundërvënies *aspekt i kryer/aspekt i pakryer*, mbështetet pikërisht mbi një proces objektiv të gramatikalizimit të bazës semantike të kundërvënies aspektore, dhe është rrjedhojë e procesit të zgjerimit të kuptimeve kategoriale të kundërvënies.

Edhe nga ky parashtrim i shkurtër i teorive rreth thelbit të kategorisë gramatikore të aspektit mund të arrijmë në përfundimin se vështirësia e klasifikimit të dallimeve kuptimore midis foljeve të aspektit të kryer edhe atij të pakryer qëndron jo aq në karakterin “thelësisht abstrakt” të kësaj kategorie në gjuhët sllave. Në radhë të parë paqartësitë a vështirësitë e përcaktimit të kuptimeve, të formave të aspektit të kryer edhe atij të pakryer kushtëzohen nga gërshetimi i kuptimeve të vetë formës gramatikore me kuptime leksikore, kontekstuale, apo me kuptime të kategorive të tjera. Ky ndërveprim i ngushtë bën që

përmbajtja kuptimore e kategorisë gramatikore në njëfarë mënyre të modifikohet, të fitojë ngjyrimë të ndryshme, të cilat, në njëfarë mase bëhen pengesë për të depërtuar në vetë thelbin kuptimor të saj.

2.3.1.2. Mekanizmi i formimit të aspekteve dhe çiftet aspektore

Në gjuhën ruse veprimi foljor rregullisht përfaqësohet nga dy palë forma, njëra e aspektit të kryer, tjetra e aspektit të pakryer (*кончить/кончатъ, открытъ/открыватъ, узнать/узнаватъ*). Dallimi midis tyre qëndron vetëm në kuptimin gramatikor të aspektit. Duke qenë të zhveshura nga çdo nuancë leksikore, ato formojnë çifte të mirëfillta aspektore (*видовуые пары*). Me gjithë prirjen që ka folja e gjuhës ruse për të formuar çifte aspektore, një numër foljesh në këtë gjuhë ndeshen vetëm në njërin prej aspekteve – në të kryerit ose të pakryerit. Disa autorë mendojnë se numri i foljeve njëaspektore është fare i vogël. Këtu ata përfshijnë folje të tilla si: *принадлежать, руководить, относиться* e ndonjë tjetër.

Disa të tjerë thonë se numri i foljeve njëaspektore është shumë më i madh nga sa është menduar zakonisht. Ky numër sipas tyre, rritet për llogari të foljeve pa parashtesa të tipit, *писать, лежать, делать* dhe të modifikimeve të tyre semantike me anën e parashtesave, përkatësisht: *написать, полежать, сделать*, nga të cilat këto të fundit janë vetëm të aspektit të kryer (*perfektiva tantum*), kurse të parat, vetëm të aspektit të pakryer (*imperfectiva tantum*).

Cila është arsyeja që foljet *писать/написать, лежать/полежать, делать/сделать* të mos merren si forma gramatikore të së njëjtës fjalë, pra të mos merren si çifte aspektore?

Dihet që shumica e foljeve pa parashtesa në gjuhën ruse i takon aspektit të pakryer *учить, делать, читать, пить, петь, кричать, бежать, стрелять, плыть, плавать* etj. Këtyre foljeve mund t'u bashkëngjiten parashtesa të ndryshme të cilat u japin atyre ose nuanca kuptimore plotësuese (*выучить, сделать, прочитать, выпить, попеть, закричать, сбежать, настрелять, поплыть, поплавать*), ose i shkëputin ato në leksema më vete (u japin kuptim të ri leksikor), psh.: *переделать, прибежать, убежать, уплыть* etj.

Përveç dallimeve semantike, formimet parashtesore ndryshojnë edhe për nga kuptimi gramatikor i aspektit. Të gjitha ato pa përjashtim kanë kuptimin e aspektit të kryer.³⁹ Kuptohet që foljet e aspektit të kryer *прибежать, убежать*, nuk mund të formojnë çifte aspektore me foljen e aspektit të pakryer *бежать*. Ato kanë kuptime leksikore të

³⁹ Kur parashtesa i bashkëngjitet një foljeje të aspektit të kryer *бросить – забросить, кончить – закончить*, formimet parashtesore mbeten po të aspektit të kryer, por kuptimi i tyre leksikor tashmë varet nga kuptimi i parashtesës.

ndryshme (*vij me vrap, largohet me vrap*). Edhe modifikimet semantike të tipit *выучить, прочитать, написать, сделать, поплыть* etj. nuk mund të formojnë çifte aspektore me foljet *учить, читать, писать, делать, плыть* etj., edhe pse ato emërtojnë të njëjtin veprim. Arsyeja qëndron në semantikën e parashtesave, të cilat determinojnë a ngushtojnë sado pak kuptimin e foljes prodhuese. Ndryshe nga mjaft autorë, ne pajtohemi me mendimin se në gjuhën ruse nuk ka asnjë parashtesë foljore që të jetë gramatikalizuar plotësisht.⁴⁰ Në të mirë të këtij pohimi flasim faktet gjuhësore.

Po analizojmë foljet *учить - выучить* në një dialog të shkurtër:

- *Выучил* урок? - спрашивает ученика учитель.
E ke mësuar mësimin? – pyet mësuesi nxënësin.
- *Учил*, - отвечает ученик.
Mësova – përgjigjet nxënësi
- Меня не интересует *учил* ли. *Выучил*? - возражает учитель.
S'më intereson, mësove s'mësove. Ke mësuar? - kundërshton mësuesi.

Nëse folja *учить* dhe *выучить* do të shprehnin të njëjtën gjë, mësuesi do të kënaqej nga përgjigja e nxënësit, dhe reagimi i tij do të ishte i pavend. Por reagimi i mësuesit në këtë rast është plotësisht i justifikuar. Përgjigjes së nxënësit me foljen *учил*, i mungon pikërisht ajo nuancë semantike (rezultati i veprimit) të cilën e ka formimi parashtesor *выучил*. Prandaj folja parashtesore e aspektit të kryer *выучить* nuk mund të përbëjë çift aspektor me foljen joparashtesore të aspektit të pakryer *учить*. Ato gjithnjë mbeten përkatësisht perfectiva tantum (*выучил*) dhe imperfectiva tantum (*учил*).

Po për të njëjtën arsye edhe modifikime të tjera parashtesore (folje që formojnë mënyra të ndryshme veprimi) mbeten njëaspektore. Po sjellim dhe një shembull tjetër. Folja *прочитать* merret zakonisht si korrelat i aspektit të kryer për foljen e aspektit të pakryer *читать*. Nga ana tjetër, nga folja parashtesore *прочитать* me anën e prapashtesës *-ыва-* ndërtohet forma e aspektit të pakryer *прочит-ыва-ть*. Pra, kemi këtë formim zinxhir:

читать —————> *прочитать* —————> *прочитывать*
(аспект i pakryer) (аспект i kryer) (аспект i pakryer)

Por a mund të jetë folja e aspektit të kryer *прочитать* njëkohësisht korrelat i çifteve aspektore *читать – прочитать* dhe *прочитать – прочитывать*. Nëse do t'i përgjigjeshim pyetjes *Что ты делаешь?* - Përgjigja do të jetë: *Я читаю (книгу)*, por jo *Я прочитываю (книгу)*. Kjo do të thotë që folja *читать* dhe *прочитать* dallohen kuptimisht. Kuptimi i parashtesës *про-* e pengon formën e aspektit të pakryer *прочитывать*, ta paraqesë veprimin në zhvillim e sipër në të tashmen. Bashkëngjitja e

⁴⁰ Исаченко А. В. *Грамматический строй русского языка в сопоставлении с словацким*. Ч. II: Морфология, Братислава, 1960.

parashtesës *про-* ka bërë që folja *прочитать* të tregojë një veprim të përfunduar që ka arritur një rezultat të caktuar. Prandaj si çift aspektor të mirëfilltë do të pranojmë ndërtimet *прочитать – прочитывать*, ndërsa folja *читать* mbetet njëaspektore, imperfectiva tantum.

Parashtesimi në fushën e foljes së gjuhës ruse sjell jo vetëm ndryshimin e aspektit të foljes, por domosdo determinon ose ngushton edhe kuptimin leksikor të foljes. Për rrjedhojë, ndërtimet parashtesore të aspektit të kryer asnjëherë nuk formojnë çifte aspektore me foljet pa parashtesa të aspektit të pakryer. Të njëjtin funksion si parashtesat, luan në gjuhën ruse dhe prapashtesa *-ну-*. Foljet e ndërtuara me këtë prapashtesë janë të aspektit të kryer dhe tregojnë se veprimi kryhet vetëm një herë, (*толкать – толкнуть, двигать – двинуть, прыгать – прыгнуть*).

Çiftet e mirëfillta aspektore në gjuhën ruse përftohen kryesisht me anën e prapashtesimit. Prapashtesat *-ыва-*, *-ива-*, *-ва-*, shndërrojnë formimet parashtesore të aspektit kryer në aspekt të pakryer. Psh.:

крыть – открыть – открывать
лечить – долечить – долечивать
бить – разбить – разбивать

Lidhur me formimin e aspekteve në gjuhën ruse mund të pohojmë se:

1. Parashtesimi në fushën e foljes së gjuhës ruse në çdo rast është i lidhur me shndërrimin e foljeve të aspektit të pakryer në të kryer *неть – спеть, резать – разрезать, рвать – вырвать*.
2. Parashtesimi në çdo rast shoqërohet me ndryshime në semantikën e foljes. Parashtesat e ndryshme mund të modifikojnë kuptimin leksikor të foljes (në këtë rast ato formojnë mënyra të veprimit foljor), por edhe mund ta kualifikojnë atë, duke krijuar kështu folje me kuptim të ri leksikor (leksemë të re). Krahaso: *писать – написать, учить – выучить*, por *писать – подписать, учить – разучиться*.
3. Parashtesimi në asnjë rast nuk krijon çifte të mirëfillta aspektore. Në kundërshtim me pikëpamjen e disa autorëve, ne jemi të mendimit se asnjë nga parashtesat foljore nuk është desemantizuar. Si rregull, formimet parashtesore janë njëaspektore, perfectiva tantum.
4. Çiftet e mirëfillta aspektore në sistemin foljor të gjuhës ruse formohen kryesisht me anën e prapashtesimit (prapashtesat *-ыва-*, *-ива-*, *-ва-*, por edhe pa këto mjete. Krahaso: *прочитать – прочитывать, устроить – устраивать, бросить – бросать*.

5. Edhe foljet e lëvizjes për nga mënyrat e formimit të aspekteve nuk bëjnë pëjshtim nga rregullsia e përgjithshme. Ashtu si edhe tek foljet e tjera, edhe tek ky grup foljesh veprojnë po të njëjtat mekanizma aspektor-formuese.

2.3.2. Rreth studimit të dukurive aspektuale në gjuhën shqipe

Gjuha shqipe bën pjesë në grupin e gjuhëve të ashtuquajtura “joaspektore”. Ky përcaktim mbështetet në mungesën e kundërvënies formale *aspekt i kryer/aspekt i pakryer*. Mungesa e mjeteve e posaçme morfologjike për shprehjen e kuptimeve gramatikore të aspektit foljor ka bërë që në asnjë nga gramatikat e derisotme të shqipes aspekti të mos renditet krahas kategorive gramatikore të tjera të foljes si mënyra, koha, diateza etj.

Në studimin e sistemit foljor të shqipes tradicionalisht vëmendja është përqëndruar në përshkrimin e mjeteve morfologjike të shprehjes së marrëdhënies kohore. Është hedhur dritë mbi kuptimet paradigmatiche e sintagmatike të formave kohore si dhe kushtet e realizimit të tyre. Gjatë përshkrimit të formave kohore të së tashmes dhe të së shkuarës së mënyrës dëftore, studiuesit janë ndeshur edhe me kuptime a nuanca të tjera të veprimit foljor, të cilat i përkasin një rrafshi tjetër semantik, edhe pse lidhen ngushtë me kohën. Kuptime a ngjyime të tilla, të cilat pasqyrojnë tipare a karakteristika të shumta të veprimit foljor (fazën e zhvillimit të veprimit, zgjatjen, përsëritjen e tij etj.) janë vështruar si kuptime aspektore.

Për aspekt foljor në gramatikat e shqipes është bërë fjalë vetëm kur janë marrë në shqyrtim kohët e foljes, por përveç konstatimeve fragmentare, dukuria gjuhësore e aspektit nuk ka gjetur pasqyrim të plotë në sistemin foljor të shqipes. Studimet për aspektin në gjuhën shqipe janë ende të pakta. Deri më sot problemet e aspektit foljor i gjejmë të trajtuara gjerësisht në monografinë e vetme të shkruar nga gjuhëtari Ali Dhrimo “Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe” (1996), si edhe në ndonjë punim doktore, ku dukuritë e aspektit foljor të shqipes janë vështruar në përjasje me gjuhë të tjera. Por le të bëjmë një parashtrim të shkurtër se ç’është kuptuar me aspekt në gjuhën shqipe?

Po e fillojmë me konstatimin më të hershëm të profesor K. Cipo, i cili në kapitullin e Sintaksës “Vërejtje rreth pjesëve të ligjëratës” i kushton disa faqe aspektit të foljes⁴¹.

Me aspekt prof. Cipoja kuptonte karakteristika të tilla të veprimit foljor si “*veprim që zgjatet apo bëhet sa çel e mbyll sytë; nëse ai veprim tregon fillim apo mbarim; na tregon edhe nëse ky veprim ndodh vetëm një herë dhe merr fund apo përsëritet herë pas here; na thotë akoma në bëhet drejtpërdrejtë nga subjekti, apo nga tjetërkush me urdhërin e tij*”. Sipas këtij konceptimi ky gjuhëtar i ndan foljet në dy kategori të mëdha: folje me aspekt të

⁴¹ Cipo K., *Sintaksa*, 1952, fq. 49-58

vazhduar ose të zgjatur, (*ndjek, zhvilloj, rri, fle* ose siç i quan ai, - me veprim vijë), dhe folje me aspekt të çastësisë (*kap, prek, zë* – me veprim pikë).

Siç shihet, një ndarje e tillë që mbështetet tërësisht në semantikën individuale të kësaj apo asaj foljeje edhe mund të bëhet, por më së shumti ajo do të vlente për të vënë në dukje disa specifika të funksionit të ndajfoljeve në bashkëvjajtje me folje a grupe foljesh të caktuara.

Nga ana tjetër, duhet vënë në dukje se edhe foljet e veprimit “pikë” për t’u realizuar duan kohën e tyre, sado të shkurtër, madje veprimi i tyre mund të paraqitet në zhvillim e sipër. Krahaso: *kur e preka në plagë... – kur po e prekja në plagë...*

Gjuhëtari B. Beci konstaton në të folmet e zonës së Matit ndërtime me vlerë aspektore. Si të tilla ai sjell konstruktet e gegërishtes të tipit *jam tu fol, isha tu fol, qesh tu fol* (*jam/isha, qesh duke folur*). Sipas tij ato kanë “aspektin e vijimësisë”⁴². Sipas studiuesit E. Lafe format foljore të tipit *jam duke folur, isha duke folur, qesh duke folur* në gjuhën shqipe shprehin aspektin e vazhdimësisë dhe të zgjatjes së veprimit. Dukurinë gjuhësore të përsëritjes së veprimit autori e sheh si mjet të preferuar të shqipes për shprehjen e aspektit. Ky gjuhëtar bën fjalë për aspekt iterativ, durativ dhe intensiv të shprehur me anë të përsëritjes krahas formës foljore të së pakryerës, të cilën ai e vështron si formë të aspektit durativ, ndërkohë që tek e kryera e thjeshtë dhe e kryera gjen kuptimin e aspektit perfektiv. Aspekti sipas prof. Lafes përbën në gjuhën shqipe një kategori leksiko-gramatikore.⁴³

Duke analizuar nga pikëpamja strukturore e kuptimore disa togje foljore (sipas të folmeve të Shqipërisë së Mesme) të tipit *zë* (*nis, filloj, bëj, marr*) + dëftore ose lidhore (*zë e flas, filloj të shkruaj* etj.) M. Çeliku shprehet se ato kanë kuptimin aspektor të fillimit të veprimit⁴⁴. “Fillimi i veprimit, zgjatja, përsëritja, shpejtësia e realizimit” janë, sipas autorit, kuptime modale të aspektit.

Një analizë më të plotë të këtyre ndërtimeve foljore e gjejmë në artikullin e M. Totonit “Konstrukte me folje aspektore të fillimit të veprimit në gjuhën shqipe”⁴⁵. Edhe ky gjuhëtar *foljet, filloj, zë, nis*, i quan folje tipike aspektore për shprehjen e kuptimit të fillimit të veprimit. Këto folje, sipas tij, duke mos shprehur as veprim, as gjendje e kanë bjerrë kuptimin konkret të tyre dhe në konstrukte të caktuara ato fitojnë kuptimin aspektor të fillimit të veprimit (*zuri e qau, filluan të largoheshin, nisi të tregojë*). “Duke qenë i përcaktuar në fillimin e tij, veprimi i shprehur nga konstrukte të tilla paraqitet si një proces që zgjatet, që fillon dhe vazhdon të kryhet”⁴⁶.

⁴² Beci B. *Hulumtime gjuhësore në Mat*, BUSHT, SSHSH, Tiranë, 1963, 3

⁴³ Lafe E. *Përsëritja si mjet gramatikor i shprehjes së aspektit dhe shkallës sipërore në gjuhën shqipe, e parë edhe në krahasim me rumanishten*, SF, Tiranë 1966, 4

⁴⁴ Çeliku M., Karapinjalli M., Stringa R. “*Gramatika praktike e gjuhës shqipe*”, Tiranë, 2007

⁴⁵ Ttoni M., “*Konstrukte me folje aspektore të fillimit të veprimit në gjuhën shqipe*, SF.1, 1968

⁴⁶ Ttoni M., artikull i cituar, fq.89

Studiuesja ruse G.I. Ejntrej konstaton kundërvëniet e aspekteve të foljetit të formuara me anë të disa parashtesave.⁴⁷ Ajo mendon se parashtesat e shqipes mund ta shndërrojnë foljen durative në terminative, inkoative ose, duke ndryshuar dhe plotësuar semantikën e tyre, formimet parashtesore shënojnë fillimin, cakun e veprimit etj.

Parashtesat **zh-(sh)**, **ç-**, shkruan ajo, kur i bashkëngjiten foljes, i japin asaj nuancën e përfundimit të veprimit, dhe vënë në dukje prirjen e veprimit drejt caktit (*armatos-çarmatos*, *ngarkoj-shkarkoj*, *palos-shpalos*). Ne kemi përshtypjen se midis foljeve parashtesore dhe atyre pa parashtesë (foljet *ngarkoj-shkarkoj* janë të dyja parashtesore nga e njëjta temë prej burimi të huaj), përveç kuptimit të kundërt, nuk ka asnjë nuancë semantike plotësuese, e cila mund të merrej si kundërvënie aspekteve. Po kështu i pakapshëm është edhe kuptimi i fillimit të veprimit tek foljet *përvesh* (mëngët), *ndërpres* etj., të formuara përkatësisht nga foljet *vesh* dhe *pres*, me anën e parashtesave *për-* dhe *ndër-*.

Funksioni që u njeh G. Ejntrej parashtesave të shqipes në formimin e kundërvëniet e aspekteve është i paqenë. Midis foljeve të tilla, si *armatos-çarmatos*, *palos-shpalos*, *vesh-zhvesh* etj., nuk mund të bëhet fjalë për kundërvënie aspekteve. Është me rëndësi të theksojmë se aspekti është një kategori gjuhësore dhe jo logjike. Prandaj s'mund të pajtohemi me autoren në fjalë që fillimisht e përfytyron aspektin si një kategori të mendimit, pastaj, pa e ndërprerë atë, e projekton në sferën e gjuhës duke kërkuar mjetet e shprehjes së niveleve nga më të ndryshmet, nga ato leksikore deri tek mjetet sintaksore.

Parashtesimi në fushën e foljes së shqipes nuk çon në perfektivimin e saj. Parashtesat e ndryshme, kur u bashkëngjiten foljeve, sjellin me vete ndryshime të qenësishme në kuptimin leksikor të tyre: *bëj-përbëj*, *ziej-përziej*, *vesh-zhvesh*, *palos-shpalos*, *shikoj-parashikoj*, *laj-përlaj*, *laj-shpëlaj*, *kthej-përkthej* etj. Ndërkaq duhet vënë në dukje se disa parashtesa të shqipes si *për-*, *sh-*, *stër-*, *shtër-*, etj. në disa formime nuk ia ndryshojnë kuptimin leksikor temës prodhuese, *thaj-përthaj*, *prish-shprish*, *mundoj-stërmundoj*, *zgjas-stërzgjas*. Te këto folje, parashtesat nuk kanë ndonjë funksion të dukshëm, megjithatë veprimi i shprehur prej tyre është më intensiv. Këto raste relativisht të kufizuara në gjuhën shqipe nuk kanë të bëjnë me kuptimet gramatikore të aspektit të mirëfilltë, por, siç do të shtjellohet në sytë në vijim, me mënyrat e veprimit foljor.

Në gjuhën shqipe është bërë fjalë edhe për “aspekt gramatikor”, pra për forma gramatikore të foljes, të cilat i kundërvihen njëra-tjetrës nga kuptimi aspektor. Gjuhëtari F. Agalliu pohon se dallimi midis së kryerës së thjeshtë *shkova* dhe së pakryerës *shkoja* nuk është kohor, por aspektor.⁴⁸

⁴⁷ Ejntrej, G.I., *K voprosu o vido-vremennih otnoshenijah v sisteme allbanskogo jazika në “Grammaticheskij stroj ballkanskij jazikov”*, 1976

⁴⁸ Agalliu, F., *Vëzhgime mbi kuptimet e disa trajtave kohore*, SF, Tiranë, 1968, 2.

Një pohim të tillë, por disi më të plotë, e gjejmë edhe në kapitullin e foljes, të shkruar nga prof. Sh. Demiraj për maketin e Gramatikës së gjuhës shqipe (1971)⁴⁹. Autori shkruan se dallimet midis së pakryerës, së kryerës së thjeshtë dhe së kryerës kanë më fort karakter aspektor. E pakryera zakonisht e paraqit veprimin në zhvillim e sipër në një çast të caktuar të së shkuarës, kurse e kryera e thjeshtë zakonisht e paraqit veprimin të përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës. Përsa i përket së kryerës, kjo përdoret kryesisht për të shprehur përfundimin e veprimit në lidhje me çastin e ligjërimit.

Në punime a vepra të mëvonshme prof. Demiraj disa mendime të shprehura më parë i ka saktësuar a plotësuar. Kështu, për të kryerën ai vëren se ajo karakterizohet nga një sintezë e aspektit të kryer (veprim i përfunduar) dhe aspektit të pakryer (gjendje e përfutur si rezultat i veprimit të përfunduar).

Në monografinë “*Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*” prof. A. Dhrimo ndryshe nga autorët e sipërmendur, veçon aspektin prej mënyrave të veprimit. Ai është i mendimit se kategoria morfologjike e aspektit është e pranishme në sistemin foljor të shqipes. Sipas tij “aspekti i kryer e vështron veprimin si një të tërë, të mbyllur, kurse aspekti i pakryer nuk merr qëndrim fare për këtë anë të veprimit, pra e lë të pashprehur këtë anë të tij”.⁵⁰

Kundërvënien aspekt i kryer/aspekti i pakryer ky studiuës e gjen jo vetëm në dallimet midis së kryerës së thjeshtë dhe së pakryerës, por edhe tek format e së tashmes të tipit *po vrapoj* (aspekt i kryer)/ *vrapoj* (aspekt i pakryer). Për analogji të njëjtën kundërvënie e gjen edhe te e pakryera. (Më gjerë për konceptin e prof. Dhrimos mbi aspektin në gjuhën shqipe do të bëhet fjalë në kreun III).

Ka edhe studiuës që e mohojnë praninë e kategorisë gramatikore të aspektit te format kohore të foljes. Një qëndrim të tillë e gjejmë te gjuhëtari rus A.P. Sytov, i cili veçon tri lloje kundërvëniesh me vlerë aspektuale në gjuhën shqipe: kundërvëniet *imerfekt/aorist*, *progresiv/joprogresiv*, *perfekt/inperfekt*. Kundërvëniet në fjalë ai i shikon si elemente strukturuese të fushës semantike të aspektualitetit, të cilat ndryshojnë nga kundërvënia gramatikore *aspekt i kryer/aspekt i pakryer*.

Një pikëpamje të përafërt ka shprehur edhe prof. A. Xhelili, i cili mendon se “në gjuhën shqipe mund të bëhet fjalë për kuptime aspektuale të njëjës ose tjetrës trajtë kohore, por jo për kundërvënie *aspekt perfektiv ose imperfektiv*”.⁵¹

⁴⁹Shih gjithashtu: *Fonetika dhe Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, II, 1976, fq.234

Demiraj, Sh., *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, SF.3, 1977, fq.117-119

⁵⁰Dhrimo.A, *Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1996.

⁵¹Xhelili A. *Sistemi aspektoro-kohor i gjuhës ruse, vështruar në përfaqje me gjuhën shqipe*” (Autoreferat, Tiranë, 1983).

Pikëpamje të ngjashme i gjejmë edhe disa studiues të tjerë të huaj si A. V. Desnickaja, V. Fiedleri etj., Sipas tyre kundërvënia aspekt perfektiv/aspekt imperfektiv nuk është karakteristike për gjuhën shqipe.⁵²

Pikëpamjet e shprehura rreth aspektit në gjuhën shqipe mund t'i grupojmë si më poshtë:

Grupi i parë përmbledh pikëpamjet e atyre studiuesve që aspektin në sistemin foljor të shqipes e vështrojnë si dukuri të rrafshit leksikor (K. Cipo, M. Totoni, M. Çeliku etj.).

Grupin e dytë e përbëjnë pikëpamjet e atyre gjuhëtarëve, të cilët e piketojnë aspektin në rrafshin gramatikor (F. Agalliu, Sh. Demiraj, A. Dhrimo etj.).

Si pikëpamjet e grupit të parë, ashtu edhe ato të grupit të dytë, nuk i qëndrojnë kritikës. E meta kryesore e pikëpamjeve të “aspektit leksikor” mendojmë se lidhet me fshirjen e dallimit midis vetë aspektit dhe klasave semantike të foljeve. Përkimi i plotë i kuptimeve aspektore me klasifikimin semantik të foljeve në klasa e lë të diskutueshme çështjen se ç’përfaqësojnë aspektet dhe ç’përfaqësojnë grupimet semantike të foljeve.

Lidhur me të ashtuquajturin “aspekt gramatikor” duam të vëmë në dukje se studiuesit që kundërvëniet e formave kohore i vështrojnë si kundërvëniet aspektore lënë të hapur çështjen e vetë thelbit dhe kufijve të kategorive të kohës dhe aspektit, si dhe çështjet e përmbajtjes dhe mjeteve për realizimin e tyre .

Ekziston edhe *një grup i tretë* gjuhëtarësh (V. Fiedleri, A. V. Desnickaja, A. Xhelili etj.), të cilët “aspektin leksikor” dhe “aspektin gramatikor” i konsiderojnë si *mënyra veprimi* brenda fushës semantike funksionale të aspektualitetit. Sipas këtij këndvështrimi sistemi foljor i shqipes nuk karakterizohet nga aspekti në statusin e kategorisë gramatikore.

Studimet për aspektin e gjuhës shqipe, edhe pse të pakta në numër, të kryera më së shumti në rrafshin formal dhe jo aq në rrafshin përmbajtësor, shpesh kanë sjellë paqartësi në kuptimin dhe shpjegimin e vetë thelbit të aspektit. Kjo ka çuar në njëjtësimin e semantikës së komponentëve aspektualë me kuptimin kategorial të kundërvënies *aspekt i kryer/aspekt i pakryer* të gjuhëve sllave. Sipas mendimit tonë, në gjuhën shqipe mund të flitet për opozicione me vlerë aspektuale, por jo për opozicione aspektore të tipit *aspekt i kryer/aspekt i pakryer* si në gjuhën ruse.

⁵² Десницкая А.В. *О морфологической структуре албанского языка*, ВЯ, Москва, 1958, 5.

Fiedler W. *Zur Kategorie der Aspekte in dem Balkansprachen*, Zeitschrift für Slawistik, Bd. XV. Heft 1, 1970.

Polemikat, kundërthëniet dhe vështirësitë në diferencimin e semantikës aspektuale nga ato temporale kanë të bëjnë kryesisht me mpleksjen e kuptimit leksikor të vetë foljes dhe përdorimit të saj në këtë ose atë kontekst a situatë aspektuale

2.4. Tipologjia e situatave të përdorimit të aspekteve dhe disa veçori të përkthimit të tyre në gjuhën shqipe

Kuptimet kategoriale gramatikore të aspekteve realizohen në kushte të ndryshme kontekstuale. Në vartësi prej tyre veçohen disa tipa të caktuar përdorimesh të formave të aspektit të kryer dhe të aspektit të pakryer, të cilët në literaturën gjuhësore njihen edhe me termin “*kuptimet e veçanta të aspekteve*”⁵³, veçse përdorimi i termit “kuptimet e veçanta të aspekteve” krijon idenë sikur këto kuptime shprehen vetëm me anë të aspektit foljor. Në fakt kuptimet e veçanta aspektore janë të pranishme në kontekste të caktuara të realizuara edhe me pjesëmarrjen e aspektit. Me fjalë të tjera, kuptimet e veçanta të aspekteve janë variante të semantikës së përgjithshme të aspekteve të kushtëzuara nga konteksti.

Është me rëndësi, gjithashtu, të bëhet dallimi midis tipave të përdorimit (funksionimit) të aspekteve dhe kuptimeve kategoriale gramatikore të aspekteve. Ato grupohen mbi bazën e situatave aspektuale, të cilat shprehen me anë të komponentëve të ndryshëm të thënies, treguesve gramatikorë e leksikorë.

Me mbështetjen edhe të kontekstit format aspektor-kohore të gjuhës ruse janë të afta të modifikojnë rrjedhën a shpërndarjen e veprimit në kohë, ta paraqitin atë herë si një veprim konkret të veçuar e herë si veprim në proces, herë si një veprim të përsëritur e herë si veprim të përgjithësuar, herë si veprim të vazhduar e herë si veprim të ndërprerë, herë në kuptimin e perfektit/pluskuamperfektit/aoristit e herë në kuptimin e imperfektit.

I gjithë ky informacion aspektual që realizohet nga pjesëmarrja e aspekteve në bashkëvajtje me mjetet e tjera të kontekstit kërkon vëmendje të posaçme nga përkthyesi.

Semantika aspektuale që shprehet nëpërmjet kategorisë morfologjike të aspektit në gjuhën ruse, edhe pse nuk gjen barasvlerës gramatikorë në gjuhën shqipe, mund të kompensohet a neutralizohet në përkthim përmes përdorimit të elementeve të kontekstit. Sa më i gjerë të jetë konteksti me elemente leksikore, aq më më tepër neutralizohet a zbehet roli i kuptimit gramatikor të formës aspektore.

⁵³ Bondarko A.V. *Teoria funksionalnoy gramatiki. Vvvedenie v Aspektualnost'. Vremennaya llokalizovanost'*. Taksis. L., 1987, fq. 123.

Maslov J.S. *Sistema chastnih vidovih znacheniy i tipi protivopostavleniy sovershennogo i nesovershennogo vida* // Maslov J.S. *Ocherki po aspektologii*. I, 1984, fq.72-74.

Bondarko A.V, *Vid i vremya russkogo gllagolla*, M., 1971, fq.128
Gramatika e Gjuhës Ruse, 1980, vëll.2

Për të ilustruar këtë që thamë po sjellim dy shembuj. I pari ka të bëjë me përdorimin e formës së aspektit të pakryer që shënon një veprim që kryhet disa herë në mënyrë jo të rregullt.

Это со мной *бывает*, точно ребёнок (Достоевский).

Kjo më *ndodh* mua, njësoj si fëmijë.

Në përkthimin e tekstit të mësipërm përdorimi i foljes së shqipes *ndodh* e lë disi të mangët e të përgjithshëm kuptimin foljes së rusishtes *бывает*, sepse folja e shqipes, e vetme, nuk jep idenë e një veprimi që ndodh jo rregullisht. Ky kuptim aspektual i formës së aspektit të pakryer në rusisht mund të kompensohet në gjuhën shqipe me mjete leksikore, siç mund të ishte në tekstin e mësipërm përfshirja e ndajfoljes *ndonjëherë* (*nganjëherë*). Krahaso: Kjo më *ndodh* mua **ndonjëherë**, njësoj si fëmijë.

Shembullin e dytë po marrim nga shqipja:

Në këtë kohë ai *ishte larguar* nga Shqipëria.

К этому времени он *уехал* из Албании

Përkthimi i mësipërm në pamje të parë duket korrekt, por ai s'është i tillë. Sikur fjalinë në gjuhën ruse *К этому времени он уехал из Албании* ta përkthenim në shqip, do të kishim variantin *Në këtë kohë ai u largua* nga Shqipëria dhe jo variantin me pluskuamperfektin *ishte larguar*. Kujtojmë se rusishtja, ndryshe nga shqipja, ka vetëm dy forma të së shkuarës, një për aspektin e kryer dhe tjetrën për aspektin e pakryer. Të dyja format mbulojnë të vetme gjithë spektrin semantik të formave absolute të së shkuarës dhe kuptimin taksisor të formave relative. Që të përcjellë kuptimin e puluskuamperfektit, konteksti ku është përdorur folja *уехал* duhet zgjeruar edhe me ndonjë mjet tjetër leksikor shtesë. P.sh., përfshirja në tekstin e përkthimit të ndajfoljes *уже* do të theksonte pikërisht kuptimin pluskuamperfektor. Krahaso: **К этому времени он уже уехал** из Албании. Përdorimin pluskuamperfektor të foljes ruse *уехал* e mundësojnë pikërisht dy treguesit leksikorë, ndajfoljet “**к этому времени**” dhe “**уже**”. Në kontekstin e ri përkthimi i foljes së rusishtes *уехал* me të kryerën e thjeshtë të shqipes do të ishte i pavend. Ndërtimi **Në këtë kohë ai tashmë u largua** nga Shqipëria, të vret veshin.

Sikurse shihet nga shembujt e mësipërm, mospërkimet në strukturat gramatikore midis gjuhëve bëhen shkak për vështirësi të caktuara në përkthim, por jo të pakapërcyeshme. Le të shohim më me hollësi përdorimin e aspekteve të gjuhës ruse në situata të ndryshme aspektuale dhe mundësitë e shqipes për të pasqyruar mënyrën e paraqitjes dhe shpërndarjes së veprimit foljor në kohë.

2.4.1. Tipat e situatave aspektuale

Semantika e kategorive gramatikore, ndër to edhe ajo e kategorisë së aspektit, konkretizohet dhe mbushet me përmbajtje reale gjatë të funksionimit në akte të shumta ligjërimore. Me gjithë shumëllojshmërinë e tyre, ato mund të tipizohen në struktura përmbajtësore ose siç quhen ndryshe situata kategoriale, ku secila prej tyre pasqyron një ndër variantet e situatës së përgjithshme semantike të thënies, në rastin konkret të situatës aspektuale.

Situata aspektuale s'është gjë tjetër veçse një nga karakteristikat kategoriale të thënies. Në gjuhën ruse dallohen katër tipa situatash aspektuale, brenda së cilave përmbledhet e gjithë shumëllojshmëria e përdorimit të aspekteve:

- 1) situata e një veprimi faktik të veçuar;
- 2) situata e një veprimi që përsëritet;
- 3) situata e tiparit të përhershëm të veprimit në proces;
- 4) situata e faktit të përgjithësuar.

Foljet e aspektit të pakryer (AP) i pasqyrojnë të katër tipat e mësipërm të situatave aspektuale. Më të shpeshta ndër to janë situata e veprimit konkret në proces dhe situata veprimit që përsëritet.

Foljet e aspektit të kryer (AK) marrin pjesë vetëm në dy situata aspektuale nga katër të mundshmet: në shprehjen e një veprimi konkret që nuk përsëritet dhe në përcjelljen e një situatë aspektuale të veprimeve të zakonshme ose të përsëritshme.

Po i shqyrtojmë më nga afër situatat aspektuale të mësipërme me pjesëmarrjen e formave të aspektit të kryer dhe aspektit të pakryer.

2.4.1.1. Tipat e përdorimit të aspektit të pakryer

Kuptimi me të cilin foljet e aspektit të pakryer përdoren më shumë njihet si **kuptimi i një veprimi konkret në proces** (*veprim konkret procesual*). Të përdorura me këtë kuptim foljet e aspektit të pakryer shprehin proces a gjendje, të cilat zgjasin në çastin që i konstatojmë: Po sjellim dy situata dhe përkthimet e tyre në gjuhën shqipe:

- 1) Не мешай, я работаю.
Mos më pengo, po punoj.

Në këtë rast çasti i konstatimit përkon me çastin e ligjërimimit, veprimi paraqitet në proces.

- 2) Когда Анна вошла в комнату, Долли сидела в маленькой гостиной с белоголовым пухлым мальчиком, уж теперь похожим на отца, и слушала его урок из французского чтения. /L. Tolstoi, "Anna Karenina", fq.69,
Ana e gjeti Dolin në sallonin e vogël pranë djalit topolak dhe flokëverdhë, që i ngjante shumë të atit. Po i dëgjonte mësimin e frëngjishtes. /"A.Karenina", f.64.

Në rastin e dytë çasti i konstatimit të veprimit është i fiksuar te veprimi i fjalisë së varur *Когда Анна вошла в комнату...* (Kur Ana **hyri** në dhomë). Në përkthim kjo strukturë nuk është ruajtur.

Përdorimet e mësipërme të formave së aspektit të pakryer janë përcjellë me të tashmen aktuale me pjesëzën *po* (1) dhe të pakryerën (2), të cilat e paraqin një veprim konkret në zhvillim e sipër në çastin e konstatimit.

Kuptimi konkret në proces realizohet në të tashmen, të shkuarën dhe të ardhmen. Në këtë kuptim kundërvënja aspekt i kryer/aspekt i pakryer është maksimale dhe zëvendësimi i aspektit të pakryer me të kryerit ose është i pamundur, ose e zhvendos ngjarjen në një aks tjetër kohor që përkon jo me çastin e ligjërit, por me kohën e një veprimi tjetër. Krahaso:

Когда я пришёл, мой друг открывал (AP) бутылку вина.
Kur erdha, shoku im *po hapte* një shishe verë.

Когда я пришёл, мой друг открыл (AK) бутылку вина.
Kur erdha, shoku im e *kishte hapur* shishen e verës.

Në rastin e parë folja e aspektit të pakryer (*открывал*) shpreh një veprim në **proces** në të pakryerën, bashkërvënës me veprimin e foljes në fjalinë e varur, ndërsa në shembullin e dytë zëvendësimi i formës së aspektit të pakryer me të kryerit (*открыл*) shpreh një veprim të **përfunduar** që i paraprin veprimit të foljes në fjalinë e varur. Zëvendësimi formave aspektore me njëra-tjetrën, në vartësi nga konteksti, kushtëzon në gjuhën shqipe zëvendësimin e formave brenda kohëve absolute, ose të formave absolute me format relative.

Si pjesë e veprimit konkret në proces është edhe kuptimi *k o n a t i*⁵⁴ tek disa ndërtime me pranëvënie të foljeve të të dy aspekteve të tipit: *уговаривал, но не уговорил; встречал, но не встретил; решал, но не решил; доганял но не догонил.*

Në këto raste folja e aspektit të pakryer ka kuptimin *përpiqem* (të bëj diçka, ndërsa folja e aspektit të pakryer me pjesëzën mohuese tregon për pamundësinë e arritjes së rezultatit. Në

⁵⁴ Nga *lainishtja conatus sum – përpiqem.*

këto kundërvënie kontekstuale të dy formave aspektore që qëndrojnë pranë njëra tjetrës, më së shumti theksohet kuptimi leksikor i foljes në një. Psh.:

Весь день уговаривал его, но не уговорил.

Transmetimi i kuptimit konativ nga rusishtja në shqip kërkon nga përkthyesi të përshkruajë kuptimet e shprehura nga e njëjta folje të përdorur në të dy aspektet. Në gjuhën shqipe kuptimi i këtij grupi foljesh mund të jepet sipas modelit “*përpiqem <të bëj diçka>*”, por nuk “*arrij*” rezultatin e pritur. Krahaso përkthimin e shembullit të mësipërm Gjithë ditën *u përpoqa ta bind* atë, por nuk *arrita* (*nuk munda, pa rezultat*).

Kuptimi konkret procesual në gjuhën ruse nuk është gjithpërfshirës, atë nuk e kanë të gjitha foljet e aspektit të pakryer. Përrjashtim bëjnë ato folje që nuk mund të përshkruajnë situata konkrete në proces. Po përmendim disa klasa foljesh tek të cilat ky kuptim nuk është i pranishëm.

Kategorinë e parë e përbëjnë foljet që tregojnë gjendje jokonkrete ose veprime, të cilëve u mungon tipari i procesualitet. Këtu përfshihen një numër i madh foljesh të tipit: *знать, понимать, уважать, любить, существовать, стоить, думать <что>, пребывать, (di, kuptoj, respektoj, dashuroj, ekzistoj, qëndroj, mendoj <që>, qëndroj diku).*

Megjithatë nuk përjashtohen rastet, kur foljet statike krijojnë idenë e procesit. P.sh.:

... Подумав, князь сказал: - Мне жалко этого человека. И мне не только что жалко, но вот и чувствую, что *присутствую*, при какой-то громадной трагедии души.../A.Kuprin, Granatovij braslet/

...Pasi u mendua princi foli: – Më vjen keq për këtë njeri. Dhe jo vetëm që më vjen keq, por e ndjej që *po marr pjesë* në një tragjedi të madhe shpirtërore... /A.Kuprin, Vyzylyku me gurë të kuq, shqipëruar nga M.Maçi/

– Что ж ты *стоишь*, разве порядку не знаешь? Приказывай жене-то, как жить без тебя. /A.N.Ostrovskij, Groza, fq.231/

– Ç’*po rri* si i shastisur? A s’i di zakonet ruse? Porosite tët shoqe si duhet të sillet, kur të mos jesh ti. /Shtërgata, S.Luarasi, fq.37/

Grupin tjetër të foljeve që nuk mund të kenë kuptimin e një veprimi konkret në proces e përbëjnë foljet, të cilat tregojnë llojin e veprimtarisë: *править (страной), руководить, управлять, командовать, воспитывать, царствовать etj. [drejtoj (vendin), udhëheq, drejtoj, komandoj, eduko, mbretëroj].*

Kuptimin e veprimit konkret si proces nuk e kanë edhe disa folje të tjera të tipit *хаживать, сиживать, бывать, почитывать* etj., të cilat shprehin mënyrën e përsëritjes dhe të përshkallëzimit sasior të veprimit, si dhe foljet që tregojnë vetëm çastin e arritjes së qëllimit, por jo procesin që të çon tek arritja e qëllimit, si *находить, достигать, приходить, приезжать* etj. [gjej, arrij, vij (më këmbë, me tjet transporti)].

Foljet e aspektit të pakryer i gjejmë të përdorura edhe në të ashtuquajturat kuptime periferike. Si i tillë veçohet *кuptimi potencial* i një veprimi, pra kuptimi i *aftësisë* a *mundësisë* për të kryer një veprim. Krhs.: Она *говорит* по русски = «*умеет говорить*» (Ai *flet* rusisht = *di të flasë rusisht*). Këtë kuptim e kanë foljet që tregojnë aftësi të lindura ose shprehi të fituara, p.sh.: *видеть, слышать, ходить*, (ребёнок *умеет* ходить - fëmija *di të ecë*), *говорить, плавать, читать, летать, играть* <на скрипке>, *танцевать, рисовать, водить* <машину> etj.

Disa prej foljeve të sipërpërmendura njohin përdorimin e tyre në kuptimin konkret, disa të tjera jo. Nëse do të bënim pyetjen “*Что он делает сейчас?*” (Ç’po bën ai tani?), do të përgjigjeshim: “*Плавает, играет на скрипке, рисует, пог jo водит машину*”. Ja disa shembuj:

Оказалось, что Джемма *читала* точно, превосходно – совсем по актёрски....
/I.S.Turgenjev, “Vjesennie vodi”, fq.17/.

...Dukej sheshit që Xhema vërtet *lexonte* bukur, pothuaj si aktore....
/I.S.Turgenjev, shqipërues J.Bllaci, “Ujrat pranverore”, fq.23/

Kuptimi i përsëritjes së veprimit ose siç quhet ndryshe **kuptimi iterativ**, zë një vend të veçantë në funksionimin e foljeve të aspektit të pakryer. Format e aspektit të pakryer përdoren për të emërtuar ngjarje që përsëriten, p.sh., Он *каждое утро заваривал* себе чай (Ai çdo ditë *ziente* çaj për vete). Zëvendësimi i formës së AP me formën e AK do të jepte të njëjtën ngjarje, por tashmë ngjarja ndodh vetëm një herë, p.sh., Он *заварил* себе чай (Ai *zieu* çaj për vete).

Kuptimin e përsëritjes së veprimit mund ta kenë të gjitha kategoritë e foljeve, semantika e të cilave përmban nuancën kuptimore të përsëritjes së veprimit. Para së gjithash në këtë kuptim dalin foljet që tregojnë ngjarje ose proces. Shembuj:

Каждый день, *приходя* с работы, он *открывает* окно и два часа *спит*.
Çdo ditë, kur vjen nga puna, ai *hap* dritaren dhe fle dy orë.

...В десять часов утра она *уходила* в школу, *являлась* домой к трём; от пяти до семи *гуляла* с ребёнком и книгой в саду, в семь снова *уходила* заниматься с любителями хорового пения; *возвращалась* поздно. Иногда её *проводил*

регент соборного хора, длинноволосый коренастый щёголь .../M.Gorkij, “Jeta e Klim Samginit”/

... Në dhjetë të mëngjesit ajo *largohej* për në shkollë, dhe *dukej* në shtëpi aty rreth orës tre; nga ora pesë deri në shtatë *shëtiste* në kopësht me fëmijën dhe me një libër me vete, në shtatë *ikte* përsëri për t’u marrë me amatorët e këngëve të korit, dhe *kthehej* vonë. Nganjëherë atë e *shoqëronte* drejtuesi i korit të katedrales, një burrë sqimatar, shpatullgjerë, me flokë të gjatë...

Në serinë e kuptimeve të veçanta tek foljet e aspektit të pakryer studiuesit dallojnë edhe **kuptimin përgjithësues faktik**, të cilin e kanë foljet që shënojnë një veprim rezultativ (që e ka arritur rezultatin).

Ты показывал ей это письмо?
A ia *tregove* asaj letrën?

Я тебя *предупреждал*.
Unë të *paralajmërova*.

Тебе *звонила* какая-то женщина.
Të *ka telefonuar* një grua.

Në situata të tilla kuptimi përgjithësues faktik mund të shprehet edhe me foljet e aspektit të kryer. Në këto raste në gjuhës ruse bëhet fjalë për të ashtuquajturën konkurrencë të aspekteve. Megjithatë, ndërmjet AP dhe AK ka gjithmonë dallime në rrafshin e interpretimit të veprimit, në mënyrën e vështirimit të së njëjtës ngjarje të realitetit, thelbi i të cilave të çon në përfundimin se, kuptimi përgjithësues faktik i AP thekson veprimin si fakt, ndërsa kuptimi konkret faktik i AK, vë theksin në pasojat relevante të tij. Krahaso:

Этот дом *строил* мой дед.
Këtë shtëpi e *ndërtoi* gjyshi im.

Этот дом *построил* мой дед.
Këtë shtëpi e *ka ndërtuar* gjyshi im.

Kuptimi përgjithësues faktik në gjuhën shqipe jepet me të shkuarën aoristike, perfektore ose pluskuamperfektore. Përdorimi i së shkuarës imperfektore në tekstet e mësipërme do të ishte i pamundur.

Situata e veprimit të përhershëm në gjuhën ruse jepet gjithnjë me anë të foljeve të aspektit të pakryer, ndërsa në gjuhën shqipe me format e së tashmes:

Сумма углов треугольника *равняется* 180°.

Shuma e këndeve të trekëndëshit *është e barabartë* me 180°.

2.4.1.2. Tipat e përdorimit të aspektit të kryer

Si kuptim kryesor i aspektit të kryer së gjuhës ruse njihet **kuptimi konkret faktik**. E përdorur në këtë kuptim folja e aspektit të kryer e paraqet veprimin si një fakt konkret të veçuar, i cili ka ndodhur në të shkuarën ose pritet të ndodhë në të ardhmen. (Kujtojmë se semantika e foljeve të aspektit të kryer nuk e mundësojnë përdorimin e tyre në kohën e tashme). P.sh.:

- *Отпустили* тебя?
- *Отпустили*.
- *Тë liruan?*
- *Më liruan*.

Скоро вернется. Проходите, подождите.

Do të kthehet shpejt. Kaloni, prisni.

Siç shihet në këta shembuj, realizimi i kuptimit konkret faktik kërkon kontekstin më minimal. Në këtë kuptim përdoren pothuaj të gjitha format e aspektit të kryer, të cilat e paraqitin veprimin si tërësor. Ky përdorim i foljeve të këtij aspekti njihet edhe si kuptimi aoristik i tyre. Për shprehjen e kësaj karakteristike aspektuale në të shkuarën në sistemin kohor të shqipes është e specilaizuar forma e së kryerës së thjeshtë, e cila kuptimin e veprimit si fakt konkret e paraqit përgjithësisht si të përfunduar në të shkuarën dhe të shkëputur tërësisht nga e tashmja. P.sh.:

Левин *стал* на ноги, *снял* пальто и, разбежавшись по шершавому у домика льду, *выбежал* на гладкий лёд и *покатился* без усилия... /L.Tolstoj, Anna Karenina, fq.34/.

Levini *u ngrit* në këmbë, *hoqi* pallton, *eci* nëpër akullin e ashpër para shtëpisë së vogël dhe *doli* në sheshin e patinazhit me akull të lëmuar, *rrëshqiti* pa u sforcuar... /“Ana Karenina”, shqipëruet J. Doksani, fq.33/

Përveç kuptimit konkret faktik formave të aspektit të kryer u njihen edhe disa kuptime të tjera periferike: kuptimi i veprimit demonstrativ tipizues dhe kuptimi i veprimit potencial.

Kuptimi i veprimit demonstrativ tipizues. Kemi të bëjmë me një variant të kuptimeve të veçanta të АК. Bëhet fjalë për një mënyrë ekspresive të paraqitjes së një veprimi që përsëritet ose kryhet rregullisht. Në kontekst veçohet një nga aktet e shumta të

përsëritjes, i cili shërben si shembull tipizues për akte të tjera të ngjashme. Për realizimin e këtij kuptimi konteksti luan rol vendimtar, i cili në mënyrë eksplicite duhet të paraqesë domosdoshmërisht përsëritjen e veprimit. Nganjëherë ky kuptim është quajtur dhe kuptim i zakonshëm. P.sh.:

... Знаешь как я жила в девушках? Вот я тебе сейчас расскажу. *Встану я, бывало рано, коли летом, так схожу на ключок, умоюсь, принесу с собой водицы и все, все цветы в доме полью.* ... /A. N. Ostrovskij, “Groza”, fq.27/.

... E di si kam rrojtur në derë të babait? Po ta tregoj. *Çohesha në mëngjes herët. Në verë sulesha te burimi e lahesha; mirrja ujë dhe vaditnja gjithë lulet e shtëpisë, të gjitha.* .../“Shtërgata”, Shqipëruar nga Skënder Luarasi, fq. 23/.

Në shembullin e sjellë, përdorimit të foljeve të aspektit të kryer në kohën e ardhme i paraprin konteksti, i cili mundëson shprehjen e veprimeve të përsëritura që ndodhnin në të shkuarën. Janë pikërisht treguesit kohorë “*в девушках*” (në vajzëri, kur isha vajzë) dhe folja në kohën e shkuar “*жила*” ato elemente kontekstuale, të cilat japin idenë e përsëritjes në rrafshin e së shkuarës. Përkthyesi ka bërë zgjidhje të drejtë. Kuptimin e përsëritjes së veprimit e ka dhënë me të pakryerën e shqipes, ku çdo akt veçmas ka përfunduar.

Kuptimi potencial i AK haset tek disa folje të rusishtes që shprehin aftësi intelektuale a mundësi fizike, të cilat dalin ose në kohën e ardhme ose në infinitiv në ndërtime të caktuara. Për të realizuar këtë kuptim duhet patjetër mbështetja nga një kontekst i caktuar. Ja disa shembuj:

Есть вещи, которые дамы *не простят*;
Таких книг в магазинах *не найдёшь*;
Он *решит* любую задачу;
Этот слесарь *откроет* любой замок;
Этого тебе *не понять*.

Të gjitha foljet e nënvizuara janë të aspektit të kryer dhe kuptimi shprehur prej tyre ka karakter përgjithësues. Kuptimi përgjithësues i këtyre foljeve në gjuhën shqipe del më në pah, nëse ato përdoren të shoqëruara me foljen gjysmëndihmëse *mund*: *Krahaso dy variantet e mundëshme të përkthimit të fjalive të mësipërme:*

Ka gjëra, të cilat damat *nuk mund t'i falin* - Ka gjëra, të cilat damat *nuk t'i falin*;
Të tillë libra *nuk mund t'i gjesh* nëpër librari - Të tillë libra *nuk i gjen* nëpër librari;
Ai *mund të zgjidhë* çdo lloj detyre – Ai *zgjidh* çdo lloj detyre;
Këtë *s'mund ta kuptosh* ti - Këtë *s'e kupton* ti.

Kuptimi i *shumësisë* së veprimit realizohet në një kontekst ku janë të pranishëm rrethanorët e sasisë. Ky përdorim i aspektit të kryer nuk bie aspak ndesh me tiparin e veprimit tërësor. Në këtë rast kemi të bëjmë me një veprim me “shumë akte”. Për të shprehur përsëritjen e veprimit konteksti lejon edhe përdorimin e foljeve të aspektit të pakryer, por ndryshe nga aspekti i kryer, veprimi konceptohet si “akt”, i cili përfaqëson një pjesë më vete të tij. Pikërisht këtu qëndron edhe ndryshimi ndërmjet përdorimit të AK dhe aspektit të pakryer në kuptimin e shumësisë së veprimeve. P.sh.:

Он три раза *постучал*;

Он три раза *стучал*.

Në gjuhën shqipe e hasim një përdorim të tillë tek e shkuara aoristike. P.sh.:

Baltë e madhe. Gomari na *u rrëzua dy herë*, shih si është bërë. ... (I.Kadare)

Përdorimi i së pakryerës në shqipe do të ishte i pamundur. Nuk mund të thuhet *Gomari rrëzohej dy herë*. Në gjuhën ruse një përdorim i aspektit të pakryer është i mundur, siç është po aq i mundur edhe aspekti i kryer. Të krahasohen variantet:

...Сильная грязь. Осёл у нас два раза *падал*, смотри что с ним стало.

...Сильная грязь. Осёл у нас два раза *упал*, смотри что с ним стало.

Duhet të theksuar se dallimi në këtë rast mund të jetë krejt interpretativ. Zgjedhja e aspektit të kryer apo të pakryer nuk përcaktohet nga tiparet e realitetit jashtëgjuhësor, por nga mënyra se si konceptohet veprimi: nëse rrëzimi përdhe dy herë mund të përfytyrohet si një ngjarje e tërësishme, apo si dy ngjarje të njëjta.

2.5. Realizimet semantike të aoristit, perfektit dhe imperfektit në gjuhën ruse

Gjuha ruse, ndryshe nga shqipja, nuk ka forma analoge të së kryerës së thjeshtë, të kryerës ose më se të kryerës për shprehjen e kuptimeve të aoristit, perfektit a pluskuamperfektit. Këto kuptime janë karakteristike kryesisht për foljet e aspektit të kryer.

Gjatë përdorimit të tyre, formave të aspektit të kryer (*открыл*) u mbishtresohen edhe disa nuanca të tjera semantike, që lidhen si me kuptimin kohor, ashtu edhe me atë aspektor të formës përkatëse në kohën e shkuar. Është kjo arsyeja që studiuesit flasin jo thjesht për forma aspektore, as edhe kohore, por për forma të përbashkëta aspektoro-kohore.

Nëse format e aspektit të pakryer (tipi *открывал*) shprehin në mënyrë eksplicite mungesën e lidhjeve të veprimit me planin kohor të së tashmes, format e aspektit të kryer (tipi *открыл*), përkundrazi, mund të shprehin veprime që kanë lidhje me çastin e ligjërimin, ose

që janë krejtësisht të shkëputura prej tij. Prej këtej rrjedhin dhe përdorimet e së shkuarës së aspektit të kryer në kuptimin e *a) aoristit, b) perfektit, c) pluskuamperfektit*.

Këto kuptime të së shkuarës së aspektit të kryer të rusishtes, përkojnë (edhe pse jo gjithnjë) me ato të së kryerës së thjeshtë, të së kryerës, të më se të kryerës ose të kryerës së tejshkuar të foljes në gjuhën shqipe. Le t'i shqyrtojmë ato të ilustruara me shembuj nga letërsia artistike të përkthyer në gjuhën shqipe.

2.5.1. E shkuara e aspektit të kryer në kuptimin e aoristit

Në kuptimin aoristik e shkuara e aspektit të kryer përdoret për të shprehur fakte të veçuara të së kaluarës të shkëputura plotësisht nga e tashmja.

Kuptimi aoristik zakonisht dallohet qartë në kontekste të tilla ku faktet e së shkuarës ndjekin ose zëvendësojnë njëri-tjetrin, psh.:

Кучер сперва *упёрся* каленом в плечо коренной, *тряхнул* раза два другой, *направил* седёлку, потом опять *пролез* под под поводом, пристяжной и толкнув её мимоходом в морду *подошёл* к колесу..., медленно *вытащил* за ремешок крышку, медленно *всунул* в табличку своих два толстых пальца ..., *помял-помял* табак, *перекосил* заранее нос, *понюхал* с расстановкой...

Nga vëzhgimet e përkthimeve del se format e së shkuarës të aspektit të kryer në kontekste të tilla, ku ngjarjet i lënë vendin njëra-tjetrës, në gjuhën shqipe janë dhënë më së shumti me format e së kryerës së thjeshtë. Ja përkthimi i paragrafit të mësipërm:

Karrociери im *mbështeti* më parë gjurin në kurriz të kalit të mezit, *tundi* e *shkundi* disa herë sustat, *rregulloi* më mirë të ndenjurën, pastaj *u hoq* përsëri zvarrë nëpër rripat e kalit të anës, dhe duke i rënë me grusht turinjve, *iu afrua* rrotës ..., *nxori* me nge nga xhepi një kuti të vogël për bornut, *e hapi* ngadalë, *futi* dy gishtrinjtë të trashë... *nduku* një copë herë bornutin, *shtrembëroi* hundën dhe *nuhati* nja dy a tri herë bornut. /I.S. Turgeniev, Kujtimet e një gjahtari/.

Por aty-këtu, krahas së kryerës së thjeshtë, në përkthime takohen edhe format e së kryerës, ndonjëherë edhe ato të së pakryerës.

Përkthimet me të kryerën e shqipes ndoshta e kanë bazën në mundësinë që kanë format e së kryerës dhe aoristit të ndërkëmben me njëra-tjetrën. Sa i përket zëvendësimit në përkthim të kuptimit aoristik me kuptimin e imperfektit, ai është i papërligjur dhe përgjithësisht përbën shmangie prej origjinalit. Të krahasojmë:

Дед *встал* боком к ней и ... тихо проговорил:

Përkthimi shqip: Gjyshi *rrinte* pak larg saj dhe me zë të ulët tha.... /M.Gorkij, Fëmijëria/

{Varianti në frëngjishte: Grand-père se placa à côte d'elle et (M.Gorki, L'enfance)}

Në përkthimin shqip kemi të bëjmë me dy shmangie nga origjinali; së pari, me zëvendësimin e së kryerës së thjeshtë me të pakryerën, kur konteksti kërkon përdorimin e së parës: Veprimet e shprehura nga format e aspektit të kryer (*встал боком, проговорил*) vijnë njëri pas tjetrit; së dyti “gjyshi *rrinte* pak larg” është sajim i përkthyesit që nuk përputhet me shtjellimin e mëtejshëm të fakteve në origjinal. Ç’thua *kështu, more burrë.... Dhe duke marrë në duart e saja kokën e plakut e puthi në ballë*. Këto rrethana tregojnë se gjyshi nuk ishte “pak larg”, por fare pranë (krahaso në përkthimin frëngjisht *à côte – pranë*).

Përkthimi më i saktë do të ishte: *Gjyshi u gjend përbri saj dhe ... me zë të ulët i tha: ...*

Sipas vëzhgimeve tona përkthimi i së shkuarës së aspektit të kryer me të kryerën e thjeshtë të shqipes më së shumti u takon teksteve me karakter tregimtar në këto raste:

- a) Kur veprimet e shprehura nga foljet e aspektit të kryer vijnë njëri pas tjetrit, zëvendësojnë njëri-tjetrin.

Началась война и силы двинулись с юга на север.

Filloi lufta dhe forcat lëvizën nga jugu në veri.

- b) kur forma e së shkuarës e aspektit të kryer shoqërohet nga plotësorë të tipit *тотчас, вдруг, быстро, разом* etj., që shprehin çastësinë e kryerjes së veprimit.

Он быстро обернулся, бросил на неё пожирающий взор и ...

Ai u kthye rrëmbimthi, i hodhi një vështrim sikur do ta përpinte dhe...

Krahas teksteve me karakter tregimtar, me kuptimin aoristik të së shkuarës së aspektit të kryer ndeshemi edhe në replikat e personazheve ose në vetëligjërimet e tyre. P.sh.:

А вот почему. Сегодня я сижу да читаю Пушкина... Помнится, «Цыгане» мне попались... Вдруг Аркадий подходит ко мне и молча, с таким ласковым сожалением на лице, тихонько, как у ребенка, отнял у меня книгу и положил передо мною другую, немецкую... улыбнулся и ушел и Пушкина унес. (210)

Ja sepse. Sot unë po lexoja “Ciganët” e Pushkinit... vjen Arkadi, dhe pa bërë zë, me një shprehje përkëdhelëse që tregonte se si i dhimbsesha, ngadalë, sikur të isha

ndonjë fëmijë, *më hoqi* nga dora atë libër dhe më *vuri* një tjetër, gjermanisht... *buzëqeshi* dhe doli me librin e Pushkinit në dorë.

Я сказал аристократишко, - *проговорил* Базаров.
Unë thashë “aristokratuc” - *foli* Bazarovi me përtesë.

Nga se u shtjellua më lart, mund të pohojmë se e kryera e thjeshtë e shqipes përkon me njërin nga përdorimet e së shkuarës të aspektit të kryer të gjuhës ruse, me përdorimin aoristik të saj, por jo me kuptimin gramatikor të aspektit të kryer të foljeve në këtë gjuhë.

2.5.2. E shkuara e aspektit të kryer në kuptimin e perfektit

Format e së shkuarës të aspektit të kryer në kontekste të caktuara përdoren edhe në kuptimin e perfektit, d.m.th. për të shprehur një gjendje të pranishme edhe në çastin e ligjërimin, që është pasojë e një veprimi të përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës. Përdorimi i së shkuarës të aspektit të kryer në kuptimin e perfektit realizohet në disa rrethana të caktuara kontekstuale.

Nëse kuptimi aoristik përgjithësisht del më në pah në fjalitë me dy ose më shumë folje në kohën e shkuar, kuptimi i perfektit është karakteristikë për fjalitë, të cilat zakonisht kanë një folje të aspektit të kryer në kohën e shkuar. Të krahasohen shembujt:

Она увидела девочку, бросила палку, подняла хворостину и, схвативши Сашу за шею пальцами..., стала её сечь. (Foljet e nënvizuara kanë kuptimin e aoristit).
Как ты *постарел*, Фирс! (folja e vetme *постарел* është përdorur me kuptimin e perfektit, Sa je *plakur*, Firs!)

Shpesh kuptimi i perfektit theksohet edhe nga disa tregues të tjerë leksikorë. Ndajfoljet e kohës *теперь, сейчас, уже* tregojnë që rezultati ose gjendja e përfituar nga veprimi i përfunduar në të shkuarën janë të pranishëm edhe në të tashmen. Një funksion të tillë e luajnë edhe disa pjesëza ose pasthirrma si *вот, вон, вот и, ну, ага* etj. Shembuj:

Ксения. Она тоже нравная. Захвалена, *засналась*.
Ksenia. Është ca hanxare. I është rritur mendja, *i ka hyrë vetja në qejf*.

Достигаев. ... Ага, хозяйка *прибыла!*
...Aha, *paska ardhur* edhe e zonja e shtëpisë!

Ndonjë studiues ka shprehur mendimin se kuptimi i perfektit lidhet vetëm me ligjërimin dialogjik. S'ka dyshim se në ligjërimin dialogjik format e së shkuarës të aspektit të kryer

në kuptimin e perfektit përdoren më dendur. Por kjo nuk është e vetmja sferë përdorimi. Në kuptimin e perfektit këto forma, ndonëse më rrallë, ndeshen edhe në prozë, edhe në dramaturgjë, edhe në fjalët e autorit. Shembuj:

Её жизнь *потекла* странно спокойно.

Штаб ... *роположилса* в единственном жилом помещении в этой пустыне – за изгородью брошеного конского загона, в землянке, крытой камышом.

Любова Андреевна. – А где же теперь этот способ?

Фирс. – *Забыли*. Никто не помнит.

E shkuara e aspektit të kryer në kuptimin e perfektit në përkthimet në gjuhën shqipe është dhënë me të kryerën, por në mjaft raste edhe me të kryerën e thjeshtë.

E kryera e shqipes ka zënë vend kryesisht në rastet kur forma e së shkuarën e aspektit të kryer të rusishtes shoqërohet nga treguesit leksikorë të tipit *сейчас, теперь, ещё, с тех пор*. Psh.:

Павел, напротив, одинокий холостяк, вступал в то смутное время ... когда молодость прошла, а старость ещё не *настала*.

Павли, *пërkundrazi*, njeri i vetëm beqar, po hynte në një moshë të tillë të turbullt... atëherë kur rinia ka kaluar dhe pleqëria ende *s'ka ardhur*.

Как почти все наши кладбища, оно являет вид печальный: окружавшие его канабы давно *заросли*.

Ajo ka një pamje të trishtuar, ashtu si gjithë varrezat tona: prej kohës bari *ka mbuluar* hendeqet që e rrethojnë.

Në ndonjë rast në vend të së kryerës është përdorur pa vend e kryera e thjeshtë. P.sh:

Я был ещё глуп и суевлив тогда, - отвечал Павел Петрович, - с тех пор я *угомонился*, если не *поумнел*. Теперь, напротив, если ты позволишь, я готов навсегда у тебя поселиться.

Isha akoma budalla dhe i nxirrja vetes andralla të kota,- u përgjigj Pavël Petroviçi,- që atëherë *u qetësova*, në mos *u bëra* më i mençur. Po të më lejosh unë tani jam gati të vij tek ti përgjithnjë.

Krahaso variantin me të kryerën:

Isha akoma budalla dhe nxirrja vetes andralla atëherë,- u përgjigj Pavël Petroviçi, - por nga ajo hokë *jam qetësuar*, në mos *jam bërë më i mençur*. Po të më lejosh, unë tani jam gati të vij tek ty përgjithnjë.

Nga vëzhgimi që iu bë përkthimit të disa veprave të gjinive të ndryshme del se e kryera e thjeshtë ia zë vendin se kryerës kryesisht në ligjërimin dialogjik. P.sh:

Аня. Мама, Фирса уже *отправили* в больницу. Яша отправил утром.
Anja. Mama, Firsin e *shpunë* në spital, e shpuri Jasha që në mëngjes.

Эге! Я вижу, лошади готовы. Пора! Со всеми я *простился*...
Aha! Kuajt janë gjati. Me të gjithë u *përshëndeta*.... të përqafohemi?

Рябинин. ... *Запутался* я. Как тут выйти, куда?
Rjabini - ... *U mpleksa* keq unë. Si dilet prej këtej?

Zëvendësimi i së kryerës me të kryerën e thjeshtë shpjegohet edhe me faktin se e kryera e shqipes mund të tregojë edhe një veprim të së shkuarës që nuk lidhet me asgjë me të tashmen. “Duke shkëputur lidhjet me të tashmen, në këto raste e kryera kthehet në formë sinonimike me të kryerën e thjeshtë dhe mund të ndërrohet me të”⁵⁵.

Megjithatë, përdorimi i së kryerës së thjeshtë në shembujt e mësipërm jo gjithnjë është sinonim me atë të së kryerës. Fjala vjen, në shembullin (1) midis foljeve *отправили* dhe *отправил* ka dallim. Në rastin e parë synohet gjendja e përfunduar nga veprimi i përfunduar në të shkuarën, në rastin e dytë synohet veprimi.

Kuptimi i perfektit është një ndër funksionet e formave të së shkuarës në gjuhën ruse. Ai është kuptim aspektual, karakteristik për foljet e aspektit të kryer. Pavarësisht nga periudha kohore që mund të zërë veprimi, ai vështrohet si tërësor dhe i përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës.

Сатин. Тюрьма, дед! Я четверое гола семь месяцев в тюрьме *отсидел*... а после тюрьмы нет ходу!

Satini. Burgu, xhaxho! *Kam qëndruar* në burg katër vjet e shtatë muaj... dhe s’kisha nga t’ia mbaja!

Kuptimin e perfektit në gjuhën ruse e kanë kryesisht foljet e aspektit të kryer që përbëjnë mënyrën terminative dhe inkoative të veprimit. Nuanca e fillimit të veprimit në përkthimet nga rusishtja në shqip mbetet e pashprehur. Lexuesi “rrok” përfundimin e veprimit.

⁵⁵ Dodi A., Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe, SF, 1968,1,57. 1968,1,57

Kuptimi i perfektit është karakteristik për format e aspektit të kryer, por, ndonëse rrallë, ai nuk është i huaj edhe për spektrin semantik të formave të aspektit të pakryer. Psh:

Я таких людей *видал!* – горячо воскликнул он.

Unë *kam parë* të tillë njerëz! – foli me zjarr.

Kuptimi i perfektit në gjuhën e sotme ruse nuk është sistematik, ai u mbishtresohet vetëm foljeve të një semantike të caktuar të përdorura në kontekste caktuara, ku forma e së shkuarës e aspektit të kryer mund të shprehë një veprim të përfunduar, rezultati i të cilit të jetë aktual në të tashmen. Pikërisht kjo rrethanë e bën të vështirë dallimin e kuptimit të perfektit tek foljet e aspektit të kryer nga kuptime të tjera të përafërta si kuptimi aoristik që karakterizohet nga mungesa e pasojave të veprimit në një plan kohor të mëvonshëm. Mungesa e treguesit formal e bën semantikën e perfektit në gjuhën ruse më pak të qëndrueshme.

2.5.3. E shkuara e aspektit të kryer në kuptimin e pluskuamperfektit

Edhe për kuptimin e pluskuamperfektit gjuha e sotme ruse nuk ka gramema përkatëse. Kuptimi i pluskuamperfektit përcaktohet në kontekst. Përgjithësisht kushtet kontekstuale janë analoge me ato të perfektit, vetëm se veprimi i shprehur nga folja e aspektit të kryer ka përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës. P.sh.

Посмотрим,... – говорил на следующий день Аркадию Базаров, поднималась с ним по лестнице гостиницы, в которой *остановилась* Одинцова.

Të shohim... - i thoshte të nesërmen Bazarovi Arkadit duke ngjitur se bashku shkallët e hotelit, ku *kish zënë* vend Odincova (80).

Si rregull, format e aspektit të kryer në kuptimin pluskuamperfektor përkthehen në gjuhën shqipe me më se të kryerën a të kryerën e tejshkuar. Ndonëse rrallë, e shkuara e aspektit të kryer në kuptimin e pluskuamperfektit jepet ndonjëherë edhe me të pakryerën e shqipes: P.sh.:

Напротив: он ещё мучительнее, ещё крепче *привязался* к этой женщине...

Përkundrazi, me fije gjithnjë më të forta e sundonjëse ai *lidhej* me atë grua...

Zëvendësimi i më se të kryerës me të pakryerën në planin rrëfimor njerr në plan të parë idenë e procesit.

Më të shpeshta në përkthim janë ndërkëmbimet e më se të kryerës me të kryerën e thjeshtë. Në këto raste theksohet më fort ideja e paraprirjes së veprimit ndaj planit kryesor të rrëfimit sesa lidhja e tij me një çast të caktuar të së shkuarës: Psh.:

Аркадию в последний раз пришлось удивиться: он заметил, что приятель его покраснел.

Arkadij përsëri u çudit, ai vuri re se miku i tij u skuq.

Слуги также привязались к нему....

Edhe shërbëtorët u lidhën me Bazarovin.

Арина Власьевна до того переполошилась и взбегалась по дому, что Василий Ивонович справнил её с «куропатицей»...

Arina Vllasevna u bë kaq e gjallë dhe kaq shumë hynte e dilte nëpër shtëpi, saqë Vasil Ivanoviçi e quajti “zogëzë”.

2.6. Veçori të përkthimit të foljeve të aspektit të kryer në përdorimin perfektor dhe aoristik të tyre (Analizë statistikore)

Funksionimin e formave të aspektit të kryer të rusishtes në kuptimin perfektor dhe aoristik dhe përkthimin e tyre në gjuhën shqipe i gjurmuam edhe në romanin “**Отцы и дети**” (**Etër dhe bij**) të I.S. Turgenievit, shqipëruar nga D. Shaplo. Në këtë analizë janë sjellë të dhëna statistikore për dendurinë e përdorimit të formave në fjalë dhe mënyrat e përkthimit të njërës apo tjetrit kuptim.

Nga këqyrja e materialit faktik u konstatua se shkuara e aspektit të kryer në roman “Etër dhe Bij” është përdorur 2885 herë, prej të cilave 491 herë në kuptimin e perfektit ose pluskuamperfektit dhe 2394 herë me kuptimin e aoristit.

Kuptimin perfektor e ndeshim kryesisht në ligjëratën e drejtë të personazheve të romanit ose në përsiatjet me karakter përgjithësues të autorit.

Kuptimin pluaskuamperfektor e ndeshim kryesisht në *rrëfimin epik*, në rastet e regresit, apo të spostimit të rrëfimit, në ngjarje më të hershme në kohë, dhe më rrallë në ligjëratën e drejtë të personazheve.

Për të gjykuar mbi format gjegjëse të këtyre përdorimeve në gjuhë shqipe, gjatë analizës përkthimore, kemi bërë kujdes veçanërisht në dallimet midis ligjëratës së drejtë dhe rrëfimit të autorit.

Le të shohim më hollësisht dendurinë e përdorimit e formave të aspektit të kryer në kuptimin e perfektit (pluskuamperfektit) dhe aoristit në romanin e sipërpërmendur.

2.6.1. E shkuara e aspektit të kryer në kuptimin e perfektit

Për transmetimin e *kuptimit të perfektit* në përkthimin shqip janë përdorur format kohore dhe togjet predikative të mëposhtme:

1) Koha e kryer (179 herë).

Në 35 raste kuptimi perfektor del i shoqëruar me elemente leksikore aspektuale⁵⁶, si p.sh. me ndajfoljorët e kohës: *tani, sapo, akoma, tashmë, prej kohësh*, etj. Nisur nga raporti i veprimit foljor me planin kohor që vijon, dallojmë dy nëngrupe:

a) Në 116 raste konstatohet prania e *gjendjes* në momentin e ligjërit të së tashmes reale si rezultat i një veprimi të mëparshëm. Këtu përfshihen folje që tregojnë ndryshim të gjendjes shpirtërore të njeriut, pamjes së jashtme të tij, ndryshime në natyrë etj. P.sh:

Павел < ... > вступал в то смутное время < ... >, когда молодость *прошла*, а старость еще *не настала*. (195)

Pavli < ... > po hynte në një moshë t'atillë të turbullt, të ngrysur ..., kur rinia *sapo ka kaluar* dhe pleqëria ende *s'ka ardhur*. (36)

«На меня теперь *нашла* хандра», – сказала она < ... >» (304).

«Mua *tani* më *ka kapur* një mërzë e madhe» – tha ajo < ... >» (144).

b) Nëngrupi i dytë (me 63 raste) ndryshon nga i pari për nga mungesa e *gjendjes* specifike. Këtu forma perfektore e АК tregojnë një veprim të përfunduar, por që nuk ka sjellë si pasojë një gjendje aktuale. P.sh.:

«< ... > Я ему назначил двести пятьдесят рублей в год < ... >» (174).

«< ... > Unë ia *kam caktuar* atij 250 rubla në vit < ... >» (15).

«Нет вы не русский после всего, что вы сейчас *сказали!*» (215).

“Jo, ju nuk jeni rus pas gjithë atyre që *thatë*.” (56)

Në rastin e dytë zëvendësimi i kuptimit perfektor të rusishtes me kuptimin aoristik të shqipes në përkthim mendojmë se kushtëzohet nga mungesa e gjendjes në të tashmen.

2) E kryera e thjeshtë (28 h)

⁵⁶ *Shembujt në ligjëratë të drejtë janë vënë në thonjëza.*

«< ... > извините, что *опоздал* к чаю, сейчас вернусь < ... >» (188)

«< ... > më falni që u *vonova*, tani po vij < ... >» (33)

«Извините если я *помешал*», - начал Павел Петрович < ... > (198).

«Mos ju *pengova*, më falni, - zuri të flasë Pavël Petroviç < ... > (29).

«Так знайте же, что я люблю вас, глупо, безумно ...< ... > Вот чего вы *добились*.» (268)

«Mësojeni aherë se unë ju dua marrëzisht si budalla ...< ... > Ja se ç'arritët të *bëni!*» (109)

«< ... > Молодые люди *обрадовались* < ... > прежде они просто были болваны, а теперь они вдруг стали нигилисты» (218).

«< ... > Të rinjtë u *gëzuan*. < ... > Dhe vërtet, më parë ata ishin thjesht budallenj, tani u bënë nihilistë» (59).

3) E kryera e thjeshtë në vend të së kryerës (8 raste).

Shembujt e këtij grupi karakterizohen nga një lidhje e ngushtë midis rrafshit kohor të së shkuarës dhe të së tashmes. Në këto përdorime nuk është aq i rëndësishëm fakti që veprimi është kryer në të shkuarën, por fakti që ky veprim vazhdon edhe në të tashmen:

«< ... > если ты *позволил* ей жить с тобой под одною кровлей, стало быть она это заслуживает < ... >» (184).

«< ... > Gjersa ti e *pranove* të banojë me ty nën një strehë, do të thotë se ajo e meriton < . >» (*ke pranuar*) (24).

4) **Togu jam** (koha e tashme) + *pjesore* haset 12 herë, ndërsa **togjet jam** + *mbiemër cilësor* ose *bëhem* + *mbiemër* i gjejmë të përdorura vetëm në 3 raste.

Në rastin *jam* (koha e tashme) + *pjesore* pjesorja e formohet nga folje jokalimtare që shënojnë tipare a veti të subjektit, të cilat në vetevete janë pasojë e një veprimi të përfunduar në të shkuarën. Në përkthim është përdorur herë forma e së kryerës së shqipes e herë e kryera e thjeshtë. Ja disa shembuj:

«< ... > четверо зубков у него уж е *прорезались*, а теперь вот дёсны опять *припухли*» (205).

«< ... > i kanë dalë katër dhëmbë, dhe ja tani i *janë enjtur* mishrat» (46).

«Эге! я вижу, лошади готовы. Пора! Со всеми я *простился*» (349).

«Ëhë! E shoh, kuajt janë gati. Erdhi koha të nisemi! Me të gjithë *jam ndarë*.» (221)

«< ... > с тех пор я *утомился*, если не *поумнел* < ... >» (195).

«< ... > që *aherë u qetësova*, në mos u *bëra më i mençur*. < ... >» (36).

5) Tогje me folje modale që shprehin mundësi, domosdoshmëri, dëshirë për të realizuar një veprim. (8 herë).

«< ... > Пойду прилягу, а вы мне пришлите липового чаю. *Простудился должно быть*». (356)

«< ... > Po shkoj te shtrihem pak, më sillni çaj lulebliri. *Jam ftohur si duket*». (93)

6) E tashmja e pacaktuar me vlerë gjithëkohore:

«Ага! На своем молоке *обжэгся*, на чужую воду дует. Знаем мы это» (196)

«Аха! Kur *digjet* nga qulli i fryn edhe kosit, i dimë ne këto.» (43)

«< ... > А я все-таки скажу, что человек, который всю свою жизнь поставил на карту женской любви, и когда ему эту карту убили, *раскис* и опустился до того, что ни на что не стал способен, такой человек – не мужчина < ... >» (196-197)

«< ... > Po sidoqoftë njeriu që tërë jetën e tij e vë në zarin e dashurisë, edhe kur fiton, *hidhërohet* e bie aq poshtë sa s'është i zoti për asgjë, një njeri i tillë nuk mund të quhet më burrë» (37)

2.6.2. Përdorimi i formave të aspektit të kryer në kuptimin e pluskuamperfektit

Për të përcjellë kuptimin pluskuamperfektor të formave të АК në përkthim janë shfrytëzuar disa mundësi:

1) më se e kryera ka përdorimin më të dendur (159 herë).

Dallojmë disa nëngrupe:

a) Në nëngrupin e parë folja tregon një gjendje, që vjen si rezultat i një veprimi në të shkuarën dhe aktuale për planin e rrëfimit të autorit (jo për çastin e ligjërit). (91 raste):

Дверь отворилась, и вошла Фенечка с Митей на руках. Она *надела* на него красную рубачешку, *причесала* его волосики и *утерла* лицо. (200)

Dera u hap dhe hyri Fenjeçka me Mitjën në duar. I *kish veshur* një këmishë të kuqe me një shirit në jakë...i *kish krehur* flokët dhe *larë* fytyrën. (47)

Këtij nëngrupi i bashkëngjiten dhe dy raste, ku ideja e gjendjes nuk duket aq qartë si në shembujt e tjerë, megjithatë edhe këtu objekti i përfshirë nga veprimi foljor është drejpërdrejt i pranishëm në rrëfim, për pasojë personazhi duket sikur sheh ndryshimet e ndodhur me këtë objekt. P.sh.:

...на окнах банки с прошлогодним вареньем...на бумажных их крышках сама Фенечка *написала* крупными буквами"кружовник"(200)
...në dritare kishin ca vazo me reçel nga viti i kaluar; në kapakët e tyre prej letre, Fenjeçka *kishte shkruar* vetë me gërma të mëdha "Rrush toke".(46)

b) Në nëngrupin e dytë folja tregon një veprim që ka qenë shkak për gjendjen, për të cilën flitet gjatë rrëfimit. (19 raste)

Он любил помечтать; деревенская жизнь *развила* в нём эту способность (221)
I pëlqente të ëndërronte, jeta e fshatit ia *zhvilloi* këtë prirje. (70).

Përdorimi në këtë rast i së kryerës së thjeshtë "*zhvilloi*" në vend të më se së kryerës "*kishte zhvilluar*", sips mendimit tonë, përbën shmangje në kronologjinë e ngjarjeve.

c) Në nëngrupin e tretë folja nuk emërton as gjendje, as edhe shkakun që mund të ketë sjellë këtë gjendje, në të cilën ndodhet tregimtari në momentin e rrëfimit. (30 raste)

Но Аркадий уже не слушал его и *убежал* с террасы. (184)
Po Arkadi tani as që e dëgjonte - dhe *iku* nga tarraca me vrap. (29)

Në *dy* raste format e më se të kryerës i hasim të përdorura në ligjëratë të drejtë:

«< ... > Твой отец сказывал сегодня, что он *получил* приглашение от этого вашего знатного родственника < ... >» (223).

«< ... > Yt at' sot po thoshte, që *kishte marrë* një ftesë nga ai miku juaj i rëndësishëm < ... >» (68)

«< ... > Сегодня я сию да читаю Пушкина < ... > Помнится, Цыгане мне *попались*» (210).

«< ... > Sot unë *lexoja* "Ciganët" e Pushkinit. < ... >» (51).

Variant më i saktë i përkthimit do të ishte:

Sot isha ulur dhe po lexoja Pushkinin. Më *kishte rënë në dorë* “Ciganët”.

2) e kryera e tejshkuar (15 raste)

Молодой человек, у которого от продолжительного молчания *слиплись* губы, приподнялся и с недоумением смотрел на своего начальника. (225)

Nëpunësi, të cilit nga heshtja e gjatë i *qenë ngjitur* buzët, u ngrit dhe shikoi turbulluar zotninë e vet. (75)

Павел Пьерович славился смелостью и ловкостью и *прочёл* всего пять, шесть французских книг.(192)

Pavëll Petrovic shquhej për guxim e shkathtësi, dhe *pat lexuar* gjithsej pesë-gjashtë libra frënge.(38)

3) e pakryera

Напротив: он еще мучительнее, еще крепче *привязался* к этой женщине «< ... > (193)

Përkundrazi, me fije gjithnjë e më të forta e mundonjëse ai *lidhej* me atë grua < ... >> (33)

4) e kryera e thjeshtë

Арина Власьевна до того *переположилась* и взбегалась по дому < ... >> (350)

Arina Vllasjevna *u bë* kaq e gjallë dhe kaq shumë hynte e diltë nëpër shtëpi < ... >> (188)

< ... > лицо его приняло такое безучастное выражение, словно он весь *ушёл* в какую-то заоблачную высь < ... > (189).

< ... > dhe fytyra e tij mori një pamje aq të ftohtë e indiferente sa dukej sikur mendja i *fluturoi* diku në hapësire < ... >> (35).

5) Përdorimi i së kryerës së thjeshtë në vend të më se të kryerës

Në përkthimin e kuptimit perfektor të së shkuarës së AK të rusishtes gjejmë të përdorur në disa raste formën e së kryerës së thjeshtë. Përdorimi i kësaj forme është një dukuri jo dhe aq e rrallë për gjuhën shqipe, por në shembullin e mëposhtëm dëgjuesi i rrëfimit “rrok” vetëm përfundimin e veprimit dhe jo pasojat e tij në çastin e rrëfimit.

Но Катя отвечала ему односложно: она спряталась, *ушла* в себя.(250)

Por Katja ia priste shkurt: ajo u *mbyll* në vetvete. (105)

Krahaso: Por Katja ia priste shkurt: ajo *ishte mbyllur* në vetvete.

2.6.3. Përdorimi i formave të aspektit të kryer në kuptimin e aoristit

Për të shprehur kuptimin aoristik në përkthim janë përdorur format foljore të mëposhtme:

1) e kryera e thjeshtë

Shumica e tyre dalin në planin e tregimit, dhe kjo gjë është e natyrshme po të mbahet parasysh se përdorimi i së kryerës së thjeshtë në rrëfim është një nga funksionet kryesore të kësaj forme kohore. Zakonisht përdoret kur kemi një sërë veprimesh që pasojnë njëri-tjetrit. P.sh.:

Она *протянулась, улыбнулась, закинула* руки за голову, потом *пробежала* глазами страницы две глупого французского романа, *выронила* книжку – и *заснула* < ... > (253).

< ... > *U shtri, vuri* buzën në gaz, *lidhi* duart pas kokës, *pastaj i hodhi* një sy dy faqeve të atij romani francez, që nuk vlente asnjë grosh, *lëshoi* librin nga dora dhe e *zuri* gjumi < ... > (105).

Në vartësi nga mjetet leksikore jofoljore që marrin pjesë, rrëfimin e autorit mund ta ndajmë në dy grupe:

a) në kontekste, ku mjetet leksikore jofoljore plotësuese *mungojnë* (krahas karakterit të përgjithshëm të kontekstit).

Në këtë grup përdoren foljet *flas, them, pyes, përgjigjem, kërkoj*, etj., të cilat ndërfiten ose e mbyllin ligjëratën e drejtë. Vetë vijueshmëria e replikave na jep kuptimin e përfundimit të çdo veprimi paraprak. P.sh.:

«Где же новый приятель?» – *спросил* он Аркадия.(185)

«Ку е ke mikun tënd të ri?» – e *pyeti* ai Arkadin.(30)

Николай Петрович позвонил и *закричал*: «Дуняша».(187)

Ky i ra ziles dhe *bërtiti*: «Dunjasha».(187)

b) në kontekste me *tregues leksikorë jofoljorë*. Të cilët mund të jenë:

➤ ndajfolje që shprehin çastësi veprimi.

Её голос разом *напомнил* ему: его седые волосы, его старость, его настоящее... (222)

Zëri i saj i *kujtoi menjëherë* flokët e tij të thinjur, pleqërinë, të tashmen. (62)

Он быстро *приблизился* к террасе и, качнув головою, промолвил...(188)

Ai iu *afrua shpejt* tarracës, dhe duke tundur kokën shqiptoi...(27)

- togje foljore të një semantike përgjithësuese ose ndajfolje, të cilat kanë kuptimin e veprimit me një akt, pra tregojnë kryerjen e një akti veprimi më vete: P.sh.:

Аркадий *быстро* вскинул глаза на отца (184)

Arkadi u *kthye menjëherë* nga i ati. (12)

Он *увидал* её головку сквозь золотую сетку колосьев < ... > (203)

Ai e *pa* kokën e vajzës nëpërmjet rrjetës së artë të kallirëve < ... >. (44)

Kuptimi i aoristit tek e shkuara e AK haset jo vetëm në rrëfimin e autorit, siç u pa në shembujt e mësipërm, por edhe në ligjëratë të drejtë, madje edhe kur emërtohen në ligjëratën e drejtë disa veprime të njëpasnjëshme në të shkuarën. Në situata të tilla shqipja përdor kryesisht të kryerën e thjeshtë. P.sh.:

«... Вдруг Аркадий подходит ко мне и молча *отнял* у меня книгу и *положил* передо мною другую, немецкую ... *улыбнулся* и *ушёл*, и Пушкина *унёс* < ... > (210)

«... Vjen Arkadi, dhe, pa bërë zë, ngadalë < ... > më *hoqi nga dora* atë libër, dhe më *vuri* një tjetër, gjermanisht... *buzëqeshi* dhe *doli* me librin e Pushkinit në dorë. < ... > (210)

2) e kryera e thjeshtë në vend të më se të kryerës.

E kryera e thjeshtë del në konkstin e zakonshëm epik, duke treguar parakohësi të planit të rrëfimit. P.sh.:

< ... > Вспомнил он, как *увидал* её в первый раз. Он был ещё тогда студентом. Он *встретил* её на лестнице квартиры, в которой он жил, и, нечаянно толкнув её, обернулся < ... > Она *наклонила* голову, *усмехнулась*...(189).

< ... > Iu kujtua si *u pa* për herë të parë. Aherë ai ishte ende student. *E takoi* në shkallët e shtëpisë ku banonte < ... > ajo *uli* kokën (35), *buzëqeshi* < ... > (62)

Kur kuptimi i aoristit përkthehet me format e pluskuamperfektit, në plan të parë del kuptimi i taksisë së kësaj forme. Foljet në formën e pluskuamperfektit gjithmonë japin

kuptimin e kryrjes së një veprimi para një veprimi tjetër në të shkuarën. Përkthimi i mësipërm do të tingëllonte kështu:

Iu kujtua si *ishin takuar* për herë të parë. Atëherë ai ishte ende student. *Ishin parë te shkallët e shtëpisë* ku banonte < ... > ajo *pat ulur kokën* (35), *kishte buzëqeshur* < ... >

3) Në shtatë raste foljet e mënyrës inkoative të veprimit, jepen me **të kryerën e thjeshtë të foljes “zë” + emër prejfoljor asnjanes**.

Старик один *засмеялся*; Аркадий выразил улыбку на своём лице (283).

Plaku ia *nisi të qeshurit*; Arkadi shfaqti një buzëqeshje në fytyrën e tij. (141)

Nga parashtrimi i mësipërm i funksionimit të aspekteve të rusishtes dhe mundësive të shqipes për t’i shprehur ato mund të arrijnë në disa përfundime:

- ⇒ Me thjeshtimin e formave foljore, format aspektore të gjuhës ruse bënë për vete edhe ato kuptime që më parë shpreheshin me anë të formave të aoristit, perfektit, imperfektit e pluskuamperfektit. Kuptimi aoristik, perfektor, imperfektor, pluskuamperfektor realizohen nga format aspektore në kontekste të caktuara.
- ⇒ Sikurse u vërtetua më sipër, më të afërta me shqipen, edhe pse jo gjithnjë, janë kuptimet e veçanta të aspekteve, përdorimet e tyre kontekstuale. Format e së shkuarës në gjuhën, ndryshe nga dy format aspektore të së shkuarës shqipe dallohen jo vetëm nga pikëpamja formale, por edhe nga përmbajtja e tyre.
- ⇒ Nga vëzhgimi i përkthimit shqip del se format e së shkuarës së aspektit të kryer të rusishtes, në kontekste të tilla, ku ngjarjet i lënë vendin njëra-tjetrës, janë dhënë me formën e së kryerës së thjeshtë. Aty-këtu takohen edhe format e së kryerës, ndonjëherë të së pakryerës. Përkthimet me të kryerën e shqipes, ndoshta e kanë bazën në mundësinë që kanë këto forma për t’u ndërkëmbyer.
- ⇒ Sa i përket zëvendësimit në përkthim të formave foljore të aoristit me perfektin, ai është i papërligjur dhe në përgjithësi përbën shmangie nga origjinali.
- ⇒ Transmetimi i së shkuarës së AK në kuptimin e aoristit, me të kryerën e thjeshtë të shqipes, më së shumti u takon teksteve me karakter narrativ. Megjithatë e kryera e thjeshtë e shqipes përkon më njërin nga përdorimet e së shkuarës të aspektit të kryer së AK të rusishtes, me përdorimin aoristik të saj, por jo me kuptimin gramatikor të aspektit të kryer.

- ⇒ E shkuara e AK në kuptimin e perfektit, në përkthim është dhënë përgjithësisht me të kryerën, por në mjaft raste edhe me të kryerën e thjeshtë, pra ajo ka zënë vend në ato kontekste, ku e shkuara e AK shoqërohet me tregues leksikorë.
- ⇒ Përkthimi i kuptimit perfektor të AK me të kryerën e thjeshtë të shqipes, shpjegohet me faktin se e kryera e shqipes mund të tregojë edhe një veprim, që nuk ka lidhje me të tashmen.
- ⇒ Kuptimi i pluskuamperfektit të së shkuarës së AK realizohet përgjithësisht në kushte kontekstuale analoge me ato të perfektit, vetëm se veprimi i shprehur nga folja e AK realizohet para një çasti të caktuar në të shkuarën, përgjithësisht foljet e AK në kuptimin e pluskuamperfektit janë përkthyer me trajtat e më se të kryerës dhe të kryerës së tejshkuar.
- ⇒ Kuptimi i perfektit, pluskuamperfektit, aoristit, imperfektit janë kuptime aspektuale, që ndryshojnë nga kuptimi kategorial i aspektit në gjuhët sllave.
- ⇒ E shkuara e AK në kuptimin e pluskuamperfektit, është dhënë me të pakryerën, ndonëse rrallë. Ky zëvendësim në planin rrëfimor, ndoshta është bërë për të theksuar idenë e procesit. Më të shpeshta në përkthim janë ndërkëmbimet e më se të kryerës me të kryerën e thjeshtë. Në këto raste theksohet më fort ideja e paraprirjes së veprimit, ndaj planit kryesor të rrëfimit, sesa lidhja e tij me një çast të caktuar të së shkuarës.

2.7. Limitativiteti si komponent semantik aspektual

Brenda fushës së aspektualitetit një pjesë e studiuësve dallojnë edhe një tipar tjetër semantik i cili në aspektologjinë ruse njihet si kategoria semantike e limitativitetit (rusisht *limitativnost'*). Ky tipar ka të bëjë me marrëdhëniet e veprimit ndaj cakut (limitit) të tij të brendshëm. Me cak zakonisht kuptohet kufiri kohor i veprimit, kufizimi i rrjedhës së tij në kohë. Kategoria e mësipërme mbështetet në dikotominë *veprim cakësor/veprim jocakësor*. Foljet cakësore tregojnë veprime që synojnë arritjen e cakut. Arritja e cakut a rezultatit do të thotë se veprimi është përmbushur, ka mbaruar. Foljet jocakësore tregojnë veprime, të cilat gjatë rrjedhës së tyre nuk e synojnë këtë cak.

Për ta bërë më konkrete këtë karakteristikë aspektuale të veprimit foljor po sjellim disa fakte gjuhësore nga përdorimi i formave aspektore në situatat e mëposhtme:

Так мы *привыкали* все больше и больше друг к другу и наконец совсем *привыкли* (I.Gonçarov);

Gjithnjë e më shumë ne *po mësoheshim* me njëri-tjetrin dhe më në fund *ia arritëm*.

Вот вспоминал, вспоминал, так и не вспомнил (Ю.Сбитнев).


U përpoqa ta sjell ndërmend, por s'munda ta kujtoj.

Në shembujt e mësipërm, ku shfaqen të dyja format aspektore (foljet e nënvizuara) bie në sy kundërvënia e tendencës ndaj një fakti të caktuar, përpjekja a synimi për të arritur një rezultat të caktuar (*forma e aspektit të pakryer*) ndaj relizimit real të këtij fakti, arritjes reale (mosarritjes) të rezultatit (*forma e aspektit të kryer*). Me fjalë të tjera, në ndërtimet e mësipërme kemi të bëjmë me opozicionin *arritje/mosarritje e cakt* të brendshëm të veprimit.

Sipas Ju. Masllovit kundërvënia *veprim cakësor/veprim jocakësor* i përket sferës së aspektualitetit cilësor dhe ka karakter universal, sepse bazohet në dallimet objektive që vihen re në realitetin jashtëgjuhësor. Objektivisht çdo veprim karakterizohet, nga njëra anë, nga një farë zgjatje në kohë, nga ana tjetër, kufizohet ose nga caku i brendshëm, domethënë nga arritja e rezultatit të natyrshëm gjatë zhvillimit pa pengesa të veprimit, ose nga pengesa të jashtme, të cilat mund ta ndërpresin zhvillimin e veprimit drejt cakut të tij të brendshëm, e cila mund të ndërpresë qoftë ecurinë normale të veprimit drejt cakut të tij, ashtu edhe një proces “pa perspektivë”, ose një gjendje që zgjat pafundësisht.⁵⁷

Aspektologët vënë në dukje se nocioni i cakut të natyrshëm të veprimit është karakteristikë vetëm për foljet që tregojnë veprime dinamike (veprime të mirëfillta), të cilat u kundërvihen foljeve të gjendjes a marrëdhënieve statike⁵⁸:

Kështu, Ju. Masllov te veprimi folJOR dallon tri opozicione aspektuale që ndërveprojnë njëri me tjetrin. Ai ndërton skemën e mëposhtme të hierarkisë së opozicioneve të përmendura më sipër.



⁵⁷ Маслов Ю. К основаниям сопоставительной аспектологии // Вопросы сопоставительной аспектологии. Л., 1978.

⁵⁸ Termi dhe përpunimi i konceptit të fushës së limitativitetit, si pjesë përbërëse e fushës së aspektologjisë, i përket A.V. Bondarkos. Për më gjerë shih: Бондарко А. В., Принципы функциональной грамматики и вопросы аспектологии. Изд-е 4-е. М.: Изд-во ЛКИ, 2007.

Маслов Ю., К основаниям сопоставительной аспектологии // Вопросы сопоставительной аспектологии. Л., 1978.

Nëse do të ilustronim me nga një shembull secilën gjymtyrë të të kundërvënieve të mësipërme do të kishim tablonë e mëposhtme:

- (1) veprim statik: *бежаты (vrapoj)* - gjendje statike: *спать (fle)*
- (2) veprim cakësor *переписывать (rishkruaj)* - veprim jo cakësor *ходить (eci)*
- (3) veprim që e arrin cakun *переписывать (rishkruaj)* - veprim që nuk e arrin cakun *переписать (rishkruaj)*.

Në dy nivelet e para bien në sy kundërvëniet kuptimore të shprehura nga leksema të veçanta foljore *бежаты/спать* dhe *переписывать* dhe *ходить*, ndërsa te niveli i tretë (arritje/mosarritje e cakut) kemi kundërvënie jo midis dy kuptimeve të njëjësive të ndryshme foljore, por ndërmjet kuptimeve gramatikore (aspektore) të formave të së njëjtës leksemë: *переписывать/переписать (rishkruaj)*.

Ndonjë studiues shkon edhe më tej. Bondarko, p.sh., është i mendimit se prania e kategorisë së aspektit në gjuhët sllave, e përfaqësuar nga dy palë forma të tipit *открыть/открывать*, lidhet pikërisht me raportin e këtyre formave foljore ndaj tiparit të cakut të brendshëm të veprimit, çka shërben edhe si bazë semantike për vetë kundërvënien *аспект i kryer/аспект i pakryer*. Në përkufizimin e aspektit foljor ky autor e sheh kategorinë e aspektit foljor si raport të veprimit ndaj cakut të tij të brendshëm.⁵⁹

Bashkëveprimin që ekziston në gjuhën ruse ndërmjet opozicionit semantik **folje cakësore/jocakësore** dhe opozicionit gramatikor **аспект i kryer/аспект i pakryer** mund ta paraqitim sipas skemës së mëposhtme:

⁵⁹ Bondarko A.B., *О значениях видов русского глагола*, ВЯ, № 4, 1990.

<i>Aspekti i pakryer (AP)</i>	Aspekt i kryer/Aspekt i pakryer (AK/AP)		<i>Aspekti i kryer (AK)</i>
	<i>Folje cakësore (1)</i>		
<i>Folje jocakësore Imperfektiva tantum</i>	<i>Folje që nuk e synojnë cakun</i>	<i>Folje që e synojnë cakun</i>	<i>Folje cakësore (2) Perfektiva tantum</i>
	(AP)	(AK)	
	→	→	
	<i>Folje cakësore (2)</i>		
	<i>Folje që nuk e synojnë cakun</i>	<i>Folje që e synojnë cakun</i>	
	(AP)	(AK)	
	•••		

Nga kjo paraqitje vëmë re se të gjitha format e aspektit të kryer në gjuhën ruse janë folje me cak të përcaktuar veprimi, përderisa zotërojnë tiparin e arritjes reale të tij. Ndërsa format e aspektit të pakryer mund të jenë edhe cakësore (ato që e synojnë cakun) edhe jocakësore *imperfektiva tantum* (që kanë vetëm aspektin e pakryer).

Limitativiteti përcaktohet si kategori semantike latente, pa mjete formale të shprehjes së saj. Sipas aspektologëve kategoria e limitativitetit në gjuhën ruse gjen shprehje tek aftësia që kanë foljet për të formuar çifte të pastra aspektore. Sipas Bondarkos, opozicioni veprim *cakësor/jocakësor* që ekziston brenda fushës semantike të limitativitetit “gjen mbështetje në realitetin jashtëgjuhësor, por jo aq në natyrën imanente të dukurive të emërtuara nga folja, sesa në shkallën e realizimit real të tyre”.⁶⁰

Teoritë e mësipërme rreth tiparit limitativ të veprimit nuk i kanë qëndruar kritikës.

Së pari, është e pamundur të bëjmë përshkrimin semantik të gjithë leksikut foljor vetëm mbi bazën e tre tipave të kundërvënieve për të cilat u fol më sipër. Kështu, p.sh., nëse kuptimet e foljeve *imperfektiva tantum* mund të përfshihen te opozicioni semantik

⁶⁰ Бондарко А. В., *Принципы функциональной грамматики и вопросы аспектологии*. Изд-е 4-е. М.: Изд-во ЛКИ, 2007.

“gjendje, raporte statike” (*знать - di, ограничить – kufizohet*) ose te “veprimi dinamik cakësor” (*работать–punoj*), foljet *perfektiva tantum* (psh. *вспыхнуть–shpërthen*) dalin të “pambuluara” nga asnjëri prej opozicioneve të mësipërme. Edhe pse foljet e këtij tipi tregojnë “veprime dinamike cakësore”, atyre u mungon tipari i arritjes së caktut të veprimit.

Së dyti, klasifikimi i veprimit foljor sipas tiparit limitativ është i vështirë ose i pamundur për shkak të dukurisë gjuhësore të polisemisë. Shumica e foljeve janë shumëkuptimëshe dhe në kontekste të ndryshme dalin herë si del si folje jocakësore, dhe herë si folje cakësore, p.sh., leksema polisemantike “*нужа - shkruaj*” në situatën Ребёнок уже умеет *нужа* – Fëmija tashmë *di të shkruajë*, është folje jocakësore, ndërsa në një kontekst tjetër Он *пишет* письмо – Ai po shkruan një letër është folje cakësore.

Së treti, ashtu siç vumë në dukje më sipër (shih pikën 2.5), nocioni i caktut të veprimit në thelb nuk është gjë tjetër vetëm se zëvendësimi terminologjik i nocioneve “rezultat”, “përfundim” a “mbarim” veprimi. Duke lënë jashtë vëmendjes disa nuanca të holla semantike, disa autorë vënë shenjën e barazimit midis kuptimeve të një veprimi të përfunduar a rezultativ me kuptimin gramatikor të aspektit të kryer. Këta gjuhëtarë priren të njëjtësojnë kuptimin e aspektit të kryer me caktun e veprimit.

2.8. Mënyrat e veprimit si komponent aspektual

Në nënkrerët e mësipërm u vu në dukje se termi “vid” (aspekt) në traditën gramatikore ruse fillimisht përdorej për të treguar jo opozicionin binar *aspekt i kryer/aspekt i pakryer*, por një kompleks tiparesh të veprimit foljor. Më vonë studimi i korelatëve aspektorë tregoi se kuptimi leksikor i foljeve mund ta plotësonte kundërvënien aspektore me kuptime të tjera që shënjonin stadin (fazën) e zhvillimit të veprimit, zgjatjen/moszgjatjen e veprimit, përsëritjen, rezultatin i tij etj. Për studiuesit u bë e domosdoshme futja e një termi të ri, i cili do të përmbledhte tipare të tilla të veprimit foljor, të cilat përbënin një dukuri të ndryshme nga aspekti. Për këtë qëllim në aspektologji filloi të përdorej termi *aktionsart* ose *mënyrë veprimi (способ дјejstvija)*.

Nocioni i mënyrës së veprimit u fut në gjuhësi në fillim të shek.XX nga sllavisti suedez Sigurd Agrel. Më 1908, bazuar në materialin e gjuhës polake, Agrel shkruan: “Me mënyrë veprimi (Aktionsart) unë nënkuptoj jo dy kategoritë bazë të foljes sllave, jo format që shprehin veprime perfekte dhe imperfektive, këto kategori unë i quaj Aspekte. Me termin *mënyrë veprimi* unë emërtoj pothuaj të gjithë ato *funksione semantike*, që nuk kanë tërhequr vëmendjen e askujt deri më sot, dhe aq më pak të jenë diferencuar, emërtoj ato funksione të foljeve të formuara me parashtesa (por edhe ato funksione të disa

foljevejoparashtesore ose të formuara me prapashtesa), të cilat *konkretizojnë si kryhet veprimi*, pra emërtojnë *mënyrën e kryerjes së tij*”⁶¹

Prej më se një shekulli nocionet *aspekt* dhe *mënyrë veprimi* vështrohen si dy dukuri gjuhësore të dallueshme njëra nga tjetra. Në gjuhën ruse dukuria e mënyrave të veprimit filloi të studiohet intensivisht në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar. Është me rëndësi të vëmë në dukje se gjatë kësaj periudhe nocioni i mënyrës së veprimit në gjuhësinë ruse ka pësuar ndryshime dhe është zgjeruar sa i përket caqeve semantike të kësaj kategorie. Dallojmë dy qasje:

Qasja e parë ka të bëjë me një konceptim të ngushtë të mënyrave të veprimit, i cili në thelb i qëndron besnik idesë së Agrelit. Sipas këtij kënvështrimi nocioni i mënyrave të veprimit është i zbatueshëm vetëm për ato grupime foljesh, ku modifikimi i kuptimit fillestar të foljes bëhet me mjete formale. Një qasje të tillë rreth mënyrave të veprimit foljor e gjejmë te studiues të tillë si A. Isaçeko, N. Avillova, V. Khrakovski, A. Llomov etj, edhe pse në trajtesat e tyre mund të konstatojmë dallime e mospërkime të pjesshme.⁶²

Sipas *qasjes së dytë* mënyrat e veprimit janë kuptuar më gjerë. Një interpretim i tillë bazohet në punimet e E. Koshmiderit, Ju. Masllovit, A. Bondarkos, M. Sheljakinit etj. P.sh., te Masllovi gjejmë formulimin e mëposhtëm: “me mënyra veprimi duhen kuptuar disa veçori të përbashkëta të kuptimit leksikor të këtyre ose atyre foljeve (shpesh, por jo domosdoshmërisht të shprehura me mjete fjalëformuese), veçori, të cilat i përkasin rrjedhës së veprimit në kohë të këtyre foljeve...”⁶³

Pra, sipas Masllovit, foljet mund t’i gruponim në mënyra të ndryshme veprimi mbi bazën e semantikës së tyre. Secili grup do të përfshinte foljet që shprehnin të njëjtin tip të mënyrës së zhvillimit të veprimit. Psh. foljet *сидеть, лежать, висеть* etj. përbëjnë mënyrën statike të veprimit (*statalnij sposob djestvija*), sepse të gjitha ato shprehin vazhdimësi

⁶¹ Агрелль С., *О способах действия польского глагола*, *Вопросы глагольного вида*. М., 1962.

⁶² Исаченко, А.В., *Грамматический строй русского языка в сопоставлении со словацким*. Морфология. Часть вторая. Братислава, 1960.

Авиллова, Н. С., *Вид глагола и семантика глагольного слова*. Москва, 1976.

Храковский, В.С., *Некоторые проблемы универсально-типологической характеристики аспектуальных значений. Аспектуальность и средства ее выражения*. Вопросы русской аспектологии V. Тарту, 1980.

⁶³ Маслов Ю., *Глагольный вид в современном болгарском языке*. Ленинград, 1957

Бондарко, А. В., Буланин, Л. Л. *Русский глагол*. Ленинград, 1967.

Шелякин, М. А., *Категория вида и способы действия русского глагола (Теоретические основы)*. Таллинн, 1983.

Шелякин, М. А., *Способы действия в поле лимитативности*;

Бондарко, А.В., *Теория функциональной грамматики. Введение в Аспектуальность. Временная локализованность. Таксис*. Ленинград, 1987.

monotone të gjendjes ose veprimit. Sipas këtij këndvështrimi mënyrat e veprimit mbeten brenda kuadrin të dallimeve leksikore midis foljeve.

Autorët e tjerë që mbrojnë pikëpamjen e Agrelit janë të mendimit se me mënyra veprimi duhen kuptuar vetëm modifikimet semantike të foljeve, të përfuara domosdoshmërisht me mjete të jashtme (formale) – parashtesa ose prapashtesa, p.sh., formimet *за-кричатъ*, *на-кричатъ*, *крик-ну-тъ* prej foljes së parme *кричатъ* (*bërtas*). Foljet e prejardhura *закричатъ*, *накричатъ*, *крикнутъ* emërtojnë po të njëjtin veprim real (*bërtas*), por dallojnë prej foljes prodhuese *кричатъ*, sepse e përqendrojnë vëmendjen në disa momente të veçanta të zhvillimit të këtij veprimi. Kështu, folja *закричатъ*, tregon se veprimi “rrokot” në fazën fillestare, folja *покричатъ*, e përqendron vëmendjen në një çast të kufizuar të rrjedhës së tij në kohë. Kur duam të vëmë në dukje se veprimi është kryer vetëm një herë, përdorim formimin prapashtesor *крикнулъ*. Pra, nga pikëpamja semantike formimet prapashtesore të mësipërme shprehin nuanca kuptimore plotësuese.

Aftësia e foljes së gjuhës ruse për të modifikuar me mjete të posacme (parashtesa, prapashtesa) semantikën e saj herë nga pikëpamja e fazave të zhvillimit të veprimit (veprim inkoativ, terminative, delimitative etj.), herë nga pikëpamja e shkallës së intensitetit të veprimit (veprim attenuativ, evolutiv) e herë nga pikëpamja e gjymtyrëzimit të tij të brendshëm (veprim iterativ, distributiv, komitativ etj.) përbën një veçori tjetër të kësaj gjuhe. Modifikimet semantike me mjete formale përfaqësojnë klasa semantike foljesh, grupimi i të cilave bëhet sipas tiparit të ngjashmërisë në mënyrën e rrjedhës së veprimit në kohë.

Sipas këtij këndvështrimi, jashtë mënyrave të veprimit mbeten foljet, grupimi i të cilave bëhet mbi bazën e kuptimit të tyre individual të pakushtëzuar nga mjete të posaçme morfologjike (tipi *лежатъ*, *сидеть*, *висеть*), por edhe formimet prapashtesore, të cilat shpesh shprehin si leksema më vete të tipit *выйти* - *dal* (nga *идти* - *eci*), *вырвать* - *shkul* (nga *рвать* - *shqyej*), *списать* - *korjoj* (nga *писать* - *shkruaj*) etj. Në këto raste kemi të bëjmë me fjalë të reja, prapashtesat e kanë kualifikuar kuptimin e foljes prodhuese.

Pikëpamja e mësipërme, sipas mendimit tonë, mbetet më e drejtë. Mënyrat e veprimit ndryshojnë nga mënyrat e tjera të fjalëformimit foljor, sepse, së pari, ato kuptimisht nuk shprehin nga folja, prej së cilës janë formuar; së dyti, në fushë të rusishtes mbeten njëaspektore, perfektiva tantum. Krahaso, psh.: *писать* – *написать*, *играть* – *поиграть*, *бежать* – *побежать* dhe *писать* – *списать* (*списывать*), *играть* – *проиграть* (*проигрывать*), *бежать* – *убежать* (*убегать*) etj., ku formimet prapashtesore të këto të fundit janë leksema më vete, kanë kuptim leksikor të ri. Është kjo arsyeja që veprimi i shprehur prej tyre mund të paraqitet edhe në formën e aspektit të pakryer (foljet në kllapa).

Mënyrat e veprimit, ashtu si kategoria gramatikore e aspektit, janë element strukturues i zonës semantike të aspektualitetit, por në raport me kategorinë gramatikore ato janë vështruar si një dukuri anësore, periferike. Është me rëndësi të theksojmë se mënyrat e veprimit mund të vështrohen si element periferik vetëm në kuptimin që ato, ndryshe nga aspekti, nuk përfshihen në paradigmen e foljes, nuk formojnë kundërvënje paradigmatiche dhe as që mbështeten në ndonjë sistem formash. Nga ana tjetër, ato janë një dukuri mjaft e përhapur në sistemin foljor të gjuhës ruse dhe zënë një vend të konsiderueshëm në formimin e foljeve, por pozicioni i tyre në këtë sistem është i veçantë. Veçantia qëndron në faktin se mënyrat e veprimit nuk mund të përfshihen as në fjalëformim, as edhe në formëformim. Ato zënë një vend të ndërmjetëm midis këtyre dy proceseve. Është kjo arsyeja që ato studiohen në kuadër të morfologjisë.

Ndryshe nga aspekti foljor mënyrat e veprimit nuk përbëjnë kategori gramatikore. Mungesa e çiftit aspektor midis foljeve parashtesore të aspektit të kryer dhe foljeve primitive shërben si tipar dallues i mënyrave të veprimit. P.sh., foljet *писать#написать* janë përkatësisht imperfektiva tantum dhe perfektiva tantum. Vetëm imperfektivimi dytësor i foljeve të aspektit të kryer (me anë të prapashtesave) formon çifte të mirëfillta aspektore të tipit *прочитать=прочитывать*. Çifti aspektor formohet prej foljes parashtesore të aspektit të kryer *прочитать* me anë të prapashtesës *-ыва-* (*прочитывать*).

Gramatika e gjuhës të shqipe, botim i ASH (2002), e prek dukurinë e mënyrave të veprimit foljor në sythën ku trajtohen foljet gjysmëndihmëse në rreth një faqe (f. 264-265). Me mënyrë veprimi janë kuptuar disa folje në togfjalësha të caktuar (folje gjysmëndihmëse + folja ndjekëse) që shprehin fillimin (*filloj, nis, zë, bëj, marr* etj.: *filloj të shkruaj, bëj të dal, zë e këndoj*), vazhdimin (*vijoj, vazhdoj: vazhdon të heshtë*), rritjen progresive (*vij: sa vinte e rritej*) ose mbarimin e një veprimi (*mbaroj, pushoj: mbaroi së ngrëni, pushoi së qari*).

Autorët e gramatikës së sipërcituar priren të pranojnë si mënyra veprimi në gjuhën shqipe vetëm ndërtimet analitike që shprehin faza të shtjellimit të veprimit foljor. Siç është e kuptueshme, mënyra e veprimit e shprehur prej ndërtimeve të tilla me semantikë aspektuale lidhet me semantikën e foljes ndihmëse, e cila luan rolin e modifikuesit aspektual.

Nga konceptimi i thjeshtëzuar i mënyrave të veprimit në sistemin foljor të shqipes kanë mbetur jashtë vëmendjes disa tipa të tjerë analitizmi të përfaqësuar nga togje të lira leksikore a morfologjike me semantikë aspektuale, p.sh. ndërtimet:

a) me vlerë zgjatjeje: *paska qarë e paska qarë* e ka fjetur, *priti sa priti* e iku;

b) me kuptimin e veprimit në proces: *është në udhëtim e sipër, ishte në të vdekur e sipër*;

c) me kuptimin e një veprimi progresiv: *erdhi e u skuq* nga turpi, *erdhi e u shua* ditë pas dite.

Në gramatikën e sipërpërmendur kanë mbetur të paklasifikuara edhe ato ngjyrimet a kuptime që disa parashtesa u japin foljeve, p.sh.:

a) kuptimi intensiv me parashtesën *për-*, *s-* te foljet e tipit *përskuqem*, *përvidhem*, *përthelloj*, *përshtrij*, *skuq*, *spraps*, *spastroj* etj.

b) kuptimi i zmadhimit a teprisë së një veprimi me parashtesën *stër-*, te foljet e tipit *stërmundoj*, *stërsmadhoj*, *stërholloj*, *stërngopem*, *stërnxej* etj.

c) kuptimi i një veprimi jointensiv: *stërlag* (lag lehtë), *stërpikem* (pikohem paksa, lagem lehtë me pika uji), *përvesem* (mbulohet paksa me vesë) etj.

Ne sollëm vetëm disa raste, por të tilla ka edhe të tjera, ku kuptimet a ngjyrimet sipërpërmendura kanë mbetur të paklasifikuara e të pakategorizuara. Parashtesimi në tri rastet e fundit (pikat a, b, c) nuk krijon njësi leksikore të reja, por vetëm sa modifikon kuptimin fillestar të foljes. Lind pyetja, a nuk duhen kategorizuar semantikisht e mësipërme të përfutuara me anë të parashtesave, të cilat nuk krijojnë folje të reja?

Nëse parashtesimin foljor të shqipes do ta ballafaqonim me atë të gjuhës ruse, do të na binin në sy disa veçori të këtij procesi:

Parashtesat në gjuhën shqipe, kur i bashkëngjiten foljes, nuk shërbejnë si mjet gramatikor për formimin e aspektit, ashtu si në gjuhën ruse.

Parashtesimi te folja e shqipes nuk ka atë peshë që ka ai te folja në gjuhën ruse, p.sh., foljes së shqipes *këndoj* do t'i përgjigjej folja *немь* dhe të gjitha modifikimet parashtesore të saj: *занемь*, *нонемь*, *донемь* etj. Kështu, formimeve parashtesore të mësipërme do t'u përgjigjeshin format perifrastike, përkatësisht *zë e këndoj*, *këndoj pak*, *çoj deri në fund këngën* (e këndoj deri në fund). Në gjuhën ruse, p.sh. ka rreth 15 parashtesa (shumica e tyre shumëkuptimëshe), të cilat janë shumë aktive në formimin e foljeve. Teorikisht në gjuhën ruse me anë të parashtesave dhe prapashtesës *-ся* formohen 24 folje të prejardhura. Të gjitha formimet parashtesore janë të aspektit të kryer, por jo të gjitha ato formojnë mënyra veprimi. Mënyrave të veprimit u përkasin vetëm ato formime parashtesore, kuptimi leksikor i të cilave modifikohet, por nuk shkëputet plotësisht nga kuptimi i foljes prodhuese.

Potenciali modifikues i kuptimit fillestar të foljes përmes mënyrës së parashtesimit në sistemin foljor të shqipes është shumë më i kufizuar se në gjuhën ruse, ndërkohë që

formanti fjalëformues i kësaj të fundit është komponent i rëndësishëm për formimin e mënyrave të veprimit.

Modifikimet semantike me morfema të veçanta në gjuhën ruse bëhen në disa raste krahas dublimit me mjete leksikore. Ndërkaq, duhet shtuar se jo gjithnjë ky dublim është i barazvlefshëm. Zëvendësimi, psh., i foljes *зател* me *стал (начал) неть* do ta zhvendoste vëmendjen nga fillimi i një veprimi rezultativ, tek fillimi i një veprimi në zhvillim e sipër.

Ndodh që disa nga nuancat semantike të foljeve të prejardhura të rusishtes, gjuha shqipe të mos i japë as edhe me mjete leksikore, psh., nuancat e foljeve të tilla si *намазатъ, написатъ* (përkatësisht *lyej, shkruaj* në sipërfaqe të diçkaje), *спеть, сделать, выучить* etj. (përkatësisht *këndoj, bëj, mësoj* – rezultat veprimi). Ato bëhen të qarta nga konteksti ose situata ku përdoren.

Një trajtim shumë më të plotë të mënyrave të veprimit foljor në gjuhën shqipe e gjejmë te A. Dhrimoja. Aspektit dhe mënyrave të veprimit foljor ai i ka kushtuar një studim të posaçëm, që deri më sot mbetet punimi i vetëm rreth dukurive aspektuale në gjuhën shqipe.⁶⁴

Ndryshe nga autorët e gramatikës akademike, ky autor përfshin te mënyrat e veprimit jo vetëm fazat e zhvillimit të veprimit, por çdo kuptim që lidhet me rrjedhën e veprimit në kohë, i cili realizohet nga bashkëveprimi i mjeteve foljore dhe jofoljore dhe ka karakter sintagmatik.

Lidhur me statusin e kategorisë së mënyrës së veprimit A. Dhrimo mendon se “në gjuhën shqipe mënyrat e veprimit foljor në planin e shprehjes së tyre nuk janë një kategori e pastër leksikore, por edhe fjalëformuese e sintaksore, pra në këtë vështrim janë si të thuash deri diku një kategori leksiko-gramatikore. Për më tepër, për të ndihmuar për shprehjen e një kuptimi të caktuar, shpesh, krahas mënyrave të veprimit, ndihmojnë edhe tregues leksikorë”.⁶⁵

Si mjete për shprehjen e mënyrave të veprimit në gjuhën shqipe autori konsideron disa parashtesa e prapashtesa dhe ndërtimet sintaksore me vlerë aspektuale. Po rendisim shkurt mënyrat e veprimit dhe mjetet e shprehjes së tyre, të shtjelluara në një material prej 150 faqesh. Nga shqyrtimi i materialit faktik (fondi leksikor i foljes) dhe i ndërtimeve sintaksore ai dallon nëntë mënyra veprimi: **të çastësisë, të zgjatjes, të vijimësisë, të intensitetit, të progresionit, të barazisë dhe përpjestimorësisë, të fillimit, të përsëritjes, të përfundimit.**

⁶⁴ Dhrimo A. *Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1996.

⁶⁵ Dhrimo A. *Vepër e cituar*, fq. 152

Për të krijuar një ide më të plotë për kriteret e veçimit të mënyrave të veprimit po sjellim disa shembuj për secilën prej tyre.

1. Mënyra e çastësisë së veprimit (shpreh një veprim të shkurtër, që kryhet menjëherë):

- me parafjalën *për-*: *përpyjek, përplas, përthyej, përfshij*;
- me ndërtime sitaksore të tipit: *me të dëgjuar emrin, me të shkruar letrën, me të zbritur*;

2. Mënyra e zgjatjes së veprimit (mënyra durative) (shpreh shtrirjen e veprimit):

- me ndërtime sintaksore të tipave:
presim, presim, ai s' duket; prita, prita po ti u vonove;
flet e flet pa pushim; vërtitet e vërtitet si pa faj; ha e ha e ha si lugat;
mallkoi sa mallkoi e pastaj u lodh; ai të vinte, pa le të rrinte sa të rrinte;
rri e pres; rri e mendohet;
vazhdoj të mjekohem, vijon të tregojë; vazhdon së dhëni këshilla;
është në kthim e sipër, ishte në shembje e sipër.

3. Mënyra e vijimit të veprimit (shpreh një veprim si veti të përhershme të subjektit):

- me ndërtime të tipave:
e kam zakon të fle vonë;
iu bë ves të kundërshtojë;
s' kish të ngopur; s'ka të mbaruar;
s'pushon së lehuri;
nuk ngopeshim duke parë.

4. Mënyra intensive (shpreh shkallën e intensitetit me të cilën kryhet veprimi):

- Formimet me parashtesa:
f- *fshij, fshik, fshaj; gër-* *gërgas, gërmoj, gërmit; kër-* *kredh; ka-* *kapërdij, kapërthej; n-* *ngul, ngjis, ndrij, nxis; ç-* *çmendem, çmeritem; m-* *mpreh, mbruj, mësyj, mposht, mpiks;*
për- *përfytem, përgojoj, përgjum, përgjunj, përbluaj, përpij, përplas, përmallohem, përbalt, përthelloj;*
stër- *stërzgjas, stërvit*
sh- *shqyej, shkrij, shlyej, shfajsoj, shndris, shpërhap;*
- Formime me prapashtesa:
-ë(illo-/lle-/lli-), -lo-, -le- *bubullon, fërshëllez, hingëllij, capëloj, çapëlez;*
-is-/it- *guudulis, lebetis, llokoçit;*
-(ë)ro-/rro- *blegëroj, hakërrohem;*

- Ndërtimet me foljet *rrah, rrekem, bëj, orvatem, përpiqem, mundohem, ec, hidhem etj. të tipave: rrihnin të sheshonin, rrekem të përfytyroj, bëj të çohem, orvatem të kthehem, përpiqem ta mbaj, mundohem ta lëviz; ec e fol, u hodh e tha;*
- Ndërtime të tjera: *shkoi e ra, vane e zunë, bërtit të bërtasish, mbathja t'ia mbathim, dhash e mora, pamë ç'pamë, bëri si bëri.*

5. Mënyra progresive: (shpreh rritjen progresive të veprimit në pikëpamje sasiore e cilësore)

- Ndërtimet e tipit: *rritet e rritet, shtohet e shtohet, vjen e rrotullohet, erdhi e u shpërnda, ka ardhur duke u përmirësuar, sa vinin e rralloheshin, shtohen ca e nga ca, rëndohej gjithnjë e më shumë, përdoret shpesh e më shpesh, u shua pak nga pak.*

6. Mënyra e barazisë dhe përpjestimorësisë së veprimit (shpreh raporte barazie a përpjestimorësie midis dy veprimeve ose midis një veprimi dhe një tipari a rrethane):

Nërtimet *aq..., aq...; sa..., aq..., sa më pak..., aq më pak... (aq më shumë...), sa më tepër..., aq më shumë... (aq më pak) etj.: aq kupton, aq bën; sa punonte, aq shpërblehej; sa më shumë fliste, aq më shumë i padëgjueshëm bëhej.*

7. Mënyra e fillimit të veprimit (tregon fillimin e veprimit):

- Ndërtimet me foljet filloj, zë, nis: *nis të këndo, fillon e flet, zë e thërras, kishte filluar të mëkëmbej.*

8. Mënyra e përsëritjes së veprimit (shpreh përsëritjen e një veprimi)

- Ndërtimet e tipave *sillte e risillte, thyhej e përthyhej; dukej e zhdukej, venë e vinë, bënte ç'bënte; shkruaj hera-herës (ditë për ditë, kohë më kohë) etj.*

9. Mënyra e përfundimit të veprimit (tregon përfundimin e veprimit)

- Ndërtimet e tipit *pushoi së ngrëni, mbaroi së lexuari, u lodh së foluri, plasi së qari, gjirem së thirruri, qeshi sa qeshi, hëngrën mirë e mirë etj.*

Përshkrimi dhe klasifikimi i foljeve të shqipes sipas karakteristikave aspektuale nga prof. A. Dharmo është me interes dhe përbën një ndihmesë të mirë në studimin e kategorisë semantike të aspektualitetit. Nisur nga arritjet e aspektologjisë në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit XX autori ka rivlerësuar pohimet e mëparshme rreth të ashtuquajturit aspekt në gjuhën shqipe dhe bën përpjekje për të veçuar e shqyrtuar aspektin dhe mënyrat e veprimit foljor si dy kategori të rrafshëve të ndryshme gjuhësore. Pa dashur të ndalemi me hollësi në konceptimet e autorit për këto dy kategori dhe mjetet e shprehjes së tyre në gjuhën shqipe, ne do të prekim dy-tri çështje që lidhen me mënyrat e veprimit në këtë gjuhë. (Konceptit të

autorit mbi kategorinë gramatikore të aspektit në gjuhën shqipe ne do t'i rikthehemi në kapitullin mbi kohët e foljes).

Në monografinë për aspektin dhe mënyrat e veprimit foljor shkruhet me të drejtë se “ ... për të mbetur studimi brenda caqeve të një vështrimi gramatikor, për studimin e mjeteve të shprehjes, ... me interes janë vetëm të tilla ngjyrime kuptimi, mbartës të të cilave janë shenjat morfologjike. Prandaj ne do të përpiqemi të hetojmë dhe të vëmë në pah pikërisht vetëm ato raste, ku gjuha jonë zotëron mjete të tilla të posaçme për shprehjen e mënyrave të veprimit”.⁶⁶

Midis këtyre mjeteve autori sjell edhe disa parashtesa e prapashtesa, të cilat kur i bashkëngjiten foljes, i japin asaj kuptime a ngjyrime të ndryshme të karakterit aspektual. Le të analizojmë disa shembuj të nxjerrë nga monografia e cituar.

Te mënyra intensive e veprimit janë përfshirë edhe foljet e prejardhura me parashtesën *për-* të tipit: *përflas* nga *flas*, *përpunoj* nga *punoj*, *përpiqem* nga *piqem*, *përvjel* nga *vjel*; *përgjum* nga *gjumë*, *prëmjal* nga *mjal*, *përgjunj* nga *gjunjë* etj. Siç shihet, katër foljet e para të prejardhura janë formuar nga folje të parme, ndërsa tri të fundit nga emrat. Në të gjitha këto raste foljet me parashtesën *për-* kanë kuptim leksikor të ndryshëm nga folja prodhuese, pra kemi të bëjmë me leksema të reja, të cilat edhe pse mund të ruajnë vlerë intensive, nuk mund të klasifikohen si mënyrë e veprimi. Parashtesa në këto formime nuk modifikon kuptimin e foljes prodhuese, por e kualifikon atë, I jep kuptim të ri.

Për të njëjtën arsye nuk duhet të përfshihen te mënyra intensive edhe formimet me prapashtesat *-(ë/u/o)llo-* (*ëlle-* (*ëlli*, *-lo-*, *-le-* *bubullon*, *fërshëllej*, *hingëllij*, *përcëlloj*, *capëloj*, *çapëlej*; *-is/-it-* *llamburis*, *gudulis*, *lebetis*, *llokoçit*; *-(ë)ro-/rro-* *blegëroj*, *hakërrohem*). (Formimet e këtij tipi i gjejmë edhe te mënyra e përsëritjes). Formimet prapashtesore të tipit të mësipërm nuk kanë për primar të tyre folje, kuptimi leksikor i së cilave të jetë modifikuar me anë të prapashtesave.

Jashtë klasifikimit në mënyrën intensive të veprimit duhet të mbeten edhe formime të tjera prapashtesore nga folje ose pjesë të ndryshme të ligjëratës, të cilat janë përfshirë në monografinë në fjalë, vetëm sepse prapashtesave etimologjikisht u është njohur një vlerë intensive, si *dështoj*, *dëfnej*, *gërmoj*, *gërvisht*, *gërgas*, *kridhem*, *kapërdij*, *lëshoj*, *lëvroj*, *lëvrij*, *këqyr*, *kaploj*, *kapërcej*, *kacafyt*, *ngas*, *ngujoj*, *ngurroj*, *ngul*, *ngjirem*, *ngjis*, *nxis*, *ndrit*, *ndryj*, *përbalt*, *përbaltoj*, *përloit*, *përbalt*, *përbaltoj*, *përbaltoj*, *përbaltoj*, *stërvit*, *shfnej*, *shkalavis*, *shkallmoj*, *shkokëloj*, *shqyjej*, *shkrij*, *shlyej*, *shfajsoj*, *shpërfytyroj* etj.

Jemi të mendimit se në mënyra veprimi në gjuhën shqipe duhen klasifikuar vetëm ato formime ndajshesore, të cilat e përqendrojnë vëmendjen në ndonjë tipar të brendshëm të

⁶⁶ Dhrimo A. *Vepër e cituar*, fq. 151-152.

shtjellimit të veprimit të shprehur nga folja prodhuese, si *përthur, përvidhem, përzgjedh, përthelloj, përkujudesem, përshtrij, skuqem, squllem, skalit, spraps, spërdredh, stërnxeh, stërmundoj, stërthem, shkëmbej, shkëpus etj.*

Mjetet formale (parashtesat, prapashtesat) e ngushtojnë semantikën e foljes prodhuese, por nuk prekin semantikën individuale të saj. Veçantia e foljeve të mësipërme ka të bëjë me mosshkëputjen e tyre si leksema të reja. Ja disa përdorime të tyre në tekst:

Kjo politikë, pikërisht pse është e tillë,.. i ka *përshtrirë* dhe i ka *përthelluar* marramendshëm mosdurimet, konfliktet dhe urrejtjet në jetën kombëtare... (R.Qose, Telegraf, 13 prill 2013)

Ishin stërkeqësuar kushtet për krijimtarinë. (Nga shtypi)

Për të shprehur rritjen e shkallëshkallshme të intensitetit të veprimit në gjuhën shqipe gjëjmë të pranëvendosura si formën parashtesore, ashtu edhe foljen pa parashtesë. P.sh.:

E ai njeri q'aty, ai që tash po hec përpara saj, peshon shumë randë në kujtesën e malësores, e cila *kuqet e kuqet e skuqet* nga turpi. Migjeni, Prozë 2, f.30.

Biseduam e numëruam me radhë se cilat ishin fletët tona... dhe, megjithse ato *ishin kopjuar e stërkopjuar*, dëshironim t'u hidhnim herë pas here nga një sy. (Letërsi e përkthyer).

Zhurma që vinte nga kafeneja, rreth së cilës *u sollëm e përsollëm*, nuk kishte pushuar aspak. (Letërsi e përkthyer)

Nuk kam për të harruar asnjëherë se si *vidhej e përvidhej* vështrimi i tij. (Letërsi e përkthyer)

Klasifikimi i foljeve në gjuhën shqipe sipas karakteristikave aspektuale apo “semantizmit” të tyre paraqitet i vështirë. Arsyet janë disa, por më poshtë po përmendim dy-tre faktorë, të cilët, sipas nesh, e vështirësojnë a kushtëzojnë këtë proces.

Së pari, mungesa e traditës së përshkrimit të mënyrave të mirëfillta të veprimit foljor, përjashtuar disa artikuj a konstatime fragmentare nëpër gramatika të ndryshme të shqipes.

Së dyti, numri i kufizuar i shënjesve aspektuale në gjuhën shqipe. Nga një vështrim i shpejtë i nëntë mënyrave të sipërpërmendura vetëm dy prej tyre formohen pjesërisht me parashtesa ose prapashtesa: mënyra çastore dhe mënyra intensive. Mjete mbizotëruese të shprehjes së mënyrave të veprimit në gjuhën shqipe mbeten ndërtimet analitike të tipave të ndryshëm. Siç duket, në sistemin foljor të shqipes është e pranishme prirja për të ruajtur në

rrafshin gjuhësor një numër jo të madh mjetesh të gatshme për shprehjen e kuptimeve aspektuale. Në shumicën e rasteve shqipfolësi, duke mos patur në përdorim mjete të gatshme, detyrohet “t’i prodhojë” ato vetë gjatë ligjëritimit. Ndryshe ndodh me rusishtfolësin. Në ligjërimin e tij mënyrat e veprimit vijnë si njësi të gatshme të formuara me ndajshitesa. Nëse folja e gjuhës ruse mund të klasifikohet me lehtësi në mënyra veprimi sipas ndajshitesave të posaçme, të cilat kanë fituar vlerën e shënjesit gramatikor, sistemimi i foljeve të shqipes nga pikëpamja e kuptimeve aspektuale bëhet më i vështirë për arsye të përdorimit të kufizuar të ndajshitesave si mjete modifikuese të kuptimit fillestar të foljes. Modelet e krijuara nga shqipja dhe rusishtja për relizimin e kuptimeve aspektuale, sipas nesh, kushtëzohen nga prirjet e analitizmit ose sintetizmit në këto gjuhë.

Së treti, aftësia e foljeve për të ndryshuar kuptimet a ngjyrimet aspektuale. Sipas mendimit tonë, dalja e së njëjtës folje me kuptime të ndryshme aspektuale në vartësi nga konteksti bëhet pengesë për identifikimin e grupeve leksiko-semantike dhe të mënyrave të veprimit. Po krahasojmë ndërtimet e tipit *folje+kundrinor në numrin njëjës dhe folje+kundrinor në numrin shumës*:

- | | |
|----------------------------|-----------------------------|
| - <i>hedh një gur</i> | - <i>hedh gurë</i> |
| - <i>përmend një fjalë</i> | - <i>përmend disa fjalë</i> |
| - <i>mbjell një pemë</i> | - <i>mbjell 10 pemë</i> |
| - <i>shkul një gozhdë</i> | - <i>shkul disa gozhdë</i> |

Në shembujt e sjellë foljet e kolonës së parë me kundrinor në numrin njëjës tregojnë veprime që kryhen vetëm një herë, ndërsa në kolonën e dytë po të njëjtat folje me kundrinor në numrin shumës shprehin kuptimin aspektual të përsëritjes së veprimit. Ky tip ndërtimi i mungon skemës së ndarjes së mënyrave të veprimit të A. Dhrimoja.

2.8.1. Semantika e mënyrave të veprimit në gjuhën ruse dhe veçoritë e përkthimit të tyre në gjuhën shqipe

Studimi i mënyrave të modifikimit të veprimit foljor është i rëndësishëm edhe për praktikën e përkthimit. Është me interes të shqyrtohen sa pasqyrohen në përkthim nuancat kuptimore të përfuara me anë të mjeteve fjalëformuese, si dhe të hetohen mjetet e mundshme gjuhësore për të përcjellë me saktësi kuptimet e njëjës a tjetrës mënyrë veprimi në përkthim.

Le të kalojmë në një analizë të shkurtër të semantikës së mënyrave të veprimit në sistemin foljor të gjuhës ruse duke sjellë edhe mjetet gjuhësore të gjuhës shqipe të përdorura nga përkthyesit për të transmetuar të gjithë kompleksin e karakteristikave aspektuale.

1. Mënyra e fillimit të veprimit

Për të karakterizuar nuanca të ndryshme të fillimit të veprimit në gramatika dhe në literaturën tjetër gjuhësore janë përdorur terma të ndryshëm si “fillim veprimi”, “veprim inkoativ”, “veprim ingresiv” etj. Në këtë punim ne do të përdorim termin gjithëpërfshirës “mënyrë e fillimit të veprimit”.

Idea e fillimit të veprimit në gjuhën ruse shprehet me anë të disa modeleve fjalëformuese. Si tregues formalë të kësaj mënyre në gjuhën ruse përdoren parashtesat **за-** (*засвистеть*); **по-** (*побежать*); **вз-** (*взвыть*) etj.

Parashtesa **за-** është nga më prodhimtaret në formimin e mënyrës së fillimit të veprimit. Foljet me këtë parashtesë sikur “shkëpusin” pjesën e fillimit të një situatë (veprimi), nga e cila mund të identifikohet më pas e gjithë situatën. Mënyra e fillimit të veprimi formohet kryesisht nga folje, të cilat përshkruajnë dukuri të mëposhtëme:

- 1) tinguj: *за шуметь, за грохотать, за звенеть, за мяукать, за свистеть, за стучать, за шептать, за барабанить*;
- 2) aromë, kundërmim: *за пахнуть, за вонять*;
- 3) ngjyrë, dritë: *за белеть, за зеленеть, за сверкать, за мелькать*;
- 4) gjendje të brendshme (fizike ose psikike) dhe shfaqjet e tyre: *за тошнить, за волноваться, за стесняться, за улыбаться, за капризничать, за сомневаться*;
- 5) procese homogjene, në veçanti lëvizje në drejtime të ndryshme: *заходить, за бегать, за летать, за прыгать, за плясать, за дышать*;
- 6) veprime të zakonshme: *закурить, заговорить (по-английски), заиграть (на бирже), запечь (пирог)*.

Në gjuhën ruse, si rregull, foljet perfekte që i përkasin mënyrës së fillimit të veprimit nuk formojnë çift aspektor (nuk kanë korrelatin imperfektiv). Mungesa e imperfektivimit dytësor është tipar i rëndësishëm i këtyre formimeve parashtesore.

Megjithatë në këtë gjuhë ka një numër foljesh, të cilat shënojnë fillim veprimi jo të mirëfilltë, si *заболеть, закурить, заговорить, запеть, зацвети, загореться, закипеть*, të cilat formojnë çifte aspekte me antë të prapashtesave (*заболевать, закуривать, заговаривать* etj.). Forma imperfektive përshkruan procesin se si kalon faza e fillimit të veprimit; p.sh., *закуривать* do të thotë “*ndez cigaren dhe e heq njëherë*”, *зацветать* tregon momentin e fillimit të procesit të lulëzimit, *заболевать* përshkruan një gjendje, e cila i paraprin gjendjes “*sëmurem*”. Pikërisht përshkrimi i kësaj faze, që i paraprin fillimit të veprimit, i dallon këto folje nga foljet e tjera perfekte të fillimit të veprimit.

Në literaturën gjuhësore foljet e këtij tipi njihen edhe si folje inkoative. Kuptimin inkoativ e kanë edhe foljet e lëvizjes me drejtim të *papërcaktuar* me parashtesën **за-** (*забегать, заездить, заходить*).

Në gjuhën ruse haset edhe një tip tjetër foljesh me parashtesën **но-** që shprehin fillim veprimi, por që në disa gramatika ruse quhet ndryshe edhe si mënyra *инг्रेसиве*. Dallohen dy grupe foljesh. Njërin grup e përbëjnë foljet e lëvizjes me parashtesën **но-**, të cilat tregojnë lëvizje në një drejtim, psh., *пойти, полететь, побежать, покатиться, поскокать, подуть, полить*. Duhet thënë se kuptimi i fillimit të veprimit tek këto folje është i zbehtë.

Në grupin tjetër përfshihen sërë foljesh me parashtesën **но-**, të formuara nga folje që shprehin perceptim ose gjendje të brendshme emocionale; psh., *показаться, почувствовать, почудиться, полюбить*. Po me këtë prapashtesë e formojnë nuancën ingresive të veprimit foljet e lëvizjes me drejtim të *përcaktuar* (*побежать, поехать, пойти*).

Kuptim ingresiv kanë edhe nga disa folje me parashtesën **о-/об-**: *опечалиться, обрадоваться, ободриться*, si dhe disa folje të tjera me parashtesën **у-**: *услышать, увидеть, узнать* etj.

Megjithatë, në të dy rastet kuptimi ingresiv të foljet e mësipërme ndërthuret me kuptimin rezultativ: fillimi i veprimit është i barazvlefshëm me realizimin e tij. Një dyzim i tillë shpjegon edhe përfshirjen e këtij kuptimi nga studiues të ndryshëm në mënyra të tjera të veprimit foljor.

Ndërthurje kuptimesh aspektuale kemi edhe te disa folje me parashtesën **вз-** *взвзывать, вскричать, взреветь, вздумать, встревожить, взревновать*, etj., si dhe te foljet me pjesëzën mohuese të tipit *невзлюбить*, të cilat kanë një nuancë shprehëse të veçantë. Ato njëherësh shprehin një veprim të menjëhershëm dhe të papritur.

Le të shohim më poshtë si jepen modifikimet semantike të mënyrës së fillimit të veprimit në përkthimet nga rusishtja. Ja disa shembuj:

Степан Аркадич задумался. /L.Tolstoi, Anna Karenina, fq.38/

Stepan Arkadiçi u duk i menduar. /Ana Karenina, fq.36/

С той минуты, как Анна *полюбила* Вронского, он считал своё право на неё неотъемлемым. /L.Tolstoi, Anna Karenina fq.306/

Nga çasti që Ana e *dashuroi*, ishte ai, Vronski, njeriu që i dilte zot. /Ana Karenina, fq.259/

Спавший на полу ребёнок проснулся и заплакал. /F.Dostojevskij, Prestuplenie i nakazanie, fq.140/

Foshnja që flinte në dysHEME u zgjua dhe *ia dha të qarit*. /Krim dhe ndëshkim, J.Doksani, fq.18/

Под ударом того летнего мгновенного вихря он почти так же мгновенно почувствовал – не то, что Джемма красавица, не то что она ему нравилась. /I.Turgenjev, Vjesennie vodi, fq.48/

Nën goditjen e asaj stuhie të menjëhershme verore, ai *ndjeu* po ashtu menjëherë, se jo vetëm e pëlqente Xhemën bukuroshe. /Ujrat pranverore, J. Billaci, fq.69/

Në asnjërin prej shembujve të mësipërm formimet parashtesore të rusishtes nuk janë dhënë me e ndërtimin analitik të shqipes të tipit **filloj (zë, nis)+lidhoren e foljes**. Do të ishin jo në natyrën e saj ndërtimet *ai filloi të ndjente po ashtu menjëherë* (shembulli 4). Përdorimi i së shkuarës aoristike nga ana e përkthyesve na duket me vend. Nëpërmjet kësaj forme përkthyesit kanë dhënë vlerat e aspektit të kryer, duke sakrifikuar nuancën e fillimit të veprimit. Kjo nuancë + nuanca e veprimit intensiv janë ruajtur nga përkthyesi në shembullin (3) përmes ndërtimit *ia dha të qarit*.

Në jo pak raste ndërtimet e tipit analitik *filloj të shkruaj* në përkthimet nga shqipja janë dhënë në gjuhën ruse me format sintetike. P.sh.:

<...Beni u hutua. Ç' ishte ky të folur në shumës? Ai i dha dorën dhe *filluan të ecin* të dy në drejtim të bulevardit të madh. ...> /I.Kadare, Dimri i Madh, fq.268/

<...Бэн растерялся; почему она обращается к нему на «вы»? Он протянул ей руку, и они *пошли* к центральному бульвару.> /Surovaja zima, I.Voronina, V.Modestov, fq.257/

Përdorimi i ndërtimit analitik të rusishtes (*стали ходить*) në këtë rast do të ishte pa vend, sepse konteksti nuk e lejon një gjë të tillë. Në kontekstet, ku veprimet i lënë vendin njëritjetrit gjejnë përdorim format e aspektit të kryer.

Ndryshe nga rusishtja, gjuha shqipe nuk ka mjete morfologjike për të shprehur sintetikisht nuancën e fillimit të veprimit. Si shumë gjuhë të tjera ajo përdor ndërtime analitike (shih. përkthimet e mësipërme). Por këtu vlen të nënvizohet fakti se midis **nuancës së fillimit të veprimit** të shprehur në shqipe me mënyrën analitike “filloj/nis,zë/ e këndoj” dhe asaj të shprehur sintetikisht në rusishtë “*занемь*” ka një ndryshim jo të vogël. Ndërtimet e tipit “*zë e këndoj*” tregojnë se veprimi ka filluar dhe vazhdon të shtjellohet, ndërsa formimet parashtesore të tipit “*занемь*” tregojnë fillimin e veprimit, por nuk mund ta paraqesin atë në vazhdimësinë e tij, sepse ato janë përgjithësisht të aspektit të kryer. Ndërtimeve të shqipes “*zë e këndoj, nis të tregoj etj.*” u përgjigjen në gjuhën ruse konstruktet me foljet e

fazës *начать/начинать, стать* + paskajoren e aspektit të pakryer (*начать/начинать, стать не*). Në letërsinë e përkthyer në këto gjuhë (nga rusishtja në shqipe dhe anasjelltas), nuancat midis konstrukteve “*начать не*” dhe “*зане*” në përgjithësi nuk janë ruajtur. Por ndonjë përkthyes ka vepruar ndryshe. Formimet parashtesore të kohës së shkuar “*заговорил, запел...etj.*” nuk i ka dhënë me ndërtimet analitike *zë (filloj, nis)* + folje në dëftore ose lidhore, por me formën e së kryerës së thjeshtë të foljes. Ja disa raste nga përkthimet në shqip tëj Dh. Paskos:

Ах вы, отцы наши, милостивцы вы наши, - *заговорил* он нараспев...
(И.С.Тургенев, “Записки охотника”, 140)

Ah, o babai ynë, mëshirëploti ynë, - *foli* ai duke hequr zvarrë fjalët si me të kënduar. (I.S. Turgeniev, Kujtimet e një gjahtari, 136)

Вдруг *застучала* телега и остановилась перед крыльцом: вошёл бурмистр.
(И.С.Тургенев, “Записки охотника”, 140)

Befas *u dëgjua* zhurma e rrotave të një qerreje që u ndal përpara derës. Hyri burmistri. (I.S. Turgeniev, Kujtimet e një gjahtari, 135)

Me ndërtimet analitike të shqipes të tipit *zë/nis/ të rrëfej, (nis e rrëfej)* etj. janë dhënë ndërtimet analoge të rusishtes të tipit *начать говорить*, të cilat shprehin po fillimin e veprimit, psh.:

Между тем как подали ужин Аркадий Павдыч *начал кушать*. /И.С.Тургенев, “Записки охотника”, 141/

Pasi na e shtruan darkën Arkadij Pavdiçi *zuri të hajë*. /I.S. Turgeniev, Po aty, 137/

Вот он его, Антипа-то *клевать и начал*. /И.С.Тургенев, “Записки охотника”, 149/

Që atëherë, burmistri *zuri t'i bjerë* kokës Antipit. /I.S. Turgeniev, Po aty, 142/

Mendojmë se në përkthimin e këtyre ndërtimeve është vepruar drejt. Zëvendësimi i ndërtimeve *zuri të hajë* dhe *zuri t'i bjerë* me formën e së kryerës së thjeshtë, përkatësisht *hëngri, (i) ra* do të përbënte shmangie nga origjinali. Po kështu dhe përdorimi i ndërtimit analitik në vend të trajtës së të kryerës së thjeshtë nuk do të ishte i përshtatshëm. Ne më lehtë themi: *Papritur u dëgjua zhurma e derës*, sesa *Papritur filloi të degjohet zhurma e derës*. Edhe në rusishte në këto raste përdoret forma parashtesore e aspektit të kryer *Вдруг закрипела дверь*. Folja *закрипела* fillimin e veprimit e shpreh si një ngjarje të mbyllur, si një fazë më vete pa përqendruar vëmendjen në faza të tjera të zhvillimit të tij. Forma e aspektit të kryer është përdorur edhe në pajtim me treguesin leksikor “*вдруг*”. Është kjo arsyeja që disa përkthyes nuancën e fillimit të veprimit, tek foljet parashtesore të tipit *зане, закрипеть, зашуметь* etj. e kanë mënjanuar në përkthimet e tyre duke i dhënë

përparësi transmetimit të kuptimit gramatikor të aspektit të kryer. Nuancat e ndryshme të mënyrave të veprimit jo rrallë dalin nga konteksti ku është përdorur trajta foljore.

2. Mënyra delimitative e veprimit

Si tregues formal në gjuhën ruse përdoret parashtesa **но-**, tipi *погулять*.

Foljet e kësaj mënyre veprimi përshkruajnë një “pjesë” të veprimit, kryerja e të cilit zë një kohë të kufizuar. P.sh.:

Он *погулял* полчаса.

Ai *shëtiti* gjysëm ore.

Можешь *попечатать* на моём компьютере, пока я говорю по телефону.

Mund të *shtypësh* në kompjuterin tim, ndërkohë që flas në telefon.

Me gjithë se foljet që i përkasin mënyrës delimitative të veprimit janë të aspektit të kryer, ato ruajnë disa tipare të foljeve prodhuese të aspektit të pakryer, të cilat shprehin proces. Sikurse edhe foljet e AP, foljet e AK lidhen me rrethanorë që tregojnë kohëzgjatjen e një veprimi, të cilët shprehen me rasën kallëzore pa parafjalë (psh., *почитал книгу два часа*). Ndërkohë gjejmë edhe përdorime të tjera tek foljet e aspektit të kryer me rrethanorë të të njëjtit tip, por me parafjalën “**за**”, të cilat nuk shprehin ndonjë mënyrë veprimi, p.sh. *Он прочёл книгу за два часа*).

Klasa e këtyre foljeve është shumë produktive. Mënyra delimitative e veprimit mund të formohet lirisht nga çdo folje, që shpreh proces jokalimtar, kryesisht nga folje jokalimtare, por rrallë edhe nga foljet kalimtare (më saktë, nga folje me drejtim të papërcaktuar); psh., *побегать, повеселиться, побеседовать, подумать, погулять, подышать, поиграть, покашлять, покурить, полетать, попрыгать, поработать, посидеть, походить*, etj.

Kjo mënyrë mund të formohet edhe nga folje cakësore, por kuptimi i caktuar tek këto folje humbet, psh., *полчаса почитать <газету>, поварить <варенье>*;

Foljet delimitative kanë tendencën për t’u shndërruar në korrelat të çiftit aspektor, d.m.th., zënë vendin e AK, përkrah atyre foljeve prej të cilave janë formuar.

Foljet delimitative nuk i nënshtrohen në asnjë rast imperfektivimit dytësor; folje të tipit *покашливать, покуривать, погуливать*, të cilat mund të merren si folje të formuara me imperfektivim dytësor nga foljet *покашлять, покурить, погулять*, nuk janë të tilla, ato kanë një nuancë tjetër kuptimore dhe i përkasin mënyrës së përshkallëzimit sasior ose intensitetit të ulët. Tregues formal i tyre mund të jetë parashtesa **но-** dhe prapashtesa **-ыва-**.

Po sjellim disa shembuj përkthimesh nga ruishtja të foljeve që klasifikohen në mënyrën delimitative të veprimit:

<...Если можно, *посидим* немного на скамеечке над обрывом...>

/A.I. Kuprin, Granatovij braslet/

<... Po të duash, *ulemi* pak në atë bankën buzë greminës...>

/Byzlyku me gur të kuq/

<...Он *пошутил* и *поговорил*, ровно сколько это было прилично...>

/L.Tollstoj, Anna Karenina, fq.19/

<...*Kuvendoi* dhe *bëri shaka* aq sa e kërkonte mirësjellja. ...> /Ana Karenina, fq.21/

Në rastin e parë kufizimi i veprimit në kohë, në gjuhën shqipe jepet me rrethanorin “pak”, ndërsa në rastin e dytë, ashtu si edhe në origjinal, nuk kemi të bëjmë me limitim të përcaktuar të veprimit si në rastin e parë. por në një mënyrë tjetër, veprimi gjithsesi na del i “kushtëzuar”, ose më mirë i kufizuar, në varësi të një veprimi tjetër.

Formimet parashtesore të aspektit të kryer që përbëjnë mënyrën delimitative të veprimit foljor, përkthehen në gjuhën shqipe me të kryerën e thjeshtë. Nuancën semantike të delimitativitetit (*постоять*) shqipja, në pamundësi për ta dhënë sintetikisht e jep ose me mjete të tjera leksikore, ose e le të pashprehur.

Dallojmë dy raste:

a) Nuanca delimitative shprehet me mjete leksikore kur folja nuk ndiqet nga plotësorë që tregojnë sasi kohe. Psh., Ребёнок *поплакал* и *заснул*. Fëmija *qau një copë herë* dhe fjeti. Rrethanori *një copë herë* jep idenë se veprimi është kryer në një kohë të kufizuar. E njëjta nuancë në gjuhën shqipe mund të jepet edhe me përsëritjen e vetë foljes. Fëmija *qau sa qau* dhe fjeti.

b) Kur folja shoqërohet nga plotësorë që tregojnë sasi kohe, idenë e zgjatjes së veprimit e jep plotësori. Psh.,

“Основной человек» *постоял минуты две* неподвижно и медленно поплелся домой. (209)

Njeriu “në pension” *qëndroi një dy minuta* palëvizur dhe pastaj, me ngadalë u hoq zvarrë gjer në shtëpi.

3. Mënyra perdurative e veprimit

Treguesi formal: parashtesa *про-* (*проговорить* <два часа по телефону>).

Këtu përfshihen folje, të cilat tregojnë një veprim që ndodh përgjatë një periudhe të kufizuar kohore, ku veprimi i foljes sikur e “*mbush*” këtë periudhë. Kështu, kur themi *человек проработал тридцать лет на заводе; три года пробездельничал; целый день провалялся в постели; осе полтара часа проговорил по телефону*, ne i kumtojmë bashkëbiseduesit se ajo (pra, *tridhjetë e pesë vjet, tre vjet, tërë ditën, një orë e gjysmë*) ka kaluar dhe personi gjatë kësaj periudhe kohore ka qenë tërësisht i zënë me këtë veprimtari.

Ndërsa me shprehjen “Они *прожили* вместе двадцать пять лет” do të kuptonim, *që kanë kaluar njëzet e pesë vjet, dhe gjatë gjithë kësaj periudhe ata kanë jetuar bashkë*.

Foljet e mënyrës perdurative të veprimit formohen kryesisht nga folje jokalimtare dhe përdoren vetëm në kontekste me tregues kohorë, të cilët e përforcojnë kuptimin perdurativ, *проспать до обеда, просидеть весь день, проболеть два месяца, проговорить сорок минут <по телефону>, прожить всю жизнь <в деревне>*.

Foljet *просидеть, пролежать, простоять*, që i përkasin kësaj mënyre veprimi, i nënshtrohen imperfektivimit dytësor.

Он каждый день *просиживает* по десять часов за компьютером, *пролеживает* до обеда в кровати, *простаивает* по три часа в очереди.

Ai *рри улур* në kompjuter nga dhjetë orë në ditë, *рри штрirë* në krevat deri në drekë, qëndron nga tre orë nëpër rradhë.

<...Они *простояли* два-три мгновения друг против друга;...> /F.Dostojevskij, *Idiot*, fq.85/

<...*Qëndruan* kësisoj disa çaste...> /F.Dostojevskij, *Idiot*, fq.74/

<...Ревновал он её ужасно. Говорят, целые ночи *простаивал* под ее окнами...> /A.Kuprin, *Granatovij braslet*, fq.26/

<...Bëhej xheloz për të sa të tmerronte. Thonë se i *rrinte* me netë të tëra në dritare...> /Byzlyku me gurë të kuq, përktheu M.Maçi, fq.49/

Për sa i përket nuancës perdurative që shprehin foljet parashtesore të aspektit të kryer (*прожить, проболеть, проспать*), ajo përgjithësisht në gjuhën shqipe del nga konteksti: foljet e kësaj mënyre veprimi tregojnë një veprim të përfunduar, që ka zgjatur një periudhë të caktuar kohe.

... года четыре *провел* он в чужих краях, то гоняясь за нею, то с намерением теряя ее из виду... (194).

... nja katër vjet *u end* nëpër vise të huaja, herë duke e ndjekur (princeshën), herë duke e humbur nga sytë me qëllim... (34)

Он *промутился* до утра, но не прибег к искусству Базарова... (309)

Siç duket edhe nga shembujt e sjellë nuanca e perdurativitetit në gjuhën shqipe jepet nga treguesit kohorë të cilët shoqërojnë foljen.

4. Mënyra çastore e veprimit

Treguesi formal: prapashtesa **-ну-** (*крикнуть*), **-ану-** (*мазануть*).

Tek kjo mënyrë veprimi përfshihen folje që shprehin një veprim të çastit, një veprim pikë. Pra, zgjatja e zhvillimit të veprimeve që ato emërtojnë është “*fillimi përkon me mbarimin*”. Kjo mënyrë formohet nga folje që tregojnë veprimtari të thjeshta fizike, si edhe dukuri optike a akustike, në radhë të parë tinguj të prodhuar nga njerëz ose kafshë. p.sh., *блестеть-блеснуть, брызгать-брызнуть, глотать-глотнуть, зевать-зевнуть, кивать-кив-нуть, двигать-двинуть, мигать-мигнуть, нырять-нырнуть, плевать-плю-нуть, свистеть-свистнуть, стучать-стукнуть, чихать-чихнуть*.

<... Никто лучше его не умеет во-время подкрасться и цапнуть за ногу, забраться в ледник или украсть у мужика...> /A. Çehov, Vanjka, fq. 99/

<...S’ka qen tjetër që të jetë në gjendje, si Ngjala, të të afrohet vjedhurazi e çak, të të *kafshojë* këmbën, të futet në qilar apo, ta zëmë, t’i vjedhë pulat muzhikut...> /Visare botërore, “Vanjka”, A.Çehov, shqipëroi Gj.Zheji, fq.338/

Foljet prej të cilave janë formuar foljet e kësaj mënyre, shprehin ose shumësi “çastesh” (psh., folja *моргать* shpreh përsëritje të veprimit që mbart folja *моргнуть*, folje të tilla quhen me shumë faza) ose veprime homogjene (psh., *дуть, глядеть, ругать, пугать*). Në këtë rast ajo shumësi çastesh, për të cilën folëm, krijohet nga vetë prapashtesa **-ну-**.

Foljet çastore me prapashtesën e mësipërme, kur formohen nga folje që tregojnë shumësi aktesh, stilistikisht janë neutrale; disa prej tyre formojnë me këto folje çifte aspektore (*кинуть-кидать, чихнуть-чихать, намекнуть-намекать*), disa të tjera jo (*глотнуть-глотать*).

Foljet po me këtë prapashtesë, por të formuara nga folje që tregojnë homogjenitet (*мазнуть, глянуть*), zakonisht fitojnë ngjyrimë stilistikore.

Krahas prapashtesës së sipërpërmendur, foljet e kësaj mënyre formohen edhe me prapashtesën **-ану-**, jo aq e shpeshtë në përdorim dhe me një ngjyrim më të qartë bisedor, p.sh., *рубануть, стегануть, мазануть* etj. të gjitha këto folje shprehin veprime çastore, që kryhen ashpër, me forcë, pa delikatesë, me ironi, folësi sikur nuk flet “seriozisht”.

Ka disa folje, të cilave mund t'i vendosim edhe një rën, edhe tjetrën prapashtesë, pra të dyja format janë të njëjta (*мазнуть* dhe *мазануть*).

Kësaj mënyre veprimi i bashkëngjiten gjithashtu edhe disa folje, të formuara me prapashtesën *с-* (*сосртричь, совррать, слупнуть, сробеть* etj.), dhe gjithashtu disa folje me prapashtesën *у-* (*ужалить, уколоть, укусить*). megjithatë kuptimi i çastësisë tek këto folje është më i dobët dhe shkrihet me kuptimin rezultativ të foljes.

Te mënyra çastore e veprimit përfshihen edhe disa folje që formohen nga kombinimi i prapashtesës *-ну-* dhe prapashtesave *с-, при-, вэ-* etj. P.sh.:

<...Опустит ресницы, длинные-длинные такие, и вся вдруг *вспыхнет*...>
/A.Kuprin, Granatovij, braslet, fq.24/

<...Ajo ul qerpikët e gjatë – ja kaq të gjatë, dhe papritur *ndizet* e tëra në fytyrë....>
/Byzylyku me gurë të kuq, M.Maçi, fq.46/

Sa i përket gjuhës shqipe mund të themi, që mjete të veçanta fjalëformuese për të shprehur këtë mënyrë veprimi, gjuha shqipe nuk njih. Fillimisht këtë mënyrë veprimi e ka konstatuar K. Cipoja tek disa folje që e kanë këtë kuptim në semantikën e tyre, *si bie, çel, flak, pickoj, vdes, prek, shkrepitin, zë*, etj., por edhe këto folje që e kanë në semantikën e tyre kuptimin e çastësisë, nuk mund të përcaktohen lehtë, pa pasur një kontekst të caktuar.

A. Dhrimo, në “Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe”, thekson, se ideja e veprimit çastor në gjuhën shqipe jepet nëpërmjet prapashtesës *për-*, e cila është polisemike në gjuhën shqipe. Sipas autorit *ajo jep idenë e çastësisë, të shoqëruar nga ideja e intensitetit të veprimit në folje të tilla si përlej, përpij, përpijek, përvëloj, përzë*⁶⁷ etj.

Me këtë konstatim nuk është aq lehtë të pajtohesh. Foljet prapashtesore *përlej, përzë, përfshij* përkundrejt foljeve prodhuese *lej, zë, fshij* mund të shënojnë një veprim më intensiv, edhe pse jo gjithnjë, por vështirë se bartësi i zakonshëm i gjuhës i përdor ato me nuacën kuptimore të çastësisë: *fshij nga historia dhe përfshij në histori*.

Për të theksuar idenë e çastësisë së veprimit përdoren një numër ndajfoljesh, prkt., shprehjesh ndajfoljore, *si befas, menjëherë, papritur, aty për aty, shpejt e shpejt, sa çel e mbyll sytë, fët-fët, cak*, etj. Për të shprehur këtë mënyrë veprimi i rëndësishëm është kuptimi leksikor i foljes dhe rrethanorët që e shoqërojnë atë.

5. Mënyra e përsëritjes së e veprimit (mënyra iterative)

Ndryshe nga mënyrat e veprimit që u parashtruan më sipër, foljet që përbëjnë mënyrën e përsëritjes së veprimit i përkasin formimeve prapashtesore të aspektit të pakryer.

⁶⁷ Dhrimo A., Vepër e cituar, fq.154

Tregues formalë të kësaj mënyre veprimi janë prapashtesat **-ыва-/-ива-, -ва-, -а-** (*сидживать, знаять, едать*).

Mënyra e përsëritjes së veprimit është një shfaqje e gjendjes së hershme të sistemit aspektual të gjuhës ruse dhe përbën një dukuri në zhdukje⁶⁸.

Në gjuhën e sotme ruse, relativisht të përdorshme janë formimet e mëposhtme: *ходить-хаживать, сидеть-сидживать, говорить-говаривать, слышать-слыхать* dhe *слыхивать, видеть-видать, и видывать, есть-едасть, жить-живасть, знаять-знавать, быть-бывасть*⁶⁹. P.sh.:

<...Когда-то давно хаживала за подаяньем еѣ дальняя родственница ... >
/А.Çehov, Nevesta/

<...Шумѣ вѣт перпара, vinte shpesh te gjyshja e saj ...> /А.Çehov, E fejuara, shqip. S.Caci/

Në letërsinë e shek. XIX ka pasur një numër më të madh foljesh, që tregonin përsëritje të veprimit, *ловить-лавливать, курить-куривать, бить-бивать* etj.

Вместе с ним перепелов лавливал. /Turgenjev/
Bashkë me të *kapnim* shkurta.

Në gjuhën e sotme ruse këto folje përdoren kryesisht në kohën e shkuar dhe në infinitiv. Përyashtim bën folja *бывасть*, e cila e ka ruajtur formën e kohës së tashme dhe të ardhme. Si rregull, mënyra iterative jepet në gjuhën shqipe me të pakryerën, here-herë të shoqëruar edhe me rrethanorë ose me ndërtime foljore, që japin idenë e kryerjes disa herë të një veprimi brenda një periudhe që zgjat një farë kohe p.sh.: (*bënte ç'bënte e vinte, një e dy e vinte, rastiste/qëllonte/ të vinte* etj.).

6. Mënyra e përshkallëzimit sasior dhe e uljes së intensitetit të një veprimi

Edhe kjo mënyrë veprimi përbëhet nga folje të aspektit të pakryer të formuara me prapashtesat **по-...-ыва-/-ива-, (покашливать), под-...-ыва-/-ива-(подворовывасть), при-...-ыва-/-ива-** (*прихрамывать*).

Foljet e kësaj mënyre formohen nga folje, që tregojnë procese jocakësore dhe më rrallë gjendje. Ato kanë kuptimin “të bësh diçka herë pas here dhe nga pak”: *покуривать*,

⁶⁸ Në gjuhën e sotme ruse prapashtesat **-ыва-/-ива-, -ва-, -а-** përdoren para së gjithash si tregues të imperfektivimit dytësor.

⁶⁹ Foljet *бывасть, видать, слышать*, kanë disa karakteristika të veçanta, që i dallojnë ato nga foljet e tjera të kësaj mënyre.

погуливать, покашливать, побаливать, постукивать, похажывать, похваливать, погляды-вать, поблескивать, пошучивать, повизгивать etj.

Foljet që formohen sipas këtij modeli janë dy tipash. Disa prej tyre shprehin veprime të identifikueshme vetëm në intervale të mëdha (ato nuk e kanë kuptimin e një veprimi aktual ose të zgjatur). Pyetjes, *Çfarë bën ai tani?* Mund t'i përgjigjemi: *Пьёт вино и курит; Сидит за столом и пишет статью; Лежит в кровати и читает книгу;* por s'mund të themi: *попивает и покуривает; посиживает и пописывает; полеживает и почитывает.*

Pjesa tjetër, përkundrazi, shpreh veprime aktuale ose gjendje: *покашливать, повизгивать, поблескивать, покачиваться* etj.

Më rrallë hasen edhe folje që formohen me parashtesën **под-** dhe **при-** (*подворовывать, подсмеиваться, подшучивать, приторговывать, прихрамывать*).

<...Время от времени он ласково *поглаживал* своей большой холодной рукой руку Веры, легко лежавшую на сгибе его рукава...> /Granatovij braslet, fq.24/
<...Kohë pas kohe ai *kalonte* dorën e tij të madhe e të ftohtë mbi atë të Verës, që e kish kapur lehtë në brryl...>/Byzylyku me gurë të kuq, fq.45/

<...Наконец, всё затихло, и только слышалось изредка, как в своей комнате, внизу, *покашливал* басом Саша. > /A.Çehov, Nevesta/
<...Më në fund u bë qetësi dhe u dëgjua kohë më kohë vetëm Sasha që *kollitej* me zë të trashë, në dhomën e tij në katin e poshtëm.> /A.Çehov, E fejuara, shqip. S.Caci/

Në të dy tekstet e mësipërme të dy përkthyesit e “kanë rrokur” nuancën shtesë të foljet e aspektit të pakryer *поглаживал* (shembulli 1) dhe *покашливал* (shembulli 2). Por kjo nuk ka përbërë ndonjë vështirësi të veçantë, sepse nuanca kuptimore e foljeve të mësipërme është dubluar përkatësisht me rrethanorët *время от времени (kohë pas kohe) dhe изредка (më të rrallë)*. Megjithatë në rastin e dytë kemi të bëjmë me shmangie të një natyre paksa tjetër. Shmangia ka të bëjë me përkthimin e gabuar të foljes së aspektit të pakryer *слышалось*, me formën aoristike të shqipes (*u dëgjua*), kur konteksti kërkon të pakryerën (*dëgjohej*). Me këtë korigjim dhe ndonjë redaktim tjetër teksti (2) duhej të tingëllonte kështu:

Më në fund gjithçka ra në qetësi, vetëm se në në katin e poshtëm, në dhomën e tij, *dëgjohej* kohë më kohë Sasha që *kollitej* me një zë të trashë.

Nga sa u parashtrua më sipër, për mënyrën e veprimit foljor në gjuhën shqipe dhe mënyrat e përkthimit të semantikave aspektuale të klasifikuara si mënyra veprimi në gjuhën ruse,

mund të arrijmë në përfundimin se mënyrat e veprimit në gjuhën tonë në tërësi shprehen me forma foljore, me forma foljore të kombinuara me tregues leksikorë, me folje që tregojnë stadin a fazën e zhvillimit të veprimit, me parashtesa dhe me mjete përshkruese.

Përfundime për kreun II

- ⇒ Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor janë dy dukuri që dallohen nga njëra tjetra si nga përmbajtja, ashtu dhe nga shprehja e tyre. Në qoftë se mënyrat e veprimit janë modifikime semantike të foljes (gjithnjë me mjete formale), kategoria gramatikore e aspektit e kualifikon kuptimin leksikor të saj.
- ⇒ Ndryshe nga kuptimi kategorial i kundërvënies *aspekt i kryer/aspekt i pakryer*, i cili përshkon pa përjashtim gjithë leksikun foljor, mënyrat e veprimit përfshijnë vetëm grupe të caktuara foljesh, që shprehin faza të ndryshme të shtjellimit të veprimit, shkallën e intensitetit të tij etj. Larmia e nuancave kuptimore që realizohen me mjete fjalëformuese dhe që shprehin mënyrën rrjedhës së veprimit në kohë janë një veçori tjetër e sistemit foljor të gjuhëve sllave.
- ⇒ Aspekti mbështetet në kundërvënien gramatikore *aspekt i kryer/aspekt i pakryer* dhe është element i paradigmës së foljes, ndërkohë që mënyrat e veprimit nuk formojnë kundërvënie gramatikore dhe as mund të përfshihen në paradigmen e foljes. Ato zënë një vend të ndërmjetëm midis fjalëformimit dhe trajtëformimit.
- ⇒ Për shprehjen e mënyrave të veprimit në gjuhën shqipe mjetet fjalëformuese zënë një peshë specifike të vogël, krahasuar me ndërtimet analitike, komponenti kryesor i të cilave është trajta kohore e foljes, e kombinuar me folje të tjera ndihmëse ose mjete të tjera jofoljore.
- ⇒ Mospërkimet semantike, të cilat realisht janë të pranishme në sistemet foljore të shqipes dhe rasishtes nuk përbëjnë ndonjë pengesë të pakapërcyeshme për komunikimin ndërgjuhësor midis dy gjuhëve, ndër të tjera edhe për veprimtarinë përkthimore. Mundësitë shprehëse të një gjuhe janë të pakufizuara sa i takon kombinimeve të mjeteve a njësisive gjuhësore që ajo zotëron.

Kreu III

SEMANTIKA E KOHËS DHE TEMPORALITETI

3.1. Kategoria e kohës: aspekti filozofik

Në themel të semantikës temporale qëndron nocioni “kohë”, i cili është objekt studimi jo vetëm i gjuhësisë, por edhe i shumë shkencave të tjera shoqërore e natyrore si filozofia, logjika, psikologjia, kulturologjia, fizika etj. Për studimin tonë rëndësi kanë sidomos qasja filozofike dhe linguistike e kohës.

Koha në radhë të parë është kategori filozofike, ontologjike. Për filozofët koha është një nga format e shfaqjes së materies, që së bashku me hapësirën dhe lëvizjen, krijojnë një unitet, ku koha përbën faktorin më të rëndësishëm të ekzistencës së botës dhe vetë njeriut. Nëpërmjet saj njeriu arrin “ta prekë” e të njohë realitetin që e rrethon.

Nga kohët më të hershme e deri në ditët e sotme ekzistojnë qasje të ndryshme rreth konceptimit dhe përshkrimit të kategorisë së kohës në filozofi. Me kategorinë filozofike të kohës janë marrë shumë dijetarë a shkencëtarë si Aristoteli, Aurel Augustini, Isak Njutoni, Emanuel Kanti, Edmund Gusserl etj.

Për Aristotelin koha është “numri i lëvizjeve në raport me lëvizjen pararendëse dhe atë vijuese”. Çështja e ekzistencës së kohës, sipas këtij dijetari, është paradoksale, përderisa të shkuar tani nuk ka, e ardhmja akoma s’ka ardhur, dhe “tani” është jo pjesë e kohës, por më shumë kufi midis së shkuarës dhe së ardhmes. Ideja e Aristotelit karakterizohet, nga njëra anë, si koncept relacionesh (koha jepet përmes vijimësisë së ngjarjeve, lidhjes së ngjarjes pararendëse me atë që vijon), dhe, nga ana tjetër, si koncept dinamik (përderisa e shkuara dhe e ardhmja nuk ekzistojnë, por ndodh një proces i pandërprerë).

Duke u mbështetur edhe në punimet e Aristotelit, Augustini (vitet 354-430 e.r.) pranon konceptet *kohë statike* për ekzistencën e Zotit, dhe *kohë dinamike* për ekzistencën e njeriut. Ai e sheh ekzistencën e kohës edhe në botën e sendeve si raport ndërmjet vetë sendeve: Sipas tij koha gjen shprehjen e vet në vijimësinë e sendeve njëri pas tjetrit përmes çastit të së tashmes. Augustini arrin në përfundimin se e shkuara dhe e ardhmja, megjithatë, ekzistojnë, por ekzistojnë ato vetëm për shpirtin, në ndërgjegjen e njeriut. Në të vërtetë, shkruan ai, duhet folur për tri kohë: të tashmen e së shkuarës, të tashmen e së tashmes, dhe të tashmen e së ardhmes.

Edhe për Augustinin koha përbente paradoks. Pyetjes se ç'është koha, ai i përgjigjej: "Në qoftë se mua askush nuk më pyet për këtë, unë e di, ç'është koha, nëse do të doja t'ia shpjegoj atë të interesuarit, jo, nuk e di".

Shumë më vonë Kanti e trajton kohën dhe hapësirën si forma apriori të kundërimit ndijesor, ku hapësira është forma apriori e ndijesisë së jashtme, ndërsa koha është forma apriori e ndijesisë së brendshme. Sipas tij koha është kushti i përgjithshëm i mundësimit të të gjitha dukurive, është përfytyrimi i domosdoshëm, që qëndron në bazë të të gjitha perceptimeve.

Edhe autorët e fjalorëve shpjegues në përkufizimet e tyre për kohën prekin çështjen e thelbit të kësaj dukurie, çfarë ajo përfaqëson. Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (2002) e përkufizon kohën si "formë objektive të ekzistencës së materies dhe kusht themelor të lëvizjes së saj, që shpreh se sa zgjatin sendet, dukuritë, ngjarjet ose proceset, se si vijnë këto njëra pas tjetrës".

Pa u ndalur me hollësi në trajtimet filozofike rreth kategorisë së kohës, po rendisim përmbledhtas disa koncepte për të tashmen, të shkuarën dhe të ardhmen, të cilat janë objekt studimi edhe për shkencën gjuhësore.

Më sipër u përmend se **e tashmja** është një çast i shkurtër, i cili ndan të shkuarën nga e ardhmja. Përfytyrimi i së tashmes si një çast që nuk zgjat i ka detyruar shumë dijetarë të mendojnë se bota materiale nuk ekziston realisht. Por, nga ana tjetër, çdo objekt dhe proces material, përdërisa ekzistojnë, ata në të vërtetë ekzistojnë në kohën e tashme.

Edhe pse objektet konkrete materiale që mbushin botën rreth nesh janë kalimtare dhe nuk mund të ekzistojnë pafundësisht si të tillë për një kohë të gjatë, ato nuk vijnë në të tashmen nga "e ardhmja" dhe nuk kalojnë "në të shkuarën", por shfaqen dhe pushojnë së ekzistuari si rezultat i lëvizjes së materies që ndodh në të tashmen. Lindin nga "e ardhmja" dhe kalojnë "në të shkuarën" jo vetë objektet a proceset e botës materiale, por gjendjet e tyre.

Çdo objekt a proces karakterizohet nga një sistem gjendjesh që ndërrojnë njëra-tjetrën. Pikërisht ky ndërrim i gjendjeve të objekteve dhe proceseve të botës materiale përbën rrjedhën e kohës. Mund të thuhet se vijnë nga "e ardhmja" dhe kalojnë në "të shkuarën" gjendje të ndryshme të objekteve dhe proceseve të botës materiale, ndërkohë që vetë bota materiale gjendet në një të tashme që zgjat përjetësisht.

Përdërisa nga e ardhmja "vijnë" dhe në të shkuarën "kalojnë" jo objektet materiale vetë, por vetëm gjendjet e tyre, atëherë në botën objektivistike reale nuk ka asnjë të shkuar dhe asnjë të ardhme, por ka vetëm të tashme që zgjat pa ndërprerje. Që të përfytyrojmë të shkuarën dhe të ardhmen na duhet kujtesa dhe përfytyrimi.

E shkuara është pasqyrim në ndërgjegjen tonë i vargut të ngjarjeve dhe gjendjeve të objekteve materiale, të cilat tashmë kanë pushuar së ekzistuari, ndërkohë shembëllimet e tyre ose janë ruajtur në kujtesën tonë, ose formohen në ndërgjegjen tonë në sajë të informacionit të përfutur prej tyre. Objektiviteti i së shkuarës tregon jo ekzistencën aktuale të ngjarjeve dhe gjendjeve të shkuara të objekteve dhe proceseve materiale, por vetëm atë, që dikur ato ekzistonin aktualisht në të tashmen.

E ardhmja është ai zinxhir shembëllimesh a përfytyrimesh që ekzistojnë në ndërgjegjen tonë për ngjarje a gjendje të objekteve dhe proceseve materiale që nuk kanë mbërritur akoma, por duke zëvendësuar njëra-tjetrën, mund ose duhet të realizohen në “të ardhmen” si fenomene të së tashmes. Objektiviteti i së ardhmes është objektivitet i ekzistencës potenciale të ngjarjeve dhe gjendjeve të objekteve dhe proceseve materiale, të cilat me një shkallë të caktuar vërtetësie mund të bëhen ngjarje dhe gjendje aktualisht ekzistuese të botës materiale.

Kështu, ekzistenca e objekteve materiale përbën një proces ndryshimesh të pandërprera të gjendjeve. Disa gjendje konkrete të objektit kanë vetëm ekzistencë aktuale, disa gjendje të tjera, të cilat objekti i ka pasur ose do t'i ketë edhe më, ndodhen ose “në të shkuarën” dhe ato nuk janë më, ose “në të ardhmen” dhe që ende s'janë. Pikërisht me gjendjet që i lënë vendin njëra-tjetrës janë të lidhura dhe momentet përkatëse të kohës.

Në literaturën shkencore bëhet fjalë për kohë psikologjike, biologjike, fizike, kulturologjike etj. Disa autorë dallojnë vetëm tre tipa kohësh: kohën fizike, domethënë kohën si element të botës objektive; kohën kronologjike, përmes së cilës jepet koha e ngjarjeve dhe kohën linguistike, e cila përfaqëson përpjekjet e arsyes njerëzore për të krijuar modelin e kohës reale përmes njërit ose tjetrit sistem semiotik të shprehur me mjete gjuhësore formale. Ka studiues që bëjnë fjalë për kohë absolute dhe kohë relative. Koha absolute, sipas tyre, është kusht i jashtëm i botës materiale që nuk varet nga zhvillimi i ndonjë procesi tjetër, ndërsa brenda kohës relative ndodhin procese të shumëllojshme.

Te koha studiuesit dallojnë tipare sasiore dhe cilësore. Tek të parat përfshihen tiparet metrike të kohës, të cilët mund t'i matim me anë të orës. Tiparet cilësore, ndryshe nga tiparet metrike, nuk varen nga mënyra e matjes dhe mbeten të pandryshueshme.

Te tiparet cilësore të kohës studiuesit përfshijnë:

- ⇒ njëtrajtshmërinë: koha rrjedh realisht, pa e shtuar ose ngadalësuar rrjedhën e saj;
- ⇒ njëkahshmërinë: koha ecën në një drejtim, nga e shkuara drejt së ardhmes;
- ⇒ linearitetin: rrjedha e kohës nuk kryqëzohet me veteveten;
- ⇒ pakthyeshmërinë: koha nuk kthehet mbrapsht;

- ⇒ pandryshueshmërinë e së shkuarës dhe mundësinë e korrektimit të së ardhmes;
- ⇒ lokalizimin: koha gjithmonë përkon me një çast të caktuar;
- ⇒ lidhjen me lëvizjen: koha nuk është statike, lëvizja është formë e ekzistencës së materies.

3.2. Kategoria e kohës: aspekti lingistik

Nga këndvështrimi lingistik vetë dukuritë a proceset e botës materiale, që ndodhin në kohën objektive, nuk shprehen përmes sistemeve gjuhësore të kohës. Kështu, kategoria gramatikore e kohës nuk pasqyron kohën objektive përmes formave foljore të saj, por raportet kohore midis dukurive të realitetit që na rrethon, të cilat ndryshojnë, zëvendësojnë njëra tjetrën ose kalojnë nga njëra gjendje në një gjendje tjetër.

Siç dihet, studimet gjuhësore për kohën janë mbështetur në të dhëna të shkencave të tjera si filozofia, psikologjia etj. Studiuesit i kanë kushtuar vëmendje të posaçme interpretimit gjuhësor të kohës si një kategori mjaft komplekse e realitetit që na rrethon. Çështje të ndryshme të kategorisë së kohës nuk e kanë humbur aktualitetin edhe në ditët tona. Mjaft prej pikëpamjeve të shprehura rreth kategorisë së kohës vazhdojnë edhe sot të zhvillohen më tej. Për gjuhësinë bashkëkohore vazhdon të tërheqë vëmendjen paradoksi, për të cilin bënte fjalë edhe A. Augustini në kohën e vet: nga njëra anë, kuptimet e formave kohore janë shumë të kuptueshme e të dallueshme për folësin e gjuhës, edhe pse atij i mungojnë njohuritë shkencore për to, nga ana tjetër, gjuhëtarëve u duhet të gjejnë kritere a pika mbështetëse, të cilat mund të shërbejnë si bazë për të shpjeguar funksionimin e disa formave kohore dhe kuptimet e tyre përkatëse. Kështu, p.sh., kur pohohet se format e së shkuarës shprehin parakohësi të situatës që përshkruhet në lidhje me çastin e ligjërimit, zakonisht nuk saktësohet se çfarë pikërisht kuptohet me kohë të situatës së përshkruar. Kuptohet, në fjali të thjeshta (*Këtë vit moti i mirë vazhdoi gjatë deri në vjeshtën e pasme*), një saktësim i tillë nuk kërkohet, pasi cilado fazë kohore e situatës së përshkruar, pra e gjithë situata i paraprin atij çasti, kur folësi e kumton atë.

Por si duhet vepruar në raste të tilla, kur situata e përshkruar ka filluar para çastit të ligjërimit dhe vazhdon edhe në këtë çast. Po sjellim ndonjë shembull. Për pyetjen që i drejtojmë bashkëbiseduesit lidhur me shëndetin e të njohurit tonë të përbashkët, mund të marrim përgjigjen “*Është shtruar në spital*”. Siç mund të vihet re, ky është një kontekst klasik i “së tashmes” dhe bashkëbiseduesi mund të përgjigjet njësoj edhe me formën e së tashmes “*Është në spital*”. Forma e parë (*është shtruar*) tregon se situata e filluar në të shkuarën vazhdon edhe në çastin e tanishëm.

Ja edhe një situatë tjetër. Për pyetjen “Kur ka mbretëruar Pirroja i Epirit?” mund të përgjigjem “Unë (*gjithnjë*) kam menduar se para 23 shekujsh”. Kjo përgjigje nuk tregon

se në çastin e ligjërimit folësi nuk mendon më kështu, prandaj variant i saj mund të jetë edhe forma e së tashmes “Unë *mendoj* se para 23 shekujsh”.

Përdorimet e formave foljore të mësipërme të shtyjnë të mendosh se midis tyre krijohet një hapësirë e gjerë, ku format e së shkuarës dhe së tashmes konkurojnë me njëra-tjetër. Nga ana tjetër, mund të konstatohet me lehtësi se në rastet e sjella kemi të bëjmë me parakohësi të pjesshme, e cila ndryshon, fjala vjen, nga parakohësia e plotë e shprehur me formën aoristike (*U shtrua* në spital). Ky është një dallim semantik jo pa rëndësi midis parakohësisë së plotë të shprehur përmes formave të së shkuarës dhe parakohësisë së pjesshme, të shprehur në disa raste përmes formave të së shkuarës perfekte. Me të drejtë mund të shtrohet pyetja se ç’duhet të kuptojmë me parakohësi: a është kriter i mjaftueshëm çasti i ligjërimit si pikë ndarëse midis së shkuarës dhe të tashmes? Ose më thjeshtë: themi parakohësi, por në lidhje me se?

Semantika kohore është një zonë e gjerë, e cila përfshin njësi të rrafshve të ndryshme gjuhësore me kuptim kohor. Fiksimi gjuhësor i kohës realizohet me mjete leksikore e gramatikore, të cilat formojnë një sistem tërësor të temporalitetit gjuhësor. Duke pasur një inventar të veçantë formash, koha gjuhësore, ndryshe nga koha fizike, filozofike etj., ka karakter idioetnik. Kjo do të thotë se dallimet që shfaqen në përdorimin e formave kohore në gjuhë të ndryshme nuk kanë të bëjnë me karakterin real të vetë veprimeve, por me dallime në mënyrën e konceptimit dhe interpretimit të proceseve të botës materiale nga bartësit e gjuhës. Pikërisht këto dallime kushtëzojnë përzgjedhjen e mjeteve gjuhësore për shprehjen e marrëdhënieve temporale.

Konceptualizimi i marrëdhënieve kohore dhe kategorizimi e formalizimi i tyre me mjete të ndryshme gjuhësore përbëjnë thelbin e kohës gjuhësore.

Përshkrimet të kohës gjuhësore i janë kushtuar shumë punime, një pjesë e të cilave mund të quhen trajtesa të plota. Ndër to vlen të përmenden studimet *Time and the Verb* (R. Binnick), *Вид и время русского глагола* (А.В. Бондарко), *Tense and Aspect Systems* (Ö. Dahl), *Tense* (B. Comrie) etj.⁷⁰

Në përshkrimet e kohës gjuhësore format foljore tradicionalisht kanë qenë mbizotëruese. Mjetet leksikore (leksemat temporale), edhe pse janë të shumta dhe paraqitin interes për studiuesin, kanë zënë një vend më modest në literaturën gjuhësore. Mjetet e të gjitha

⁷⁰ Binnick, R., *Time and the Verb*, Oxford: Oxford University Press, 1991.
Бондарко, А. В., *Вид и время русского глагола*, Москва, 1971.
Dahl, Ö., *Tense and Aspect Systems*, Oxford-N.Y.: Basil Blackwell, 1985.
Comrie, B., *Tense*, Cambridge: Cambridge University Press, 1985 etj.

rrafsheve gjuhësore (fjalëformuese, leksikore, morfologjike e sintaksore), që shprehin marrëdhënie kohore, përbëjnë zonën semantike të tempoalitetit.

3.3. Temporaliteti si kategori semantike funksionale

Në shkencën gjuhësore operohet me nocionin *kohë* dhe me nocionin *temporalitet*. Kemi të bëjmë me dy kuptime të kategorisë së kohës: me kategorinë semantike funksionale të temporalitetit, e cila shpreh thelbin e aspektit fizik dhe filozofik të kohës, të realizuar me mjete të ndryshme gjuhësore: gramatikore, leksikore ose me kombinimet e tyre. Midis tyre vend të veçantë në shprehjen e semantikës temporale zënë mjetet gramatikore, të quajtura tradicionalisht si koha e foljes.

Prania në gjuhë e kundërvënieve të formave foljore përbën kategorinë gramatikore të kohës. Midis kategorisë semantike të temporalitetit dhe kategorisë së kohës nuk mund të vihet shenja e barazimit. Nëse me kategori të kohës tradicionalisht është kuptuar koha gramatikore e shprehur me forma foljore, kategoria semantike funksionale e temporalitetit përfshin tërësinë e mjeteve të rrafsheve të ndryshme gjuhësore. Në hapësirën semantike të temporalitetit kategoria morfologjike e kohës është pjesë e kësaj zone dhe përbën komponentin kryesor (bërthamën) e saj. Në këtë kuptim kategoria semantike funksionale e temporalitetit ka shtrirje vëllimore më të gjerë sesa kategoria e kohës.

Temporaliteti është koha e jashtme e ngjarjes (veprimit ose gjendjes) me karakteristikë të qartë deiktike. Tek kategoria e temporalitetit ideja e kohës shfaqet si orientim i veprimit ndaj një treguesi të jashtëm, çastit të ligjëritimit. Pikërisht ky lloj orientimi e dallon temporalitetin nga aspektualiteti, nëpërmjet të cilit, siç është vënë në dukje në këtë punim, jepen karakteristikat e brendshme të rrjedhës së veprimit në kohë.

Semantika temporale në gjuhësi është kundruar nga këndvështrime të ndryshme. Në literaturën gjuhësore të dhjetëvjeçarëve të fundit ndeshemi edhe me kënvështrime të tjera si: qasja semantike funksionale, semantike sintaksore, konjitive e komunikative. Të gjitha këto qasje flasin për drejtime të caktuara në studimet gjuhësore në vartësi nga prioritetet e secilit drejtim. Studiuesit e sistemit foljor të shqipes janë mbështetur kryesisht në parimet e gramatikës tradicionale: duke analizuar mjetet e shprehjes së marrëdhënieve kohore, është hedhur dritë mbi kuptimet kohore të formave foljore.

Pavarësisht nga larmia e këndvështrimeve të sipërpërmendura dhe numrit të konsiderueshëm të punimeve, në gjuhësinë bashkëkohore bien në sy disa prirje në përshkrimin e kohës gjuhësore. Konkretisht:

- largimi në një farë shkalle nga analiza e mirëfilltë gramatikore;

- studimi i kategorisë gjuhësore të temporalitetit duke shfrytëzuar të dhëna të shkencave të tjera;
- marrja parasysh e tipave të ndryshëm të marrëdhënieve temporale në gjuhë;
- marrja parasysh e lidhjeve sistimore të kategorisë së temporalitetit me kategori të tjera semantike.

Prirjet e mësipërme mund të vështrohen si dy drejtime, të cilat dallohen midis tyre nga përparësitë në studimin e aspekteve të ndryshme të semantikës temporale:

- 1) drejtimi i parë e përqendron vëmendjen në përshkrimin e orientimit kohor me anë të formave vetore të foljes (veprimi i shprehur prej foljes i përket kohës së shkuar, kohës së tashme, kohës së ardhme). Treguesit leksikorë të kohës përshkruhen në gramatika në kreun e rrethorëve.
- 2) për drejtimin e dytë është karakteristikë bashkëveprimi i mjeteve gramatikore dhe leksikore të cilat marrin pjesë në shprehjen e kohës.

Për trajtimin e problematikës temporale në gjuhën shqipe ne do të ndjekim drejtimin e dytë për faktin se format gramatikore, kur përdoren në ligjërim, bashkëveprojnë jo vetëm njëra me tjetrën, por edhe me leksikon që i rrethon. Në vartësi nga këta tregues leksikorë ndryshojnë kuptimi dhe funksioni i njëjës ose tjetrës formë. Në shumicën e rasteve mjetet leksikore saktësojnë a konkretizojnë kuptimet e formës gramatikore. Prandaj kur përshkruajmë aspekte të ndryshme të kohës gjuhësore është e udhës të studiohen të gjitha mjetet (gramatikore, leksikore a fjalëformuese), që shprehin raporte kohore. Ky sistem heterogjen mjetesh, që konvergjon mbi bazën e funksioneve semantike të përbashkëta, formon fushën semantike funksionale të temporalitetit.

Në sistemin foljor të shqipes dhe rusishtes fusha semantike funksionale e temporalitetit është njëqendrore (monocentrike), pra me qendrën (bërthamën) dhe periferinë e saj. Qendrën e përbëjnë format kohore të foljes (kategoria gramatikore e kohës), ndërsa mjetet e tjera (leksikore, leksiko-gramatikore, kontekstuale) qëndrojnë në periferi të formave kohore të foljes.

Me të drejtë mund të shtrohet pyetja, pse koha gramatikore është element qendror i zonës semantike të temporalitetit, ndërsa mjetet e tjera janë elemente periferike të saj. Koha foljore përbën bërthamën e fushës sepse:

- a) sema e kohës është e pranishme te të gjitha format vetore të foljes;
- b) format foljore, si rregull, kanë aftësinë për të realizuar në mënyrë të pavarur lokalizimin kohor të veprimit.

Mjetet e tjera jofoljore që kryejnë funksionin e rrethorëve të kohës nuk kanë aftësi të shprehin në mënyrë të pavarur karakteristikën temporale të veprimit. Nga disa studiues ato

vështrohen si mjete plotësuese, të cilat shoqërojnë format kohore të foljes dhe saktësojnë kuptimin e tyre kohor. Studiues të tjerë janë të mendimit se mjetet leksikore, pavarësisht nga pozicioni periferik i tyre në raport me kategorinë gramatikore të kohës, në disa raste janë përcaktuese në realizimin e orientimit kohor. “Format foljore të kohës kanë mundësi të kufizuara, ndërkohë që leksiku temporal i kategorive të ndryshme ka mundësi shumë më të mëdha.”⁷¹

Në vartësi nga situata temporale mjetet leksikore ose mund të konkretizojnë, ose mund të modifikojnë kuptimin e formës foljore

3.4. Temporaliteti jofoljor

Interpretimi gjuhësor i nocionit të kohës është shumështrësor. Ai prek të gjitha nivelet e gjuhës, si shtresën e gjerë të leksikut “kohor” (njësitë emërore a ndajfoljore temporale), kategoritë gramatikore, të cilat shprehin përfytyrimin e njeriut mbi kohën, orientimin e tij kohor, ndërtimet e ndryshme sintaksore, të cilat shprehin raporte të përmbajtjes së kumtimit ndaj njërit ose tjetrit plani kohor.

Në studimet për kategorinë gramatikore të kohës në gjuhën shqipe tradicionalisht vëmendja kryesore është përqendruar në përshkrimin e mjeteve morfologjike të shprehjes së marrëdhënieve kohore, duke hedhur dritë kryesisht mbi kuptimet paradigmatiche të formave kohore. Më pak vëmendje u është kushtuar mjeteve leksikore, të cilat në bashkëvajtje me mjetet e tjera realizojnë shprehjen e semantikës temporale. Një qasje e tillë, që merr parasysh jo vetëm mjetet foljore, por edhe kushtet e realizimit të kuptimeve të tjera sintagmatike me mjete jofoljore, e kalon studimin në rrafshin semantiko-funksional.

Mjetet leksikore jofoljore (emra, ndajfolje temporale, ndërtime të caktuara sintaksore etj.) janë elemente përbërëse të fushës semantike funksionale të temporalitetit. Brenda kësaj fushe ato formojnë një mikrofushë më vete, e cila, krahasuar me kohën gramatikore, qëndron në periferi të saj. Për nga potenciali semantik elementet përbërëse të mikrofushës karakterizohen nga pasuria e ngjyresave kuptimore kohore. Përshkrimi i këtyre njësive brenda fushës semantike funksionale të temporalitetit është kompleks, përderisa shprehja gjuhësore e konceptit të kohës realizohet me mjete të rrafshëve të ndryshme.

Periferinë e fushës semantike funksionale të temporalitetit e përbëjnë rrethanorët, funksionin e të cilëve e kryejnë pjesë të ndryshme të ligjëratës si:

- 1) emrat: *kohë, erë, epokë, periudhë, moment, çast, dhjetëvjeçar-i, dyzetditësh-i* etj.);

⁷¹ Ерзинкян Е. Л., *Дейктическая семантика слова*, 1988, 73.

- 2) mbiemrat: *i shkuar, i tanishëm, i ardhshëm, i vjetshëm, i sivjetshëm, i qëmotshëm, moshatar etj.*);
- 3) ndajfoljet ose lokucionet ndajfoljore: *tani, dje, pastaj, vitin e shkuar, javën e ardhshme, së shpejti, të dielën, të premteve etj.*
- 4) lidhëzorët dhe parafjalët: *gjatë drekës, para mbledhjes, pas darke, përpara se të bisedojmë, në prag të dimrit, pas festës, gjithë ditën, pas mësimit, midis drekës dhe darkës, në pushimin e vogël, nga mëngjesi, me vite, me orë, në tri ditë, për dy orë, në mes të bukës, në vazhdimësi të, pas etj.*).
- 5) ndërtime sintaksore (fjalitë e nënrenditura): *Kur arritën në rrëzë të kodrave, u dëgjua fare pranë kënga e kundërshtarit (S. Godo, Plaku i Butkës).*

Njësitë leksikore mund të shprehin:

- njëkohësi: *sot, tani, në kohën tonë, aktualisht etj.*;
- parakohësi: *dje, herën e kaluar, dikur, më parë, dy vjet më parë, më 1990-ën;*
- paskohësi: *nesër, së shpejti, pas dy ditësh, në të ardhmen etj.*

Si rregull, pas këtyre ndajfoljeve temporale vijnë format kohore të së tashmes, të së shkuarës ose të së ardhmes. P.sh.:

Sot nuk po dal nga shtëpia.

Në atë kohë morëm urdhër të niseshim nga Korça në Pogradec... (S. Godo, po aty);

Nesër ose pasnesër do të botoj një shkrim për ruajtjen e mjedisit.

Analiza e raporteve temporale në një thënie konkrete tregon që rrethanorët temporalë, si tregues kontekstualë që zgjerojnë thënien, përcaktojnë temporalitetin e përgjithshëm të saj. Pikërisht në rrafshin e thënies shfaqet “lëvizshmëria” e kuptimeve të formave temporale të foljes: e njëjta formë, në prani të ndajfoljeve temporale, mund të përdoret për të shprehur kuptime të ndryshme kohore. Kur në kontekst treguesit temporalë mungojnë, folja zakonisht shpreh në mënyrë të drejtpërdrejtë kuptimin e saj kategorial (temporal ose temporalo-aspektual).

Forma foljore shpreh kohën e ngjarjes, ndërsa leksiku temporal shpreh kohën e referencës, dhe së bashku ato përcaktojnë tipin e situatës temporale të shprehur nga fjalia. Kështu, raporti midis pikave të referimit kushtëzojnë funksione të ndryshme të mjeteve leksikore. Kur koha e kumtimit përkon me kohën e ngjarjes, ato luajnë rol konkretizues, kur ato nuk përkojnë, luajnë rol modifikues të temporalitetit gramatikor.

Në gramatikën e gjuhës shqipe I, për ndajfoljet e kohës shkruhet se ato “emërtojnë një rrethanë kohore, d.m.th kohën kur kryhet a kohën sa zgjat veprimi ose gjendja e shprehur

nga një folje, ose nga një emër prejfoljor i nyjzuar”⁷². Dhe më tej pohohet se ndajfoljet mund të tregojnë “kohën e zgjatjes së një veprimi, a të një gjendjeje, ose dendurinë e tyre, si edhe përforcimin e përsëritjen rregullisht të një veprimi pas një periudhe të caktuar kohe”.

Nga ky përkufizim, duket se te koncepti **kohë** autorët përfshijnë edhe zgjatjen në kohë të veprimit, çka, sipas nesh, vjen nga paqartësia në dallimin e kuptimeve temporale nga ato aspektuale.

3.3.2. Temporaliteti foljor: kategoria gramatikore e kohës

Ndryshe nga mjetet temporale jofoljore, leksiku foljor për nga natyra e tij është mjete kryesor i shprehjes së dinamikës së ngjarjeve (veprimeve). Leksiku foljor është i aftë të përcjellë të gjitha etapat e zhvillimit të një procesi. Leksiku foljor i gjuhës shqipe, për nga pikëpamja e informacionit që përcjell, përbën sistemin më të pasur në forma kohore. Përmes tyre shprehen drejtpërsëdrejti kategoritë gramatikore të foljes.

Kur flasim për kategoritë foljore kemi parasysh kuptimet kategoriale gramatikore, leksiko-gramatikore dhe semantiko-funksionale si: mënyra, koha, diateza, veta, numri, klasat leksiko-gramatikore (foljet kalimtare/jokalimtare, foljet që shprehin mënyrën e veprimit, foljet modale), fushat semantiko-funksionale (modaliteti, tempoaliteti, aspektualiteti, taksisa, vetorësia, diatezorësia etj.).

Në studimet për sistemin foljor të shqipes koncepti i *kohës* tradicionalisht është lidhur me kategorinë gramatikore të kohës, e cila është pasqyrim specifik i kohës objektive. Kjo kategori e foljes realizon lokalizimin temporal të ngjarjes, që bëhet objekt kumtimi.

Kategoria morfologjike e kohës përkufizohet si një sistem formash që i kundërvihen njëra tjetrës, të cilat tregojnë marrëdhëniet e veprimit ndaj çastit të ligjërimit. Kategorinë e kohës në gjuhën shqipe, përveç mënyrës dëftore e kanë edhe mënyra të tjera si habitorja, lidhorja, kushtorja e dëshirorja.

Kategoria e kohës së foljes është e pranishme në të gjitha gjuhët. Pjesa më e madhe e tyre karakterizohet nga kundërvënia gramatikore trigjymtyrëshe *e tashme – e shkuar – e ardhme*. Një kundërvënie e tillë “treshe” është e pranishme në gjuhën shqipe, në gjuhët gjermanike, romane, sllave dhe gjuhë të tjera.

Në gjuhën ruse zhvillimi i aspektit foljor nxori nga përdorimi mjaft forma kohore. Sot kjo gjuhë karakterizohet nga një sistem i thjeshtëzuar i sistemit kohor (pesë forma kohore). Ai

⁷² *Gramatika e gjuhës shqipe I*, 2002 fq. 362-363

përbëhet nga dy forma foljore të së shkuarës, dy forma për kohën e ardhme një për kohën e tashme. Ka studiues që tek e tashmja përfshijnë formën e së ardhmes të aspektit të kryer (shih më poshtë). Në gjuhën e sotme ruse kategorinë gramatikore të kohës e kanë vetëm format e mënyrës dëftore.⁷³

3.3.2.1. Deiksis kohor

Çdo objekt i botës materiale dhe çdo situatë (veprim i shprehur nga një folje) nuk mund të paraqitet ndryshe, veçse i lokalizuar në hapësirë dhe në kohë. Orientimi i objektit ose i situatës në kohë ose hapësirë realizohet në lidhje me qendrën deiktike, deiksisin hapësinor ose deiksisin kohor. Deiksisin hapësinor tregon pozicionin e objektit në lidhje me folësin, ndërsa si qendër deiktike për orientimin kohor të situatës shërben çasti i ligjërit. Deiksisin kohor mat pozicionin e fragmenteve kohore në raport me qendrën deiktike (*dy vjet më parë, pas disa ditësh* etj.).

Lidhur me faktin se në gjuhë të ndryshme koha zakonisht konceptohet si lineare, d.m.th. si vektor i drejtuar nga e shkuara drejt së ardhmes, lokalizimi kohor i situatës ka të bëjë me kronologjinë relative të dy situatave në boshtin kohor:

- 1) situatës së përshkruar
- 2) situatës së aktit ligjërimor (çastit kur folësi e kumton këtë situatë).

Kjo është mënyra më e thjeshtë e lokalizimit të situatës në kohë, e cila është e pranishme pothuaj në të gjitha gjuhët, pavarësisht nga dallimet kulturore në perceptimin e kohës si të tillë nga bartësit e tyre.⁷⁴

Në lidhje me çastin e ligjërit, që shërben si pikë referimi, situata e përshkruar (veprimi ose gjendja) mund të tregojë parakohësi, njëkohësi ose paskohësi. Përkatësia e veprimit foljor ndaj njërit prej planeve kohore të mësipërme përbën thelbin e kohës si kategori gramatikore.

Kështu, kategoria e deiksisit kohor mund të përfshijë jo më shumë se tri gramema:

- a) situata e përshkruar përkon në kohë me çastin e ligjërit;
- b) situata e përshkruar i paraprin çastit të ligjërit;
- c) situata e përshkruar vjen pas çastit të ligjërit.

Gramema të tilla në gjuhë njihen si: **e shkuar**, **e tashme** dhe **e ardhme**.

⁷³ *Russkaya grammatika*, 1980, fq.626

⁷⁴ Плунгин В.А., *Общая морфология*, М. 2003, fq. 264

Është me rëndësi të vëmë në dukje se deiksisi kohor nuk jep asnjë informacion për mënyrën se si zhvillohet situata (nëse është çastore, nëse zgjat, nëse ka përfunduar ose jo etj.). I gjithë ky informacion i përket semantikës aspektuale, e cila realizohet nga format kohore në bashkëvajtje me elemente të kontekstit.

Në varësi nga pozicioni i ndërsjellë midis intervalit kohor që zë situata e përshkruar në boshtin kohor dhe pikës së referimit, gjuhët mund të dallohen sipas parametrave të mëposhtëm:

Parametri i parë ka të bëjë me pozicionin e ndërsjellë midis intervalit kohor, gjatë të cilit situata e përshkruar ndodh në realitetin aktual dhe pikës së referimit të zgjedhur në boshtin kohor. Në këtë rast situata që bëhet objekt kumtimi mund të ketë kuptimin e njëkohësisë, parakohësisë ose paskohësisë.

Parametri i dytë lidhet me pozicionin e ndërsjellë midis pikës së referimit dhe çastit të ligjërit. Edhe ky parametër i ka kuptimet e mësipërme të njëkohësisë, parakohësisë ose paskohësisë. Pika e referimit mund të përputhet me çastin e ligjërit, mund t'i paraprijë atij, ose mund ta pasojë atë.

Parametri i tretë ka të bëjë me largësinë relative midis intervalit kohor, që zë situata e përshkruar dhe pikës së referimit. Në këtë rast pika e referimit është e ndryshme nga çasti i ligjërit.

Dy parametrat e parë përcaktojnë statusin e kategorisë gramatikore të kohës si kategori deiktike. Lokalizimi i intervalit kohor që zë situata e kumtuar në lidhje me pikën e referimit, kur kjo e fundit përkon me çastin e ligjërit, përbën kohën gramatikore absolute. Koha absolute ka tri kuptime:

- **kuptimin e së tashmes** - intervali kohor që zë situata e përshkruar përfshin çastin e ligjërit ose është bashkërënës me të;
- **kuptimin e së shkuarës** - intervali kohor që zë situata e përshkruar i paraprin çastit të ligjërit;
- **kuptimin e së ardhmes** - intervali kohor që zë situata e përshkruar vijon pas çastit të ligjërit.

Kuptimet kohore të së tashmes, të së shkuarës dhe të së ardhmes shprehen gramatikisht si në gjuhën shqipe (*vrapij, vrapoja/vrapova/kam vrapuar, do të vrapoj*), ashtu edhe në gjuhën ruse (*бегаю, бегаи, буду бегаи*). Prania në gjuhë e njërive gramatikore që shprehin kohë absolute është përgjithësisht universale.

Lokalizimi i situatës së përshkruar në lidhje me pikën e referimit, të ndryshme nga çasti i ligjëritimit njihet në gjuhësi si kohë relative. Për të emërtuar kohën relative disa studiues përdorin termin e huazuar nga greqishtja *taksisë*, të cilin e futi në gjuhësi R. Jakobsoni.⁷⁵

Kategoria e taksisë, ndryshe nga koha absolute, nuk ka si orientues çastin e ligjëritimit. Si pikë referimi për kuptimet taksisore shërben koha e një ngjarje tjetër. Sipas disa gjuhëtarëve, kuptimet e taksisë në gjuhët e pajisura me mjete të posaçme përbëjnë kategori gramatikore. Gjuha shqipe, sipas nesh, bën pjesë te gjuhët e pajisura me mjete formale për shprehjen e kuptimeve të taksisë (format pluskuamperfektore, format e së ardhmes së të shkuarës dhe së ardhmes së përparme të së shkuarës).

Ndryshe nga shqipja, në gjuhën ruse kategoria e taksisë nuk përbën kategori gramatikore. Kjo gjuhë nuk ka forma gramatikore të posaçme për shprehjen e kohës së një veprimi në lidhje me një veprim tjetër (shih kreun për taksisën).

3.3.2.2. Çasti i ligjëritimit si pikë e orientimit temporal

Çastin e ligjëritimit si bazë për marrëdhëniet kohore e kanë pranuar shumë gjuhëtarë a studiues. Kështu kanë edhe vepruar autorët e gramatikave teorike të gjuhës shqipe si dhe autorë të tjerë librash a tekstesh të gramatikës për shkollat. I njëjti qëndrim është mbajtur edhe në mjaft gramatika të gjuhës ruse.⁷⁶

Lidhur me pranimin e çastit të ligjëritimit si element të analizës gramatikore në literaturën gjuhësore ruse ndeshesh edhe me pikëpamje të kundërta. Në monografinë e vet “Gjuha si sistem i kategorive të pasqyritimit”⁷⁷ gjuhëtari rus V.N. Migirin mëton për një “interpretim të ri” të disa problemeve tradicionale të gjuhësisë teorike, që lidhen, ndër të tjera, edhe me kategoritë foljore të kohës, aspektit, diatezës, vetës dhe numrit.

Sa i takon kategorisë së kohës ky autor shkruan se “ka shkaqe të heqim dorë nga formulimi tradicional (format kohore shprehin lidhjen e kohës së veprimit me çastin e ligjëritimit) dhe të propozojmë një përcaktim tjetër: “format kohore shprehin lidhjen e kohës së veprimit dhe aktit të ligjëritimit”. Në përputhje me këtë përcaktim autori bën edhe zëvendësimin e termave *kohë e shkuar*, *kohë e tashme*, *kohë e ardhme* me termat *veprim i shkuar*, *veprim i pranishëm*, *veprim i ardhshëm*, *veprim i përherëshëm*.

⁷⁵ Jakobson R., *Shifters, verbal categories and the Russian verb*, Harvard University, 1957.

⁷⁶ *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrar shqipe* (botim i Akademisë së Shkencave, 1976);

Gramatika e gjuhës shqipe I (botim i Akademisë së Shkencave, 2002); *Русская грамматика*, М. 1980, etj.

⁷⁷ Мигирин В.Н., *Язык как система категорий отображения*, М. 1972.

Megjithatë, kjo mënyrë konceptimi lë të paqartë se ç'vijueshmëri mund të ketë, fjala vjen, veprimi i përhershëm dhe akti i ligjërimit. Nga ana tjetër, duke zëvendësuar termat *kohë e shkuar*, *kohë e tashme*, *kohë e ardhme*, si “krejtësisht të papërshtatshme” me termat *veprim i shkuar*, *veprim i pranishëm*, *veprim i ardhshëm*, *veprim i përhershëm*, a duhet ruajtur edhe vetë termi “kategori e kohës”? E thënë më thjeshtë, cilat do të ishin ato karakteristika të veprimit foljor që do të përbënin thelbin e kohës si kategori gramatikore?

Çastit të ligjërimit i ka kushtuar disa faqe edhe I.G.Koshevaja në monografinë e saj “Strukturat tipologjike të gjuhës”.⁷⁸ Ajo mendon se pranimi i çastit të ligjërimit si bazë për marrëdhëniet kohore ka ardhur si rezultat i ngatërimit të kohës objektive me kohën gramatikore dhe pohon se “duke qenë dukuri psikologjike, çasti i ligjërimit nuk ka lidhje të drejtëpërdrejtë me specifikën e formës foljore” dhe më tej shkruan: “Çdo fjali në kohën e shkuar ose të ardhme gramatikisht nuk ka asnjë lidhje me çastin e ligjërimit”. Për të ilustruar këtë pikëpamje ajo sjell shembuj të tillë si “*Это было в 1917 году – Kjo ka ndodhur më 1917*”, “*Это произойдет в 2067 году - Kjo do të ndodhë në vitin 2067*” etj. dhe shtron pyetjet “... ku duhet ta kërkojmë këtu funksionin lokalizues të çastit të ligjërimit?”, “... ç’hyn në punë çasti i ligjërimit si orientues në linjën kohore?” etj.⁷⁹

Është e vërtetë që rrethanorët e kohës së tipit *në vitin 1917, në shekullin XV, të premtën*, etj., nuk kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me çastin e ligjërimit, por ato shërbejnë si lokalizues të një ngjarje të caktuar përmes këtij apo atij sistemi kalenderik (kronologjik). P.sh., kur themi “*Të premtën u mbyll fushata zgjedhore*” kemi parasysh jo çdo të premtë, por atë më të afërtën prej çastit kur informacionin e mësipërm e bëjmë objekt kumtimi. Lidhja me çastin e ligjërimit në këto fjali është e pranishme, por, në qoftë se s’është e drejtëpërdrejtë, ajo është e tërthortë ose implicite.

Në gjuhë ndeshen edhe fakte të tilla si: Toka *sillet* rreth diellit; Grafiti e *percjell* elektricitetin, kurse diamanti jo; Lumi Drin *derdhet* në Detin Adriatik etj., të cilat duken sikur nuk kanë lidhje me një kohë të caktuar. Në këto raste nëpër gramatika zakonisht flitet për vlerë gjithëkohore të së tashmes, por disa studiues këto fakte i sjellin si argument në të mirë të pikëpamjes së tyre se çasti i ligjërimit nuk mund të shërbejë si pikë referimi për marrëdhëniet kohore. Ashtu si edhe shumë studiues të tjerë, ne mendojmë se këto fakte gjuhësore nuk bëjnë përjashtim dhe as përmbysin situatën, për arsyen e thjeshtë se përdorimi i kohës së tashme në fjalitë e mësipërme do të ishte i pamundur, në qoftë se plani jashtëkohor nuk do përfshinte planin kohor të së tashmes.

Në literaturën gjuhësore për çastin e ligjërimit është shkruar shumë dhe ne nuk do të ndalemi posaçërisht në të. Ne i përmbahemi mendimit të njohur se shprehja në gjuhë e

⁷⁸ Кошневая И.Г., *Типологические структуры языка*, М. 1972.

⁷⁹ Кошневая И.Г., *по ату*, f. 149

lidhjes së veprimit me çastin e ligjërimin lind si domosdoshmëri e vetë procesit të komunikimit. Asnjë komunikim nuk do të ishte i mundur pa rolin aktiv të folësit. Çasti i ligjërimin nuk është as diçka subjektive dhe as rezultat i thellimit në analizën psikologjike të procesit të ligjërimin; ai ekziston objektivisht si për folësin, ashtu edhe për dëgjuesin, të cilit i drejtohet një kumtim i dhënë. Çastin e ligjërimin ne e shohim si fakt thjesht lingvistik, që shërben si orientues në përcaktimin e marrëdhënieve kohore të veprimit foljor.

Në lidhje me çastin e ligjërimin në gjuhën shqipe dhe në gjuhën ruse dallohen tri kohë: e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja. Në disa gramatika të shqipes këto kohë quhen *kohë themelore*.⁸⁰

Ne jemi kundër përdorimit të këtij termi, sepse s' mund të ketë kohë jothemelore. Nënndarjet e së shkuarës, p.sh., nuk mund të quhen kohë dytësore, sepse e shkuara nuk përfaqësohet nga ndonjë formë e veçantë dhe nënndarjet të jenë degëzime të saj. Të gjitha format kohore shprehin njëllaj marrëdhëniet kohore të parakohësisë, njëkohësisë ose paskohësisë.

Nëpër studime a gramatika të shqipes në paradigmen e formave kohore të mënyrës dëftore janë përfshirë tradicionalisht diku tetë, diku nëntë e diku dhjetë forma të tilla. Numri prej 8, 9 ose 10 formash ka lëvizur nga përfshirja ose mospërfshirja e ndonjë forme kohore me përdorim më të rrallë si e ardhme.⁸¹

***Po i paraqesim kohët e mënyrës dëftore në formën e një tablele
(vetëm për zgjedhimin vepror):***

	E TASHME	E SHKUAR		E ARDHME	
1.	<i>hap</i>	E pakryer:	<i>hapja</i>	E ardhme:	<i>do të hap</i>
2.		E kryer e thjeshtë:	<i>hapa</i>	E ardhme e përparme:	<i>do të kem hapur</i>
3.		E kryer:	<i>kam hapur</i>	E ardhme e së shkuarës:	<i>do të hapja</i>
4.		Më se e kryer:	<i>kisha hapur</i>	E ardhme e përparme e së shkuarës:	<i>do të kisha hapur</i>

⁸⁰ Demiraj Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, 1985, fq. 712

⁸¹ Për më shumë shih: Riza S., *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare*, 1994, fq. 205-209;

Demiraj Sh., *vepër e cituar*, 1985, fq. 715;

Gramatika e gjuhës shqipe 1, 2002, fq.306

Ilo Dilo Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, 2009, fq. 75.

Gjuha letrare shqipe për të gjithë, SHBLSH, 1976

**KATEGORIZIMI GJUHËSOR I IDESË SË KOHËS NË SISTEMIN FOLJOR TË GJUHËS SHQIPE,
KRAHASUAR ME GJUHËN RUSE**

5.		E kryer e tejkshkuar:	<i>pata hapur</i>		
----	--	-----------------------	-------------------	--	--

Ndarja e formave kohore të paraqitura në tabelën e mësipërme ka si pikë referimi çastin e ligjërimin ose një çast tjetër. Kështu, nga pesë nëndarjet e së shkuarës vetëm *e pakryera*, *e kryera e thjeshtë dhe e kryera* tregojnë veprime që kanë si pikë referimi çastin e ligjërimin, Dy kohët e tjera të së shkuarës, *më se e kryera dhe e kryera e tejkshkuar*, meqenëse veprimi i tyre nuk i referohet çastit të ligjërimin, por një çasti tjetër, përbëjnë kohët relative. Për nëndarjet e së ardhmes në gramatikën e shqipes nuk gjejmë ndonjë grupim të tyre në kohë absolute dhe relative, edhe pse jo të gjitha ato i referohen çastit të ligjërimin si pikë referimi absolute.

Në këtë punim ne do të konsiderojmë si forma të mirëfillta temporale vetëm ato forma, të cilat vendosin në boshtin kohor ngjarje të ndryshme në lidhje me çastin e ligjërimin, pra të ashtuquajturat kohë absolute. Format e *më se të kryerës*, *të kryerës së tejkshkuar*, *të ardhmes së të shkuarës* dhe *të ardhmes së përparme të së shkuarës*, veprimi i të cilave nuk ka si pikë referimi çastin e ligjërimin, ne do t'i përfshijmë në kategorinë semantike të taksisë. Sipas këtij këndvështrimi kategoria e kohës do të përbëhet vetëm nga e tashmja dhe format absolute të së shkuarës dhe të së ardhmes, pra prej atyre formave që tregojnë njëkohësi, parakohësi dhe paskohësi në lidhje me çastin e ligjërimin.

Po i paraqitim kohët e mënyrës dëftore me nëndarjet e tyre në formën e një table:

	E TASHME	E SHKUAR		E ARDHME	
1.	<i>hap, po hap</i>	E pakryer:	<i>hapja, po hapja</i>	E ardhme:	<i>do të hap</i>
2.		E kryer e thjeshtë:	<i>hapa</i>	E ardhme e përparme:	<i>do të kem hapur</i>
3.		E kryer:	<i>kam hapur</i>		

Krahasuar me ndarjen tradicionale të kohëve në mënyrën dëftore, tabela e mësipërme karakterizohet nga:

- a) pranimit i çastit të ligjërimin si orientues i vetëm absolut i lokalizimit kohor të veprimit foljor. Format e tjera foljore (*më se e kryera*, *e kryera e tejkshkuar*, *ardhmja e së shkuarës*, *e ardhmja e përparme e së shkuarës*), koha e të cilave përcaktohet në raport me kohën e një veprimi tjetër në të shkuarën a në të ardhmen

mbeten jashtë kësaj skeme. Ato përfshihen në kategorinë semantike të taksisë (shih kreun IV).

- b) Tek e tashmja dhe e pakryera janë përfshirë edhe format analitike me paravënien e pjesëzës *po*. Me anë të kësaj pjesëze bëhet dallimi semantik midis së tashmes/së pakryerës aktuale (*po hap/po hapja*) dhe së tashmes/së pakryerës joaktuale (*hap/hapja*). Përfshirjen e dy formave me pjesëzën *po* e gjejmë te prof. Sh. Demiraj në Gramatikën historike të gjuhës shqipe apo edhe në ndonjë punim tjetër para saj.⁸²

Në gjuhën ruse kategoria gramatikore e kohës është kategoria më e afërt me aspektin foljor. Madje ato bashkëveprojnë aq ngushtë, saqë elemente të përmbajtjes së tyre gjuhëtarët i kanë klasifikuar herë si kohore e herë si aspekte. Dhe kjo është e shpjgueshme, nëse mbajmë parasysh se kategorinë e kohës dhe kategorinë e aspektit para së gjithash i afron ideja e kohës, e cila është e pranishme si në kuptimet e njëres, ashtu edhe të tjetres kategori, por në secilin rast kjo ide konkretizohet në mënyra të ndryshme. Kuptimet kohore, ndryshe nga ato aspekte, kanë funksion deiktik, orientues, lokalizues. Ndërvarësia e kohës së foljes nga aspekti në gjuhën ruse shprehet si në numrin e trajtave kohore për secilin aspekt, ashtu edhe në kuptimet e tyre gramatikore.

Në shumë gramatika të gjuhës ruse gjejmë paraqitjen e mëposhtme të sistemit aspektoro-kohor të foljes në këtë gjuhë:

	ASPEKTI I KRYER	ASPEKTI I PAKRYER
E TASHME	---	<i>открываю</i>
E SHKUAR	<i>открыл</i>	<i>открывал</i>
E ARDHME	<i>открою</i>	<i>буду открывать</i>

Sikurse shihet nga kjo tabelë, me përjashtim të së tashmes, e cila del me një formë, dy kohët e tjera përfaqesohen nga dy të tilla, njëra e aspektit të kryer dhe tjetra e aspektit të pakryer. Një paraqitje e tillë e sistemit aspektoro-kohor të foljes në gjuhën ruse (vetëm për diatezën veprorë) jo gjithnjë u përgjigjet fakteve gjuhësore. Fjala është për formën e tipit “*открою*”, semantika e së cilës është barazuar me kuptimin e kohës së ardhme të thjeshtë.

⁸² Demiraj Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, 1985, fq.718; Demiraj Sh., *Reth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, SF, 3, 1977, fq. 124.

S'ka dyshim se në mjaft përdorime kjo formë ka kuptimin e së ardhmes, por do të ishte pa vend të pohohej se ky është kuptimi i vetë formës. Si formë e aspektit të kryer, ajo asnjëherë s'mund të shprehë përfundimin e veprimit në të tashmen, ai pritet të ndodhë në të ardhmen, por nuk përjashtohet mundësia që një veprim i shprehur nga forma e aspektit të kryer (tipi *открою*) të jetë në zhvillim e sipër në çastin e ligjërimit; p.sh., Он сейчас оденется (Ai tani do të vishet/Ai tani mbaron së veshuri).

Disa studiues (A.V. Isaçenko, A.V. Bondarko)⁸³ kanë vënë në dukje se edhe për nga origjina e tyre, format e tipit *войдѣт, выйде́т, сядет* etj, janë forma të së tashmes. Prandaj në fjalitë Он то *войдѣт*, то *выйде́т*; То *покурю* месяц, два, то *опять брошу*, format e aspektit të kryer *войдѣт, выйде́т, покурю, брошу* nuk kanë kuptimin e kohës së ardhme, por atë të së tashmes perfekteve. Nga ky këndvështrim mendojmë se kanë të drejtë ata autorë që format e tipit *открою* i përfshijnë te koha e tashme dhe në vend të termit “e ardhme e thjeshtë” përdorin termin “e tashme e aspektit të kryer”, ose “ e tashme perfekte”.

Kategorinë e kohës në gjuhën ruse e kanë vetëm format e mënyrës dëftore, të cilat përbëjnë edhe bazën e kësaj kategorie.⁸⁴ Koha e veprimit foljor përcaktohet në lidhje me këtë ose atë pikë referimi, e cila mund të jetë çasti i ligjërimit, ose një çast tjetër që përkon me kohën e kryerjes së një veprimi tjetër. Në gramatikën e sipërpërmendur vihet në dukje se te kategoria morfologjike e kohës këto dallime nuk janë të shprehura. Kuptimet kategoriale të formave kohore në këtë gjuhë orientohen në një pikë të vetme referimi, e cila është një nocion gramatikor abstrakt që pasqyron në formë të përgjithësuar çastin e ligjërimit dhe çdo çast tjetër në lidhje me të cilin përcaktohet koha e veprimit në ligjërimit.

Gjuhës ruse i mungojnë format e posaçme për shprehjen e kuptimeve të taksisës. Të njëjtat forma të shkuarës përdoren edhe për shprehjen e kohës relative. Gjatë përdorimit relativ të formave të kohës së shkuar, sistemit kohor të thjeshtuar të rusishtes i duhen mjete plotësuese për shprehjen e kuptimit të parakoësisë në raport me kohën e një veprimi tjetër brenda të të njëjtit plan kohor (për më shumë shih kreun IV).

3.4. Interpretimi i potencialit semantik të formave kohore të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe

3.4.1. Koha e tashme

⁸³ Исаченко А.В., *Грамматической строй русского языка в сопоставлении с словацким*, Морфология, М. 2003, 466-467, Бондарко А.В., *Вид и время русского глагола*, М. 1971, 102;

⁸⁴ *Русская грамматика*, М. 1980, fq. 626

Hapësira semantike e kohës së tashme, ndryshe nga kohët e tjera të mënyrës dëftore, paraqitet pa kufij të qartë. Spektri semantik i së tashmes nuk mbetet brenda çastit të ligjërit, në disa përdorime ai shtrihet edhe në të shkuarën, edhe në të ardhmen. Kjo veçori e strukturës semantike të së tashmes lidhet kryesisht me paqartësinë e kufijve midis varianteve të ndryshme kuptimore të përfuara gjatë përdorimit dhe funksionimit të kësaj forme kohore. Nga ana tjetër, veçimi i semantikës temporale nga semantika të tjera, të afërta me të, paraqet vështirësi jo të vogla për interpretimin e formave kohore të së tashmes.

Fillimisht po ndalemi në analizën e potencialit semantik dhe veçoritë funksionale të formave kohore të së tashmes për të mbërritur në problematikën e interpretimit dhe kategorizimit gjuhësor të përmbajtjes semantike të kësaj forme kohore në gjuhën shqipe.

Në gjuhësi semantika e së tashmes përgjithësisht përkufizohet si bashkëronie (njëkohësi) e veprimit të shprehur nga folja me çastin e ligjërit. Një përkufizim të tillë e gjejmë edhe në gramatikat e shqipes. Kuptimi themelor i foljes në kohën e tashme të mënyrës dëftore është të tregojë kryerjen e një veprimi në një kohë që përfshin edhe çastin e ligjërit⁸⁵.

Por faktet gjuhësore dëshmojnë se veprimi i shprehur nga e tashmja i kapërcen caqet e çastit të ligjërit, përderisa fragmenti i situatës që ndodhet në fushëpamjen e folësit në këtë çast, si rregull, është pjesë e një situatë të tërë, ku fillimi dhe fundi i saj nuk rroken prej tij.

Situata e papërfunduar që përfshin edhe çastin e ligjërit mund të vështrohet jo vetëm si një ngjarje që zhvillohet përpara syve të folësit në këtë çast (Shiko, kush *po vjen.*), por edhe si një ngjarje që është përsëritur rregullisht në të shkuarën dhe e aftë për t'u përsëritur edhe në të ardhmen (Ai *sëmuret* sa herë që i duhet të qëndrojë në këtë qytet).

E tashmja e dëftores mund të shënojë edhe një situatë që zë vend jo aq shumë “tani” (edhe pse vërtetohet edhe “tani”), sesa “vazhdimisht”, madje “gjithmonë” (Midhjet *kultivohen* në Sarandë. Uji *ngrin* në temperaturën 0 gradë).

Çasti gjuhësor i ligjërit, siç dihet, është një nocion me kufij të rrëshqitshëm, i aftë për t'i zgjeruar ata si në të shkuarën, ashtu dhe të ardhmen. Prandaj, te forma e së tashmes gjejmë të aktualizuar edhe komponentë të semantikës gramatikore të kohës së shkuar dhe të kohës së ardhme. P.sh.:

Kur u ngjita lart në kodër, *hedh* sytë e *shoh* një shtëpi tërësisht të rrënuar.
Treni *mbërrin* pas dy orësh.

⁸⁵ *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë: Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, 2002, 30

Kjo kundërthënie e thelbit të kohës së tashme është pasqyruar edhe në disa nga përkufizimet gramatikore të kësaj grameme.

R. Jakobson e vështron kohën e tashme si një kategori tipike pa tipar dallues (“e tashmja si e tillë është e papërcaktuar në raport me kohën”)⁸⁶. Kalimi i shpeshtë i së tashmes në planet kohore të së shkuarës dhe të së ardhmes, si dhe prania e treguesve leksikorë të së shkuarës ose të së ardhmes flet qartë për lidhjet e saj me këto plane kohore (Kam kohë që *po* ju *pres*, që nga mëngjesi. Sot farmacia *punon* deri në orën njëzet). Megjithatë, përdorimi i formave gramatikore të së tashmes në kontekste të së shkuarës ose të së ardhmes nuk i kundërvihet kuptimit gramatikor të këtyre formave, sepse edhe në këto përdorime ato ruajnë gjithnjë kuptimin e së tashmes. Veprimet e shkuara apo të ardhme aktualizohen, paraqiten si të tanishme.

Sipas J. Knjazevit, koha e tashme “nuk zë ndonjë vend të mëvetësishëm në boshtin kohor, sepse ajo përfaqëson në vetvete bashkimin e segmenteve të së shkuarës dhe së ardhmes, zgjatja e të cilëve varet nga veçoritë e situatës së dhënë”⁸⁷. Edhe në gramatikat e lashtësisë, vazhdon arsyetimin e tij ky autor, e tashmja vështrohej si bashkim i së shkuarës dhe së ardhmes pa asnjë shpëputje. Sipas Priscianit, fjalia Unë *po shkruaj* një vjershë (scribo verbum) është me vend “përderisa unë ende nuk e kam përfunduar atë, kam shkruar një pjesë të saj dhe më duhet të shkruaj akoma edhe një pjesë”.

Edhe në rrafshin filozofik segmenti kohor i së tashmes është shumë konvencional. Kufijtë e saj janë shumë të lëvizshëm. Si e tashme mund të perceptohet një segment kohor kur unë flas ose shkruaj, si psh.: *këtë çast*, *sot*, *këtë muaj*, *këtë vit*, *gjithë jetën*, madje gjithnjë, pa kufizim kohor (Toka *rrotullohet* rreth diellit). Ky segment mund të jetë edhe tepër i shkurtër. Edhe brenda sekondës apo fraksioneve të saj teorikisht mund të vendosen një numër i pakufizuar “copëzash” të së tashmes.

Pra, nga pikëpamja filozofike e tashmja është një kufi i lëvizshëm që ndan të ardhmen nga e shkuara. Por kjo në rrafshin filozofik. Në jetën e përditshme ekziston një e tashme në të cilën ne jetojmë, kuptohet, me kufij të ndryshueshëm, por gjithsesi kjo e tashme për ne është realitet. Me sa duket, perceptimi i kësaj së tashme lidhet me aftësinë e kujtesës sonë për të ruajtur një farë kohe një pjesë të informacionit, emocioneve, operacioneve mentale etj. Këto “fragmente” që i kanë kaluar së shkuarës ruhen për një farë kohe në vetëdijën tonë dhe perceptohen si pjesë të së tashmes. Mendojmë se një interpretim i tillë na

⁸⁶ Jakobson R., *Zür Struktur des russischen Verbuns*, Charisteria Gulielmo Mathesio, Prague 1932, fq. 78.

⁸⁷ *Po aty*.

⁸⁷ Knjazev J.P., *Nastojachee vrjemja: semantika i pragmatika. Llogicheskij analiz jazika. Jazik i vrjemja*. Moskva, 1977

ndihmon të kuptojmë shkaqet e transponimit të formave kohore nga njëri rrafsh kohor në tjetrin.

Edhe nga ky parashtrim i shkurtër mund të konstatohet me lehtësi se, nga pikëpamja e funksionimit të formave të së tashmes, bashkërendia e veprimit foljor me çastin e ligjëritit është një plan kohor difuz shumë i gjerë. Nga ana tjetër, aktualizimi i veprimit në çastin e ligjëritit është një segment a çast në lëvizje që ndan të shkuarën nga e ardhmja. Sikurse do të vëmë në dukje më poshtë, analiza e semantikës dhe funksionimit të formave të së tashmes dëshmon për kuptim kategorial të tyre tërësisht të përcaktuar, edhe pse në disa përdorime situata e shënuar nga format gramatikore të së tashmes jo gjithnjë përfytyrohet si e njëkohshme (bashkërendëse) me çastin e ligjëritit.

3.4.1.1. E tashmja sintetike

Siç dihet, e tashmja e mënyrës dëftore në sistemin foljor të shqipes përbëhet nga forma sintetike e tipit *vrapoj* (Ai *vrapon* shpejt) dhe nga dy forma analitike të tipave *po vrapoj* dhe *jam duke vrapuar* (Ai *po vrapon* drejt nesh; Ai *është duke vrapuar* drejt nesh). Në gegërishte ndeshet edhe varianti i tipit *është kah ban*:

A e din qeveria çka *asht kah ban* Zogu në çerdhe të korbit? (S. Drini, Bajram Curri);

Jemi kah mundohemi me i ba këto punë si thue ti (S. Drini, po aty).

Në gramatikat e gjuhës shqipe e tashmja sintetike (*vrapoj*) tradicionalisht është quajtur e tashme e pacaktuar (tregon veprime që nuk lidhen me një kohë të caktuar), ndërsa format analitike (*po vrapoj* dhe *jam duke vrapuar*), duke qenë se si rregull kanë të njëjtën vlerë, njihen të dyja si të tashme të caktuara (tregojnë veprime që lidhen me një kohë të caktuar)⁸⁸. Kuptimi *veprim i caktuar/veprim i pacaktuar* është vështruar si tipar dallues i kundërvënies *forma analitike/ forma sintetike*. Një kundërvënie të tillë e gjejmë edhe tek e pakryera e dëftores, por me ndryshimin e vetëm se veprimi i shprehur nga folja i takon planit kohor të së shkuarës.

E tashmja sintetike përdoret për ta paraqitur veprimin herë si të zakonshëm, herë si tipik e herë si të ngahershëm. Me anë të kësaj forme përcillen edhe fakte a të vërteta me vlerë të përgjithshme, të cilat kanë vend në të tashmen, por nuk lidhen me çastin e ligjëritit. P.sh.:

Çdo fundjavë *ngjitemi* në malin e Dajtit.

⁸⁸ Kristoforidhi K., *Grammatiki tis alvanikis glosis*, Konstandinopojë, 1882;
Demiraj Sh., *Grammatikë historike e gjuhës shqipe*, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1985, fq. 717, 740;

Moti i mirë *duket* që në mëngjes.
Fjalën e fundit e *thotë* të parën.
Malet *tunden*, por nuk *bien*.

Duhet vënë në dukje se çasti i ligjëritimit edhe në këta shembuj kuptohet që është i përfshirë, përndryshe përdorimi i tyre do të ishte i pamundur.

Krahas përdorimeve të mësipërme, e tashmja sintetike përdoret edhe për të shprehur veprime që përsëriten rregullisht ose veprime që vijnë njëri pas tjetrit në të tashmen. P.sh.:

Rojat *ndërrohen* çdo katër orë.
Futet brenda në kullë, *mbyll* derën me shul... *Vrapon* mbi kryet e të vëllait e *zhgrehet* në vaj. I *puth* ballin, i *puth* sytë e ia *lan* fytyrën me lotë të nxehtë.
(Gj. Fishta, Lahuta e Malsisë - ritreguar për fëmijë nga O. Grillo).

Duke pasur të përbashkët me format analitike vetëm semën e bashkërënies së veprimit me çastin e ligjëritimit, forma sintetike dallohet prej tyre për nga mënyra e paraqitjes së veçorive të zhvillimit (rrjedhjes) së veprimit. Ajo e paraqet veprimin kryesisht si joaktual, të përgjithësuar dhe të palokalizuar në kohë.

Jemi të mendimit se karakteri abstrakt (jokonkret, joaktual) i një veprimi të palokalizuar në segmentin kohor përbën tiparin themelor të formës sintetike të së tashmes, të cilën ne priremi ta quajmë *të tashme joaktuale*.

Potencialin semantik të së tashmes sintetike mund ta vështrojmë në dy rrafshë: paradigmantik dhe sintagmatik.

Rrafshi paradigmantik do të përfshinte, krahas kuptimit të bashkërënies së veprimit me çastin e ligjëritimit, edhe kuptimin abstrakt të së tashmes sintetike. Në këtë kuptim ajo përdoret në kontekste që përmbajnë përshkrime a gjykime të tipit:

Nga alltari vinte një zë i ëmbël që këndonte të kënduarat e vdekjes: Cili gëzim i jetës *mbetet* i pa përzjerë me hidhërim? Cila lavdi *qëndron* mbi dhe e paçvendosur?
(M. Kuteli, E madhe është gjëma e mëkatit).

Me një kuptim të tillë të tashmen sintetike e gjejmë edhe në kontekste ku veprimet përsëriten rregullisht, ndodhin shpesh, zakonisht, gjithnjë, ndonjëherë, më të rrallë etj.⁸⁹
P.sh.:

⁸⁹ Demiraj Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1985, f. 717.; *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002. f. 307

Zakonisht mëngjeseve të lirisë *lahen* llogaritë e vjetra, meritë, smira e zezë
(I. Kadare, Mosmarrëveshja).

Fëmijët *shkojnë* në shkollë çdo mëngjes.
Kjo vajzë gjithmonë *reciton* bukur.
Mbesa *kthehet* në vendlindje çdo vit.

Forma sintetike me kuptimin e së tashmes joaktuale përdoret në tekste të letërsisë artistike ku fiksohen tablo të mjedisit rrethues, në letërsinë shkencore, publicistike, në proverba, fjalë të urta, aforizma, pra në ato tekste ku vetitë e disa dikurive duhet t'i paraqitim si të përgjithësuara a me vlerë mbarëkohore.⁹⁰

P.sh.:

Vendi *është* i bukur, sepse toka *bleron* në të katër stinët e motit... sepse flokja e
dëborës
nuk *zbret* përveç se rrallë - një herë në shtatë vjet. Dhe as ahëre kur *zbret*, dëborë
nuk
shtrohet përdhe mbasi *tretet* në erë. Qiparisa të gjelbër *tregojnë* majë kodrave
vendet ku
më parë ngriheshin faltoret e perëndive të shumta...
(M. Kuteli, E madhe është gjëma e mëkatit).

Për disa popuj, kryesisht popujt e mëdhenj, ekzistenca nuk *kushtëzohet* prej lirisë.
(I. Kadare, Mosmarrëveshja)
Vdesin njerëzit, por s'*vdesin* orvatjet dhe besimet e tyre (R. Qosja);
Atje ku *fillon* pasuria, *fillon* kopracia (Balzak);
Njerëzit pa shkak nuk *vdesin*;
Dardha nën dardhë *bie*;
Ujku qimen e *ndërron*, por zakonin s'e *harron*.

Sikurse shihet nga shembujt e sjellë, formave të së tashmes sintetike u mungon lidhja
aktuale me qendrën deiktike (pikën e referimit) të folësit (tregimtarit).

Në rrafshin sintagmatik forma sintetike e së tashmes, përveç kuptimit të përputhjes së
veprimit me çastin e ligjërimin, del edhe me kuptimin e një veprimi aktual konkret. Në këtë
përdorim treguesi i kohës së tashme kombinohet në kontekst me mjete leksikore
specifikuese që e lidhin veprimin me një çast konkret të ligjërimin. Në këtë rast veprimi
paraqitet si aktual, i lokalizuar në kohë. Si mjete specifikuuese mund të shërbejnë vetë
konteksti a situata ose paraqitja e situatës si akt ligjërimor i drejtpërdrejt. P.sh.:

⁹⁰ Riza S., *Sistemi foljor i letrarshes shqiptare bashkëkohore*, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë
dhe Letërsisë, Tiranë 1994, f. 116.

Pika, pika! As gjyshit s'i ke ngjarë, as tët ati s'i ke ngjarë. Ja si më *thërret* gjaku. Ja si më *gjëmojnë* veshët. Edhe hiri i tyre më *thërret*...Rri ti! (D.Agolli, Njeriu me top).

- Të qara nuk dëgjoheh, – *flet* ajo me vete.

Në prova vajza u paraqit shumë mirë, por tani në skenë nuk *dridhet* nga emocionet.

Në këtë rrafsh e tashmja sintetike karakterizohet nga një spektër i gjerë semantik. Atë e gjejmë të përdorur në tekstet e letërsisë artistike në funksionin e së tashmes aktuale përshkruese. Në tekste të tilla forma sintetike e së tashmes rrit shprehësinë e ligjëritimit. P.sh.:

Ka dy net që në gryka malesh u dukën zjarret e fshatrave që *digjen* [*po digjen*]
(I. Kadare, Kështjella).

Ma rrëmbyen djalin nga duart, e shtynë dhe e nxorën jashtë... U turra jashtë. – Ku ma *shpini* [*po ma shpini*] djalin, ku? (F. Gjata, Zemër shqiptare).

Për formën e së tashmes sintetike, kur ajo funksionon si e tashme aktuale, nuk janë të rralla edhe rastet e përdorimit të saj në vend të kohës së shkuar ose kohës së ardhme. Përdorimi i së tashmes sintetike në kontekste të së shkuarës bazohet në raportin midis planit kohor të ligjëritimit të autorit a të lexuesit dhe planit kohor të ngjarjeve. Në këto përdorime e tashmja sintetike, ose siç quhet ndryshe e tashmja historike (praesens historicum), e sjell veprimin më të gjallë sesa vetë forma e së shkuarës.⁹¹ P.sh.:

Pasi dola nga zyra po ecja rrugës duke sjellë nëpër mend atë zyrtar të ulur mbi një tavolinë të vjetër që vetëm shkruante e shkruante. Papritur më *thërret* dikush në emër. *Kthej* kokën dhe *shoh* një mikun tim të vjetër...

Ky përdorim i së tashmes sintetike mund të interpretohet edhe si tërheqje e folësit në të shkuarën, por gjithsesi në këto raste kemi të bëjmë me dy anë të së njëjtës dukuri, aktualizimin e së shkuarës. Vjen e shkuara në të tashmen a tërhiqet folësi në të shkuarën, nga pikëpamja gramatikore e rëndësishme është që konteksti tregon të shkuarën, ndërsa forma gramatikore, të tashmen. Vetë forma gramatikore e së tashmes në këtë rast shërben si mjet i aktualizimit të së shkuarës. Kuptimi gramatikor i kësaj forme në përdorimin e mësipërm ruhet, por si rezultat i kontrastit me kontekstin kuptimi gramatikor i së tashmes paraqitet në variantin figurativ: veprimi përfytyrohet sikur po ndodh në të tashmen, por në të vërtetë ai i përket së shkuarës.

⁹¹ *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002. fq. 308

Në kuptimin e së ardhmes e tashmja sintetike gjen përdorim në rastet kur folësi e quan të nevojshëm të aktualizojë një veprim të pritshëm. Veprimi i përket së ardhmes, por synimi për t'u realizuar jepet në të tashmen. P.sh.:

- Ne... duhet të jemi të përgatitur. – Këto ditë *vijnë* gjermanët (D.Agolli, Njeriu me top).

Veprimi i pritshëm mund t'i përkasë një të ardhme të afërt, por edhe një të ardhme më të largët: P.sh.:

Nesër *nisem* për specializim jashtë shtetit.

Verën tjetër *hyjmë* në shtëpinë e re.

Është me rëndësi të vëmë në dukje se përdorimi figurativ i së tashmes sintetike në kontekste të së shkuarës ose të së ardhmes mundësohet jo nga aftësia e kësaj forme për të përfshirë një hapësirë kohore maksimalisht të gjerë para dhe pas saj, por sepse forma sintetike është e aftë të shërbejë si mjet i aktualizimit të veprimeve të së shkuarës ose të së ardhmes në planin kohor të së tashmes.

3.4.1.2. E tashmja analitike

Forma analitike e tipit *po vrapoj* është ndërtuar nga e tashmja sintetike me paravendosje të pjesëzës *po*, ndërsa forma perifrastike e tipit *jam duke vrapuar* përbëhet nga folja ndihmëse *jam* (*je, është, jemi, jeni, janë*) në kohën e tashme + përcjellorja e foljes së dhënë. Semantika e formës perifrastike është rezultat i bashkimit të semave të dy komponenteve: sfondi i kohës së tashme shprehet nga folja ndihmëse, ndërsa kuptimi i vazhdimit të veprimit jepet nga përcjellorja e foljes kuptimplotë. Të dyja format analitike, si rregull, kanë të njëjtën vlerë dhe mund të zëvendësojnë njëra tjetrën. P.sh.:

- Ç'bën këtu vetëm? – *Jam duke u vërtitur* kot nëpër dhomë, ngaqë *s'po më vjen gjumë*.

Jo nga të gjitha foljet mund të ndërtohet forma analitike me pjesëzën *po*. Forma analitike u mungon një numri të vogël foljesh që karakterizojnë subjektin për një kohë të pacaktuar, si: *jam, kam, di, dua gjendem, nxë* etj. Përdorimet me pjesëzën *po* të këtyre foljve (*Si po je?; A po e di ku jam tue shkue; Edhe sëmurë po jam, edhe para s'po kam*) nuk janë karakteristike për shqipen standarde. Ato ndeshen në dialekte, kryesisht në gegërishte.

Format analitike të së tashmes në gjuhën shqipe janë të specializuara për të shprehur situata që kryhen në çastin e ligjëritimit. P.sh.:

- Ku e ke Etleven ti? - ... është duke parkuar makinën (N. Tozaj, Përmbysja).
A i sheh ata të tjerët dhe ai njihet? Ai që *po flet*... është Abdyl Frashëri...
(Gj. Fishta, vepër e cituar).

Foljet e mësipërme (*është duke parkuar, po flet*) shprehin veprime konkrete të lokalizuara në segmentin kohor. Pjesëza *po* shërben për të aktualizuar veprimin në çastin e ligjëritimit. Format analitike në do t'i quajmë të *tashme aktuale*.

Veprimi konkret zhvillohet në çastin e ligjëritimit, edhe pse ai faktikisht mund të ketë filluar para këtij çasti dhe mund të vazhdojë edhe në të ardhmen, por kjo mbetet krejtësisht jashtë vëmendjes së folësit. Vëmendja përqëndrohet pikërisht se ç'ndodh në këtë çast. P.sh.:

Po gëdhin më në fund.

Rakip Lami s'u përmbajt më. Lëshoi çibukun në shesh dhe zuri tëmthat me duar. -
Po më godit rëndë, more djalë! (Sh. Musaraj, Belxhiku që këndon vence).

E tashmja e çastit të ligjëritimit është e pranishme në kontekste a situata që përmbajnë pyetje dhe përgjigje për to, nëse po kryhet ky ose ai veprim. P.sh.:

Ç'po bën? - Po pi kafe.

Ç'është? - pyeti Vaideja, - pse gjithë kjo qetësi? - Po bëhet mbledhje, - iu përgjigj minatori (Dh. Xhuvani, Tuneli).

Prania e formave të mënyrës urdhërore në të tashmen nga folje të përceptimit pamor ose dëgjimor përgatit a kushtëzon në një farë shkalle situatën e një veprimi konkret që zhvillohet para folësit dhe dëgjuesit:

Gonxhet po shpërthejnë, shih, po çelin

Mijëra lule, mijëra dashuri! (J. Bllaci, Zërat e natës);

.....

Dëgjo ç'thonë gjetet më të rënë,

Këtë natë vjeshte me stuhi:

"Lamtumirë, e shtrenjta dega mëmë!

Tokë e ftohtë po na merr në gji!.. (J. Bllaci, po aty).

Shprehja e një veprimi konkret mund të mos kërkojë mjete të veçanta, mjafton për këtë edhe një kontekst minimal. P.sh.:

Papritur Miti heshti, zgjati veshin nga dritarja dhe tha:

- *Po na sjellin darkën* (Sh. Musaraj, Belxhiku që këndon vence).

Variant i së tashmes aktuale është edhe e tashmja e reportazhit a tregimit për një ngjarje që zhvillohet para syve të folësit (tregimtarit):

Banorët e ndërtesës *po evakuohen* me shpejtësi. Vatrës së zjarrit *po i afrohen* edhe dy makina të tjera zjarrfikëse dhe një autoambulancë.

Ndonjëherë e tashmja aktuale zë një pozicion të ndërmjetëm midis së tashmes së një veprimi konkret në çastin e ligjëritit dhe së tashmes së një veprimi që kryhet ngaherë. P.sh.:

Si shumë kafe *po pi* kohët e fundit [Si shumë kafe *pi* kohët e fundit].

Ka shumë kohë që prindërit *po e përjetojnë* largimin e fëmijëve [Ka shumë kohë që prindërit *e përjetojnë* largimin e fëmijëve].

Në këta shembuj veprimi kryhet në çastin e ligjëritit, por jo vetëm në këtë çast. Përfshirja e një segmenti kohor të së shkuarës mbështetet edhe nga tregues leksikorë temporalë, si *kohët e fundit, muajin tjetër, prej kohësh* etj. Ka raste kur treguesit leksikorë nuk janë të domosdoshëm. P.sh:

Në këtë klinikë *po specializohem* edhe unë.

Në disa përdorime me anë të së tashmes aktuale jepen situata që do të kryhen ose mund të kryhen pas çastit të ligjëritit: Në këto raste folësi, duke përdorur të tashmen, shpreh sigurinë se veprimet do të kryhen në të ardhmen e afërt. P.sh.:

Atëherë *po shkoj* të interesohem ca për ngjarjen, - tha Skënder Mani dhe u largua (N. Tozaj, Përmbysja).

Një gjahtar kishte dalë për gjah, kur sheh një lepur që *po flinte*. Fërkoji duart nga gëzimi e filloi të mendonte: Unë *po e vras* këtë lepur, mishin *po ia ha* për darkë, lëkurën *po e shes* tre grosh. Me ata tre grosh *po blej* një pulë... (Përrallë).

Nëse do t'i bënim një përmbledhje të shkurtër parashtrimit të mësipërm, tabloja semantike e formave të së tashmes do të paraqitej si më poshtë:

Format e së tashmes së dëftores mbartin kuptimin kategorial të njëkohësisë së veprimit me pikën e referimit (çastin e ligjëritit).

Variante semantike më të rëndësishme të formave të së tashmes janë e tashmja aktuale (format analitike) dhe e tashmja joaktuale (forma sintetike). Dallimin midis varianteve të së tashmes (*vrapij/po vrapij, jam duke vrapuar*) ne e shohim në kundërvënien kuptimore *veprim aktual/veprim joaktual*. Një interpretim i tillë përlligj plotësisht konstatimin e gjuhëtarëve se kundërvëniet tek format e mënyrës dëftore shërbejnë për të treguar jo vetëm

kohën e kryerjes së një veprimi, por dhe mënyrën e paraqitjes së zhvillimit të veprimit si dhe aktualizimin e tij.⁹²

Potenciali semantik i formës sintetike të së tashmes në rrafshin paradigmatic përbëhet nga sema e bashkërënies së veprimit (situatës) me çastin e ligjërimit dhe sema e veprimit abstrakt (të përgjithësuar), ndërsa në rrafshin sintagmatik kemi bashkëronie të situatës me një çast jokonkret (të përgjithësuar) të ligjërimit.

Potenciali semantik i formave analitike, krahas bashkërënies së veprimit me çastin e ligjërimit, ngërthen tiparet e një veprimi aktual, të lokalizuar në kohë, që realizohet në çastin e ligjërimit, por në disa përdorime mund të mos kufizohet vetëm brenda caqeve të tij. Një kuptim i tillë tek e tashmja analitike është kombinim i tipareve semantike “veprim konkret”, “veprim i lokalizuar në kohë” me tiparin “veprim aktual në çastin e ligjërimit”, pra që zhvillohet në periudhën e ligjërimit të folësit, pavarësisht sa zgjat ajo.

Tek e tashmja sintetike kemi kombinimin e tipareve “veprim abstrakt (jokonkret)”, “veprim i palokalizuar në kohë” me tiparin “veprim joaktual në çastin e ligjërimit”. Tiparet e mësipërme, si elemente të përmbajtjes së formave kohore të së tashmes, vërtetohen jo vetëm në sferën e gjuhës si fakte të organizimit të saj strukturor, por edhe në kontekst, ku të gjithë elementet përbërëse kryqëzohen dhe bashkëveprojnë me komponentë të kategorive të tjera semantike. Pikërisht kjo ndërthurje e tipareve semantike të mësipërme e bën relativisht të ndërlikuar interpretimin dhe kategorizimin gjuhësor të tyre.

3.4.1.3. Interpretimi i idesë së kohës te format e së tashmes

Për të tashmen e shqipes (por edhe për kohët e tjera të dëftores) janë bërë përpjekje për veçuar kuptimin kohor nga kuptimet e tjera, të përafërta me të, që i përkasin rrafsheve të ndryshme semantike. Disa studiues a autorë gramatikash i kanë klasifikuar ato si kuptime a nuanca aspektore (perfektive ose imperfektive), por në shumicën e rasteve pa shpjeguar se ç’është kuptuar me aspekt foljor në këtë gjuhë. Kështu, për prof. Sh. Demiraj e tashmja (prkt., e pakryera) e mënyrës dëftore në gjuhën shqipe karakterizohet nga aspekti i pakryer a imperfektiv⁹³. Ky pohim mbështet në faktin se si e tashmja, ashtu dhe e pakryera, e paraqitin veprimin në zhvillim e sipër.

Në monografinë “Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore” të gjuhëtarit S. Riza gjejmë përcaktimin: “...për nga specifika e saj koha e tashme (pavarësisht nga shkurtësia eventuale e fenomenit përkatës) është në çdo gjuhë (jo e aspektit kryemjor a

⁹² Agalliu F., «Vëzhgime mbi kuptimet e disa trajtave kohore». *Studime filologjike* 2 (1968), fq. 135.

⁹³ Demiraj Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1985, fq. 716.

*perfektiv), por e aspektit pakryemjor a imperfektiv, e n'anë tjetër fakti se aspekti imperfektiv dhe ai durativ (a vazhdimor) zakonisht mezi dallohen njëri nga tjetri...;*⁹⁴

Siç shihet, nocioni “aspekt” nga dy autorët e mësipërm, por edhe nga të tjerë, është kuptuar gjerë. Me aspekt imperfektiv (të pakryer) për të tashmen janë kuptuar tipare të ndryshme që karakterizojnë mënyrën e rrjedhjes a shpërndarjes së veprimit foljor në kohë si: veprim në proces (që zhvillohet mu në çastin e ligjërit), veprim që zgjat, veprim që përsëritet etj. Këto karakteristika duhen klasifikuar si kuptime aspektuale që u përkasin mënyrave të veprimit foljor (aktionsart), por jo si kuptime të mirëfillta aspektore. Asnjë nga semantikët e mësipërme nuk është gramatikalizuar në gjuhën shqipe.

Një këndvështrim të ri, të përkundërt me dy autorët e sipërcituar, e gjejmë tek A. Dhrimo⁹⁵. Dallimin kuptimor dhe formal të formave të tipit *vrapoj/po vrapoj*, edhe pse simbolikisht larg aspektit klasik, ky autor priret ta vështrojë atë si kundërvënje gramatikore *aspekt perfektiv/aspekt imperfektiv*. Formën sintetike të së tashmes (*vrapoj*) ai e quan të tashme të pacaktuar imperfektive, ndërsa dy format analitike (*po vrapoj, jam duke vrapuar*) - të tashme të caktuara perfektive⁹⁶.

Pohimi i prof. Dhrimos se format analitike kanë aspekt perfektiv, sepse e paraqitin veprimin jo në proces, por si tërësor, të përmbledhur, bëhet për herë të parë në gjuhësinë shqiptare. Me gjithë ndihmesën e pamohueshme të autorit në sqarimin e mjaft koncepteve aspektologjike të mishëruara në materialin e shqipes, një interpretim i tillë nuk duket bindës:

Së pari, do të ishte e vështirë, a më saktë, e pamundur që veprimi konkret, aktual në çastin e ligjërit, i shprehur me anë të formave analitike të së tashmes (ose të së pakryerës) të konceptohej si i përmbledhur, si i tërë, pra i aspektit perfektiv. Një veprim konkret që unë e shikoj (dëgjoj, ndiej) nuk mund të jetë i i përmbledhur, i mbyllur, ku të gjitha fazat (fillimi, vazhdimi dhe përfundimi) të jenë shkrirë në një të tërë. P.sh., në fjalinë *Shiko, fëmija po i zbrit vetë shkallët* kemi të bëjmë me një veprim në dinamikën e tij, me një proces që shpaloset gjatë çastit (aktit) të ligjërit, ku vetë subjekti ndodhet në mes të tij. Prandaj kjo formë e tashmes aktuale në gjuhën shqipe s'mund të jetë e aspektit perfektiv. Madje edhe në gjuhët sllave, të pajisura me kategorinë morfologjike të aspektit foljor, një semantikë e tillë është e huaj për format e aspektit perfektiv. Në këto gjuhë ajo është karakteristike vetëm për format e aspektit imperfektiv.

⁹⁴ Riza S., *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë 1994, fq. 116.

⁹⁵ Dhrimo A., *Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*, Libri Universitar, Tiranë 1996.

⁹⁶ Dhrimo A., *po aty*, 61, 70.

Së dyti, paravendosja e pjesëzës *po* foljes kuptimplotë në të tashmen *vrapoj* në gjuhën shqipe nuk sjell ndryshime të karakterit aspektor. Me fjalë të tjera, kjo pjesëz nuk shërben si mjet gramatikor për perfektivimin e formës sintetike (formimin e aspektit të kryer prej saj), për rrjedhojë forma *po vrapoj* nuk mund t'i kundërvihet formës *vrapoj* në planin aspektor. Madje përdorimi i pjesëz *po* me format e kohës së tashme dhe të pakryer nuk ka të bëjë as me vazhdimësinë e veprimit. Sipas nesh varianti i së tashmes me pjesëzën *po* përdoret për të lokalizuar a fikësuar veprimin në një çast të zhvillimit të tij në të tashmen.

Së treti, prof. Dhrimo konstaton me të drejtë se forma e së tashmes analitike (e tashmja e caktuar perfekte sipas autorit) “është e lidhur pazgjydhmërisht me çastin e ligjërimit. Ai përbën fushën e vetme, ku zhvillohen të gjitha variantet kuptimore. Kjo fushë qëndron si një e tërë e plotë dhe e mbyllur përpara dëgjuesit a lexuesit”⁹⁷. Por konstatimi i cituar s’do të thotë aspak që edhe veprimi, i cili zhvillohet në këtë periudhë kohore, (sipas autorit “të mbyllur”), paraqitet si i tërë a i përmbledhur. Çasti i ligjërimit është element deiktik që shërben për të dalluar veprimet që kryhen në këtë çast nga ato që kryhen para tij dhe pas tij. As më shumë e as më pak këtu kemi të bëjmë vetëm me fiksimin e veprimit në boshtin kohor, pra mbetemi brenda semantikës temporale, ku koha paraqitet si veti e jashtme e veprimit foljor me karakteristikë të qartë deiktike. E thënë ndryshe, çasti i ligjërimit si pikë orientuese, shërben vetëm për krijimin e përfytyrimit gjuhësor për marrëdhëniet kohore.

3.4.2. Koha e shkuar

Koha e shkuar tregon se veprimi foljor i paraprin çastit të ligjërimit, situata e shprehur nga folja ka ndodhur para këtij çasti.

Për shprehjen e një fakti (ngjarje, shtate), që ndodh para çastit të ligjërimit, folësi i gjuhës shqipe vihet përpara zgjedhjes së njëres prej tri formave absolute. Ai detyrohet të zgjedhë ose formën e së pakryerës, ose formën e së kryerës së thjeshtë, ose formën formën e së kryerës. P.sh.:

Atë ditë të shënuar... djemuria *mblidhej* rreth pusit të Kavalonës (J.Xoxa, Lulet e kripës).

Ai *vështronte* gjithë kohën nga korrodori... (N. Tozaj, Pas përmbysjes).

Sa herë e *shihte*, Halilit i *shkonte* ndërmend martesë (A. Gjakova, Dritëhijet e një qyteti).

Ai *vështronte* gjithë kohën nga korrodori... (N. Tozaj, Pas përmbysjes).

⁹⁷ Dhrimo A., *po aty*, fq. 79-80, 88.

Të nesërmen *erdhi* njoftimi zyrtar se Korça i *mbetej* Shqipërisë, por fati i Gjirokastrës *dihej* akoma (S. Godo, Plaku i Butkës).

Ashtu ai *mbeti* për gati një orë (N. Tozaj, po aty).

Unë shtëpinë e *kam bërë* me djersën e ballit, - *u hodh* Nuriu (K.Blushi, Pajtoni i fundit).

Kam qenë në vende të mëdha, Lul, në vende të zhvillueme. *Kam pa* fabrika. Nuk *kam hy* brenda, se nuk jam inxhinier e *nuk më kanë interesue*, por *kam pa* se si nxjerrin tym, si hyjnë e dalin me mija veta (A. Gjakova, Dritëhijet e një qyteti).

Çdonjëra prej këtyre formave shpreh veprime që i përkasin zonës temporale të së shkuarës, i cili është kuptimi përbashkues i tyre. Por krahas semantikës temporale, secila formë e kohëve absolute karakterizohet edhe nga disa tipare të tjera semantike, të cilat nuk kanë të bëjnë me kohën të jashtme (absolute). Në bashkëveprim me mjete të tjera leksiko-gramatikore e kontekstuale format e e së shkuarës japin informacion edhe për mënyrën se si është zhvilluar a shpërndarë veprimi në kohë. Në këtë rast kemi të bëjmë me të ashtuquajturën kohë të brendshme të kryerjes së një veprimi, e cila qëndron në rrafshin aktual.

Po analizojmë më me hollësi potencialin semantik të tri formave të së shkuarës: të së pakryerës, të së kryerës së thjeshtë dhe të së kryerës.

3.4.2.1. E pakryera

Përmbajtjen semantike të së pakryerës e përbën tipari i parakohësisë, i cili përcakton raportin e kësaj forme me pikën e referimit (çastin e ligjërimin). Ai është i vetmi tipar temporal i pastër dhe i qëndrueshëm i kësaj forme kohore. Tiparet e tjera, siç do të shtjellohet më poshtë, janë të ndryshueshme.

Duke ruajtur semantikën gramatikore të së shkuarës (veprime që kanë ndodhur para çastit të ligjërimin), format e së pakryerës tregojnë gjithashtu se veprimi i përket tërësisht së shkuarës. Në rrafshin kohor të së shkuarës veprimi (proces) është i veçuar nga çasti i ligjërimin dhe asnjë fragment i tij nuk shkrihet me këtë çast. Kuptimi kohor i së pakryerës (perspektiva kohore) mund të zbulohet edhe përmes treguesve leksikorë (rrethanorëve) të tipit *atëherë, në atë kohë* etj. P.sh.:

Atëherë dyqanet e pazarit *mbylleshin* në orën shtatë. (Migjeni, Vepra)

Atë javë *zbatohej* një vendim i përkohshëm i shtabit... (Z. Çela, Mali i tejdukshëm).

Shkëputja e procesit nga çasti i ligjërimin te format e së pakryerës duket qartë në fjali të tilla si “Më *pëlqente* shumë profesioni i mësuesit”.

Duke vendosur këtë fjali në rrafshin kohor të treguar nga ndajfolja “*atëherë*” (**Atëherë** më *pëlqente* shumë profesioni i mësuesit), folësi e lokalizon veprimin në të shkuarën, i cilin nuk ruan asnjë lidhje me të tashmen. Nëse po këtë fjali, do ta vendosnim në rrafshin kohor të treguar nga ndajfolja “*më parë*” (**Më parë** më *pëlqente* shumë profesioni i mësuesit), në mënyrë implicite folësi do të pohonte se profesioni i mësuesit tani nuk i pëlqen më. Në këta shembuj duket qartazi “*censura*” kohore midis veprimit (*pëlqente*) dhe çastit të ligjërimin.

E pakryera përdoret zakonisht për përshkrimin e situatave të përhershme a të vazhdueshme në të shkuarën, si dhe të veprimeve që zhvillohen njëkohësisht me veprime të tjera. P.sh.:

Lartësia e trupit të tij (kalit të Trojës –A.P.) *ishte* baraz me nivelet e kateve të katërta të ndërtesave. Nga të çarat, ata *vështronin* fytyrat e panumërta që *mbushnin* dritaret. Këto dritare *ishin* fare pranë tyre, vetëm disa metra larg, megjithatë fytyrat e njerëzve nuk *shquheshin* dhe aq qartë. Ato *kishin* një shprehje të ngrirë... Atykëtu, parapa ndonjë dritareje bosh, *dukej* dhoma. Në një nga dhomat konstruktori pa dy pleq, burrë e grua, që *po hanin* drekën dhe, me sa duket, as nuk *çanin* kokën të dinin ç’*bëhej* përjashta. (I.Kadare, Përbindëshi).

Ndërsa *thithte* tymin, nuk i *hiqte* sytë nga fletët e shpërndara mbi syprinën e tryezës. (I.Kadare, po aty).

Për nga struktura e pakryera e shqipes del me dy forma: me formën sintetike (*vrapoja*) dhe format analitike (*po vrapoja, isha duke vrapuar*). Ashtu si tek e tashmja, format analitike të së pakryerës shprehin një veprim konkret që dikur ishte aktual, por tashmë ka kaluar në të shkuarën. Në këtë kuptim e pakryera analitike është paralele me të tashmen aktuale tipit (*po vrapoj, jam duke vrapuar*). Ato e paraqitin veprimin në proces (në zhvillim e sipër) në rrafshin e së shkuarës P.sh.:

Po kërkoja shtëpinë e një së njohurës sime, por shoh se kam ngatërruar apartamentin.

(Z. Çela, Mali i tejdukshëm).

Nga ana tjetër, ai dërgoi njerëz të lajmërohej Sali Butka mbi sa *po ngjante* (S. Butka, Plaku i Butkës).

Zhurma e trenit që *po hynte* në stacion sa vinte e shtoej (K.Blushi, Pajtoni i fundit).

Ishim duke dalë nga shtëpia, kur ra zilja e telefonit.

Veprimi i paraqitur në zhvillim e sipër me të pakryerën mund të theksohet me mjete të ndryshme, ndër të tjera, me rrethanorët ndajfolorë *ngadalë, ngeshëm, qetë-qetë, shkallë-shkallë, tashmë, në këtë kohë* etj. P.sh.:

Një mbrëmje, për t'u shlodhur, kisha dalë e *po shëtisja* bregut **mengadalë**.
(J.Bllaci, Zërat e natës);

Ca nga ca atij *po* i *mbylleshin* sytë;

Po ecte ngeshëm pa u shqetësuar nga pikat e shiut që kishin nisur;

Tashmë ai *po përgatitej* për rrugë të gjatë.

Malsorja plakë u çue e *po* i *avitej ngadalë*. (Migjeni, Vepra).

Edhe ndërtimet e tipit *pashë (ndjeva, dëgjova, parandjeva, nuhata), kur (si, se)* përgatisin perceptimin e veprimit në proces e sipër. P.sh.:

E pashë, kur *po* e *fshihte* atë fotografi të hershme të saj;

E ndjeu se *po* i *afrohej* fundi:

E dëgjova si *po bërtiste* nga dhembjet e forta.

Për të shprehur një veprim në zhvillim e sipër format e së pakryerës ndonjëherë dalin edhe pa pjesëzën *po*, por konteksti, në njërin a tjetrën mënyrë, mundëson perceptimin e veprimit në zhvillim e sipër. P.sh.:

Ai kishte 30 minuta që më *priste* (që *po* më *priste*), kur mbërrita unë.

Kuptimi i veprimit “në zhvillim e sipër” në gramatikat e shqipes vështrohet si kuptimi themelor i i së pakryerës. Ja si e përkufizojnë autorët e Gramatikës së gjuhës shqipe të Akademisë së Skencave (2002) këtë formë të së shkuarës: “*Kuptimi themelor i së pakryerës është të tregojë një veprim në zhvillim e sipër në një çast të caktuar të së shkuarës*”.⁹⁸

Në të vërtetë kuptimi i veprimit “në zhvillim e sipër” është një ndër përdorimet e saj dhe realizohet në kontekste të caktuara. Madje ky kuptim nuk ka lidhje as me kohën e mirëfilltë të kësaj forme. I vetmi tipar semantik, i pandryshueshëm, me të cilin e pakryera futet në të gjitha kontekstet është tipari i parakohësisë. Prandaj do të ishte e udhës që në përkufizimin e së pakryerës të përfshihej tipari i parakohësisë. E pakryera, përpara se të jetë e pakryer, është kohë e shkuar (imperfektore). Ky është tipari themelor kohor që e dallon të pakryerën nga e tashmja dhe e ardhmja.

⁹⁸ Gramatika e gjuhës shqipe 1, 2002, fq. 308.

Nëpërmjet formës sintetike (*vrapoja*) e pakryera shpreh veprime që përsriten, veprime të zakonshme ose të ngahershme. Këto kuptime, ashtu si edhe veprimi konkret në zhvillim e sipër, janë variante të funksionimit të së pakryerës.

Te format e së pakryerës kuptimi i përsëritjes së veprimit ose i veprimit të zakonshëm karakterizohet nga tipari i moslokalizimit kohor. Veprimi kryhet brenda caqeve të së shkuarës, por ai nuk është i lokalizuar në ndonjë periudhë të caktuar kohe.

Ky përdorim i së pakryerës përngjason me kuptimin abstrakt të së tashmes, pavarësisht nga planet e ndryshme kohore, të cilave u përkasin. Si tek e tashmja, ashtu edhe tek e pakryera përsëritja e veprimit është e palokalizuar në kohë, por shkalla e abstraktimit të tyre është e ndryshme. Tek e tashmja kuptimi i veprimit të përsëritur a të zakonshëm është më i abstraktuar, më i përgjithësuar, prandaj atë e gjejmë në sentenca a proverba të ndryshme. Një shkallë e tillë abstraktimi e veprimit të përsëritur a të zakonshëm tek e pakryera kufizohet nga konturet e hapësirës semantike të së shkuarës. Brenda këtyre caqeve e pakryera e veprimit të përsëritur është e pranishme, por pa arritur atë shkallë përgjithësimi si e tashmja. P.sh.;

Kërkoje qumësht, milje dhinë dhe e pije; përmendje kalin, hipje mbi të dhe ia mbathje; përmendje fjalën ligësi dhe djalli vinte menjëherë pranë teje... . (Letërsi e përkthyer)

Për shprehjen e përsëritjes së veprimit marrin pjesë elemente të kontekstit, të cilat në bashkëveprim me formën foljore të së pakryerës realizojnë kuptimin në fjalë. Si mjete të tilla shërbejnë rrethanorët e tipit *çdo ditë, kohë pas kohe, herë pas here, nganjëherë (kanjiherë –formë dialektore)* etj. P.sh.:

Kuajt mblaçitëshin ngadalë dhe *turfallonin herë pas here* (Letërsi e përkthyer);

Çdo drekë ai *pinte* një gotë verë të kuqe;

Ai qeshte dhe fliste, por vetë ndërkaq i *hidhte* sytë **kohë pas kohe** me frikë e me dyshim nga Solomoni (Letërsi e përkthyer);

Kanjiherë i shoqi *vinte* dejshëm (Migjeni, Vepra).

Ndikimi i elementeve të kontekstit dhe prirja e vetë formës gramatikore të së pakryerës ndaj këtij ndikimi përbëjnë dy faktorë, që luajnë rol në paraqitjen e veprimit si të zakonshëm a të përsëritur.

Kuptimi i veprimit të përhershëm tek e pakryera përkon me të njëjtin kuptim të së tashmes, por duhet vënë në dukje se sfera kohore e së pakryerës është më e kufizuar. E pakryera mbetet brenda caqeve të saj, ndërsa e tashmja shtrihet edhe në plane të tjera kohore. Edhe lokalizimi i veprimit në kohë te forma sintetike e së pakryerës është më i përcaktuar. P.sh:

Vëllai i tij *punonte* si murator në një kompani ndërtimi.

Ai *nuk peshonte* më shumë se 50 kg.

Ajo i *mbante* flokët të prera shkurt.

Nga sa u tha, mund të arrijmë në përfundimin se e pakryera e shqipes karakterizohet nga tipari semantik temporal i parakohësisë (veprimi kryhet para çastit të ligjërit). Ky tipar mbetet i pandryshueshëm në të gjitha përdorimet e saj, pavarësisht nga konteksti që e rrethon atë. Gjatë funksionimit format e së pakryerës nën ndikimin e kontekstit fitojnë kuptime të tjera, të cilat modifikohen vartësisht nga elementet kontekstuale që marrin pjesë. Kështu, format e së shkuarës imperfekte mund të paraqitin veprimin e shkuar herë në zhvillim e sipër, herë si të përsëritur (a të përsëritshëm), herë si të zakonshëm a të përhershëm. Këto modifikime semantike, që i mbishtresohen formës kohore të së pakryerës, shprehin mënyrën e rrjedhës së veprimit në kohë dhe i përkasin sferës aspektuale, mënyrave të veprimit foljor.

Ashtu si te format e së tashmes, dallimi kuptimor, i shprehur edhe me mjet formal (*po vrapoja/vrapoja*), nuk ka të bëjë aspak me kundërvënien *aspekt perfektiv/aspekt imperfektiv* të këtyre dy formave, ashtu siç shkruan prof. A. Dhrimoja në monografinë e vet.⁹⁹

Vërejtjet e bëra rreth këtij problemi për të tashmen qëndrojnë edhe për të pakryerën, pavarësisht planeve të ndryshme kohore, të cilave këto forma u përkasin. Çështja “çalon” edhe nga pikëpamja terminologjike. Po të shqipëroheshin plotësisht të dy gjymtyrët e togfjalëshave të përdorur në monografinë e cituar “*e pakryer imperfektive*” dhe “*e pakryer perfektive*” me “*e pakryer e pakryer*” dhe “*e pakryer e kryer*”, do të përfitohej një lloj kakofonie e pakuptimtë. Përdorimi i termave të huazuar nga latinishtja (perfektiv/imperfektiv) nuk e përmbys situatën. Ata nuk mund ta përlligjin praninë e kundërvënies gramatikore të aspektit të format *po vrapoja/vrapoja*.

Format e së pakryerës, që mbartin kuptimin e veprimit si proces, i kundërvihen formave të së kryerës së thjeshtë, të cilat shprehin një veprim të shkuar si një fakt të kryer. Meqenëse situata e përshkruar është tërësisht e shprehur nga e tashmja, format e së pakryerës i kundërvihen edhe formave të së kryerës, të cilat në njërin ose tjetrën mënyrë ruajnë lidhjen me të tashmen.

Nga mjaft studiues të sistemit foljor të shqipes është konstatuar me të drejtë se e pakryera e shqipes është një e tashme e planit kohor të së shkuarës.¹⁰⁰ Dallimi midis tyre qëndron në

⁹⁹ Dhrimo A. (vepër e cituar fq. 89, 102).

¹⁰⁰ Agalliu F., *Vëzhdime mbi kuptimet e disa trajtave kohore*, SF, 2, 1968; Hysa E., *Rreth përdorimeve të së pakryerës së dëftores në gjuhën shqipe*, SF, 3, 1975

Demiraj Sh., *Reth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, SF, 3, 1977

tiparin semantik të secilës formë: parakohësia tek e pakryera dhe njëkohësia tek e tashmja. Ky tipar lidhet me çastin e ligjërit si e njëjta pikë referimi për të dy kohët. Kuptimi kategorial i parakohësisë për të pakryerën dhe i njëkohësisë për të tashmen (por edhe i paskohësisë tek e ardhmja e tipit *do të vrapoj*) përbën dominanten e përmbajtjes semantike të këtyre formave kohore, tiparin themelor dhe specifik të tyre. Dominanti i përmbajtjes semantike që është tipari semantik i përhershëm, i përket tërësisht rrafshit morfologjik. Krahas dominantit semantik, “përmbajtja semantike në tërësinë e saj përfshin jo vetëm rrafshin morfologjik, por edhe mundësitë potenciale kryesore të formës gramatikore në rrafshin semantik funksional, i cili përmbledh edhe funksione që realizohen nga forma me mbështetjen e elementeve të kontekstit.”¹⁰¹

Vlen të theksohet se paralelizmi midis së pakryerës dhe së tashmes nuk është i plotë. Ashtu siç u vu në dukje në parashtrimet e mësipërme, vendi që zë e tashmja midis së shkuarës dhe së ardhmes kushtëzon disa veçori të funksionimit të kësaj forme gramatikore, të cilat nuk hasen te forma e së pakryerës (“rrëshqitja” e së tashmes edhe në rrafshin kohor të së pakryerës).

Në gjuhën e sotme ruse, ashtu si edhe në shumicën e gjuhëve të tjera sllave, forma e së pakryerës (imperfektit të vjetër) nuk është ruajtur. Si barasvlerës funksional i imperfektit në këto gjuhë shërben e shkuara e aspektit të pakryer. Përfundim bën bullgarishtja dhe maqedonishtja, të cilat jo vetëm e kanë ruajtur imperfektin e gjuhës së vjetër sllave, por e përdorin atë në format e aspektit të pakryer dhe të aspektit të kryer, p.sh., në bullgarishte *Той се хилеше, щом го зърнеше отдалеч /Ai buzëqeshte, sapo e shihte atë së largu/ (се хилеше – imperfekt i aspektit të pakryer/ зърнеше – imperfekt i aspektit të kryer). Si barasvlerës për formën e aspektit të kryer në gjuhën ruse do të shërbente ndërtimi me foljen *бывало* + forma e aspektit të kryer të foljes. Përkthimi i mundshëm i fjalisë së mësipërme do të ishte *Он улыбался, как только бывало увидит его издали.**

3.4.2.2. E kryera e thjeshtë

E kryera e thjeshtë, ashtu si e pakryera, karakterizohet nga tipari semantik i parakohësisë në raport me pikën e referimit. Veprimi i shprehur prej saj ndodh para çastit të ligjërit:

Në orën e drekës Diana *shkoi* me ngut në spital. (N. Tozaj, Përmbysja);

U ngrit, fiku dritën dhe *shkoi* te dhoma e fëmijëve. (N. Tozaj, po aty).

Format e së kryerës së thjeshtë në shembujt e mësipërm (*shkoi, u ngrit, fiku, shkoi*) tregojnë para së gjithash jo procese në kuptimin e ngushtë të kësaj fjalë, por ngjarje, fakte.

¹⁰¹ Бондарко А.В., *Грамматическая категория и контекст*, Л.1971, 82.

Ndryshe nga e pakryera, ato e shprehin veprimin si një një fakt të gatshëm, pa strukturë dinamike të brendshme të rrjedhës së tij në kohë. Nëse krahasojmë thëniet *Dje shkrova artikullin* dhe *Dje po shkuaja artikullin* do të kemi: në rastin e parë situata lidhet me praninë e artikullit të gatshëm, ndërsa në rastin e dytë kihet prasysh situata e vetë procesit të të shkruarit.

Format e së kryerës së thjeshtë i përgjigjen pyetjes “Ç’ndodhi?” (*u largua, u kthye, qeshi, qau etj.*). Format e së pakryerës, përkundrazi, tregojnë procese, ngjarje që shpalosen në të shkuarën. Veprimet e shprehura prej saj i përgjigjen pyetjes “Ç’ndodhte?” (*largohej, kthehej, qeshte, qante etj.*). Ashtu si format e së pakryerës, format e së kryerës së thjeshtë shprehin në mënyrë eksplicite shkëputjen e veprimit nga çasti i ligjërimit. Mungesa e lidhjeve të veprimit e shprehur nga e pakryera dhe e kryera e thjeshtë me planin kohor të së tashmes i dallon këto dy forma kohore nga e shkuara tjetër absolute, e kryera.

E kryera e thjeshtë dhe e pakryera, edhe pse karakterizohen nga i njëjti tipar semantik (parakohësia), dallohen nga njëra-tjetra edhe sa i takon tiparit të lokalizimit kohor. Tek e pakryera tipari i lokalizimit kohor përgjithësisht mungon, edhe pse nuk përjashtohet. I vetmi tipar i qendrueshëm i saj është kuptimi kohor i parakohësisë, i cili përbën dominantin e përmbajtjes semantike të kësaj forme. Tek e kryera e thjeshtë tiparit të parakohësisë i bashkëngjitet edhe tipari i lokalizimit kohor, i cili është i pranishëm në të gjitha përdorimet e saj (përjashtuar përdorimet e figurshme). Parakohësia dhe lokalizimi kohor së bashku përbëjnë dominantin e përmbajtjes semantike të së kryerës së thjeshtë në gjuhën shqipe, i cili e dallon këtë formë foljore të së shkuarës nga forma e së pakryerës.

Format e së kryerës së thjeshtë, përdoren kryesisht për të paraqitur veprime që pasojnë a zëvendësojnë njëri-tjetrin. Kjo është forma kryesore për përshkrimin e fakteve a ngjarjeve të së shkuarës. P.sh.:

Hyra në dhomë ku kishin vendosur pushkët... Mora një armë në dorë. E ngrita lart me tytë nga Çabрати dhe e drejtova diku nga qielli, por nuk gjeta shenja. (A. Gjakova, Dritëhijet e një qyteti).

Djali ngriti sytë, e pushtoi Bajon për mesi dhe mbështeti kokën në gjoksin e tij. Bajua u çudit. Shikoi Saliun dhe i shkeli syrin, pastaj u ul dhe e mori djalin pranë. (S. Godo, Plaku i Butkës)

Mjeku u përkul mbi të vrarën, mënjanoi një tufë flokësh dhe një copë herë vështroi plagën e gjoksit. (I. Kadare, Përbindëshi).

Në gjuhën ruse ngjarjeve zinxhir që zëvendësojnë njëra-tjetrën, të shprehura nëpërmjet formave të së kryerës së thjeshtë, u përgjigjen format e aspektit të kryer të së shkuarës (përdorimi aoristik). P.sh.:

Ai iu afrua dritares, e hapi pakëz dhe u ul në divan - Он подошел к окну, приоткрыл его и присел на диване.

E kryera e thjeshtë përdoret edhe për të përshkruar veprime të zakonshme a të përsëritura në të shkuarën. Kuptimin e përsëritjes e ka jo vetë forma foljore, por konteksti me elementet e vet aspektuale në funksionin e rrethorëve. P.sh.:

Lajmi *u dha disa herë* në televizionin publik.

Shpesh *u ndjeva* i tepërt në atë mjedis profesionistësh.

Në raste të tjera e kryera e thjeshtë mund të shprehë edhe fakte të përgjithësuara (thënie a të vërteta) me vlerë gjithëkohore, pavarësisht se koha e realizimit të tyre është vendosur në planin kohor të së shkuarës. P.sh.:

Ç'kërkoi gjeti, si shtroi fjeti.

Kush mëngoi, bloi.

Në Gramatikën e ASH (2002) gjejmë këtë përcaktim për kohën e kryer të thjeshtë: *“Kuptimi themelor i së kryerës së thjeshtë është të tregojë përfundimin e një veprimi në një çast të caktuar të së shkuarës. Pra, ndryshimi i kësaj kohe nga e pakryera ka më fort karakter aspektor.”*¹⁰²

Sipas këtij përkufizimi bëhet e qartë se kuptimi gramatikor i së kryerës së thjeshtë përcaktohet nga dy faktorë: nga vendi që zë në sistemin e formave kohore (në të shkuarën) dhe nga semantika aspektuale e kësaj forme. Megjithatë, ne mendojmë se formulimi i sipërpërmendur për kuptimin themelor të së pakryerës lë të paqarta dy momente:

- a) nëse kuptimi i përfundimit të veprimit përshkon ose jo tërë klasën e foljes;
- b) nëse përfundimi i veprimit është kuptim aspektual ose temporalo-aspektual.

Faktet gjuhësore provojnë se jo të gjitha foljet në të kryerën e thjeshtë kanë kuptimin e përfundimit të veprimit. Ky kuptim është karakteristik kryesisht për foljet “objektore”, pra për ato folje, veprimi i të cilave përfshin një objekt. Psh.:

Fëmija *e theu* gotën.

Era e fortë *e rrëzoi* pemën.

¹⁰² Gramatika e gjuhës shqipe 1, 2002, fq. 310.

Foljet *theu* në fjalinë e parë dhe *rrëzoi* në fjalinë e dytë tregojnë se veprimi i emërtuar prej tyre ka përfunduar dhe ai nuk mund të vazhdojë më tej. Nuk mund të themi, p.sh. *Fëmija e theu gotën dhe vazhdoi ta thyente atë ose Era e fortë e rrëzoi pemën dhe vazhdoi ta rrëzonte atë.*

Por ka një numër foljesh, të cilat në kohën e kryer të thjeshtë nuk shprehin përfundim veprimi. P.sh.:

E *mbështeta* që në fillim propozimin e tij.

E *simpatizova* atë njeri që ditën e parë.

Veprimet e shprehura prej foljeve *mbështeta* dhe *simpatizova* mund të vazhdojnë edhe më pas në të shkuarën. Kuptimi leksikor i tyre lejon ndërtimet *E mbështeta që në fillim propozimin e tij dhe vazhdova ta mbështes pa mëdyshje* dhe *Që ditën e parë e simpatizova atë njeri dhe vazhdova ta simpatizoj deri ditën e fundit*. Nëse foljet *mbështeta* dhe *simpatizova* do të tregonin veprime të përfunduara, dy ndërtimet e fundit do të ishin të pamundura. Këto fakte gjuhësore tregojnë se jo të gjitha foljet kanë kuptimin e përfundimit të veprimit në të kryerën e thjeshtë.

Mund të dallojmë disa grupe foljesh, kuptimi leksikor i të cilave në të kryerën e thjeshtë nuk lejon perceptimin e veprimit (gjendjes) si të përfunduar. Ato mund të tregojnë:

- ⇒ gjendje statike: *dua, dashuroj, urrej, vuaj, dergjem, lëngo, hesht, përtoj, duroj, dëshiroj* etj.
- ⇒ gjendje shpëtore: *gëzohem, hidhërohem, trishtohem, egërsohem, mallëngjehem, tërbohem, përmallohem, acarohem, nervozohem* etj.
- ⇒ marrëdhënie: *kushton, zotëroj, përkon, (i) përket, (i) përgjigjet (diçkaje), di, kam* etj.
- ⇒ mjeshtëri, profesion: *tregtoj, kalëroj, drejtoj, udhëheq, qeveris, mbretëroj, sundoj, prij, administroj, komandoj, paraprij* etj.
- ⇒ ekzistencë, prani: *ekzistoj, gjendem, ndodhem, mungoj, jam* etj.

Është me interes të vëmë në dukje se grupeve të mësipërme të foljeve në të kryerën e thjeshtë të shqipes në gjuhën ruse u përgjigjen format e së shkuarës të aspektit të pakryer *любил, ненавидел, принадлежал, руководил, управлял, грустил, относился, располагал, имел* etj. Këto folje në rusisht janë vetëm të aspektit të pakryer, imperfektiva tantum: P.sh.:

Që ditën e parë të punës ai *u udhëhoq* nga egoizmi.

С первого дня работы им *руководил* эгоизм.

Nga ky çast ajo u *trishtua* pa masë.

С этого же момента она безмерно *грустила*.

Format e së shkuarës të aspektit të kryer *руководил* dhe *грустила* në kontekstet e mësipërme janë përdorur në kuptimin aoristik. Këtej del se krahas foljeve të aspektit të kryer, kuptimi aoristik është karakteristik edhe për foljet e aspektit të pakryer. Kjo flet në të mirë të pikëpamjes se kuptimi aoristik dhe kuptimi gramatikor i aspektit të kryer nuk janë e njëjta gjë.

Rreth kundërvënies e kryer e thjeshtë/e pakryer (aorist/imperfekt)

Kur bëhet fjalë për nënndarjet e së shkuarës autorët e gramatikave të shqipes i emërtojnë ato me të drejtë si forma kohore, të cilat tregojnë parakohësi në lidhje me çastin e ligjërimin, por që i kundërvihen njëra-tjetrës në rrafshin aspektor¹⁰³.

Te kundërvënien e kryer e thjeshtë/e pakryer prof. Sh. Demiraj, dallon kuptim aspektor të pastër. E kryera e thjeshtë, sipas autorit, “synon të vërë në dukje përfundimin e veprimit në një çast të caktuar të së shkuarës, pra karakterizohet nga aspekti perfektiv”, ndërsa e pakryera “e paraqit veprimin në zhvillim e sipër në një çast të caktuar të së shkuarës, pra karakterizohet nga aspekti imperfektiv”.¹⁰⁴ Me kuptim *aspekt perfektiv/aspekt imperfektiv* është kuptuar kundërvënien *veprim i përfunduar/veprim i papërfunduar (në zhvillim e sipër)*. Edhe gjuhëtarë të tjerë që janë marrë format foljore të së shkuarës, si A. Dodi, F. Agalliu etj. konstatojnë se dallimi midis formave kohore të së shkuarës nuk është kohor, sepse të gjitha ato tregojnë parakohësi në lidhje me çastin e ligjërimin. Te këto forma ata shohin një komponent tjetër, komponentin aspektor, semantika e të cilit, sipas tyre, mundëson dallimin e këtyre formave nga njëra-tjetra.

Prof. Ali Dhrimo shkon edhe më tej. Brenda së pakryerës, ashtu si edhe tek e tashmja, ai dallon kundërvënien aspektore midis së pakryerës së pacaktuar imperfektive (*vrapoja*) dhe së pakryerës së caktuar perfektive (*po vrapoja*). Nga ana tjetër, ai veçon edhe kundërvënien midis së kryerës së thjeshtë (*vrapova*) dhe së pakryerës të pacaktuar imperfektive (*vrapoja*). Pra, sipas këtij studiuesi, forma e së pakryerës së pacaktuar imperfektive e tipit *vrapoja* shërben njëherazi si gjymtyrë e dy kundërvënieve: e pakryer e caktuar perfektive/e pakryer e pacaktuar imperfektive (*po vrapoja/vrapoja*) dhe kryer e thjeshtë/e pakryer e caktuar imperfektive (*vrapova/vrapoja*).¹⁰⁵

¹⁰³ Gramatika e gjuhës shqipe 1, T., 2002, fq. 274,

¹⁰⁴ Demiraj Sh., Gramatikë historike e gjuhës shqipe, 1985, fq. 713

¹⁰⁵ Dhrimo A., *vepër e cituar*, fq. 89-109)

Duke vënë në themel të kundërvënies *e kryer e thjeshtë/e pakryer* kupimin e *përfundimit/mospërfundimit* të veprimit si kuptim themelor të natyrës aspektore, duke përdorur të njëjtën terminologji aspektologjike (aspekt perfektiv, aspekt imperfektiv), autorët e mësipërm në një farë mënyre heqin paralele midis përmbytjes së kësaj kundërvënie dhe përmbytjes së kundërvënies *aspekt perfektiv/aspekt imperfektiv* në gjuhët sllave.

Kundërvënia *e kryer e thjeshtë/e pakryer* mund të përliqet vetëm për tiparin *veprim i përfunduar/ veprim në zhvillim e sipër* dhe vetëm për atë grup foljesh që shpreh përfundim të mirëfilltë të veprimit. Kjo kundërvënie mbetet e pjesshme, jogjithëpërfshirëse. Ka të drejtë prof. Dhrimo kur shkruan se “ kundërvënie aspektore me të kryerën e thjeshtë nuk përbëjnë të dy variantet e saj (të së pakryerës –A.P.) *en blok*, në tërësinë e tyre, por vetëm njëri variant i saj e pikërisht e pakryera e pacaktuar imperfektive, sepse ajo e jep veprimin në rrjedhje e sipër... ”¹⁰⁶ Pra, jashtë kësaj kundërvënie mbeten përdorime të tjera të së pakryerës si kuptimi i përsëritjes së veprimit në të shkuarën, kuptimi i veprimit të zakonshëm, të ngahershëm etj. Kundërvënia izolohet edhe nga rastet për të cilat u fol më sipër, kur e pakryera e shqipes shpreh jo vetëm veprime të papërfunduara, por edhe veprime të përfunduara (Ai çdo mbrëmje na *telefononte* në shtëpi; Ajo *dërgonte* disa mesazhe në ditë).

Nga ky këndvështrim mund të pohohet se kundërvënia *veprim i përfunduar/veprim i papërfunduar* tek format e thjeshta të së shkuarës nuk mund të kundrohët si kuptim i pastër aspektor për disa arsye:

Së pari, sikurse u vu në dukje më sipër, jo të gjitha foljet në të kryerën e thjeshtë shprehin veprim të përfunduar. Kuptimi i përfundimit të veprimit është i pranishëm kryesisht te foljet që pasohen nga një kundrinor, të përfshirë nga veprimi i foljes.

Së dyti, përfundimi i veprimit është vetëm njëra nga fazat e tij, ndërkohë që faza të tjera të zhvillimit të tij mbeten jashtë fushëpamjes së folësit. Për më tepër në këtë fazë të veprimit kufiri midis semantikës aspektore dhe semantikës kohore të konceptit përfundim i veprimit fshihet.

Së treti, veprim të përfundur mund të tregojnë edhe format e së pakryerës. P.sh.:

Ai *lexonte* disa gazeta në mëngjes.

Gjatë ditës ajo *pinte* disa kafe.

¹⁰⁶ Dhrimo A., *vepër e cituar*, fq.133.

Në këta shembuj foljet imperfektore *lexonte, pinte* tregojnë veprime me disa akte, ku secili akt veçmas ka përfunduar. Këto fakte gjuhësore na çojnë në përfundimin se, përderisa i njëjti tipar është i pranishëm edhe tek e shkuara aoristike, edhe tek e shkuara imperfektore, mbështetja në të bëhet e pavlefshme për të pohuar se në gjuhën shqipe kundërvënia *veprim i përfunduar/veprim i papërfunduar* është kundërvënie aspektore (në kuptimin e kundërvënies gramatikore *aspekt perfektiv/aspekt imperfektiv* në gjuhët sllave).

Së katërti, prej disa dhjetëvjeçarësh aspektologët nuk e konsiderojnë kundërvënien *veprim i përfunduar/veprim i papërfunduar* si tipar semantik që qëndron në themel të kategorisë morfologjike të aspektit. Së bashku me fazat e tjera (fillimin dhe vazhdimin e veprimit) kuptimi i përfundimit të veprimit, apo siç njihet ndryshe në aspektologji *kuptimi terminativ*, i përket mënyrave të veprimit dhe jo kategorisë së aspektit. Kategoria e aspektit, për gjuhët që e kanë këtë kategori, ngrihet mbi tiparin e veprimit tërësor për format perfektive, përkitazi, mungesën e këtij tipari te format imperfektive. Foljet që kanë kuptimin e veprimit tërësor nuk mund të shoqërohen me folje që tregojnë fazën e veprimit, si p.sh., nis, filloj, vazhdoj, mbaroj etj.

Së fundi, ka edhe një argument të tërthortë që vërteton se kundërvënia e *kryer e thjeshtë/e pakryer* e shqipes, për nga përmbajtja kuptimore, nuk është identike me kundërvënien *aspekt i kryer/aspekt i pakryer* në gjuhët që kanë kategorinë morfologjike të aspektit. Në të mirë të këtij mendimi flet prania e këtyre dy llojeve kundërvëniesh në bullgarishte e maqedonishte. Këto gjuhë kanë edhe aorist të aspektit të kryer, edhe aorist të aspektit të pakryer, edhe imperfekt të aspektit të kryer, edhe imperfekt të aspektit të pakryer. Prania e të dy kundërvënieve në këto gjuhë sllave flet për semantikë të ndryshme të tyre.

Po kështu, në gjuhën ruse, së cilës i mungon imperfekti, aoristi e perfekt, format e aspektit të kryer ose të aspektit të pakryer, në varësi nga konteksti, dalin me kuptimin e aoristit, perfektit, imperfektit, pluskuamperfektit. Kjo do të thotë se midis kundërvënies aorist/imperfekt, apo midis kundërvënieve të tjera brenda së shkuarës së shqipes nuk mund të vendoset shenja e barazimit me kuptimet e kundërvënies aspekt i kryer/aspekt i pakryer të gjuhëve sllave.

Krahasuar me gjuhën ruse, mund të pohojmë se e kryera e thjeshtë e shqipes përkon me njërin nga përdorimet e së shkuarës të aspektit të kryer të gjuhës ruse, me përdorimin aoristik të saj, por jo me kuptimin gramatikor të aspektit të kryer të foljeve në këtë gjuhë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për të pakryerën, e cila përkon me format e së shkuarës të aspektit të pakryer, kur ato përdoren në kuptimin e imperfektit.

Duam të theksojmë se kategoria e aspektit në gjuhën shqipe nuk ka gjetur shprehje formale. Format e së shkuarës në gjuhën shqipe nuk janë të specializuara për shprehjen e kuptimeve kategoriale të aspektit. Shqipes i mungojnë mjetet e perfektivimit dhe

imperfektivimit të veprimit foljor. Asnjë karakteristikë e veprimit foljor në gjuhën shqipe, përfshirë edhe tiparin e përfundimit të veprimit, nuk është gramatikalizuar plotësisht në mënyrë që të përshkojë gjithë leksikun foljor në të gjitha përdorimet pa u kufizuar nga çasti i ligjërimimit.

Ndryshe nga kundërvënien e kryer e thjeshtë/e pakryer, kundërvënien aspekti i kryer/ aspekti i pakryer përfshin gjithë foljen në tërë paradigmen e saj. Ajo është indiferente ndaj çastit të ligjërimimit (krahaso, p.sh., paskajoret e tipit *открыть/открывать*, të cilat nuk e kanë kategorinë e kohës, por i përkasin aspektit të kryer ose aspektit të pakryer). Përkundrazi, kuptimi i kundërvënies e kryer e thjeshtë/e pakryer në shqipe nuk e kalon këtë prag, ajo kufizohet prej tij dhe mbetet brenda planit kohor të së shkuarës.

Mendojmë se për gjuhën shqipe do të ishte më e drejtë të flitej jo për aspektin *perfektiv/aspekt imperfektiv*, por për kuptime aspektuale, me të cilat ne kuptojmë tiparet e vazhdimit, zgjatjes, intensitetit, përfundimit, përsëritjes së veprimit etj, të cilat realizohen nga format kohore në bashkëveprim me leksikun dhe kontekstin. Realizimi i kuptimeve a nuancave të mësipërme, të ndryshme nga kuptimi kategorial i kohës, ka lidhje me zonën semantike të aspektualitetit, pra me mënyrën e paraqitjes së rrjedhës së veprimit në kohë.

Siç është vënë në kreun e parë të këtij punimi, semantika e aspektualitetit në gjuhën shqipe gjen shprehje në rrafshin semantik funksional dhe varet nga bashkëveprimi i paradigmeve kohore dhe kontekstit aspektual. Diferencimi i kuptimeve aspektuale nga ato temporale tek nëndarjet e së shkuarës së shqipes mundëson jo vetëm analizën e formave foljore të kësaj kohe, por hedh dritë edhe mbi strukturimin e kësaj kategorie semantike.

Natyrisht, kuptimet a nuancat e ndryshme që përftohen nga bashkëveprimi i formës gramatikore, i kontekstit ose i një klase të caktuar leksikore duhen marrë parasysh, por kjo s'do të thotë që ato duhet t'i vishen formës gramatikore. Duhet diferencuar mirë kuptimi themelor i vetë formës nga kuptimet e tjera që realizohen në kontekste të ndryshme. Për të pasur një tablo më të qartë për të tri kohët e së shkuarës, le të shqyrtojmë edhe kohën e kryer, e cila gjithashtu bën pjesë të kohët absolute që shpreh parakohësi në raport me çastin e ligjërimimit.

3.4.2.3. E kryera

E kryera, ashtu si e pakryera dhe e kryera e thjeshtë, bën pjesë të kohët absolute. Ajo shpreh parakohësi në raport me çastin e ligjërimimit, por ndryshe prej tyre, ajo nuk i shkëput lidhjet me këtë çast.

Për nga përmbajtja e kryera zë një vend të veçantë midis formave të tjera të së shkuarës. Ajo lidh dy plane kohore, planin kohor të së shkuarës dhe planin kohor të së tashmes. Ndonjë studiues dyzimin e së kryerës edhe tek e shkuara, edhe tek e tashmja e shpjegon me motivimin pragmatik të gjuhës.¹⁰⁷

Me kohë të kryer zakonisht kuptohet ajo formë foljore që tregon një veprim të së shkuarës, i cili në njërën ose tjetrën mënyrë është relevant për të tashmen. Një veprim i së kryerës, i përfunduar a i nisur në të shkuarën, është aktual edhe në të tashmen, përkatësisht nëpërmjet pasojave a rezultatit të tij në çastin e ligjërimin ose nëpërmjet vazhdimin të veprimit edhe në këtë çast. Pra, e kryera i kundëvitet së kryerës së thjeshtë dhe së pakryerës për nga tipari i *pranisë/mospranisë* në të tashmen (çastin e ligjërimin) të gjendjes a pasojave të përfuara nga veprimi që ka përfunduar në të shkuarën. Në raport me dy format e tjera të së shkuarës, e kryera, për nga pikëpamja e pranisë së lidhjeve me të tashmen, mund të përkufizohet pozitivisht, pra si gjymtyrë e shenjuar e kundërvënies *e kryer/e kryer e thjeshtë, e pakryer*. (Veprimi i shprehur nga e kryera e thjeshtë dhe e pakryera janë plotësisht të shkëputura nga plani kohor i së tashmes). Ja disa shembuj:

Dëgjoni, - thirri Saliu duke ngritur defterin lart. – Plaku ju *ka shkruar* një vjershë për ditën e sotme, që kjo luftë të mos harrohet kurrë. (S. Godo, Plaku i Butkës).

Unë *kam bisedue* me firma të ndryshme mbrenda e jashtë vendit. (A. Gjakova, Dritëhijet e një qyteti).

Fëmija ka dy ditë që nuk *ka ngrënë* asgjë.

Veprimi i shprehur nga e kryera më së pari e nxit bashkëbiseduesin (lexuesin) të shkojë nëpërmend një situatë që ka ndodhur më parë, para çastit të ligjërimin. Në këtë kuptim ajo ka semantikë të qartë kohore. Por format e së kryerës nuk mbeten vetëm në konstatimin e faktit në të shkuarën, ato transmetojnë diçka më shumë se aq. E kryera jep një informacin origjinal që e lidh këtë të fundit me një çast që vjen pas, me të cilin mund të jetë në raporte të tilla si shkak-pasojë etj. Kjo trajtë e përbërë shpreh “vlerën” që ka veprimi i shkruar për të tashmen. Një gjë e tillë nuk vërehet tek e kryera e thjeshtë. Ajo paraqit faktin që kumtohet ndryshe: si një fakt të dhënë pa ndërmjetësinë e ndonjë diçkaje tjetër, pa ndonjë karakteristikë të veçantë për faktin e kumtuar. Kjo vërtetohet edhe me aftësitë që kanë këto forma për t’u kombinuar me rrethorë të kohës. Zakonisht e kryera e thjeshtë përdoret në bashkëvajtje me tregues leksikorë të tipit *dje, vitin e kaluar, më 1980* etj., të cilët shprehin kohën konkrete të përfundimit të veprimit. Këta tregues nuk janë karakteristikë për format e së kryerës. Këto zakonisht përdoren me rrethorë të tipit *rrallë, shpesh, disa herë etj.*

¹⁰⁷ Кашкин В.Б., *Перфект как субъективное время*, Вестник ЛГУ, 1983, № 20 (серия истории языка, литературы, 4).

Dallimet që vërehen në aftësitë kombinuere tek format e mësipërme, duhen parë të lidhura ngushtë me kuptimin e tyre gramatikor.

Për nga përbërja e kryera është ndërtim analitik, e cila i kundërvihet formave sintetike të së pakryerës dhe së kryerës së thjeshtë. Ajo përbëhet nga pjesorja e foljes, së cilës i paravendosen format vetore të foljeve ndihmëse *kam/jam* në të tashmen (*kam/jam emëruar*). Siç duket, përbërja analitike kushtëzon edhe dyzimin e semantikës të së kryerës.

Si formë foljore, që dallohet formalisht nga e kryera e thjeshtë dhe e pakryera, e kryera është e përhapur në gjuhë me sistem të zhvilluar treguesish gramatikorë foljorë. Atë e gjejmë në greqishten e re, gjuhët skandinave, anglishte, spanjishte, frëngjishte (vetëm në gjuhën e shkruar) etj. Nga gjuhët sllave të kryerën e kanë ruajtur plotësisht vetëm gjuha bullgare dhe gjuha maqedonase. Në shumicën e gjuhëve sllave, ndër to edhe në rusishte, kjo trajtë gramatikore mungon. Për shprehjen e kutimeve perfekte gjuha ruse përdor format aspektoro-kohore të foljes dhe mjete leksikore të kontekstit. P.sh.:

E *kemi bërë* gjysmën e punës - Половину работы **уже** сделали.

E *kam dëgjuar* këtë, por s'kam dëshirë të debatoj me ju. - Я **уже** это слышал, но спорить с вами не хочется.

Në shembullin (1) kuptimi perfektor jepet me formën e së shkuarës të aspektit të kryer *сделали*, i mbështetur nga treguesi ndajfoljor i kohës **уже**. Në shembullin (2) kuptimi perfektor është dhënë me formën e aspektit të pakryer *слышал*, i mbështetur po nga i njëjti tregues leksikor **уже**. Përdorimi i formave të aspektit të kryer dhe aspektit të pakryer në kuptimin perfektor tregon se kuptimi gramatikor i perfektit dhe kuptimi gramatikor i aspektit nuk janë e njëjta gjë.

Ndryshe nga e kryera e thjeshtë, format e së kryerës nuk përdoren për përshkrimin e ngjarjeve joaktuale. Por cilat do të ishin disa nga situatat që motivojnë përdorimin e formave të së kryerës. Mund të veçojmë disa tipa motivimi:

1) Përdorimi i formave të së kryerës motivohet në rastet kur folësi do të vërë në dukje ndryshimin e gjendjes së tij ose të tregojë një raport të caktuar ndaj asaj që kumton:

Më është ndezur gjaku, më vlon nëpër deje nga kjo paudhësi.

E *kam kryer* porosinë tënde që javën e shkuar.

2) Rezultati i veprimit të përfunduar në të shkuarën shërben si informacion i mjaftueshëm që folësi të hamendësojë, të nxjerrë një përfundim:

Gjuhën e ftohtë e *kanë gatuar* me hudhra e limon. Është meze e mirë për raki (N. Tozaj, Përmbysja).

3) Përdorimi i së kryerës motivohet nga përceptimi i drejtpërdrejt i rezultatit të veprimit:

E sheh, na i *kanë pre* krahët Lah, - tha Halili me shtrëngim. (A. Gjakova, Dritëhijet e një qyteti)

Nuk e di. Po ma merr mendja se nuk *ka pasë* mbramë ndonjë malësor tjetër në Gjakovë (A. Gjakova, po aty).

4) Veprimin e shprehur nga e kryera dhe çastin e ligjëritimit i lidh ideja e qëllimit:

Kam ardhur tek ju që të marr një përgjigje të saktë.

5) Veprimi i së kryerës kushtëzon mundësinë e një veprimi tjetër pas tij.

E *keni veshur* shumë fëmijën, do të djersitet.

6) Përdorimi i së kryerës motivohet gjithashtu nga ballafaqimi i situatave në të tashmen:

Ke dëgjuar a ke lexuar në ndonjë libër për të tilla tortura? Tani po i provoj vetë.

Interpretimi i funksioneve të së kryerës, mendojmë, se nuk ka gjetur zgjidhje të kënaqshme. Vështirësitë lidhen me semantikën komplekse të vetë formës. Një problematikë e tillë haset edhe në studime për gjuhë të tjera. Ka autorë që perfektin e vështrojnë si formë thjesht kohore, studiues të tjerë e lidhin atë me kategorinë e aspektit foljor, disa të tretë e shohin si formë aspektoro-kohore. Dallimet në klasifikimin e funksioneve të së kryerës varen nga fakti se cili prej komponentëve të kësaj semantike nxirret në plan të parë. Para se të shfaqim ndonjë mendim lidhur me këtë çështje, le të analizojmë shkurt disa tipa funksionimi të formave të së kryerës në gjuhën shqipe.

1. Veprimi i shprehur nga e kryera mund të modelohet si pikë (në formën e një pike), pavarësisht nga ndonjë gjymtymir i mundshëm logjik a jashtëgjuhësor i veprimit. Në këtë përdorim dalin të ashtuquajturat folje “objektore” (që shoqërohen nga një kundrinor). P.sh.:

Kemi të dhëna se disa nga prijësat grekë, ndonëse e mbajnë të fshehtë, e *kanë humbur* ndërkaq pushtetin në vendet e tyre (I. Kadare, Përbindëshi);

Uh, sa mirë që paske ardhë, dajë... Xhija na *ka gatue* një pite të mirë (A. Gjakova, Dritëhijet e një qyteti).

Për përdorim alkooli në udhëtim atij ia *kanë hequr* të drejtën e drejtimit të automjetit.

Në shembujt e mësipërm format e së kryerës shprehin veprime të veçuara të përfunduara, të cilat, si rregull, nuk shoqërohen nga tregues të tjerë leksikorë.

Duhet vënë në dukje se edhe tek e kryera, ashtu si tek e kryera e thjeshtë, jo të gjitha foljet tregojnë një veprim që ka përfunduar. Po krahasojmë foljet e mëposhtme:

Që ditën që *vdique*, që kur s'të kam parë, lotët që *kam derdhur* s'më *janë* dhe *tharë!*
(A. Z. Çajupi, Vaje)

Për nga tipari i përfundimit të veprimit folja *vdique* (*vdes*) ndryshon nga foljet e së kryerës *kam derdhur* dhe *s'janë tharë*. Dy foljet e fundit nuk përjashtojnë mundësinë që veprimi të vazhdojë edhe më pas, çka tregon se veprimi nuk ka përfunduar, ndërsa te folja *vdiqu* (*ka vdekur*) veprimi ka përfunduar, vazhdimi i mëtejshëm i tij është i pamundur. Krahaso: *ka derdhur lotë dhe vazhdon të derdhë edhe tani; s'janë tharë dhe vazhdojnë të mos thahen edhe tani*. Një gjë e tillë është e pamundur nga folja *vdes*: nuk mund të themi *ai vdiq (ka vdekur) dhe vazhdon të vdesë edhe tani*.

2. Veprimi mund të modelohet ose si një fragment, ose si një seri fragmentesh a pikash. P.sh.:

Ekipi juaj i *ka fituar* të gjitha ndeshjet.
Ju i *keni arritur* të gjitha objektivat.
Ka dredhur cigare Rrushmani e u *ka dhënë* Milit e Becit... (Gj. Fishta, Lahuta e Malsisë, ritreguar për fëmijë nga O. Grillo).

Ky përdorim i formave perfektore njihet edhe si kuptimi rezultativ i së kryerës.

3. Veprimi mund të modelohet si seri pikash a fragmentesh, të cilat përbëjnë shfaqje të veçanta të këtij veprimi që nuk synojnë ndonjë rezultat të caktuar. P.sh.:

Kam genë në vende të mëdha, Lul, në vende të zhvillueme. *Kam pa* fabrika... *kam pa* se si nxjerrin tym e si hyjnë e dalin me mija veta. Fabrikat sjellin pare, Lul. (A. Gjakova, vepër e cituar).

4. Veprimi mund të kryhet vetëm një herë, por edhe mund të përsëritet. P.sh.:

Sot e *kam parë* drejtorin vetëm një herë.
Ai është *shoqëruar* shpesh me më të rritur.

Sikurse shihet nga shembujt e sjellë, folësit i intereson vetë fakti i kryerjes së veprimit në një periudhë të mëparshme. Funksionin e formave të mësipërme mund ta quajmë si të kryer me vlerë të përgjithësuar. Përgjithësimi i faktit mund të shoqërohet me tregues leksikorë të tipit *asnjëherë, kurrë, shpesh, gjithmonë* etj. (Kam qenë koleg me të, por asnjëherë s'kam qenë miku i tij).

Nga sa thamë, mund të arrijmë në përfundimin se për interpretimin e funksioneve të së kryerës duhen marrë parasysh kuptimi i vetë formës gramatikore, kuptimi leksikor i foljes si dhe ndikimi i mjeteve të kontekstit.

Për kundërvëniet e formave të së shkuarës prof. Sh. Demiraj në veprën e tij “Gramatikë historike e gjuhës shqipe” shprehet se ato karakterizohen nga nuancat aspektore. Kështu, tek kundërvëniet *e kryer e thjeshtë/e pakryer* ai dallon kuptim aspektor të pastër¹⁰⁸. E kryera e thjeshtë, sipas autorit, “synon të vërë në dukje përfundimin e veprimit në një çast të caktuar të së shkuarës, pra karakterizohet nga aspekti perfektiv”, ndërsa e pakryera “e paraqit veprimin në zhvillim e sipër në një çast të caktuar të së shkuarës”¹⁰⁹, pra karakterizohet nga aspekti imperfektiv”. Për kundërvënien *e kryer/e kryer e thjeshtë*, po ky studiues shprehet se ajo “është më pak e kapshme dhe, si rrjedhim, edhe më e vështirë për t’u shpjeguar”. Të dyja këto kohë e paraqesin veprimin të përfunduar para çastit të ligjërimin, por nëse veprimi foljor i shprehur me të kryerën e thjeshtë nuk lidhet me çastin e ligjërimin, veprimi i shprehur me të kryerën, për shkak të pasojave, nuk i shkëput lidhjet me të. Autori arrin në përfundimin se “e kryera karakterizohet nga një sintezë e aspektit të kryer (veprim i përfunduar) dhe i aspektit të pakryer (gjendja e përfutur si rezultat i veprimit të përfunduar). E kryera, pra, është një formë kohore, që nëpërmjet aspektit të përzier lidh të shkuarën me të tashmen”. Te kuptimi i aspektit të përzier, prof. Demiraj sheh edhe dallimin midis së kryerës dhe dy formave të tjera të së shkuarës: së kryerës së thjeshtë dhe së pakryerës.

Pohimi se format kohore të së kryerës karakterizohen nga aspekti i përzier është i pambështetur. Në aspektologji nuk ekziston nocioni “aspekt i përzier”, ashtu siç nuk ekziston, fjala vjen, nocioni “rasë e përzier”. Një formë foljore e përdorur në fjali nuk mund të shprehë njëkohësisht edhe kuptimin e aspektit të kryer, edhe kuptimin e aspektit të pakryer. Ka folje në gjuhën ruse, të cilat i kanë të dy aspektet (të ashtuquajturat folje dyaspektore) të tipit *обещать-premtoj, арестовать-arrestoj, казнить-ekzekutoj, велеть-urdhëroj, организовать-organizoj* etj., por kur përdoren në fjali, ato shprehin njërin prej kuptimeve aspektore, ose kuptimin e aspektit të kryer, ose kuptimin e aspektit të pakryer: P.sh.:

¹⁰⁸ Demiraj, Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, 1985, fq. 713

¹⁰⁹ Demiraj, Sh. *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, 1985, fq. 713-715

Шахтёры *организуют* часто протесты (aspekti i pakryer) / Minatorët *organizojnë* shpesh protesta.

Завтра шахтёры *организуют* протест (aspekti i kryer) / Nesër minatorët *do të organizojnë* një protestë.

Po kështu forma e rasës emërore nuk mund të ketë njëherazi edhe kuptimin e një rase tjetër të zhdrejtë. Kjo është aq e pamundur, sa edhe pamundësia për të qenë njëherazi edhe i ri, edhe plak ose për të qenë në të njëjtën kohë edhe duke notuar në det, edhe duke vrapuar në pyll. Duke bërë interpretimin e së kryerës së shqipes ne harrojmë për një çast se ajo quhet perfekt jo për kuptimin kohor (ashtu si e pakryera dhe e kryera e thjeshtë ajo është kohë e shkuar), por për lidhjet e saj me të tashmen nëpërmjet pasojave a rezultatit të veprimit. Pikërisht kjo veçori e saj përbën atë që ne e quajmë kuptim perfektor të së shkuarës, të ndryshëm nga kuptimi imperfektor dhe aoristik. Atëherë, pse duhet të shpikim kundërvënie aspektore brenda së njëjtës formë, apo terma të pambështetur nga faktet gjuhësore të tipit aspekt i përzier? Prania e “produktit” të një veprimi të së shkuarës në të tashmen nuk formon kundërvënie aspektore të tipit *aspekt i kryer/aspekt i pakryer*. Po të ishte kështu, dëftoren në gjuhët e tjera që nuk kanë forma të posaçme për shprehjen e kuptimit modal të habisë, do të duhej ta quanim mënyrë të përzier. S’do të kishte kuptim, për shembull, që mënyrën dëftore të gjuhës ruse ta quanim mënyrë të përzier vetëm pse format foljore të saj, me mbështetjen e mjeteve kontekstuale ose intonacionore, shprehin kuptimin modal të habisë.

Как хорошо *играешь* ты на скрипке!

- Sa mirë i rënke (fjalë për fjalë *i bie*) violinës ti.

Edhe në raport me të kryerën e thjeshtë dhe të pakryerën, e kryera nuk formon kundërvënie aspektore. Për ilustrim po sjellim një situatë, ku gjejmë të përdorura format e së kryerës dhe së pakryerës të mënyrës dëftore. P.sh.:

Kameramanët *kanë filmuar* skenat e dhunës që *shfaqeshin* parreshtur para syve të tyre.

Në këtë fjali me dy njësi kallëzuesore është e pranishme kundërvënia e kryer/e pakryer (*kanë filmuar/shfaqeshin*). Kjo kundërvënie nuk mund të merret si kundërvënie aspektore (*aspekt perfektiv/aspekt imperfektiv*) për faktin se vetë fjalia funksionon në kontekstin morfologjik të së tashmes abstrakte, e cila kushtëzon kuptimin temporal të së kryerës. Forma foljore e së kryerës (*kanë filmuar*) realizon kuptimin e perfektit, pra, shpreh një veprim që është aktual me çastin e ligjërimit, ndërkohë që forma e së pakryerës (*shfaqeshin*) tregon një veprim me disa akte (të përsëritura), i cili i paraprin çastit të ligjërimit dhe s’ka lidhje me të. Madje njësia e dytë kallëzuesore e kësaj fjalie (*shfaqeshin*) karakterizohet edhe nga kuptimi aoristik. Secila nga skenat e shfaqura përbën një akt më

vete të përfunduar në të shkuarën. Të dyja format kohore të mësipërme realizojnë kuptimin kategorial të parakohësisë: forma e së kryerës (*kanë filmuar*) e realizon atë në lidhje me kontekstin morfologjik të së tashmes abstrakte, ndërsa forma e së pakryerës (*shfaqeshin*) - në raport me të kryerën.

E kryera e shqipes mund të shprehë edhe një veprim që ka përfunduar në të shkuarën, por që rezultati konkret i veprimit nuk është i pranishëm në çastin e ligjëritimit. Edhe në këtë rast nuk mund të pohojmë se forma e së kryerës ka kuptimin e aspektit të kryer. P.sh.:

Ai ka ndërtuar ura të varura (në kuptimin: ai di, është i aftë të bëjë diçka të tillë).

Forma e së shkuarës në kontekstin e mësipërm shpreh kryerjen e një veprimi (disa herë) për të karakterizuar subjektin e tij në momentin e dhënë. Nëse do ta përkthenim këtë fjali në gjuhën ruse të pajisur me kategorinë morfologjike të aspektit, forma e perfektit të shqipes **ka ndërtuar** do të jepej me formën joperfektive të rusishtes: Он строил всякие мосты.

Në një kontekst tjetër e kryera e shqipes mund të tregojë jo rezultatin në çastin e ligjëritimit, por vetë situatën, e cila nuk ka përfunduar dhe është e pranishme në këtë çast: P.sh.:

Unë asnjëherë nuk e kam harruar këshillën tënde (në kuptimin: unë edhe tani e kujtoj, e kam parasysh).

Edhe në këtë rast e kryera e shqipes do të jepej në gjuhën ruse me formën e aspektit të pakryer: Я никогда не забывал твоего совета.

Në varësi nga veçoritë leksiko-gramatikore të foljeve dhe nga konteksti format e së pakryerës, së kryerës së thjeshtë dhe së kryerës, krahas kuptimit të parakohësisë në raport me çastin e ligjëritimit, gjatë funksionimit të tyre, kanë aftësinë të modifikojnë kuptimet e tyre. Gjatë shqyrtimit të këtyre formave kohore ne u ndeshëm me semantika të tilla si:

- ⇒ veprim konkret/veprim abstrakt (i përgjithësuar);
- ⇒ veprim i veçuar/veprim i përsëritur;
- ⇒ veprim i përfunduar/veprim në proces (në zhvillim e sipër);
- ⇒ veprim aktual/veprim joaktual;
- ⇒ veprim që karakterizohet nga zgjatja/moszgjatja e tij;
- ⇒ veprim që karakterizohet nga kontakti/mungesa e kontaktit me të tashmen e etj.

Të gjitha këto karakteristika të veprimit foljor në kohën e shkuar janë komponentë aspektualë, të cilët në raport me komponentin temporal të së shkuarës janë dytësorë, jo relevantë. Semantika e aspektualitetit në gjuhën shqipe gjen shprehje në rrafshin semantik

funksional dhe varet nga bashkëveprimi i paradigmatave kohore me kontekstin apo situatën aspektuale.

Disa vërejtje të karakterit terminologjik

Lidhur me nëndarjet e kohës së shkuar dhe kuptimet e tyre në literaturën gjuhësore të shqipes hasim termat *e pakryer, e kryer e thjeshtë, e kryer, më se e kryer dhe e kryer e tejshkuar*, por aty-këtu gjejmë edhe termat e huaj *imperfekt (imperfektor), aorist (aoristik), perfekt (perfektor), pluskuamperfekt (pluskuamperfektor)*. Sa i përket gjymtyrëve të kundërvënieve që formohen brenda së shkuarës dhe dallimeve të tyre gjejmë termat *veprim perfektiv, veprim imperfektiv, aspekt i kryer, aspekt i pakryer ose aspekt perfektiv, aspekt imperfektiv*, por edhe termat *ngjyrim aspektor a nuancë aspektore, folje aspektive* etj.

Siç shihet, termat gjuhësorë të mësipërm ose janë kalkuar nga gjuhë të tjera, ose janë huazuar prej tyre. Të gjithë ata, edhe pse i lidh ngushtë ideja e kohës, ngërthejnë në vetvete semantikë të ndryshme: temporale, aspektuale e taksisore. Është bërë traditë që *e pakryera, e kryera e thjeshtë, e kryera, më se e kryera dhe e kryera e tejshkuar* të vështrohen secila si kohë më vete dhe kjo është ngulitur aq shumë sa kur pyet mësuesit a nxënësit se sa kohë ka folja, është vështirë të dëgjosh shifrën tri.

Termet *perfekt, imperfekt, aorist* në vetvete nuk ngërthejnë semën e kohës (ajo jepet me termin e shkuar), por mënyrën e rrjedhës së veprimit në kohë. Ka të drejtë prof. S. Riza kur shkruan se “t’ashtuquajturat kohë të **pakryeme** dhe të **kryeme**... në fakt janë: e para – kohë e kaluar e aspektit **pakryemjor** p.sh. **mbanja** prkt. **kapnja**, e dyta – kohë e kaluar e aspektit **kryemjor: mbajta** prkt. **kapa**”. /Nënvizimet janë të autorit/.¹¹⁰ Nëse do ta përditësonim me terminologjinë e sotme, citimi i mësipërm do të tingëllonte kështu: “të ashtuquajturat kohë e **pakryer** dhe e **kryer**... në fakt janë: e para – kohë e shkuar e aspektit të **pakryer**, p.sh. **mbaja**, prkt. **kapja**, e dyta – kohë e shkuar e aspektit të **kryer: mbajta**, prkt. **kapa**”.

Me konstatimin e prof. Rizës pajtohemi vetëm me pjesën e parë të tij: koha e veprimeve të kryera para çastit të ligjërimit duhet quajtur më së pari *kohë e shkuar* dhe jo *kohë e pakryer, kohë e kryer e thjeshtë ose kohë e kryer*. Koha s’mund të jetë e tillë: e kryer, e pakryer, e kryer e thjeshtë ose e kryer e përbërë. Kohët gramatikore janë vetëm tri: e tashme, e shkuar dhe e ardhme. Nëpërmjet tyre realizohet vendosja kronologjike e ngjarjeve, fakteve (veprimeve) në boshtin kohor në raport me çastin e ligjërimit. Emërtimet

¹¹⁰ Riza S., *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Tiranë 1994, fq.119

e kryer, e pakryer etj., nuk lidhen me lokalizimin kohor të veprimit në raport me këtë çast. Një veprim mund të perceptohet si i kryer ose i pakryer edhe në të ardhmen.

Duke iu referuar aspektit të gjuhëve sllave prof. Riza i ndan foljet në dy klasa “gramatikore” të ndryshme: folje perfektive a kryemjore dhe folje imperfektive a pakryemjore. Ai shkruan: “Kështu p.sh. rusionjtja aspektin e dytipshëm e njeh për që të gjitha kohët të të gjitha mënyrëve, kurse të njëjtin aspekt shqipja e njeh vetëm për 2 nga 3 shkallët e kohës së kaluar të mënyrës dëftore e pikërisht për t’ ashtuquajturat kohë **të pakryeme** dhe **të kryeme**” (*nënvizimet janë të autorit*)¹¹¹. Termat *perfektiv/imperfektiv* (*i kryer/i pakryer*) i gjejmë të përdorura edhe nga prof. Sh. Demiraj,¹¹² prof. A. Dhrimo¹¹³, por edhe te disa autorë të tjerë.

Termat *perfektor/imperfektor* nuk kanë asgjë të përbashkët me termat *perfektiv/imperfektiv*, të cilët në gjuhën shqipe përdoren për të emërtuar kuptimet e kundërvënies *e kryer e thjeshtë/e pakryer* ose për të emërtuar si *perfektive ose imperfektive* forma të ndryshme foljore. Përdorimi i termave *perfektiv/imperfektiv* (*e kryer perfektive, e pakryer imperfektive*) kushtëzohet edhe nga tautologjia që krijohet nga përdorimi në vend të tyre i termave shqip *i kryer/i pakryer: kohë e kryer e aspektit të kryer/kohë e pakryer e aspektit të pakryer*. Kjo që thamë ka të bëjë me anën e jashtme të problemit. Ajo që ka më shumë rëndësi, sipas nesh, është njëjtësimi i kundërvënies *e shkuar perfektore, e shkuar aoristike/e shkuar imperfektore* me kuptimin gramatikor *aspekt perfektiv/aspekt imperfektiv*, përfshirë këtu edhe ndarjet e prof. Rizës folje perfektive a kryemjore dhe folje imperfektive a pakryemjore.

Duke i perceptuar të *kryerën, të pakryerën, të kryerën e thjeshtë* si kohë të veçanta të së shkuarës ne lëmë jashtë vëmendjes kuptimin *perfektor, imperfektor a aoristik* të tyre dhe i zëvendësojmë ato me kuptimet e aspektit të kryer dhe të aspektit të pakryer. Termat *perfektor/imperfektor* nuk duhen ngatërruar me termat aspektorë *perfektiv/imperfektiv*, të cilët janë karakteristikë për gjuhët sllave. Një kategori e tillë gramatikore që mbështetet në kundërvënien *aspekt i kryer/aspekt i pakryer*, nuk është zhvilluar në sistemin foljor të shqipes.

Për të shmangur këtë pështjellim semantikash të rrafshëve të ndryshme gjuhësore ne do të parapëlqenim përdorimin e termave *e shkuar imperfektore, e shkuar aoristike, e shkuar perfektore*. Duke përmendur në secilën nëndarje termin *e shkuar* ne vëmë në dukje:

së pari, kuptimin temporal të parakohësisë, që është tipari i vetëm i qëndrueshëm për të trija nëndarjet e së shkuarës;

¹¹¹ Riza S., vepër e cituar, fq.118.

¹¹² Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë 1985

¹¹³ Dhrimo A., *Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*, Tiranë 1996)

së dyti, me termin *e shkuar imperfektore* kuptojmë një veprim a) që i paraprin çastit të ligjërimin, b) që i ka shkëputur lidhjet me të tashmen dhe c) që mund të jetë i lokalizuar ose jo në një çast të caktuar të së shkuarës;

së treti, me termin *e shkuar aoristike* kemi parasysh një veprim a) që i paraprin çastit të ligjërimin, b) që i ka shkëputur lidhjet me të tashmen dhe c) në çdo rast të lokalizuar në një çast të së shkuarës;

së fundi, me termin *e shkuar perfektore* kuptohet një veprim a) që i paraprin çastit të ligjërimin dhe b) që ruan lidhjet me të tashmen.

3.4.3. Koha e ardhme

Koha e ardhme është dukuri gjuhësore universale, e cila haset në gjuhët e familjes indoevropiane, por edhe në gjuhë të tjera. Kuptohet, krahas kuptimeve dhe funksioneve të përbashkëta, secila prej gjuhëve ka veçoritë e saj sa i takon hierarkisë së funksioneve dhe mënyrës së shprehjes së kuptimeve të së ardhmes.

Përshkrimi i saktë i kohës së ardhme paraqitet i vështirë. Semantika e saj në njëfarë mase është e kushtëzuar nga karakteri hipotetik i veprimit në të ardhmen dhe nga ngjyrimet modale që shoqërojnë format e kësaj kohe. Përpjekja për të veçuar kohën e ardhme “të pastër” nga e ardhmja “e modalizuar” mbetet subjektive, përderisa nuk ka kritere të sakta për një ndarje të tillë.

Në gjuhën shqipe *e ardhmja*, *e ardhmja e përparme*, *e ardhmja e së shkuarës* dhe *e ardhmja e përparme e së shkuarës* janë forma të mëvetësishme, të cilat në lidhje me çastin që merret si pikë referimi kanë dallime të qenësishme në semantikën e tyre. Në lidhje me këtë çast prof. Sh. Demiraj dallon brenda së ardhmes tri lloje kundërvënish të formave që e përbëjnë atë:¹¹⁴

a) forma e tipit *do të punoj* (e ardhmja e mirëfilltë) shpreh një veprim që pritet të kryhet pas çastit të ligjërimin. Në lidhje me këtë çast kjo formë qëndron në raport të përkundërt me atë të kohëve absolute të së shkuarës (mënyra dëftore);

b) forma e tipit *do të punoja* (e ardhmja e së shkuarës) shpreh një veprim që pritej të kryhej pas një çasti të caktuar të së shkuarës. Kjo formë qëndron ndaj formës *do të punoj* në raport të ngjashëm me formën e së pakryerës ndaj së tashmes *punoj* dhe shpreh një raport të përkundërt me atë të kohëve relative të së shkuarës (mënyra dëftore);

¹¹⁴ Demiraj Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, 1985, fq. 715.

c) forma e tipit *do të kem punuar* (e ardhmja e përparme) shpreh një veprim që pritet të kryhet para një veprimi tjetër, por që të dy veprimet kryhen pas çastit të ligjërimit. Ndaj së ardhmes *do të punoj* kjo formë shpreh raport parakohësie të ngjashëm me atë të kohës së kryer *kam punuar* ndaj së tashmes *punoj*.

Krahas kundërvënieve të mësipërme, do të duhej të flitej edhe për një kundërvënie të katërt të formës *do të kisha punuar* (ardhmja e përparme e së shkuarës), për të cilën prof. Demiraj pohon se kjo formë shpreh raport kohor parakohësie të ngjashëm me atë të më se të kryerës *kisha punuar* ndaj kohës së kryer *kam punuar*, por meqenëse e ardhmja e përparme e së shkuarës pothuajse nuk përdoret ose përdoret rrallë, ajo herë përfshihet e herë jo në sistemin e formave kohore të së ardhmes.

Nga format e renditura më sipër shprehin paskohësi në raport me çastin e ligjërimit vetëm e ardhmja dhe e ardhmja e përparme. Format e tjera (e ardhmja e përparme, ardhmja e përparme e së shkuarës), qëndrojnë jashtë kohës absolute. Marrëdhëniet kohore të shprehura përmes tyre i referohen kohës së një veprimi tjetër. Ashtu si tek e shkuara, ato janë kohë relative dhe i përkasin kategorisë së taksisë. Në shtjellimin e mëposhtëm ne do të shqyrtojmë si kohë të ardhme vetëm format e së ardhmes dhe së ardhmes së përparme.

3.4.3.1. E ardhmja

E ardhmja e tipit *do të vrapoj* (e ardhmja e mirëfilltë) bën pjesë te kohët absolute të mënyrës dëftore. Përmbajtja semantike e së ardhmes karakterizohet nga tipari temporal i paskohësisë në lidhje me çastin e ligjërimit, i cili përbën dominantin e kësaj përmbajtjeje. Tipari temporal i paskohësisë bën dallimin midis kohës së ardhme, kohës së tashme dhe kohës së shkuar.

Format e së ardhmes përdoren dendur në ligjëratën e drejtë të personazheve, në përshkrimin e ngjarjeve të ardhshme që përfytyrohen a merren me mend, në letërsinë fantastike shkencore etj. P.sh.:

Unë *do të vij* nesër në mëngjes në orën shtatë për t'u nisur në aeroport. Zekir beu *do të vijë* në orën katër e gjysëm për t'u nisur me..., si e ka emrin beu? – bëri me kokë Mehmet beu nga Forja. (D. Agolli, Arka e djallit).

...Grumbulli i refugjatëve u zhduk përmes gërmadhëve. *Do të ikin larg*, mendoi Konstruktori, *do të hedhin rrënjë* në ndonjë fushë tjetër dhe ndoshta *do të ngrenë* një qytet të ri. *Do të përpiqen* të harrojnë tmerrin e kësaj nate, por nuk *do të mundin* dot. *Do t'u duket* sikur e harruan, por kjo *do të jetë* e përkohshme. Në netët e tyre të

ngrohta të dashurisë, ky tmerr *do të kalojë* turbull-turbull në embrionet e kërthinjve të tyre. Dhe këta, kur të rriten, here pas here *do të hedhin* sytë e trembur në horizont, për të parë a mos po shfaqet Kali prej Druri. (I. Kadare, Përbindëshi).

Sa i përket kuptimeve të tjera të së ardhmes, që realizohen gjatë funksionimit (përdorimit) të saj, për nga tipari i lokalizimit kohor të veprimit, ato përkojnë me kuptimet aspektuale të së shkuarës imperfekte ose të së shkuarës aoristike.

Në gjuhësinë tonë deri më sot nuk gjejmë ndonjë studim të posaçëm për semantikën aspektuale të formave të së ardhmes. Kemi hasur një konstatim të shkurtër te prof. S. Rizës, i cili shkruan: “Ka gjuhë, siç është p.sh. rusishtja, ku koha e ardhshme paraqet dy palë trajta të ndryshme për dy aspektet e ndryshëm, çka nuk ndodh në shqipe ku dy aspektet e kësaj kohe mund të dallohen vetëm në dritë të kontekstit. P.sh. trajtat (jo të diferencuara për shkak aspektit) të së ardhshmes shqip **do të shkruan** – rusisht do t’ishin për t’u përkthyer herë me trajtat e aspektit pakryemjor: **буду писат’**, herë me ato të kryemjorit: **напи́су**.”¹¹⁵

Përkthimi i formave të së ardhmes së shqipes me format aspektore të rusishtes nuk do të thotë se e ardhmja e shqipes, krahas kuptimit temporal të paskohësisë, shpreh edhe kuptimin e kundërvënies *aspekt i kryer/aspekt i pakryer* të gjuhës ruse. Ne mendojmë se gjatë funksionimit të së ardhmes, në rrethana të caktuara kontekstuale, formave kohore të saj u mbishtresohen disa kuptime të tjera, të cilat përbëjnë semantikën aspektuale (por jo aspektore) të saj.

Le të shohim disa prej përdorimeve të së ardhmes së shqipes, të cilave në gjuhën ruse u përgjigjen format e së ardhmes analitike (aspekti i pakryer), të formuara nga kombinimi i formave vetore të foljes ndihmëse *быть* dhe infinitivit të foljes themelore (*буду писать, будешь писать...*).

Ashtu si e pakryera, format e së ardhmes mund të tregojnë:

- 1) veprime konkrete të veçuara;
- 2) veprime që përsëriten;
- 3) veprime që perceptohen si fakte të përgjithësuara.

Sikurse shihet, ky paralelizëm i përdorimeve të së ardhmes me format e thjeshta të së shkuarës paraqet interes për simetrinë e funksioneve temporale e aspektuale ndërmjet tyre.

¹¹⁵ Riza S., *vepër e cituar*, fq. 125

1) Veprimi konkret i veçuar, i shprehur me format e së ardhmes, është analog me të njëjtin përdorim të shkuarës imperfektore dhe të së tashmes aktuale. Por në qoftë se e shkuara e një veprimi konkret bazohet në riprodhimin e një veprimi dikur aktual, veprimi konkret i së ardhmes akoma nuk ekziston, nuk është i pranishëm. Prandaj, ndryshe nga e shkuara që e shpreh veprimin në proces e sipër, kupimi i veprimit në proces tek e ardhmja në shumë raste ose mungon, ose është i zbehtë. P.sh.:

Unë do të pres dhe ajo natë do të vijë kur ata të dy, duke përbuzur frikën *do të dalin* nga qyteti e *do të shëtisin* në fushën e shkretëtë, që u përket të gjithëve. (I. Kadare, Përbindëshi).

Atëherë unë do të marr këtë heshtë të moçme e *do të zbres* shkallët ngadalë ngadalë në tokë. (I. Kadare, po aty).

- Ja, *do të shkojë* Mersini të ngushëllojë Sherif Abecenë për fletorën e Bankës, që na la shëndenë! - tha Faslli Gropa... (D. Agolli, Arka e djallit).

Pjesa e parë e këtyre periudhave përgatit perceptimin e veprimit pasues në proces. Në këto raste kemi të bëjmë me kuptim procesual të shprehur.

Në shembullin e mëposhtëm të së ardhmes së një veprimi konkret, kuptimi procesual nuk theksohet ose mungon. Dobësimi ose mungesa e procesualitetit kushtëzohet nga veçoritë e kuptimit leksikor të foljes, nga njëra anë, dhe nga përkatësia e veprimit planit kohor të së ardhmes (veprimi nuk është kryer), nga ana tjetër. Theksimi i veprimit në proces e sipër në këto raste nuk është i domosdoshëm. P.sh.:

Dëgjoni, *do të ankohe*!. (Имейте в виду, я буду жаловаться!).

Folja *ankohe* në këtë shembull është neutrale ndaj idesë së procesit.

Në raste të tjera e ardhmja tregon veprime të përhershme, analoge me veprime të shprehura nga e pakryera. P.sh.:

Një ditë të gjithë do të largohen në qytet, ndërsa unë *do të jetoj* përgjithmonë këtu në fshat, pranë detit.

Në këtë shembull rëndësi ka kuptimi leksikor i vetë foljes *jetoj* (veprim që zgjat), por edhe treguesi leksikor *përgjithmonë*, i cili thekson vazhdimësinë.

Në varësi nga konteksti veprimet konkrete të veçuara të së ardhmes në gjuhën ruse jepen me format e aspektit të kryer ose të pakryer. P.sh:

Tani pa humbur kohë *do t'u telefonosh* prindërve.

Ты сейчас же, немедленно *позвонишь* (АК) по телефону родителям.

Tani *do të vijnë* të gjithë dhe *do të hamë* darkë
Сейчас все *придут* (AK), *ужинать* будем (AP).

2) Edhe kuptimi aspektual i përsëritjes së veprimit në të ardhmen është analog me të pakryerën po në të njëjtin funksion. P.sh.:

Çdo javë unë *do të frekuentoj* kursin e gjuhës angleze.

- Herë pas here këto *do t'i nxjerrim* jashtë! - tha ai... (D. Agolli, po aty)

Kuptimi i përsëritjes në shembujt e mësipërm shprehet përmes rrethanorëve *çdo javë, herë pas here*.

Në disa raste veprim të përsëritur mund të tregojë vetë forma foljore e së ardhmes, pa ndihmën e mjeteve të kontekstit. P.sh.:

Ti *do ta punosh* tokën, *do ta mbjellësh*, *do të marrësh* prodhimet e saj dhe *do të ushqehesh*.

Në gjuhën ruse kuptimi i përsëritjes së veprimit është karakteristikë për foljet e aspektit të pakryer. P.sh.:

- Поможешь? - Я всегда помогал и *буду помогать* тебе.

- Do të më ndihmosh? – Unë gjithnjë të kam ndihmuar dhe *do të të ndihmoj*.

3) Me kuptimin e një fakti të përgjithësuar e ardhmja del zakonisht në ato kontekste, ku folësi e përqendron vëmendjen jo tek mënyra e zhvillimit të veprimit, por tek veprimi si fakt. P.sh.:

- Këndo, mos nguro! - Jo. Nuk *do të këndo*.

Do të hash? - pyeti ai.

Edhe format e së ardhmes me kuptimin e faktit të përgjithësuar në ruishte jepen me formën e së ardhmes analitike:

Есть будешь? - спросил он.

3.4.3.2. E ardhmja e përparme

E ardhmja e përparme (*do të kem larë*) është formë foljore analitike, e cila për nga ndërtimi është analoge me format analitike të së kryerës (*kam/jam larë*). Ajo përbëhet nga format

vetore të foljeve ndihmëse në të ardhmen *do të kem/do të jem* dhe pjesorja e foljes kryesore.

E ardhmja e përparme shpreh një vprim që pritet të kryhet në të ardhmen para një veprimi tjetër. Kjo formë e së ardhmes mund të quhet edhe si e shkuar në të ardhmen. Pavarësisht nga veprimi pasues, veprimi i së ardhmes së përparme perceptohet si i përfunduar dhe jo gjithnjë kryhet në planin e së ardhmes. Format e së ardhmes i gjejmë në fjali të nënrenditura, por edhe në fjali të pavarura. P.sh.:

Do të shkoj të takoj motrën, se ndoshta *do të më ketë sjellë* librin që e prosita.

Ekspertët do të sqarojnë se si *do të ketë ndodhur* aksidenti.

Do të ketë qenë pakujdesi e rastit.

Kështu *do të ketë ngjarë*.

Sikurse u vu në dukje, e ardhmja e përparme shpreh një veprim në të ardhmen para fillimit të një veprimi tjetër po në të ardhmen. P.sh.:

Shtëpia do të shitet. Gjithçka do të marrë formë zyrtare, kur *do të jetë firmosur* akti noterial.

E ardhmja e përparme mund shprehë edhe veprime të shkuara në raport me çastin e ligjërimin. Në të tilla raste kjo formë zakonisht shoqërohet nga ndajfolje modale që shprehin supozim, gjasë etj. Në gjuhën ruse ky kuptim përkon me të shkuarën e aspektit të kryer. P.sh:

Nuk po gjej syzet. **Me sa duket** *do t'i kem lënë* në dhomën sipër.

Я не могу найти очки. **Очевидно**, я их *оставил* наверху.

Me siguri ajo përsëri *do të jetë grindur* me drejtorin – tha ai.

Наверное, она опять *поссорилась* с директором – сказал он.

Nëpërmjet formave të së ardhmes së përparme fiksohet jo procesi, por përfundimi i tij. Kuptimi aspektual i faktit të kryer të shprehur me format e së ardhmes së përparme transmetohet në gjuhën ruse nëpërmjet formave të aspektit të kryer. P.sh.:

Kjo ditë do të vijë dhe në këtë ditë ne *do të kemi korrur* fitore të rëndësishme.

Этот день придёт, в этот день мы *одержим* важную победу.

Kur *do të kem mbërritur* në Tiranë, do t'ju telefonoj.

Как только *приеду* в Тирану, я позвоню.

Në disa raste e ardhmja e përparme e shqipes në gjuhën ruse mund të përkthehet edhe me format e aspektit të pakryer. Në këto përdorime format e së ardhmes së përparme shprehin ngjyrimë të ndryshme emocionale si: gëzim, keqardhje, indinjatë etj. P.sh.:

Do t'i ketë ardhur keq për këtë gabim.

Он *сожалел* об этой ошибке.

E gjithë kjo *do të ketë shkuar* kot.

И все это *оказалось* напрасным.

Përfundime për kreun III

- ⇒ Me aspekt gjuhësor të kohës tradicionalisht është kuptuar pasqyrimi i një modeli të caktuar të kohës në gjuhë. Thelbi i kohës gjuhësore ka të bëjë me konceptualizimin e marrëdhënieve kohore, kategorizimin dhe formalizimin e tyre me mjete gjuhësore. Koha gjuhësore, ndryshe nga koha fizike, filozofike etj., ka karakter idioetnik. Dallimet e ndryshme që shfaqen në përdorimin e formave kohore në gjuhën shqipe dhe gjuhën ruse nuk kanë të bëjnë me karakterin real të vetë veprimeve, por me veçoritë në mënyrën e konceptimit dhe interpretimit të proceseve të botës materiale nga bartësit e këtyre gjuhëve. Pikërisht këto dallime kushtëzojnë për zgjedhjen e mjeteve gjuhësore për shprehjen e marrëdhënieve temporale.
- ⇒ Semantika kohore shprehet me njësi të rrafshëve të ndryshme gjuhësore. Në rrafshin semantiko-funksional mjetet gjuhësore mund të jenë foljore (gramatikore) dhe jofoljore (leksikore), të cilat formojnë një sistem tërësor të temporalitetit gjuhësor.
- ⇒ Temporaliteti është koha absolute, koha e jashtme e ngjarjes (veprimit ose gjendjes) me karakteristikë të qartë deiktike. Tek kategoria e temporalitetit ideja e kohës shfaqet si orientim i veprimit ndaj një treguesi të jashtëm, çastit të ligjërimit. Pikërisht ky lloj orientimi e dallon temporalitetin nga aspektualiteti, nëpërmjet të cilit jepen karakteristikat e brendshme të rrjedhës së veprimit në kohë. Sistemi i formave foljore që i kundërvihen njëra-tjetrës në raport me çastin e ligjërimit përbën kategorinë gramatikore të kohës. Në hapësirën semantike të temporalitetit kategoria morfologjike e kohës është pjesë e kësaj hapësire, njëherazi edhe komponenti qendror (bërthama) e saj.
- ⇒ Kuptimet kategoriale të njëkohësisë (e tashmja), parakohësisë (e shkuara) dhe paskohësisë (e ardhmja) në raport me çastin e ligjërimit janë kuptime gramatikore të formave kohore brenda sistemit morfologjik të shqipes. Shprehja e kohës absolute në gjuhën shqipe realizohet përmes formave të së tashmes, së pakryerës, së kryerës së thjeshtë, së kryerës, së ardhmes dhe së ardhmes së përparme. Gjatë funksionimit të formave kohore kuptimet gramatikore pasurohen, konkretizohen

- ose modifikohen. Kjo ndodh nga bashkëveprimi i kuptimeve kategoriale të kohës me kontekstin.
- ⇒ Shprehja e kohës së kryerjes së një veprimi në lidhje me një pikë tjetër referimi, të ndryshme nga çasti i ligjërit, zakonisht me kohën e një veprimi tjetër, përbën kategorinë e taksisë. Semantika taksisore në gjuhën shqipe realizohet gramatikisht përmes kohëve relative të së shkuarës dhe të së ardhmes.
 - ⇒ Semantika temporale e formave foljore të mënyrës dëftore është e aftë të kombinohet me semantikën aspektuale. Në gjuhën shqipe asnjë nga karakteristikat aspektuale të veprimit foljor që kanë të bëjnë me rrjedhën e brendshme të zhvillimit të veprimit në kohë nuk formojnë kundërvënie të pastra dhe gjithëpërfshirëse të aspektit foljor. Kundërvëniet brenda së tashmes dhe së pakryerës, përkatësisht *vrapoj/po vrapoj, vrapoja/po vrapoja*, kundërvëniet brenda formave të së shkuarës (*e kryer e thjeshtë/e pakryer*) ose kundërvënia brenda së kryerës (*veprim i përfunduar në të shkuarën/rezultat i pranishëm në të tashmen*) nuk përkojnë me kundërvënien gramatikore të tipit *aspekt i kryer/aspekt i pakryer* në gjuhën ruse.
 - ⇒ Kuptimet e imperfektit, aoristit dhe perfektit, të shprehura në gjuhën shqipe nëpërmjet formave përkatëse të së shkuarës, në gjuhën ruse, së cilës i mungojnë mjetet morfologjike përkatëse, ato janë të pranishme në çdo tekst. Në varësi nga mjetet leksikore kontekstuale kuptimet e imperfektit, aoristit dhe perfektit shprehen në çdo rast ose me format foljore të aspektit të kryer ose me format e aspektit të pakryer.

Kreu IV

TAKSISA DHE MJETET GJUHËSORE TË SHPREHJES SË SAJ NË GJUHËN SHQIPE

4.1. Statusi konceptual dhe kategorial i taksisë

Termi “taksisë” (nga greqishtja τάξις - rend, renditje) është relativisht i ri në gjuhësi. Për herë të parë ky term është përdorur nga R. Jakobsoni më 1957¹¹⁶, por si dukuri gjuhësore studimi i taksisë ka një traditë më të hershme. Në gjuhësinë perëndimore kjo traditë u vendos nga studimet e Uorfit, Blumfildit e Koshmiderit, të cilët marrëdhëniet kohore të parakohësisë, njëkohësisë dhe paskohësisë ndërmjet veprimeve i vështronin si kategori foljore të veçantë, të ndryshme nga kategoria e kohës. Pikërisht këtë kategori gjuhësore Jakobsoni e emërtoi “taksisë” si “shembëllim grek” i termit “order” (rend) të propozuar nga Blumfildi. Konceptet e tij për problematikën taksisore u përqafuan më pas edhe nga studiues të tjerë.

Për të pasur një ide më të qartë rreth konceptit të taksisë të formuluar nga Jakobsoni, le të ndalemi në disa momente kryesore të arsyetimit të tij.

Kur bëhet fjalë për klasifikimin e kategorive foljore, Jakobsoni është i mendimit se duhen pasur parasysh “dy dallime të rëndësishme” midis:

- a) vetë kumtimit **s** (*speech*) dhe temës së kumtimit **n** (*narrate*);
- b) vetë faktit **E** (*event*) dhe çdo pjesëmarrësi të tij **P** (*participant*), qoftë ky subjekt ose objekt i veprimit.

Krahas dallimeve të mësipërme autori veçon edhe katër tipare semantike klasifikuese:

- a) faktin që kumtohet **En**;
- b) faktin e kumtimit (aktin e komunikimit) **Es**;
- c) pjesëmarrësit e faktit që kumtohet **Pn**;
- d) pjesëmarrësit e faktit të kumtimit (pjesëmarrësit e aktit të komunikimit) **Ps**, qoftë ky folësi ose bashkëbiseduesi¹¹⁷.

Duke u mbështetur në tiparet e mësipërme, Jakobsoni i ndan kategoritë foljore të marra në shqyrtim në dy tipa: a) kategori që tregojnë pjesëmarrësit e faktit që kumtohet dhe b)

¹¹⁶ *Shifters, Verbal Categories and the Russian Verb*, Harvard University, 1957

¹¹⁷ Яковсон Р.О., *Шифтеры, глагольные категории и русский глагол*, Принципы типологического анализа языков различного строя. М., 1972, fq. 99.

kategori pa tregues të tillë. Kategoritë e tipit të parë “mund të karakterizojnë ose vetë pjesëmarrësit e faktit që kumtohet (**Pn**), ose raportet e tyre me këtë fakt (**PnEn**)”. Kategoritë e tipit të dytë “karakterizojnë ose vetë faktin që kumtohet (**En**), ose raportin ndaj një fakti tjetër që kumtohet (**EnEn**)”¹¹⁸. Pikërisht këtë kategori të fundit, të shënuar me formulën (**EnEn**), Jakobsoni e emërtoi taksisë.

Kategoritë që karakterizojnë vetëm faktin ose pjesëmarrësit e tij (**Pn**) Jakobsoni i emërton “**desinjatorë**”, ndërsa kategoritë që karakterizojnë korrelacionin midis ngjarjeve të ndryshme ose pjesëmarrësve të ndryshëm (**En En** ose **Pn En**) - “**konektorë**”. Pra, të gjitha kategoritë e foljes, nëse ato karakterizojnë faktin që kumtohet dhe/ose pjesëmarrësit e tij, Jakobsoni i klasifikon ose “sipas raportit me faktin e kumtimit... (.../**En**), ose sipas pjesëmarrësve të tij... (.../**Pn**), ose pavarësisht nga të gjitha këto”¹¹⁹.

R. Jakobsoni, ashtu si edhe O. Jesperseni, kohën foljore në lidhje me çastin e ligjërimit e quan kategori “**shifter**”, ndërsa kohën e foljes që nuk lidhet me këtë çast, por me kohën e një veprimi tjetër, ai e emërtoi si kategori “**jo shifter**”. Kategorinë foljore të taksisë ai e përfshiu te kategoritë jo shifter.

Si shembull tipik i kategorisë shifter shërben kategoria tradicionale e kohës, e paraqitur nga Jakobsoni me formulën (**EnEs**). Këtë kategori ai e përkufizon në këtë mënyrë: “Koha karakterizon faktin që kumtohet në raport me faktin e kumtimit. Kështu, koha e shkuar tregon se fakti që kumtohet i paraprin faktit të kumtimit”. Në cilësinë e kategorisë jo shifter, që gjithashtu lidhet me shprehjen e idesë së kohës, Jakobsoni përmend kategorinë e aspektit, përderisa veprimi (fakti, ngjarja) karakterizohet nga parametrat e brendshëm kohorë, pa iu referuar faktit të kumtimit. Kategorinë e aspektit ai e shënon me formulën (**En**). Mbi bazën e këtyre kundërvënieve binare Jakobsoni përcakton veçoritë e kategorive foljore të vetës, diatezës, mënyrës, dëshmimit,¹²⁰ ndër to edhe të taksisë.

Sipas këndvështrimit të parë kuptimet taksisore të njëkohësisë, parakohësisë e paskohësisë shprehen me mjete formale. Vetëm në këtë rast mund të flitet për taksisë si kategori gramatikore foljore jo shifter. Në njëfarë mënyre taksisa si koncept zëvendëson, edhe pse jo gjithnjë, konceptin tradicional “kohë relative”. Gjuhëtarët kanë vënë re se dallimi ndërmjet koncepteve tradicionale të kuptimeve kohore absolute dhe relative është aq i qenësishëm, sa mund të flitet për kategori krejtësisht të ndryshme. Për kohët relative Jakobsoni shprehet se ato e mbulojnë pjesërisht fushën e kategorisë së taksisë.

¹¹⁸ Якобсон P.O., *vepër e cituar*, fq. 99.

¹¹⁹ Якобсон P.O., *vepër e cituar*, fq. 100.

¹²⁰ Një dukuri e tillë është vënë në dukje për gjuhën shqipe nga Z. Sadikaj. Fjala është për veprime të shprehura nga format pluskuamperfektore, të cilat folësi nuk i paraqit si të dëshmuara ose të përjetuara prej tij. Krhaso: Kur u ktheva unë fëmija *kishte fjetur* – Kur u ktheva unë fëmija *fjeti*). Për më shumë shih: Z. Sadikaj “*Funksionet semantike të trajtave pluskuamperfektore të gjuhës shqipe*” në *Gjurmime albanologjike*, Seria Shkencat filologjike, VIII, 1978.

Një gjë e tillë pasqyrohet në konceptet e sotme për kohën dhe taksisën. Ju. Masllov thekson se kombinimi i taksisës dhe i kohës jep kuptimin e orientimit kohor kompleks të shprehur në disa gjuhë me forma të veçanta, të përfshira në sistemin e të ashtuquajturave kohë relative.¹²¹

Sipas këndvështrimit të dytë, taksisa mund të shprehet me mjete të ndryshme morfologjike, sintaksore morfo-sintaksore e leksikore, të cilat formojnë fushën semantike funksionale, e cila ndërthuret me fushat e temporalitetit dhe aspektualitetit. Nga kjo pikëpamje taksisa ekziston në të gjitha gjuhët, por si kategori gramatikore, që dallon nga koha dhe aspekti, ajo është e pranishme në gjuhët e pajisura me një sistem të posaçëm formash gramatikore. “...ndër konceptet gramatikore që shprehen me forma foljore në gjuhën ruse” Jakobsoni përfshin taksisën e varur, të shprehur me përcjellore, e cila tregon një fakt që kumtohet, që shoqëron një fakt tjetër kryesor. Kjo pikëpamje e Jakobsonit i nxiti disa gjuhëtarë rusë ta vështrojnë taksisën si kategori semantike funksionale, e cila pasqyron një nga aspektet e idesë së përgjithshme të kohës. Kështu, A.V. Bondarko e vështrohet taksisën si kategori semantike funksionale që bazohet në bashkëveprimin e elemnteve semantike të rrafshëve të ndryshme gjuhësore: morfologjik (format aspektore), leksiko-gramatikor (disa lidhëza, parafjalë, ndajfoje), sintaksor (tipa të caktuar fjalish polipredikative)¹²².

Pra, sipas Jakobsonit e Bondarkos, në gjuhën ruse, fusha semantike funksionale e taksisës ka strukturë policentrike. Atë e përbëjnë ndërtimet me përcjellore, format aspektoro-kohore të foljes si dhe disa mjete leksiko-sintaksore, të cilat janë të afta për të aktualizuar semantikën taksisore. Rol jo të vogël luajnë lidhëzat (kohore), të cilat jo vetëm orientojnë veprimin e fjalisë së nënrenditur në raport me veprimin e fjalisë kryesore, por kanë aftësinë të përcaktojnë funksionin taksisor midis veprimeve brenda pjesëve të periudhës. Kuptohet që shprehja e raporteve taksisore në gjuhën ruse do të ishte e pamundur pa pjesëmarrjen e semantikës aspektuale-temporale të formave foljore.

Në rrafshin e përmbajtjes semantika taksisore dallohet nga semantika temporale dhe aspektuale, por njëherazi është e lidhur ngushtë me to. P.sh., në gjuhën ruse marrëdhëniet taksisore përcaktohen nga bashkëvajtja e tipareve aspektuale të dy veprimeve, që i bashkon plani temporal i së tashmes, së shkuarës ose së ardhmes. Në planin e shprehjes fusha semantike funksionale e taksisës ka disa veçori strukturore të ndryshme nga fushat e temporalitetit dhe aspektualitetit.

Në gjuhën shqipe, përkundrazi, kategoria semantike e taksisës ka strukturë monocentrike, bërthamën e së cilës e përbëjnë kohët relative, të specializuara për shprehjen e semantikës taksisore. Raporte parakohësie a paskohësie midis veprimeve, pavarësisht nga çasti i

¹²¹ Маслов Ю. С., *Избранные труды, Аспектология*, М. 2004, fq. 37-38.

¹²² Бондарко А.В., *Теория функциональной грамматики*, Л. 1987, fq. 234.

ligjërimin, shprehin dy format e së shkuarës pluskuamperfektore (më se e kryera dhe e kryera e tejshkuar) dhe dy format e së ardhmes (e ardhmja e së shkuarës dhe e ardhmja e përparme e së shkuarës). Këto forma foljore me semantikë taksisore nuk kufizohen nga elemente të tjera të kontekstit, të cilat përbëjnë komponentët periferikë të fushës.

Nuk janë të paktë studiuesit që mbrojnë pikëpamjen se taksisa ka statusin e kategorisë gramatikore. Kështu p.sh., në bullgarishte, e cila, ndryshe nga shumica e gjuhëve të tjera sllave, ka ruajtur një sistem të pasur me forma kohore, gjuhëtarët J. Pençev e I. Kucarov pohojnë se bërthamën e kategorisë gramatikore të taksisë e përbën kundërvënia e formave relative dhe formave absolute. Për shprehjen e marrëdhënieve taksisore këta gjuhëtarë, krahas formave foljore relative, nuk përjashtojnë edhe mjetet sintaksore (Pençev), madje edhe mjetet komplekse: edhe sintaksore, edhe leksikore, edhe mjetet e kombinuara leksiko-sintaksore. (Kucarov)¹²³.

Edhe sllavistja tjetër T.N. Molloshnaja është e mendimit se “taksisa është kategori gramatikore (morfologjike). Ajo formohet nga dy palë forma kategoriale që i kundërvihen njëra-tjetrës: nga format kategoriale që korrelojnë me momentin e ligjërimin (M1) dhe format kategoriale që korrelojnë me një moment tjetër (M2) në të shkuarën”.

Në gjuhët romane dhe gjermanike kategoria e taksisë tradicionalisht është barazuar me kohën relative. Ja si e paraqit taksisen N. Telin: “Kategoria temporale e taksisë është studiuar relativisht vonë. Komponenti më i rëndësishëm i taksisë - kuptimi i PARAKOHËSISË (angl. Anteriority, gjerm. Vorzeitigkeit) – mbështetet në kuptimet kohore dhe formon kuptime komplekse kohoro-taksisore, përmbajtjes së të cilave në të shkuarën, në të tashmen dhe në të ardhmen u shtohet komponenti i parakohësisë. Natyrisht, kihet parasysh perfekti i së shkuarës (“pluskuamperfekti”), perfekti i së tashmes dhe perfekti i së ardhmes (futurum exactum). Para futjes së konceptit të taksisë këto kuptime përbënin problemin “shekullor” për gramatikën tradicionale”¹²⁴.

4.2. Shprehja e semantikës taksisore në gjuhën shqipe

Gjuhëtarë të ndryshëm mendojnë se taksisa është e pranishme në çdo gjuhë, por si kategori gramatikore e veçantë, që e dallon atë nga temporaliteti dhe aspektualiteti, ajo ekziston në

¹²³ Пенчев Й., *Време, таксис, синтаксис*. Български език, 1985, № 6, fq. 223-228.

Кучаров Ив., *Категория на таксис на съвременния български език*. Доклади от международен конгрес по българистика, V. 3, Съвременен български език, София, 1987.

¹²⁴ Телин Н.Б., *О системном статусе перфектного значения в функциональной грамматике*, Язык: система и функционирование. М., 1988. fq. 236-249.

Телин Н.Б., *Познание, перспектива и метафора времени*, Типология вида. М., 1998, fq. 430-443.

gjuhët, që zotërojnë sistem të posaçëm formash gramatikore. Gjuha shqipe është e pajisur me forma gramatikore për shprehjen e marrëdhënieve taksisore, por studime të posaçme që i kushtohen problemeve të taksisë, semantikës dhe mjeteve të shprehjes së saj deri më sot nuk kemi. Megjithatë duam të theksojmë se dukuritë gjuhësore që lidhem me kategorinë e taksisë (kohët relative) janë studiuar e përshkruar në punime a gramatika të kësaj gjuhe (Gramatika historike e prof. Sh. Demirajt, Gramatika e gjuhës shqipe, botim i ASH dhe shumë punime të autorëve të tjerë).

Cilat do të ishin disa nga argumentet që flasin në të mirë të idesë së veçimit të kategorisë gramatikore të taksisë në sistemin folJOR të shqipes?

Në Gramatikën e gjuhës shqipe 1 (2002) gjejmë këtë përkufizim për kategorinë e kohës: *“Nëpërmjet të kategorisë së kohës shprehet lidhja midis kohës kur kryhet veprimi i emërtuar nga folja dhe një çasti të caktuar, që merret si bazë për marrëdhëniet kohore. Si bazë për marrëdhëniet kohore në gjuhën e folur merret çasti i ligjërimit, kurse në gjuhën e shkruar merret ose çasti kur shkruajmë, ose një çast tjetër i përfytyruar”*. Në një shënim që shoqëron këtë përkufizim thuhet: *“Për të mos e ngarkuar tekstin pa nevojë, si bazë për marrëdhëniet kohore do të përmendet vetëm çasti i ligjërimit”*¹²⁵.

Nëse i përmbahemi këtij formulimi, do të vëmë re se të ashtuquajturat kohë relative të shqipes (më se e kryera, e kryera e tejshkuar, e ardhmja e së shkuarës dhe e ardhmja e përparme e së shkuarës), mbeten jashtë tij, përderisa veprimi i shprehur prej tyre nuk ka lidhje me çastin e ligjërimit.

Për dy kohët relative të së shkuarës prof. Sh. Demiraj shkruan: *“Kur dy veprime janë kryer në kohë të ndryshme të së shkuarës, ai që është kryer më parë, shprehet zakonisht me njëri nga dy kohët relative të së shkuarës, kurse veprimi i dytë shprehet sipas rastit, me anë të njëres prej tri kohëve “absolute” të së shkuarës”*¹²⁶.

Pjesa e parë e këtij përcaktimi na thotë se dy veprimet kryhen në kohë të ndryshme të së shkuarës, pra njëri prej tyre, ai që shprehet me formë foljore të kohës absolute ka si pikë referimi çastin e ligjërimit, ndërsa veprimi i dytë, i shprehur me njëri nga format e kohëve relative, ka lidhje me kohën e veprimit të parë, por jo me çastin e ligjërimit. Çasti i ligjërimit në këtë rast nuk mund të shërbejë si pikë referimi për marrëdhëniet kohore të shprehura me anë të formave pluskuamperfektore. Është kjo arsyeja që më se kryera dhe e kryera e tejshkuar nuk mund të përfshihen në përkufizimin e mësipërm. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për të ardhmen e së shkuarës dhe të ardhmen e përparme të së shkuarës.

¹²⁵ Gramatika e gjuhës shqipe I, botim i Akademisë së Shkencave, 2002, fq. 273.

¹²⁶ Demiraj, Sh., *“Gramatikë historike e gjuhës shqipe”*, Tiranë 1985”, fq. 713

Këto dy forma gjithashtu kanë si pikë referimi kohën e një veprimi tjetër dhe jo çastin e ligjërimit.

Pra, tradicionalisht në sistemin foljor të shqipes dy kohët e shkuara pluskuamperfektore dhe dy kohët e ardhme të së shkuarës paraqiten gramatikisht si kohë foljore me raporte të dyfishta në kohë: raporti i ngjarjes që kumtohet ndaj një ngjarje tjetër të kumtuar dhe njëherazi edhe ndaj aktit të ligjërimit. Kjo mënyrë paraqitjeje, me sa duket, është pasojë e mbartjes së kohës fizike a kategorive logjike në rrafshin e raporteve gjuhësore. Në përcaktimin e marrëdhënieve kohore nuk mund të ketë kohë me orientim të dyfishtë. Të ashtuquajturat kohë relative nuk shprehin marrëdhënie kohore në lidhje me çastin e ligjërimit, prandaj ato duhen veçuar nga kategoria e kohës dhe duhen përfshirë në kategorinë gramatikore të *taksisë*.¹²⁷

Siç u vu në dukje më sipër, kategoria morfologjike e taksisë në gjuhën shqipe përfaqësohet nga dy format pluskuamperfektore (më se e kryera dhe e kryera e tejshkuar) dhe dy format e së ardhmes (e ardhmja e së shkuarës dhe e ardhmja e përparme e së shkuarës). Dy format pluskuamperfektore dhe e ardhmja e përparme e së shkuarës shprehin parakohësi në lidhje me kohën e një veprimi tjetër të shprehur me anë të një forme kohore absolute të së shkuarës. Vetëm e ardhmja e së shkruarës shpreh marrëdhënie paskohësie në lidhje me kohën e një veprimi tjetër në të shkuarën. Po i analizojmë më me hollësi marrëdhëniet taksisore të shprehura me format foljore të mësipërme.

4.2.1 Marrëdhëniet taksisore të parakohësisë

Marrëdhënie parakohësie midis dy veprimeve shprehin më se e kryera dhe e kryera e tejshkuar, të cilat funksionojnë në planin e së shkuarës. Veprimi i shprehur prej tyre domosdoshmërisht i paraprin një veprimi tjetër që kryhet po në të shkuarën. P.sh.:

Nuk e kuptoja, pse atij njeriu *s'i kishte mbetur* një thërrime nga dinjiteti njerëzor.

E mora vesh çfarë krimi *qe bërë* e se shkaktari qeshë vetë...(Dh. Xhuvani, vep. e cituar).

Për këto dy forma pluskuamperfektore në gramatikat e shqipes gjejmë një përkufizim të tillë: “Kuptimi themelor i më se të kryerës është tregojë një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës”¹²⁸.

Në të njëjtën mënyrë përkufizohet edhe e kryera e tejshkuar, e cila vështrohet si formë sinonime me të parën¹²⁹. Këtë përkufizim e cituam për të tërhequr vëmendjen në

¹²⁷ Në këtë punim është ruajtur pa ndryshime termi *taksisë* i propozuar nga Jakobsoni, megjithëse për analogji me termin *sintaksë* (nga greqishtja *syn+taxis*) mund të përdorej edhe termi *taksë*. Termi *taksë* do të ishte i përshtatshëm edhe për termat e tjerë gjuhësorë si *parataksë*, *hipotaksë*, *diataksë* etj.

¹²⁸ *Gramatika e gjuhës shqipe I*, 2002, fq. 314

elementin “**çast i caktuar i së shkuarës**”, të cilin e gjejmë edhe në përkufizimin e së pakryerës, edhe në përkufizimin e së kryerës së thjeshtë. [E pakryera tregon një veprim në zhvillim e sipër në një **çast të caktuar të së shkuarës**; e kryera e thjeshtë një veprim të përfunduar në një **çast të caktuar të së shkuarës**]. Por ky element në përkufizimin e formave pluskuamperfektore ka një dallim të qenësishëm nga dy të tjerët. Çasti i caktuar i së shkuarës tek e pakryera dhe e kryera e thjeshtë është deiktik, d.m.th., ka lidhje “të pandërmjetshme” (term i përdorur nga S. Riza) me të tashmen, me çastin e ligjërit. Te format pluskuamperfektore, përkundrazi, ky çast është “i ndërmjetshëm” është vetë koha e shkuar e një veprimi të shprehur me të pakryerën ose të kryerën e thjeshtë, por edhe me vetë format pluskuamperfektore. Ja disa shembuj:

Naxhija e **kuptoi** se i *kishte thënë* një fjalë të rëndë të vëllait... (A. Gjakova, Dritëhijet e një qyteti).

S’ **po kuptoja** ç’krim *qe bërë*. (Dh. Xhuvani, Shpirtin nuk e shes).

Ndjeva uri. S’më **kujtohej** nëse *kisha ngrënë* darkë. (Dh. Xhuvani, po aty).

Disa herë i **qe dukur** se diçka *ishte kthjelluar* në ndërgjegjen e tij... (I. Kadare, Dimri i madh).

S’**kisha dëgjuar** se *ishte hapur* dera, se si *kishte hyrë* pa u ndier zonja fon Vydelizin. (Dh. Xhuvani, po aty).

Sikurse vihet re nga shembujt e mësipërm, marrëdhëniet taksisore të parakohësisë, të shprehura me format pluskuamperfektore, nuk janë relevante për tashmen, ashtu sikurse janë marrëdhëniet e parakohësisë, të shprehura me anë të formave perfektore. Të krahasohen shembujt:

Ajo po më thotë se *ka luajtur* në piano (është e aftë të luajë dhe tani).

Ajo më tha se *kishte luajtur* në piano (kjo aftësi nuk është më aktuale).

Pra, në rastet e shprehjes së kuptimit të parakohësisë me format pluskuamperfektore kemi të bëjmë me marrëdhënie taksisore midis veprimeve.

Taksisa gjen shprehjen e saj në ndërtime sintaksore me dy ose më shumë njësi kallëzuesore (shih shembujt e mësipërm). Krahas formave gramatikore, ndërtimet sintaksore të tipit të periudhës, që përbëhen nga pjesa kryesore dhe pjesa e nënrenditur e fjalisë, janë kusht dhe njëherazi edhe mjet i shprehjes së raporteve taksisore. Po kaq i rëndësishëm është edhe kushti tjetër: kuptimet taksisore midis dy veprimeve duhet t’i përkasin të njëjtit plan kohor.

Në gjuhë shqipe hasen rëndom edhe ndërtime njëkallëzuesore që shprehin marrëdhënie taksisore. K. Cipo shkruan se pluskuamperfekti “është një kohë relative, një kohë që nuk

¹²⁹ Po aty, fq. 315

mund të përdoret e veçuar, por në lidhje e marrëdhënie me një kohë tjetër, qoftë kjo formalisht e shprehur ose e nënkuptuar”.¹³⁰ Në këto raste kuptimi i parakohësisë ndaj një veprimi tjetër del nga konteksti a elemente të tij. P.sh.:

Jo. S’*kisha ngrënë* gjithë ditën veç asaj gjysme kafeje në kafe “Liza”... (konteksti i mëparshëm: *s’ mbaja mend* nëse kisha ngrënë...) (Dh. Xhuvani, vepër e cituar).
E *kisha dëgjuar* edhe më parë atë këngëtar (= kur këndonte).

Marrëdhëniet taksisore midis veprimeve janë të lidhura ngushtë me shprehjen e zhvillimit të veprimit dhe shpërndarjen e tij në kohë. Aspektualiteti është element i pandashëm i tyre. Në gramatikat e shqipes format pluskuamperfektore përkufizohen si forma që tregojnë veprim të përfunduar. P.sh.:

Do të kishte aq forcë a të rronte deri atje për ku *qe nisur*. (Dh. Xhuvani, vepër e cituar).

Ziguri çalonte se i *kishin hyrë* në këmbë gjemba (D. Agolli, Njeriu me top).

Përveç kuptimit të veprimit të përfunduar forma pluskuamperfektore (më se e kryera) mund të shprehë edhe kuptime të tjera aspektuale. P.sh.:

Ai e dinte se Maria gjithnjë e *kishte dashur* atë.

Pastaj ai përsëri zuri vend te muri i shtëpisë, i cili edhe më parë e *kishte tërhequr* atë.

Forma *kishte dashur dhe kishte tërhequr* në fjalitë e mësipërme shprehin veprime që kanë zgjatur në të shkuarën. Përveç foljes ndihmëse në të pakryerën (*kishte*), kuptimi i vazhdimit të veprimit mbështetet edhe nga treguesit ndajfoljorë *gjithnjë*, përkatësisht *edhe më parë*.

Në gjuhën ruse këtyre përdorimeve të pluskuamperfektit të shqipes u përgjigjen format e aspektit të pakryer:

Он знал, что Мария его всегда *любила*.

Потом он снова уставился в стену дома, которая и до этого его *привлекала*.

Në përdorime të tjera e shkuara pluskuamperfektore, kur ajo përsëritet, shpreh veprim intensiv. P.sh:

¹³⁰ K. Cipo, Gramatika shqipe, Tiranë, 1949, f.115.

Fëmija *kishte qarë e kishte qarë*, pastaj lodhja dhe të ftohtët e kishin vënë në gjumë që të mbërdhinte ngadalë (A. Gjakova, vepër e cituar).

Në ndonjë rast më se e kryera mund të shprehë njëkohësi të veprimit, nëse si pikë referimi në këtë përdorim do të pranohet formën e përcjellores. P.sh.:

E kishte sjellë Europën, më në fund, këtu, siç sillet mushka xanaxare për të kapërxyer mëdyshjet e për ta bindur se, **duke hyrë** në Arbëri, osmanët *kishin hyrë*, ndërkaq në shtëpinë europiane (I. Kadare, Mosmarrëveshja).

Vdekjen asaj shtëpie ia *kishte dërguar* vetë, **duke e futur** në një gjyle topi! (D. Agolli, Njeriu me top).

4.2.1.1. E ardhmja e përparme të së shkuarës

E ardhmja e përparme në planin e së shkuarës përdoret rrallë, por kur përdoret si e tillë, ajo shpreh marrdhënie taksisore të parakohësisë. P.sh.:

Ajo me siguri kishte marrë me mend se diçka e papëlqyeshme *do të kishte ndodhur* në dhomën e gjumit. (Dh. Xhuvani, vepër e cituar).

As më shkoi në mendje se kjo dashuri një ditë *do ta kishte rigjetur* jehonën e saj. (Letërsi e përkthyer).

S'e kishte menduar se ai dokument *do të ishte djegur* me të tjerat.

Foljet e nënvizuara tregojnë veprime, të cilat mund të jenë kryer para një veprimi tjetër në të shkuarën.

Kuptimi taksisor i parakohësisë ndaj një veprimi tjetër në të shkuarën zbehet, kur forma e së ardhmes së përparme së të shkuarës përdoret në pjesë fjalishë të përbërë, prej së cilave varet një fjali e nënrenditur që shpreh kusht hipotetik. P.sh.:

Po të ishte imi, *do t'ia kisha falur* (Dh. Xhuvani, vepër e cituar).

Mbase *do të kishin thënë* ndonjë fjalë edhe më të ashpër, sikur të mos ndërhynte Perlati. (Gramatika e gjuhës shqipe, II, 1997, fq. 581)

4.2.2. Marrëdhëniet taksisore të paskohësisë

Paskohësi në raport me një veprim tjetër të së shkuarës në gjuhën shqipe shpreh vetëm forma e ardhme e së shkuarës. Kjo formë foljore shpreh një veprim që pritej të kryhej pas

një veprimi tjetër në të shkuarën. Forma e së ardhmes nuk na thotë gjë, nëse veprimi u krye ose jo. P.sh.:

Më dukej se *do ta tradhtoja* veten time... (Dh. Xhuvani, Shpirtin nuk e shes).

Pas meje u kthye edhe Sabina e druajtur si *do ta priste* zonja jonë kthimin tonë aq të shpejtë. (Po aty).

Këto veçori të semantikës së së ardhmes së të shkuarës mund të vështrohen edhe si premisë për shprehjen e ngjyimeve të ndryshme modale. Veprimet e shprehura prej saj mund të jenë të supozuara, hipotetike etj. P.sh.:

Po ta bënte këtë gabim, *do ta paguante* rëndë.

Dhe unë nuk dija se ç' *do të bënte* Xheku po ta prekte Herta (Dh. Xhuvani, po aty).

Semantika e së ardhmes së të shkuarës është e lidhur në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhët e tjera ballkanike, me zhvillimin e të ashtuquajturës mënyrë kushtore. Në gjuhën shqipe, por edhe në bullgarishte kjo formë është klasifikuar si formë kohore relative, ndërsa në greqishte dhe rumanishte e ardhmja e së shkuarës kryen funksionin e mënyrës kushtore. Ne mendojmë se prania e ngjyimeve modale të kjo formë foljore, edhe pse jo rrallë ato janë mbizotëruese ndaj elementit temporal taksisor, nuk motivon kalimin e së ardhmes së të shkuarës të mënyra kushtore, sepse kuptimet modale mund të ekzistojnë vetëm mbi bazën e kuptimeve temporale.

Lidhur me sa u tha, duam të vëmë në dukje një fakt jo pa rëndësi: forma e mënyrës kushtore (do të vrapoja) nga pikëpamja temporale është neutrale, por si e ardhme e së të shkuarës ajo është e aftë të shprehë edhe orientimin ndaj kohës së një veprimi në të shkuarën, pra ndaj një çasti të së shkuarës.

Funksioni taksisor i së ardhmes së të shkuarës vihet re qartë në tekste tregimtare, qoftë edhe të shkurtra. P.sh:

Tani po përfytyronte sikur atë natë, diku në fushë, të kish takuar Helenën dhe të dy bashkë të futeshin për t'u mbrojtur nën barkun e kalit. Ai *do t'i jepte* asaj xhaketen e tij, *do ta ngrohte* dhe pastaj *do të ngjiteshin* të dy nëpër këmbët e prapme e *do të futeshin* në barkun e kalit. Barku *do të ishte* i shkretë, i braktisur dhe ata *do të shtriheshin* në krahët e njëri-tjetrit. Jashtë *do të vërshëllente* stuhia dimërore, era *do të ulërinte* nëpër zgavrat e errëta dhe trarët e mëdhenj *do të pikonin* ujë. Ajo *do të trembej* e ai *do ta shtrëngonte* në gjoks për ta qetësuar. (I. Kadare, Përbindëshi)

Përfundime për kreun IV

- ⇒ Në shumicën e gjuhëve folësi e vendos ngjarjen që përshkruan ose në njërin nga tri kohët e foljes: në të tashmen, në të shkuarën ose në të ardhmen, ose e lokalizon atë në lidhje me kohën e një veprimi tjetër. Shprehja e marrëdhënieve kohore midis veprimeve përbën kategorinë gramatikore të taksisës.
- ⇒ Kategoria e taksisës vështrohet si sistem i marrëdhënieve kohore midis veprimeve në ndërtime sintaksore me dy a më shumë njësi kallëzuesore që i përkasin të njëjtit plan kohor.
- ⇒ Në gjuhën shqipe taksisa përbën kategori gramatikore (morfologjike). Të ashtuquajturat kohë relative në sistemin foljor të shqipes shërbejnë si mjete formale për shprehjen e marrëdhënieve të parakohësisë dhe paskohësisë së veprimit foljor.
- ⇒ E vështruar nga pozicioni i gramatikës funksionale, kategoria semantike e taksisës është dukuri universale, e cila integrom mjete të rrafshëve të ndryshme gjuhësore: morfologjike (format relative të foljes), sintaksore (ndërtime bipredikative), leksikore (tregues ndajfoljorë, lidhëzorë) ose kombinime të tyre.

PËRFUNDIME TË PËRGJITHSHME

Në këtë punim janë bërë përpjekje për të hedhur dritë mbi disa çështje të kategorizimit dhe interpretimit gjuhësor të idesë së kohës në gjuhën shqipe në përjasje me gjuhën ruse. Ideja e kohës është vështruar si një makrosistem gjuhësor që përfshin jo vetëm sistemin e formave kohore që shprehin marrëdhëniet e veprimit foljor me çastin e ligjërit, por edhe sisteme të tjera në përbërje të tij, të cilat pasqyrojnë marrëdhëniet kohore midis vetë veprimeve dhe mënyrën e paraqitjes së zhvillimit të veprimit në kohë.

Semantikave të përmendura kanë në themel të tyre idenë e kohës, por secila prej tyre qëndron në rrafshin e ndryshme gjuhësore. Marrëdhëniet e veprimit foljor me çastin e ligjërit gjejnë pasqyrim në kategorinë semantike të temporalitetit, marrëdhëniet kohore midis veprimeve përbëjnë kategorinë semantike të taksisë, ndërsa mënyrat e paraqitjes së zhvillimit të veprimeve në kohë i përkasin kategorisë semantike të aspektualitetit.

Shqyrtimi i kategorive në fjalë është mbështetur në arritjet e studimeve gjuhësore bashkëkohore, të cilat në dhjetëvjeçarët e fundit i kanë kapërcyer caqet e morfologjisë dhe janë shtrirë edhe në rrafshin leksikor e sintaksor. Në mënyrë të veçantë në punim janë bërë përpjekje për të analizuar dhe interpretuar elementet përbërëse të kompleksit aspektualo-temporalo-taksisor dhe mjetet e ndryshme gjuhësore që marrin pjesë në shprehjen semantikave të mësipërme në gjuhën shqipe.

Në gjuhën shqipe kompleksi aspektualitet-temporalitet-taksisë përmbledh kategoritë gramatikore të kohës dhe taksisë, të shprehura me mjete të posaçme morfologjike, si dhe kategorinë leksiko-gramatikore të mënyrave të veprimit, të cilat nuk përfshihen në paradigmen e foljes.

Analiza e dukurive gjuhësore të aspektualitetit, temporalitetit dhe taksisë në përjasje me gjuhën ruse kushtëzoi vështrimin e tyre në rrafshin semantiko-funksional. Mungesa e aspektit foljor në statusin e një kategorie morfologjike në gjuhën shqipe, apo e kategorisë taksisë në gjuhën ruse, nuk do të thotë që shqipes a rusishtes u mungojnë mjetet e tjera të shprehjes së semantikës aspektuale, përkatësisht semantikës taksimore. Interpretimi dhe diferencimi i këtyre mjeteve është i mundur, kur dukurisë së marrë në shqyrtim i qasemi jo vetëm nga ana formale, por edhe nga ana përmbajtësore e funksionale.

Përshkrimi dhe interpretimi i kategorive semantike të temporalitetit, taksisë dhe aspektualitetit në punim janë mbështetur kryesisht në parimet e gramatikës funksionale, e cila në shqyrtimin e fakteve gjuhësore nisat nga semantika për te mjetet. Në radhë të parë janë bërë objekt shqyrtimi mjetet morfologjike të shprehjes së kategorive semantike të mësipërme, por pjesërisht edhe mjetet e niveleve të tjera gjuhësore. Analiza e kësaj tërësie

mjetesh që plotësojnë njëri-tjetrin, na ka dhënë dorë të bëjmë një interpretim më të mbështetur dhe përshkrim më të plotë të semantikës aspektuale, temporale e taksisore.

Megjithëse ideja e kohës (në kuptimin e gjerë të fjalës) është i vetmi element përbashkues i kategorive semantike funksionale të aspektualitetit, temporalitetit dhe taksisë, përthyerja e kësaj ideje prej tyre është e ndryshme. Janë pikërisht orientuesit e ndryshëm kohorë ata faktorë që ndikojnë në diferencimin e pasqyrimin gjuhësor të idesë së kohës brendapërbrenda këtij grupimi kategorish.

Kategoria semantike e temporalitetit shpreh lidhjen e veprimit me çastin e ligjërit, si orientues i jashtëm absolut. Aspektualiteti pasqyron “kohën e brendshme”, mënyrën e shpërndarjes a rrjedhës së veprimit në kohë. Te kategoria e taksisë koha e një veprimi përcaktohet në lidhje me kohën e një veprimi tjetër si orientues relativ.

Aspektualiteti është i lidhur ngushtë me kohën inherente të veprimit. Kjo do të thotë se çdo veprim kërkon periudhën e vet kohore (sasinë e vet të kohës) për t’u realizuar. Tiparet (karakteristikat) aspektuale të veprimit shënojnë mënyrën e shpërndarjes së veprimit brenda kohës inherente, nëse ky veprim është i shkurtër (çastor) ose zgjat (me ose pa kufizim), nëse kryhet vetëm një herë ose disa herë, nëse gjatë zhvillimit të tij arrin një cak të brendshëm ose nuk e synon atë, nëse është në zhvillim e sipër ose perceptohet si një fakt tërësor etj. Në një kuptim më të ngushtë sfera e aspektualitetit përfshin të gjitha karakteristikat e veprimit foljor nga pikëpamja e pranisë/mungesës së paraqitjes së perspektivës kohore. Në një kuptim më të gjerë aspektualiteti përmbledh të gjithë tipat e rrjedhës a shpërndarjes së veprimit në kohë (në ç’fazë të zhvillimit të tij është, sa dinamike, statike, intensive është rrjedha e tij). Karakteristikat aspektuale janë lidhura kryesisht me fushëveprimin e predikatit foljor përderisa komponenti foljor i thënies (leksema foljore – tema e saj), përveçse shënon një ngjarje, jep për të edhe informacion aspektual lidhur me parametrat e e rrjedhës së veprimit në kohë.

Aspektualiteti është jo vetëm kategori semantike, por edhe bashkim i dyanshëm i semantikës aspektuale me sistemin e mjeteve shprehëse, të cilat formojnë fushën përkatëse semantike funksionale. Brenda caqeve të kësaj fushe ndërthuren tipa të ndryshëm kuptimesh aspektuale, të cilët shprehin nuanca a karakteristika të veprimit foljor. Elementet formale (formantët e posaçëm morfologjikë), të cilët shprehin kuptimin themelor të kategorisë semantike përkatëse përbëjnë qendrën (bërthamën) e fushës semantike funksionale si komponenti kryesor dhe më i abstraktuar i saj, ndërsa periferia përfaqësohet nga mikrofusha (mikrozona) të tjera, të strukturuar nga mjete leksiko-gramatikore ose leksikore. Fusha semantike funksionale e aspektualitetit në këto gjuhë është monocentrike.

Në sistemin foljor të gjuhës ruse, por edhe në gjuhët e tjera sllave, aspekti dëshmohej si kategori morfologjike që mbështetet në kundërvënien binare *aspekt i kryer (perfektiv)/aspekt i pakryer (imperfektiv) (sovershennij/njesovershennij vid)*. Prania e aspektit foljor në statusin e kategorisë gramatikore është veçori e strukturës morfologjike të këtyre gjuhëve. Kjo do të thotë se folja në këto gjuhë jo vetëm emërton një veprim ose gjendje, por ka aftësinë t'i karakterizojë ato gramatikisht edhe nga pikëpamja e kuptimeve aspektore. Zgjedhjen e njëres prej formave aspektore folësi i kësaj gjuhe e ka të detyruar. Njëra apo tjetra formë aspektore mbart me vete një ngarkesë të caktuar semantike, e cila karakterizon shpalosjen e veprimit në kohë.

Është me rëndësi të vëmë në dukje se aspekti foljor, ndryshe nga koha, nuk kufizohet dhe nuk i referohet qendrës deiktike (çastit të ligjërit). Folja e gjuhës ruse mbetet e të njëjtit aspekt, pavarësisht se përdoret në të tashmen, në të shkuarën a në të ardhmen ose në format e paskajores a përcjellores. Kuptimin e aspektit (të kryer ose të pakryer) e ka çdo folje e gjuhës ruse në cilëndo trajtë të saj. Kjo do të thotë se në kuptimet aspektore (aspektuale) ideja e kohës shfaqet si veti e brendshme e vetë veprimit.

Është e natyrshme që në gjuhë të ndryshme komponentët aspektualë të mësipërm të mos kenë të njëjtën shpërndarje, sepse secila gjuhë e “gjymtyron” realitetin që na rrethon në mënyra të ndryshme. Për rrjedhojë edhe organizimi i fushës semantike funksionale të aspektualitetit është i ndryshëm. Shqipja bën pjesë në gjuhët “joaspektore”. Deri më sot asnjë autor i gramatikave të shqipes nuk e ka renditur aspektin krahas kategorive gramatikore të tjera të foljes. Megjithatë, termat *aspekt, ngjyrim aspektor, aspekt i kryer, aspekt i pakryer* i gjejmë në gramatikat e shqipes, duke filluar që nga gjysma e dytë të shekullit të kaluar. Termi aspekt në gjuhën shqipe është kuptuar gjerë, pothuaj është përdorur si sinonim i mënyrave të veprimit foljor (aksionsart). Me këtë term autorë të ndryshëm kanë kuptuar tipare të tilla të veprimit foljor si: veprim që zgjat (veprim durativ), veprim çastor (momental), veprim në proces, veprim i zakonshëm, veprim i përfunduar, veprim i përsëritur (iterativ) etj.

Shqipja nuk ka mjete të posaçme për formimin e aspektit të kryer ose të pakryer (perfektivimin ose imperfektivimin e veprimit foljor).

Fusha semantike funksionale e aspektualitetit në gjuhën shqipe përbëhet nga mënyrat e veprimit foljor, togje të formuara me folje që tregojnë “fazën e veprimit” (fillimin, vazhdimin, dhe përfundimin e një veprimi, ndërtime të tjera analitike me semantikë aspektuale; tregues leksikorë të tipit *gjatë, në çast, gradualisht, ngadalë, shpesh, përmjërësh* etj.

Semantika aspektuale që ngërthejnë format foljore realizohet nga bashkëveprimi i tyre me elemente të kontekstit ose me kuptime të kategorive të tjera foljore, sidomos me kategorinë

e kohës, por edhe me atë të diatezës dhe mënyrës, ashtu siç veprojnë ato edhe në vetë realitetin gjuhësor.

Mjete mbizotëruese të shprehjes së mënyrave të veprimit në gjuhën shqipe mbeten ndërtimet analitike të tipave të ndryshëm. Sistemi foljor të shqipes është i prirë të ruaj në rrafshin gjuhësor një numër jo të madh mjetesh të gatshme për shprehjen e kuptimeve aspektuale. Në shumicën e rasteve shqipfolësi, duke mos patur në përdorim mjete të gatshme, detyrohet “t’i prodhojë” ato vetë gjatë ligjërimin. Ndryshe ndodh me rusishtfolësin. Në ligjërimin e tij mënyrat e veprimit vijnë si njësi të gatshme të formuara me ndajshesë. Nëse folja e gjuhës ruse mund të klasifikohet me lehtësi në mënyra veprimi sipas kuptimit të ndajshesave të posaçme, të cilat kanë fituar vlerën e shënjesit gramatikor, sistemimi i foljeve të shqipes nga pikëpamja e kuptimeve aspektuale bëhet më i vështirë për arsye të përdorimit të kufizuar të ndajshesave si mjete modifikuese të kuptimit fillestar të foljes. Modelet e krijuara nga shqipja dhe rusishtja për relizimin e kuptimeve aspektuale kushtëzohen nga prirjet e analitizimit ose sintetizimit në këto gjuhë.

Ndryshe nga aspektualiteti që përbën kohën e brendshme (rrjedha e veprimit në kohë), temporaliteti është koha e jashtme e veprimit (çasti absolut) me karakteristikë të qartë deiktike. Te kategoria e temporalitetit ideja e kohës shfaqet si orientim i veprimit ndaj çastit të ligjërimin.

Semantika kohore është një zonë e gjerë që shprehet me njësi të rrafshve të ndryshme me kuptim kohor. Fiksimi gjuhësor i kohës realizohet me mjete leksikore e gramatikore, të cilat formojnë një sistem tërësor të temporalitetit gjuhësor. Mjetet e të gjitha rrafshve gjuhësore (leksikore, morfologjike e sintaksore), që shprehin marrëdhënie kohore, përbëjnë zonën semantike të tempoalitetit. Në studimet për sistemin foljor të shqipes mjetet leksikore (leksemat temporale), edhe pse janë të shumta dhe paraqitin interes për studiuesin, kanë zënë një vend më modest në literaturën gjuhësore. Format foljore tradicionalisht kanë qenë mbizotëruese në përshkrimet e kohës gjuhësore. Format foljore shprehin kohën e ngjarjes, ndërsa leksiku temporal shpreh kohën e referencës, dhe së bashku ato përcaktojnë tipin e situatës temporale të shprehur nga fjalia. Kështu, raporti ndërmjet këtyre dy pikave referimi kushtëzon funksione të ndryshme të mjeteve leksikore. Kur koha e kuptimit përkon me kohën e ngjarjes, ato luajnë rol konkretizues, kur ato nuk përkojnë, luajnë rol modifikues të temporalitetit gramatikor.

Tërësia e mjeteve të rrafshve të ndryshme gjuhësore përbën fushën semantike funksionale të temporalitetit, mbi të cilën ngrihet kategoria përkatëse. Në hapësirën semantike të temporalitetit kategoria morfologjike e kohës është pjesë e kësaj hapësire dhe përbën komponentin qendror të saj. Në raport me kategorinë gramatikore të kohës mjetet e tjera (leksikore, leksiko-gramatikore, kontekstuale) mund të kaarakterizohen si elemente periferike të fushës. Pavarësisht nga pozicioni periferik i tyre, në disa raste mjetet jofoljore

janë përcaktuese në realizimin e orientimit kohor. Në vartësi nga situata temporale mjetet leksikore ose mund të konkretizojnë, ose mund të modifikojnë kuptimin e formës foljore.

Në lidhje me çastin e ligjërimit, që shërben si pikë referimi, situata e përshkruar (veprimi ose gjendja) mund të tregojë parakohësi, njëkohësi ose paskohësi. Përkatësia e veprimit foljor ndaj njërës prej planeve kohore të mësipërme përbën thelbin e kohës si kategori gramatikore. Kështu, kategoria e deiksisit kohor mund të përfshijë jo më shumë se tri gramema: a) të tashmen (situata e përshkruar përkon në kohë me çastin e ligjërimit), b) të shkuarën (situata e përshkruar i paraprin çastit të ligjërimit), c) të ardhmen (situata e përshkruar vjen pas çastit të ligjërimit).

Si forma të mirëfillta temporale për mënyrën dëftore në këtë punim janë pranuar vetëm ato forma që vendosin në boshtin kohor ngjarje të ndryshme në lidhje me çastin e ligjërimit, të ashtuquajturat kohë absolute. Format e *më se të kryerës, të kryerës së tejshkuar, të ardhmes së të shkuarës dhe të ardhmes së përparme të së shkuarës*, veprimi i të cilave nuk ka si pikë referimi çastin e ligjërimit, janë përfshirë në kategorinë gramatikore të taksisë. Sipas këtij këndvështrimi kategoria e kohës përbëhet nga e tashmja dhe format absolute të së shkuarës dhe të së ardhmes, pra prej atyre formave që tregojnë njëkohësi, parakohësi dhe paskohësi në lidhje me çastin e ligjërimit.

E tashmja dhe e shkuara imperfektore e shqipes, krahas semës së kohës (njëkohësi, përkatësisht parakohësi të veprimit të shprehur nga folja me çastin e ligjërimit) shprehin edhe kuptime aspektuale si: veprim në zhvillim e sipër në të tashmen, përkatësisht në të shkuarën, veprim që zgjat veprim, që përsëritet, veprim të ngahershëm, veprim të papërfunduar etj. Këto tipare të veprimit foljor duhen klasifikuar si kuptime aspektuale që u përkasin mënyrave të veprimit foljor (aktionsart), por jo si kuptime të mirëfillta aspektore. Asnjë nga semantikët e mësipërme nuk është gramatikalizuar në gjuhën shqipe.

Edhe kundërvënia *veprim i përfunduar/veprim i papërfunduar* tek format e thjeshta të së shkuarës (e kryer e thjeshtë/e pakryer) nuk mund të kundrohet si kundërvënie *aspekt i kryer/aspekt i pakryer*. Kuptimi i përfundimit të veprimit nuk përfshin të gjitha klasat e foljes dhe të gjitha variantet e funksionimit të tyre (*Ai zbriti dalëngadalë shkallët dhe pa u nxituar iu afrua portës së jashtme* (foljet e nënvizuara shprehin veprime me dinamikë të brenshme). Nga ana tjetër, veprim të përfundur mund të tregojnë edhe format e së pakryerës. Kuptimi i përfundimit të veprimit është vetëm njëra nga fazat e tij që e afron atë me mënyrat e veprimit foljor, por jo me kategorinë morfologjike të aspektit.

E kryera, ashtu si edhe kohët e thjeshta të së shkuarës, ruan semën e kohës së shkuar, por ndryshe nga ato, veprimi i shprehur prej saj në njërën ose tjetrën mënyrë është relevant për të tashmen. E shkuara perfektore i kundërvihet së kryerës së thjeshtë dhe së pakryerës për

nga tipari i *pranisë/mospranisë* në të tashmen (çastin e ligjërit) të gjendjes a pasojave të përfutuara nga veprimi që ka përfunduar në të shkuarën.

Karakteristikë për format e së shkuarës në gjuhën shqipe të shoqëruara edhe me elemente të kontekstit (tregues leksikorë) është jo vetëm realizimi i kuptimeve kategoriale të kohës (marrëdhëniet e parakohësisë), por edhe i kuptimeve të karakterit aspektual.

Marrëdhëniet e paskohësisë në lidhje me çastin e ligjërit shprehen nëpërmjet së ardhmes dhe së ardhmes së përparme. Përshkrimi i saktë i kohës së ardhme paraqitet i vështirë. Semantika e saj në njëfarë mase është e kushtëzuar nga ngjyrimet modale që shoqërojnë format e kësaj kohe.

Gjatë funksionimit të së ardhmes, në rrethana të caktuara kontekstuale, formave kohore të saj u mbishtresohen disa kuptime të tjera, të cilat përbëjnë semantikën aspektuale të tyre. Format e së ardhmes së mirëfilltë, ashtu si e pakryera, mund të tregojnë veprime konkrete të veçuara, veprime që përsëriten dhe veprime që perceptohen si fakte të përgjithësuara. Paralelizmi që vihet re midis përdorimeve të së ardhmes dhe formave të thjeshta të së shkuarës paraqet interes për simetrinë e funksioneve temporale e aspektuale ndërmjet tyre.

E ardhmja e përparme shpreh një vprim që pritet të kryhet në të ardhmen para një veprimi tjetër. Kjo formë e së ardhmes mund të quhet edhe si e shkuar në të ardhmen. Pavarësisht nga veprimi pasues, veprimi i së ardhmes së përparme perceptohet si i përfunduar. Nëpërmjet formave të së ardhmes së përparme fiksohet jo procesi, por përfundimi i tij. Pra, në lidhje me çastin e ligjërit në shqipfolësi detyrohet ta lokaizojë ngjarjen e përshkruar ose në kohën e tashme, ose në njërën nga format e kohës së shkuar ose në njërën nga format e së ardhmes.

Por folësi i shqipes duhet të bëjë edhe një zgjedhje tjetër: në lidhje me kohën e një veprimi tjetër ai duhet ta vendosë ngjarjen ose njërën nga format pluskuamperfone (më se e kryera, e kryera e tejshkuar), ose në njërën nga format e së ardhmes në të shkuarën (e ardhmja e së shkuarës dhe e ardhmja e përparme e së shkuarës). Shprehja e marrëdhënieve kohore të parakohësisë ose paskohësisë midis veprimeve përbën kategorinë gramatikore të taksisë.

Veçimi i kuptimeve taksisore në kategori morfologjike më vete në gjuhën shqipe është i përligjur. Folja e kësaj gjuhe është i pajisur me një sistem formash që i kundërvihen njëra-tjetrës në rrafshin e shprehjes së marrëdhënieve të parakohësisë a paskohësisë në lidhje me një pikë tjetër referimi, të ndryshme nga çasti i ligjërit.

Kategoria e taksisë në punim vështrohet si sistem i marrëdhënieve kohore midis veprimeve në ndërtime sintaksore me dy a më shumë njësi kallëzuesore që i përkasin të

njëjtë plan kohor. Të ashtuquajturat kohë relative të së shkuarës a të së ardhmes në sistemin foljor të shqipes shërbejnë si mjete formale për shprehjen e marrëdhënieve të parakohësisë dhe paskohësisë së veprimit foljor.

Kategoritë semantike funksionale të temporalitetit dhe taksisë realizohen me mjete të të gjitha niveleve përmbajtësore të sistemit gjuhësor:

në nivelin morfologjik – kategoritë gramatikore të kohës dhe taksisë;

në nivelin sintaksor – tipat semantikë strukturorë të fjalive të përbëra, pjesët e të cilave shprehin marrëdhënie kohore ose taksisë;

në nivelin leksikor – kuptimet individuale të fjalëve të veçanta të përdorura për shprehjen e kohës dhe taksisë.

Studimi në fjalë përbën përpjekjen e parë për të shqyrtuar pasqyrimin gjuhësor të idesë së kohës në kompleksin semantik aspektualitet-temporalitet-taksisë, i cili përfshin si mjetet gramatikore, ashtu edhe ato leksikore e kontekstuale. Studime të mëtejshme kërkohet të ndërmerren për çështjet e strukturimit të këtyre mjeteve, përcaktimit të statusit të tyre etj.

BIBLIOGRAFIA

NË GJUHËN SHQIPE:

- AGALLIU F. 1968 «Vëzhgime mbi kuptimet e disa trajtave kohore». *Studime filologjike*, 2;
AGALLIU F. “Mbi pjesëzën po në gjuhën shqipe” SF.1982, 2, Gramatika shqipe, 1949
BECI B. *Hulumtime gjuhësore në Mat*, BUSHT, SSHSH, Tiranë, 1963, 3
CIPO K. “Gramatika Shqipe”, 1949
CIPO K. “Sintaksa”, 1952
ÇELIKU M., Karapinjalli M., Stringa R. “Gramatika praktike e gjuhës shqipe”, Tiranë, 2007
DEMIRAJ SH. Morfologji e gjuhës së sotme shqipe, (dispensë) I, II, 1961, 1963
DEMIRAJ SH. Kuptimet kryesore të kohëve të mënyrës dëftore, SF, 1971, 4
DEMIRAJ, SH., *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, SF.3, 1977, fq.117-119
DEMIRAJ SH., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1985,
DEMIRAJ SH., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1985,
DODI A. Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe, SF, 1968 I
DHRIMO A., *Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*, Shtëpia Botuese “Libri Universitar”, Tiranë 1996.
Gramatika e gjuhës shqipe 1. 2002, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë;
Gramatika e gjuhës shqipe. Vëll.1, Red.prof. Sh.Demiraj, Tiranë, 2002
Gramatika e gjuhës shqipe. Vëll.2, Red. nga M.Domi, Tiranë, 2002
Fonetika dhe Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, II, 1976, fq.234
HYSA E. Rreth përdorimeve të së pakryesrës së dëftores në gjuhën shqipe, Sf, 1975, 3
ISMAJLI B. Shumësia e tekstit, 1977
LAFE E. *Përsëritja si mjet gramatikor i shprehjes së aspektit dhe shkallës sipërore në gjuhën shqipe, e parë edhe në krahasim me rumanishten*, SF, Tiranë 1966, 4
SADIKU Z. Transponimi i kuptimeve aspekto-kohore të kohës së tashme, përmbledhje punimesh. VII, 1971
SADIKU Z. Funksionet semantiko-kohore, aspektuale dhe modale të imperfektit të gjuhës shqipe. – Gjurmime albanologjike, seria e shkencave filologjike, 1974, 4
SADIKU Z. Funksionet semantike te trajtave pluskuamperfektore të gjuhës shqipe, Gjurmime albanologjike, seria e shkencave filologjike, 1976, 6
SADIKU Z. Funksionet semantike kohoro-aspektore të aoristit të gjuhës shqipe. Gjurmime albanologjike, seria e shkencave filologjike, 1977, 7
XHELILI A. Vështrim mbi disa përdorime të formave foljore të së shkuarës të aspektit të kryer të gjuhës ruse, të ballafaquara me shqipen,
TOTONI M., “Konstrukte me folje aspektore të fillimit të veprimit në gjuhën shqipe, SF.1, 1968

XHELILI A. *Sistemi aspektoro-kohor i gjuhës ruse, vështruar në përfaqje me gjuhën shqipe*” (Autoreferat, Tiranë, 1983).

Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrar shqipe (botim i Akademisë së Shkencave, 1976);

ILO DILO SHEPERI, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, 2009, fq. 75.

Gjuha letrare shqipe për të gjithë, SHBLSH, 1976

KRISTOFORIDHI K., *Grammatiki tis alvanikis glosis*, Konstandinopojë, 1882;

TOPALLI, K. 2010, *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Tiranë;

RIZA, S. 1994, *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë;

BIBLIOGRAFIA NË GJUHË TË HUAJ:

AGREL S. *O способах действия польского глагола // Вопросы глагольного вида*. М., 1962.

АВИЛОВА Н. С., *Вид глагола и семантика глагольного слова*. Москва, 1976

BASHA N., XHELILI A., *Sovremennij russkij jazik*, Morfollogia II, 1981

БРОЙ В. *Семантика глагольного вида как отвлечение от предельных свойств лексем*, Семантика и структура славянского вида. Kraków, 1997.

БРОЙ В. *Сопоставление славянского глагольного вида и вида романского типа (аорист: имперфект: перфект) на основе взаимодействия с лексикой*. – Типология вида: проблемы, поиски, решения. М., 1998

БОНДАРКО А. В., *Принципы функциональной грамматики и вопросы аспектологии*. Изд-е 4-е. М.: Изд-во ЛКИ, 2007.

БОНДАРКО А. В., 2002, *Teoria znachenija v sisteme funkcionalnoy grammatiki*, Rossiskaja Akademija Nauk, Institut Lingvističeskikh issledovanij, Moskva;

БОНДАРКО А. В. *Вид и время русского глагола (значение и употребление)*. - М., 1971

БОНДАРКО А. В., *Теория функциональной грамматики*, 1987;

БОНДАРКО А.В. *Темпоральность, Теория функциональной грамматики: Темпоральность. Модальность*, redaktuar nga A.V. Bondarko - Л.: Наука, 1990 - 264

БОНДАРКО А. В. *Проблемы грамматической семантики и русской аспектологии*. - СПб., 1996

БОНДАРКО А. В., Bullanin LI. LI. 1967 “*Russkij gllagoll*”, L.,Просвещение, 1967,

БОНДАРКО А. В. *Teoria funkcionalnoy grammatiki. Vyjedenie v Aspektualnost’. Vremenaya Lokalizovanost’*. Taksis. L., 1987,

БОНДАРКО А. В., *Грамматическая категория и контекст*, Л.1971, 82.

БОНДАРКО А. В. *Принципы функциональной грамматики и вопросы аспектологии*. - М.: УРСС, 2001.

Brugman A. und Delbrück K. *Grundriss der vergleichenden Grammatik der indogermanischen Sprachen*. Strassburg, 1913,

- ВАСИЛЬЕВ Л.М. *Современная лингвистическая семантика: Учебное пособие для вузов* - М., Высшая школа, 1990 – 176;
- ВАХЕК И. “*Пражские исследования в области структурной грамматики на современном этапе*”, Сборник статей, (Москва, 1967),
- ВИНОГРАДОВ В.В. *Русский язык. Грамматическое учение о слове.* - М.: Высшая школа, 1972 - 616 fq. (botimi i parë 1947).
- ВЕЖБИЦКА А. *Семантические универсалии и описание языков.* М., 1999.
- ВСЕВОЛОДОВА М.В., *Поля, категории и концепты в грамматической системе языка*, Вопросы языкознания, 2009, № 3.
- VENDLER Z. 1967, *Verbs and Times* //Vendler Z. *Linguistics in Philosophy.*N.Y.: Ithaca;
- GUILLAUME G. *Immanence et transcendence dans la categorie du verbe* // GUILLAUME G. *Langage et science du langage.* 3-e ed. P., 1973.
- ГЕРАСИМЕНКО В.Г. *Роль видо- временных форм в организации различных типов текста.* Филол.наука - 1991 - 5 - fq. 106 - 111.
- ГЛОВИНСКАЯ М.Я. *Семантика, прагматика и стилистика видо - временных форм*, Грамматические исследования. Функционально - стилистический аспект: *Грамматика русского языка.* Том 1. Фонетика и морфология. Ред. коллегия В.В. *Грамматика.* Русская грамматика. М., 1980.
- Грамматическое значение и смысл.* Л., 1978.
- ГЭРЕЙ Г. Б. *Глагольный вид во французском языке* // Вопросы глагольного вида. М., 1962
- ГИРО-ВЕБЕР М. *Вид и семантика русского глагола* / ВЯ, 1990, №2 , fq.102-112.
- ГОРБОВ А.А. *Сопоставительный анализ аспектуальных значений глаголов в текстах русской драматургии и их переводах на немецкий язык:* Автореф. канд. дис. СПб., 1994.
- ГОРБОВ А.А. *О понятии «способ действия» и его отношении к аспектуальности*, Язык и речевая деятельность. Т. 1. 1998.
- ГОРБОВА Е.В. *Сопоставительный анализ категорий поля аспектуальности в русском и испанском языках и их речевой реализации:* Канд. дис. СПб., 1996.
- ГОРБОВА Е.В. *Опыт разработки универсальной классификации характеров глагольного действия*, Материалы XXVIII межвузовской научно-методической конференции преподавателей и аспирантов. Вып. 16. Секция общего языкознания: В 2 ч. Ч.1. СПб., 1999.
- ГУХМАН М.М., *Понятийные категории, языковые универсалии и типология*, Вопросы языкознания, 1985, №3., И.И. Мещанинов, *Понятийные категории в языке*, Труды Военного института иностранных языков, 1945 №1.
- ДЕСНИЦКАЯ А.В. *О морфологической структуре албанского языка*, ВЯ, Москва, 1958, 5.
- DUCHÂSES O. “*Sur le problème de l'aspect et du caractère de l'action verbale en français*”, *Le Français modern*, 1966., № 3. - P. 161-184.

- ДОБРОМЫСЛОВ В.А., РОЗЕНТАЛЬ Д.Э. *Трудные вопросы грамматики и правописания.* Пособие для учителей. Под ред. А.Б. Шапиро - М., 1955 - 288 с.
- ЕЈНТРЕЈ, G.I., *K voprosu o vido-vremennih odnoshenijah v sisteme allbanskogo jazika në "Grammaticeskij stroj ballkanskijh jazikov"*, 1976
- ЕРЗИНҚЯН Е. Л., *Дейктическая семантика слова*, 1988, 73.
- ЗАЛИЗНЯК АННА А., ШМЕЛЕВ А. Д. *Введение в русскую аспектологию.* М., 2000
- ЗВЯГИНЦЕВ В. *Структурно-семантические и прагматические характеристики восклицательных предложений в английской диалогической речи*, 1977,
- ИСАЧЕНКО А. В. *Грамматический строй русского языка в сопоставлении с словацким.* Ч. II: Морфология, Братислава, 1960.
- ИВАНОВА И.П. *Вид и время в современном английском языке.* -Л.: Изд-во Ленинград, 1961.
- НГУЕН ВАН ТХАНЬ. *Номинативные и синтагматические значения русских глаголов и система видо - временных форм*, Русский язык в школе – 1987
- КАЦНЕЛЬСОН С. Д., *Типология языков и речевое мышление.* Л., 1972,
- КАШКИН В.Б., *Перфект как субъективное время*, Вестник ЛГУ, 1983, № 20 (серия истории языка, литературы, вып. 4).
- КАШКИН В.Б. *Функциональная типология перфекта.* Воронеж, 1991
- КАРОЛЯК С. *Понятийная и видовая структура глагола // Семантика и структура славянского вида: В 2 ч. Ч. I.* Kraków, 1995.
- КЛИМОНОВ В. Д. *Аспектуальные классы и их грамматическая семантика // Семантика и структура славянского вида: В 2 ч. Ч. II.* Kraków, 1997.
- КРАСУХИН К.Г. *Движение на оси времени и глагольное время.* Вопросы филологии - 2000 - 1 - fq.5 - 12.
- КНЈАЗЕВ Ј.Р., *Nastojachee vrjetnja: semantika i pragmatika. Llogicheskij analiz jazika. Jazik i vrjetnja.* Moskva, 1977
- КУКУШКИНА О.В., Ремнева М.Л. Категория вида и времени русского глагола - М., 1984.
- KURYŁOWICZ J. *The inflectional categories of Indo-European.* — Heidelberg: Carl Einter, 1964.
- KOSHEVAJA I.G., *Tipologicheskie strukturi jazika*, 1972, fq.41
- КУЦАРОВ ИВ., *Категория на таксис на съвременния български език.* Доклады от международен конгрес по българистика, V. 3, Съвременен български език, София, 1987.
- ЛОПАТИН В.В., Милославский И.Г. Современный русский язык. Теоретический курс. Словообразование. Морфология. Под ред В.В. Иванова - М., 1989;
- MATHESIUS V. *Obsahový rozbor současné angličtiny na základě obecně lingvistickém.* Nakladatelství, ČSAV. Praha 1961.
- МАСЛОВ Ю.С. Введение в языкознание: Учебник для филол. спец. вузов - М., 1998;
- МАСЛОВ Ю.С. *Sistema chastnih vidovih znachenij i tipi protivopostavlenij sovershennogo i nesovershennogo vida // Masllov J.S. Oчерки по aspektologii. I*, 1984, fq.72-74.

- Русская грамматика*, М. 1980, etj.
- МАСЛОВ Ю.С. *Очерки по аспектологии*. -Л.: Изд-во Ленинград. ун-та, 1984.
- МАСЛОВ Ю.С. *Вид и лексическое значение глагола в современном русском литературном языке*, *Очерки по аспектологии*. Л., 1984.
- МАСЛОВ Ю.С. *Вопросы глагольного вида в современном зарубежном языкознании*, *Вопросы глагольного вида*. М., 1962.
- МАСЛОВ Ю.С. *Система основных понятий и терминов славянской аспектологии*, *Вопросы общего языкознания*. Л., 1965.
- МАСЛОВ Ю.С. *К основаниям сопоставительной аспектологии*, *Вопросы сопоставительной аспектологии*. Л., 1978.
- МАСЛОВ Ю.С. *Очерки по аспектологии*. Л., 1984.
- МАСЛОВ Ю.С., *Избранные труды, Аспектология*, М. 2004, fq. 37-38.
- МЕЛИГ Х. Семантика предложения и семантика вида в русском языке, *Новое в зарубежной лингвистике*. 1985;
- МЕЙЕ А. *Введение в сравнительное изучение индоевропейских языков*. — М.: Издательство ЛКИ, 2007
- МУРЯСОВ Р.З. Некоторые проблемы контрастивной аспектологии, *Вопросы языкознания*, 2001, №5.
- МЕЩАНИНОВ И. И., *Глагол* -Л.: Наука, 1982;
- МИГИРИН В.Н., *Язык как система категорий отображения*, М. 1972
- MIKLOSICH F. *Vergleichende Grammatik der slavischen Sprachen*, Wien, 1883
- МИЛОСЛАВСКИЙ И.Г. *Морфологические категории современного русского языка: Учебное пособие*. - М.: Просвещение, 1981;
- МИЛЛЕР ДЖ.Э. *Типология и варианты языка: английский перфект*. – В кн.: *Типология вида: проблемы, поиски, решения*. М., 1998
- МУЧНИК И.П. *Грамматические категории глагола и имени в современном русском литературном языке* - М., Наука, 1971
- НЕДЯЛКОВ В.П. (ред.). *Типология результативных конструкций: результатив, стив, пассив, перфект*. Л., 1983
- РАЗМУСЕН Л. *О глагольных временах и об отношении их к видам в русском, немецком и французском языках*. — Журнал министерства народного просвещения, 1891. № 6.
- ПЕНЧЕВ Й., *Време, таксис, синтаксис*. Български език, 1985, № 6, fq. 223-228.
- ПЕРЕЛЬМУТЕР И. А., *К становлению категории времени в системе индоевропейского глагола*, *Вопросы языкознания*. — 1969. — № 5.
- ПЕРЦОВ Н.В. *К проблеме инварианта грамматического значения*. 1. (Глагольное время в русском языке), *Вопросы языкознания* - 1998 1 fq. 3 - 27.
- ПЕШКОВСКИЙ А. М. *Русский синтаксис в научном освещении*, М. 1956
- ПЛУНГЯН В.А. *Общая морфология: введение в проблематику*. М., 2000

- ПОСПЕЛОВ Н.С. *Прямое и относительное употребление форм настоящего и будущего времени глагола в современном русском языке* // Исследования по грамматике русского литературного языка. Сборник статей. - М., 1955 – 356 fq.
- FIEDLER W. *Zur kategorie der Aspekts in dem Balkansprachen*, Zeitschrift für Slaëistik, Bd. XV. Heft 1, 1970.
- Современный русский язык / Под ред. В.А. Белошапковой. - М., 1989 - 800с.
- Современный русский язык. Ч.2. Морфология. Синтаксис, redaktuar nga E.M. Галкина Федорук, shtepia botuese МГУ, 1964.
- Современный русский язык. Анализ языковых единиц me tri pjese, pj. 2, Л.Д. ЧЕСНОКОВА, В.С. ПЕЧНИКОВА. Морфология /Redaktuar nga E.I. Диброва - М., 1995;
- Современный русский язык в таблицах и схемах. Ч.3. Учебное пособие. / Р.С. Астрина, А.М. Дмитриева, Л.Г. Коротаева и др. - М., 1985 - 256с.
- Современный русский язык: Учебник для студентов, ред. П.А. Леканта - М., 2000
- Современный русский язык, Под ред. Н.М. Шанского, В.В. Иванова - М., 1987;
- COMRIE, B. 1976. *Aspect: An introduction to the study of verbal aspect and related problems*, Cambridge University Press, Cambridge;
- СУСОВ И.П., *Введение в теоретическое языкознание*, Электронный учебник в формате Doc. Тверской государственной университет, 2000.
- СМИРНИЦКИЙ А.И. Синтаксис английского языка.-М.: Изд-во лит-ры на иностр. яз., 1957.
- СМИРНИЦКИЙ А.И. Морфология английского языка. -М., 1959.
- ХРАКОВСКИЙ, В.С., *Некоторые проблемы универсально-типологической характеристики аспектуальных значений. Аспектуальность и средства ее выражения*. Вопросы русской аспектологии V. Тарту, 1980.
- ШЕЛЯКИН М.А., *Категория вида и способы действия русского глагола (Теоретические основы)*. Таллинн, 1983.
- ШЕЛЯКИН, М. А., *Способы действия в поле лимитативности*
- ТЕЛИН Н.Б., *О системном статусе перфектного значения в функциональной грамматике*, Язык: система и функционирование. М., 1988. fq. 236-249.
- ТЕЛИН Н.Б., *Познание, перспектива и метафора времени*, Типология вида. М., 1998, fq. 430-443
- THELIN, NILS B., 1980 “Aspekt und Aktionalität im Russischen”, *Die Welt der Slawen, Halbjahresschrift für Slaëistik*, XXV, 2; N. F. IV, 2, f.428—440. Verlag Otto Sagner, München;
- ТРОНСКИЙ И. М., *Общеиндоевропейское языковое состояние*. — М.: УРСС, 2004
- F.DE SAUSSURE, *Cours de linguistique gënerale*, 1967, fq.162
- СТЕПАНОВ Ю.С., *Основы общего языкознания*, М. 2001
- ЯКОБСОН Р. *Значение лингвистических универсалий для языкознания* // История языкознания XIX и XX веков в очерках и извлечениях. М., 1965, ч. II. Фр. Данеш,
- ЯКОБСОН Р.О., *Шифтеры, глагольные категории и русский глагол*, Принципы типологического анализа языков различного строя. М., 1972, fq. 99.

ЯРЦЕВА В.Н. «Длительные времена» и проблема вида в английском глаголе//Ученые записки ЛГУ. 1940. №58. Вып. 5.

JESPERSEN O., “*Fillosofia grammatiki*”, përkthim nga anglishtja, M. 2002

WHORF B. L., *Language, thought and reality / Selected Writings of Benjamin Lee Whorf / ed. by J. B. Carrol. Cambridge, MA, 1956.*

HEYSE K., *System der Sprach Wissenschaft.* – Berlin, 1856.

I. TRIER, *Sprachliche Felder-Zeitschrift für deutsche Bildung. Vol. 1. – Heidelberg, 1932.* (Cituar sipas С.И. Дружинина, *Функционально-семантическое поле как новый метод целостного грамматического описания языковых явлений*, Филологические науки, 2007, Vol. 12).

Fortson B. *Indo-European language and culture. An Introduction.* — Padstow: Blackwell Publishing, 2004

COMRIE B. *Aspect: An Introduction to the Study of Verbal Aspect and Related Problems.* Cambridge, 1976.

VENDLER Z. *Verbs and Times // Linguistics in Philosophy.* Ithaca; New York, 1967.

FJALORË:

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (1973) *Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe.* Tiranë.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (2002) *Fjalor i Shqipes së Sotme*, Botimet Toena, Tiranë.

Ефремова Т.Ф., Костомаров В.Г. Словарь грамматических трудностей русского языка. - М., 1986 – 411fq.

Краткий справочник по современному русскому языку / Л.Л. Косаткин, Е.В. Клобуков, П.А. Лекант; Под ред. П.А. Леканта. - М., 1991 – 383fq.

Лингвистический энциклопедический словарь // Гл. ред. В.Н. Ярцева. - М., 1990;

Русский язык. Энциклопедия / Гл. ред. Ю.Н. Караулов. - М., 1997 – 703fq.

Языкознание. Большой энциклопедический словарь, ред. В.Н. Ярцева - М., 1998;